

HALIL MYRTO

**KËRKIME ARKEOLOGJIKE
DHE HISTORIKE**

(Përmbledhje artikujsh shkencorë)

Përzgjedhi për botim, Afrim HOTI

Botimet Jozef, 2025

KËRKIME ARKEOLOGJIKE DHE HISTORIKE
(Përmbledhje artikujsh shkencorë)

Punuar nga Halil MYRTO

Përzgjedhi për botim: Afrim HOTI

Redaktor shkencor: Afrim HOTI

Përgatiti për shtyp: Muzeu Arkeologjik Durrës
Nën kujdesin e Alban Ramohitaj

©: Muzeu Arkeologjik, Durrës

Në kopertinën e parë:
Altar i një ambjenti kulti, fundi i shek.IV para Kr.

Në kopertinën e dytë: Bazilika në Gjericaj (Shek.VI)

Botimet Jozef, 2025

ISBN: 978-9928-940-56-8



Halil MYRTO
(1935-2002)

PËRMBAJTJA (CONTENU)

Parathënie (<i>Préface</i>)	7
I. ARTIKUJ (<i>ARTICLES</i>).....	15
Probleme nga historia më e herëshme e Durrësit (<i>Problemes de l'histoire antique de Durres</i>)	17
Un luogo di culto con altare a gradini a Durazzo	44
Një sanktuar antik në periferi të Durrësit (<i>Un sanctuaire antique dans les environs de Durrës</i>)	75
Të dhëna mbi shtrirjen e Dyrrahut në pjesën jugperëndimore të Kënetës (<i>Donnees sur l'etendue de Durrachium dans la partie sud-occidentale du marais</i>)	111
Monedha perandorake bizantine nga Durrësi (491-1025) (<i>Monnaies imperiales byzantines provenant de Dyrrachium - 401-1025</i>)	151
Konsiderata mbi obeliskun e Apolonisë (<i>Considerations sur un obelisque a Apollonie</i>)	197
II. MATERIALE (<i>MATÉRIALES</i>).....	209
Dy varëse bronzi të kohës së hekurit (<i>Deux pendentifs de bronze de l'âge de Fer</i>)	211
Një varrezë antike në fshatin Vrrin (<i>Un cimetière antique dans le village de Vrrin</i>).....	213
Mbi disa qendra arkeologjike ndërmjet Kavajës dhe Durrësit. (<i>A propos de certains centres archéologiques situés entre Kavaja et Durrës</i>)	232
Hartë e monumenteve dhe e gjurmëve antike e mesjetare të rrethit të Durrësit I (<i>Carte des monuments de la région de Durrës I</i>)	255
Hartë e monumenteve dhe e gjurmëve antike e mesjetare të rrethit të Durrësit II (<i>Carte des monuments de la région de Durrës II</i>)	309

III. RAPORTE GËRMIMESH (<i>RAPPORTES DE FOUILLES</i>).....	383
Gërmimet arkeologjike të vitit 1984 - Durrës Kënetë	385
Gërmimet arkeologjike të vitit 1986 - Durrës-Kënetë.....	387
Gërmimet arkeologjike të vitit 1987 - Durrës – qytet.....	390
Gërmimet arkeologjike të vitit 1988 - Gjuricaj, Shkëmbi i Kavajës (Durrës)	393
Gërmimet arkeologjike të vitit 1989 - Gjuricaj (Durrës).....	396
Gërmimet arkeologjike të vitit 1990 - Gjuricaj-Ishëm (Durrës).....	399

PARATHËNIE

Më 20 mars 2025 është dita e 90-vjetorit të lindjes së prof. dr. Halil Myrtos, një intelektual energjik, që ka lënë pas një varg punimesh të botuara në shtypin shkencor të vendit dhe të huaj.

Kam pasur privilegjin, që për afro një dekadë (1981-1990), të bashkëpunoj, në Muzeun Arkeologjik të Durrësit, me prof. Halil Myrton. E përfytyroj gjithnjë si një koleg të palodhshëm që, edhe pse nuk gëzoi një jetëgjatësi normale, solli kontribute me vlerë në lëmin e shkencës.

Halil Myrto u lind në Markat të Konispolit, më 20 mars 1935. Pasi mbaroi Shkollën Pedagogjike në Tiranë, më 1954, ndoqi Fakultetin Filologji-Histori të Universitetit Shtetëror të Tiranës, që e përfundoi me sukses më 1960.

Aktiviteti në lëmin e arsimit shfaqet në kohën kur punon si mësimdhënës i letërsisë dhe i historisë në shkollat e rretheve Sarandë, Tepelenë (1952-1955) dhe të rrethit të Durrësit (1955-1968), ku, për pesë vite, ishte edhe drejtor shkolle.

Por, goditjet për motive politike, pushimet e pa drejta nga puna, e detyruan të përballojë një betejë të gjatë përpjekjesh për mbijetesë. Kështu më 1968 filloi kalvari i përvuajtjeve duke e dëbuar, jo vetëm nga arsimi dhe shkolla, por edhe familjarisht, nga qyteti. Për disa vite e detyruan të punojë si punëtor, derisa më 1971, filloi si punonjës i thjeshtë dhe asistent-arkeolog në

Muzeun e Durrësit. Më 1975, sërish u pushua nga puna për të njejtat motive. Më pas e rikthyen dhe nga viti 1978 e në vazhdim, deri më 1991, punoi pa ndërprerje në Muzeun Arkeologjik Durrës. Gjatë kësaj periudhe u shqua për integritetin personal dhe këtë e demonstronte si profesionist e krijues virtuozy. Për këto arsye, iu dha e drejta për të kryer gërmime arkeologjike dhe të botonte në revistat akademike. Më 1990, mbrojti tezën: "Periferia dhe prapatoka e Durrësit në antikitet" dhe mori titullin "Kandidat i Shkencave" që, më pas, u barazvlerësua nga Këshilli i Ministrave me gradën shkencore "Doktor". Ndërsa, pak vite më vonë, iu akordua titulli "Profesor".

Veprimtaria e tij kërkimore reflekton përmasa të gjera të nivelit, në shkallë të lartë. Do të mjaftonte fakti që, tridhjetë vite më parë, ai shkruan artikullin: "Probleme nga historia më e herëshme e Durrësit", (Botuar në studime Historike 2, 1986), për ta quajtur atë një historian të mirëfilltë; po kështu do të mjaftonte fakti i dytë i botimit të veprës: "Bibliografi e Qendrave Antike të Shqipërisë" (Botuar në italisht, në Leçe, më 1998), për ta renditur atë ndër bibliografët me zë në Itali e më gjerë. Por, nuk do të lëmë pa përmendur, si arritje të tretë, faktin se, ka qenë kazma e arkeologut Myrto që ka zbuluar dy vepra të arkitekturës antike: Altarin e Kënetës (sot ekspozuar në oborrin e Muzeut Arkeologjik Durrës) dhe Bazilikën e Gjericajt në Ishëm, momumente këto, që mbajnë autorësinë e tij.

Një dhunti e veçantë ishte përvetësimi, njohja dhe përdorimi aktiv i gjuhëve të huaja: anglisht, frëngjisht, italisht dhe pak greqisht. Literatura e parë, nga gjuha anglishte në shqip, u publikua nga Shtëpia Botuese "Naim Frashëri" më 1965. Që nga

viti 1971 e në vijim, ka përkthyer nga anglishtja një numër artikujsh dhe vepra shkencore për arkeologjinë. Përkthimet zenë vend në Arkivin e Bibliotekës së Institutit të Arkeologjisë dhe në atë të Bibliotekës së Institutit të Monumenteve.

Ai u shqua si një trajnues pasionant për përgatitjen e brezit të ri dhe si përpunues i krijimtarisë shkencore popullore.

Për disa vite, drejtoi në Shtëpinë e Pionierit, (Sot Qendra kulturore e Fëmijëve), Rrethin e Arkeologjisë, duke transmetuar te nxënësit pasionin e bukur të arkeologut. Nëpërmjet një programi të pasur trajnues botoi broshurën "Fjala e Monumenteve", me tekste dhe ilustrime mbi zbulimet arkeologjike dhe monumentet në rrethin e Durrësit

Prof. Myrto ka bashkëpunuar për divulgim temash nga arkeologjia e nga historia antike, edhe me organe të shtypit ("Adriatiku", "Pionieri", "Horizonti", "Shkenca dhe Jeta"), si dhe me Radion e Televizionin shqiptar.

Ndryshimet e viteve '90, në jetën e vendit tonë, ndikuan drejtpërsëdrejti për pozicionimin e tij në përshtatje me rrethanat e reja politike.

Në kapërcyell të viteve 1990-1991, ishte ndër anëtarët e parë të Komitetit Themelues të Degës së Partisë Demokratike në rrethin e Durrësit dhe anëtar i Shoqatës të ish të dënuarve dhe të persekutuarve politikë, që në themelimin e saj. Por, në mars të vitit 1991, u shkëput shpejt, heq dorë nga veprimtaria politike dhe u shpërngul në Itali, në qytetin e Leçes, ku jetoi e punoi së bashku me familjen, gruan dhe dy vajzat.

Sapo mbërriti në Itali, bashkëpunoi me Organizatën Jo-qeveritare CTM të Leçes, në mbledhjen e ndihmave ekonomike për Shqipërinë, ndërkohë që drejtoi gazetën dhe më pas revistën dygjuhëshe “Përtej Detit” (1991-1996), që trajtonte probleme të emigrantëve shqiptarë në Itali

Më pas, inkadrohet tërësisht në jetën shkencore dhe kulturore italiane. Kjo shihet në pjesëmarrjet në dhjetra konferenca, kongrese dhe seminare shkencore, ku ai trajton një seri çështjesh lidhur me historinë e kulturën e popullit shqiptar.

Ndihmesë të çmuar ai dha edhe si anëtar i Shoqatës së ish të dënuarve dhe të persektuarve politikë të diasporës shqiptare me qendër në Bruksel. E po kështu, edhe si anëtar i Shoqatës së Historianëve Shqiptarë të Diasporës me qendër po në Bruksel.

Duke u integruar thellësisht në punën kërkimore shkencore, gjatë viteve 1991 -1995, u angazhua si bashkëpunëtor i jashtëm në Universitetin e Leçes, në atë të Kozenzës si dhe në disa institucione të tjera italiane.

Në vitet 1991-1992, për qytetarët leçezë drejtoi vullnetarisht, një kurs të gjuhës shqipe, çka u bë shembull për inkurajimin e hapjes së Katedrës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe pranë Universitetit të Leçes, në vitin akademik 1992-1993.

Gjatë viteve 1995-2000, punoi si lektor i gjuhës shqipe pranë Katedrës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Leçes; ndërkohë që u angazhua si bashkëpunëtor dhe ekspert lingistik i gjuhës mëmë.

Përgjatë viteve 1991-1994, ka kryer hulumtime kërkimore për evidentimin e raporteve midis dy brigjeve të Kanalit të

Otrantos në antikitet, duke vështruar edhe konkordancat leksikore e lidhje të tjera gjatë mesjetës, studime këto, të botuara në disa revista akademike të Leçes, Kozencës dhe në Greqi: “Studi di Antichita”, “Studi Linguistici Salentini”, “Miscellanea Franciscana Salentina”, “Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell’ Università della Calabria”, ΜΠΕΣΣ Α, etj.

Nga një përmbledhje rreth veprimtarisë së prof. Myrtos rezulton se ajo është thellësisht akademike dhe publicistike. Në auditorët italiane ka shtjelluar një problematikë të larmishme dhe të mprehtë të shoqërisë shqiptare në vitet 1991-1995. Ai është ftuar dhe ka marrë pjesë me kumtesa ose diskutime në Kongreset dhe Seminaret ndërkombëtare ku figuron si ligjerues në:

-Kongresin Ndërkombëtar pranë Universitetit të Trentos: “I giovani non europei ed il processo d'integrazione”, 11-12 tetor 1991.

-Seminarin Ndërkombëtar mbi gjuhën dhe kulturën shqiptare në Universitetin e Kalabrisë, 10.6.1994 (kumtesë: “Le credenze popolari albanesi sulle vette dei monti”, botuar më 1997).

-Kongresin Ndërkombëtar mbi gjuhën dhe letërsinë shqiptare, në Universitetin e Kozencës, (nëntor 1994).

- Kongresin Ndërkombëtar “Mediterranea People and Commonwealth Nations”, në Stilo të Kalabrisë, 13-14 tetor 1995 (kumtesë: “The Albanians in Canada”, botuar më 1995).

-Seminarin mbi shkëmbimet kulturore Itali-Shqipëri, Lecce-Corigliano Calabro, 24-28 tetor 1995 (diskutim në italisht)

- Seminarin kulturor, organizuar nga Departamenti i Shken-
cave Historike, Filozofike e Gjeografike të Universitetit të Leçës,
në Kopertino, më 9 korrik 1997, (kumtesë në italisht),

- Seminarin Ndërkombëtar me temë: "Questione arbëreshe
dall'identità all futuro" San Marzano 29-30 nëntor 1997, (kum-
tesë: "Testimonianze storiche e linguistiche degli Arbëreshë di
S. Marciano e del Salento")

- Seminarin e III Ndërkombëtar i Studimëve Shqiptare, orga-
nizuar nga Universiteti Kalabrisë, 19-21 dhjetor 1997 (kumtesë:
"Testimonianze dell 'antropinimiu albanese nel Salento").

- Kongresin Ndërkombëtar me temën "Minoranze linguisliche
in Calabria (proposta per la difesa di identità etnico-culturali
neglette", organizuar nga Universiteti i Mesinës, Locri 5-7
qershor 1998, (kumtesë: La presenza dell Arbëresh e l'influenza
dell'Albanese moderno nel Salento: storia e attualità)

- Kongresin Ndërkombëtar me temë: "Memoria e diaspora"
organizuar nga Universiteti i Leçës, 15-19 prill 1999 (kumtesë
në italisht mbi diasporën mesjetare shqiptare në Salento me
hyrje mbi historinë e shtypjes serbe në Kosovë).

Kongresin e organizuar nga LIONS CLUB të Leçës, 14 prill
2000, (kumtesë "Rom: valori autentici da salvare - valori civili
da insegnare"), çmuar me diplomë nga presidentët e klubeve
LIONS të Leçës.

Ligjerata mbi kulturën, historinë dhe zbulimet arkeologjike
në Shqipëri, ka mbajtur gjithashtu në Universitetin e Trentos
(1991), të Padovës (1991), të Kozencës, të Leçës (1991-2000),

si dhe në disa shkolla të mesme të provincave: Lece, Brindisi, Taranto, në Bibliotekën komunale të Estes (Padova), etj.

Në revista shkencore brenda e jashtë vendit ka publikuar mbi 30 tituj me artikuj të ndryshëm. Ai është autor i veprës kryesore: “Bibliografi e Qendrave antike të Shqipërisë” (Albania archeologica: Bibliografia sistematica dei centri antichi), botuar në italisht nga shtëpia botuese “Edipulia”, më 1998). Kjo vepër vlerësohet ndër punimet e një gjinie të veçantë në lëmin e punimeve albanologjike.

Punime të tjera të rëndësishme janë edhe vëllimet: Albanesi alla Porta, (Manni Editori, 1991); “Parlo albanese: corso base di lingua albanese”, (Adriatica Editrice Salentina, 2000).

Halili po mbush gati një çerek shekulli që është ndarë nga ne. Ai u nda nga jeta më 12 maj 2002, pas një sëmundje të pashërueshme. Studjues të njohur të shkencës italiane kanë vlerësuar veprimtarinë dhe kontributin e tij. Kështu, prof. Francesco D’Andria, e vë më mirë në dukje, kur e cilëson Halil Myrton si kolegun e respektuar që ngriti një urë lidhëse midis vendit Apenin dhe Shqipërisë.

Falë vlerave të spikatura profesionale ai është vlerësuar nga Këshilli Bashkiak i Durrësit, me emërtimin e një rruge të qytetit, me emrin: “Prof. Halil MYRTO”.

Ky ishte Halil Myrto, Bir i shquar i Çamërisë, një nga intelektualët e shquar të Durrësit dhe studjues i pasionuar në fushën e kulturës.

Në kujtim të veprës po publikojmë një pjesë të punimeve, me përmbledhje artikujsh shkencorë nga fusha e arkeologjisë dhe

historisë, ku ndihmesat e tij janë të shumta. Midis punimeve spikatin: dy artikujt mbi një mjedis kulti antik me altar, zbuluar në periferi të Durrësit (në shqip dhe italisht). Një vlerë të veçantë mbartin artikujt mbi: Hartën e monumenteve dhe gjurmëve antike dhe mesjetare të rrethit të Durrësit (botuar në revistën Monumentet 2, 1981 dhe 1, 1982). Interes paraqesin edhe informacionet për rezultatet e gërmimëve arkeologjike për zbulimin e disa monumenteve arkeologjike në Durrës, Shënavlash, Gjuricaj, Shkëmbi i Kavajës dhe në fshatra të tjerë të rretheve Durrës e Kavajë (botuar në revistën “Iliria”).

Afrim HOTI

I
ARTIKUJ
(*ARTICLES*)

PROBLEME NGA HISTORIA MË E HERËSHME E DURRËSIT¹

Që në lashtësi, historia e Durrësit paraqitet e lidhur jo vetëm me ngjarje që i përkasin vendit të ilirëve të Jugut, por edhe me ngjarje që i përkasin një rrezeje më të gjerë, ballkanike, apo mesdhetare. Në këtë artikull, duke u përpjekur të japim një ndihmesë modeste mbi çka është thënë deri tani, do të diskutojmë dy probleme nga historia më e hershme e këtij qyteti: themelimin e Epidamnit dhe kolonizimin grek, pozita e tij para dhe gjatë Luftës së Peloponezit (431- 404 p.e.re).

Përsa u përket mendimeve të shfaqura vitet e fundit se Epidamni dhe Dyrrahu kanë qenë dy qytete në një largësi të konsiderueshme nga njëri-tjetri², ose dy vendbanime të afërta, por me jetën e tyre të pavarur³, duhet ta themi që në fillim se na duken ende të paargumentuara. Pajtohemi me pikëpamjen e përgjithshme që Epidamnin dhe Dyrrahun i konsideron si të njëjtin qytet, vendi i të cilit është identifikuar me atë të Durrësit të sotëm.⁴

¹ Marrë nga :”Studime Historike” ,2 1986 f.129-146.

² K. Zheku, Epidamni dhe Dyrrahu janë një qytet i vetëm apo dy qytete të ndryshme, Tradita ndërtimore në Shqipëri, Tiranë, 1981, f. 53-61.

³ B. Jubani. Disa çështje mbi binomin Dyrrah-Epidamn, në Materiale të sesionit shkencor arkeologjik Durrës, Durrës, 1983, f. 68-75.

⁴ Shih p.sh. argumentimin e C. Praschniker - A. Schober. Archaologische Forschungen in Albanien und Montenegro, Wien, 1919, f. 36-40.

1. Mbi themelimin e Epidamnit dhe kolonizimin grek

Në historiografinë e sotme zakonisht bëhet fjalë për vendosjen e kolonistëve grekë në Epidamn në vitin 627-626 p.e.s., pa ndonjë interpretim mbi mënyrën e kryerjes së këtij procesi, ose mbi mundësinë e ekzistencës së një qendre banimi në këtë pikë para kolonizimit.⁵ Kjo duket se vjen, nga njëra anë, për shkak të mbështetjes tek njoftimi i kufizuar që jep për këtë çeshtje Tukididi, si autori më i besuar, dhe nga ana tjetër, për shkak të mungesës së të dhënave arkeologjike. Megjithatë ka pasur në të kaluarën, ka edhe sot përpjekje që, bazuar dhe në burime të tjera, e kapërcejnë këtë ngurrim. Po ashtu, vitet e fundit janë shtuar edhe të dhënat arkeologjike. Këto të dhëna për Durrësin para e protohistorik deri më sot përbëhen, në fakt, kryesisht nga gjetje rasti. Brenda në qytet janë gjetur dy çekanë guri të lëmuar dhe me brimë në mes⁶, që datohen në epokën e eneolitit dhe në atë të bronzit. Gjetje rasti tipologjikisht të datueshme si të epokës së neolitit dhe të asaj të bronzit, vijnë dhe nga rrethinat.⁷

Për periudhën hershme të hekurit, gjetjet janë më të shumta. Kohët e fundit në Durrës janë zbuluar fragmente qeramike të

⁵ Historia e Shqipërisë I (maket), Tiranë, 1977, f. 61; Shih dhe Les Illyriens. Tirane, 1985, f. 44.

⁶ V. Toçi. Popullsia e Durrhahut në dritën e të dhënave historike-arkeologjike, në Kuvendi I i Studimeve Ilire, Tiranë, 1974, f. 377. Njëri nga çekanët është i pabotuar (ruhet në fondet e muzeut arkeologjik).

⁷ H. Myrto. Hartë e monumenteve dhe e gjurmëve antike e mesjetare të rrethit të Durrësit I, Monumentet, 1981, 2, f. 65, 66, 70 dhe Pjesa II; në Monumentet; 1982; 1, f. 34.

tipit “devollit” të gjysmës së parë të shek. VII p.e.s.⁸ Përveç këtyre, në pika të ndryshme brenda qytetit, si dhe në periferi, është zbuluar qeramikë protokorintike e greko-lindore e shek. VII p.e.s.⁹ Material arkeologjik i shekujve X-VII p.e.s. është gjetur dhe në disa pika në fushën e Erzenit të Poshtëm, si dhe në fushën e Kavajës.¹⁰

Këto gjetje, edhe pse deri tani të rastësishme, vërtetojnë se Durrësi dhe rrethinat e tij kanë qenë të banuara para kolonizimit grek. Këtë përfundim e mbështesin tërthorazi edhe konkluzionet tanimë të njohura, se ka ekzistuar një rrugë detare që lidhte territorin e Shqipërisë me botën egjeane që në epokën e bronzit,¹¹ se rruga kryesore tregtare përmes Ballkanit në atë epokë kalonte në Shqipërinë e Mesme¹² dhe se në brendësi të vendit janë vërtetuar vendbanime paraqytetare që nga periudha e vonë e bronzit e mbrapa dhe protoqytetare që nga shek. VII p.e.s.¹³

Si qendër protoqytetare brenda mjedisit që përfshin bregdetin nga grykëderdhja e Matit deri në atë të Shkumbinit, do të merrej me më tepër gjasi një pikë e tillë siç është Durrësi, që gëzon

⁸ F. Tartari. Gjetje qeramike protoqytetare nga Durrësi. «Adriatiku», 11.10.1985.

⁹ H. Hidri. Gërmime në nekropolin e Dyrrahut-Kodra e Dautës (viti 1977) Iliria, 1983, 1, f. 137 dhe F. Tartari, po aty.

¹⁰ H. Myrto. Hartë... I, f. 65: Dy varëse bronzit të kohës së hekurit. Iliria, 1984, 2, f. 59; A. Hoti. Qendra të reja prehistorike dhe protourbane në rrethin e Durrësit në Materiale të sesionit..., f. 45.

¹¹ F. Piendi. The relations between the territory of Albania and the Aegean World during the bronze age and in the beginning of the iron age, (kumtesë e mbajtur në Kongresin e studimeve egjeane, Sheffield, 1973).

¹² N.G.L. Hammond, Varrime me tuma në Shqipëri dhe probleme të etnogenjenezës, në Kuvendi I..., f. 153.

¹³ N. Ceka. Lindja e jetës qytetare tek ilirët e Jugut, Iliria, 1983, 2, 1. 145.

kushte topografike edhe si liman i mirë, po ashtu edhe për komunikim të lehtë tokësor me zonën përreth. Ndërsa lehtësia e komunikimit me luginën e Shkumbinit dhe me ato të Matit e të Drinit, do ta kthente Durrësin në shërbim të linjave tregtare më të gjata, që i kapërcejnë së tepërmi kufijtë e zonës përreth.

Ky mendim, që nëpërmjet të dhënave të mësipërme vetëm se mund të sugjerohet dhe, arkeologjikisht, sa ka filluar të vërtetohet, gjen më tepër mbështetje nëpërmjet një analize të të dhënave burimore.

Thuhet se në Durrës ka ekzistuar një mbishkrim që ndërtimin e qytetit antik ia dedikon dy heronjve kreteze, Amfionit dhe Zetit, themeluesve mitologjikë të Tebës.¹⁴ Kjo legjendë e mangët dhe e çuditshme siç paraqitet, mbi bazën e të dhënave të deritanishme është vështirë të interpretohet. Megjithatë mendojmë se nuk duhet nënçmuar, për aq sa na kujton kohën e atyre lidhjeve tregtare të botës egjeane me bregdetin tonë, tashmë të vërtetuara.

Më tepër hollësi gjejmë në një traditë tjetër, që në mënyrë më të plotë e riprodhon Apiani: "Mbreti i barbarëve të këtij vendi, Epidamni, ndërtoi pranë detit një qytet dhe e quajti sipas emrit të tij Epidamn. I biri i së bijës së tij, Dyrrahu, të cilin e konsiderojnë se rrjedh nga Poseidoni, ndërtoi pranë qytetit një liman dhe i dha emrin Dyrrah. Me Dyrrahun, në luftën që i bënë të vëllezërit u bashkua Herakliu kur po kthehej nga Erythea, me kusht që të merrte një pjesë të tokës. Prandaj dyrrahasi e quanin Herakliun si themelues të kolonisë dhe pjesëtar në tokë. Thuhet

¹⁴ A. Comnena. Alexias, III, 12 në Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë, 1962, f. 430. Shih dhe L. Heuzey H. Daumet, Mission archéologique de Macedoine, Paris, 1876, f. 100.

se në këtë betejë Herakliu vrau padashur Jonin, të birin e Dyrrahut, dhe se vetë Herakliu e hodhi trupin e të vërrit në det, me qëllim që Joni të bëhej eponim i këtij të fundit."¹⁵

Mendimin se kjo legjendë-mitike është krijuar nga grekët në kohën e kolonizimit¹⁶ e shohim pjesërisht të drejtë. Themi pjesërisht, sepse do ta quanim më tepër të përpunuar prej tyre, mbi një bazë ilire, që e kanë gjetur në vend. Kjo vihet re edhe me një shqyrtim të thjeshtë të saj.

Legjenda e riprodhuar nga Apiani të le përshtypjen se përbëhet nga një version i vjetër dhe një shtesë më e re. Si version fillestar konsiderojmë pjesën që bën fjalë për një mbret vendas, dinast ndoshta, që ndërton pranë detit një qytet, siç duket një kështjellë, një akropol. Deri këtu ky version duket origjinal, ndryshe nga shumica e legjendave të lashta që themelimin e kolonive greke, apo të qyteteve antike, e lidhin me epokën heroike të Luftës së Trojës, apo me ndonjë epokë më të herëshme.¹⁷ Po ashtu, karakteristikë është se qyteti fillestar këtu i dedikohet jo një hyjnie apo heroi, por një të vdekshmi. Vetëm ndërtimi i limanit më pas lidhet me një hero, Dyrrahun, të birin e hyut të detit.

¹⁵ Apiani. *Bella civilia*, Libri II, 39 në Ilirët dhe Iliria, Tiranë, 1965, f. 260.

¹⁶ N.G.L. Hammond. *A History of Macedonia* 1, Oxford, 1972, f. 4; S.C. Bakhuizen, "Midis ilirëve dhe grekëve, qytetet e Apolonisë dhe të Epidamnit", kumtesë në Kuvendin II të studimeve ilire (Tiranë, 20-22 shtator 1985), "Iliria", 1986, (në shtyp).

¹⁷ S. Byzantini, s.v. Buthrotos, Byllis, në Ilirët dhe..., 1. 417, 418; Pausania, V, 34, në Ilirët dhe..., 1. 246; J. Bérard. *La colonisation grecque de l'Italie Méridionale et de la Sicile dans l'antiquité*, Paris, 1957, f. 7.

Këtë përsërit edhe Stefan Bizantini: "u quajt Epidamn nga Epidamni, vajza e të cilit, Melisa, lindi me Poseidonin djalnin Dyrrah." ¹⁸ Kaq pothuaj përmendin dhe Dion Kasi ¹⁹ dhe Prokopi i Gazës. ²⁰ Fakti që këta autorë nuk shtojnë më tepër se kaq, na e përforcon bindjen për ta konsideruar këtë si version që është njohur më vete edhe në antikitet, pra si pjesën më autentike të legjendës që riprodhon Apiani.

E shtuar më pas duket pjesa që bën fjalë për Herakliun. Mbasi është shpjeguar një herë themelimi i limanit me anën e një heroit vendas, siç është Dyrrahu, përpjekja për ta lidhur këtë themelimin edhe me emrin e një heroit të mitologjisë greke, duket se i përgjigjet një kërkesë të re, që nuk mund të ishte veçse rast themelimi kolonish greke, në Sicili p.sh., që lidhen me luftërat e kolonistëve grekë: janë të njohura të Herakliut për të fituar tokë për pasardhësit e tij, dorët heraklidë. ²¹

Që figura e Herakliut në legjendën tonë është e shtuar më pas, për këtë na vjen në ndihmë dhe kronologjia e brendshme e saj: koha e mbërritjes së Herakliut nuk është as ajo e ndërtimit të kështjellës nga mbreti Epidamn, as ajo e ndërtimit të limanit prej nipit të tij, por një kohë e mëpasme, kur vëllezërit i bëjnë këtij të fundit luftë për zotërimin e qytetit. Këtu duhet vërejtur gjithashtu se Herakliu përzihet në këtë luftë, me kusht që të merrte një pjesë

¹⁸ S. Byzantini. Vep. e përmend., s.v. Dyrrahion, f. 418.

¹⁹ D. Kasi. Historia Romana (fragmenta), Libri XLI, 49, në Ilirët dhe... t. 274.

²⁰ Pr. i Gazës. Panegyricus in imperatorem Anastasium, 2, f. 491-492, në Ilirët dhe..., f. 414.

²¹ M. Giangoulio. Greci e non-greci in Sicilia alla luce dei culti e delle legende di Eracle, në Actes du Colloque de Cortone (24-30 mai), 1981, Roma, 1983, f. 788 e vazhdim.

të tokës dhe, më tej, "dyrrahasit e quanin atë vetëm themelues të kolonisë, jo të qytetit dhe të limanit pranë tij, që ishin themeluar nga Epidamni e Dyrrahu."

Në legjendë, përveç Epidamnit dhe Dyrrahut, përmendet dhe një figurë tjetër e mitologjisë ilire, ajo e Jonit. Fakti që ky i fundit përmendet dhe nga autorë të lashtë si Eskili e Likofroni,²² dëshmon tërthorazi dhe për lashtësinë e dy të parëve. Këto personazhe të mitologjisë ilire sigurisht janë njohur nga grekët pas kolonizimit të Epidamnit, ndërsa emrat e Poseidonit dhe të Melisës kuptohet që janë adoptuar në legjendën vendase nga ana e kolonistëve: për perëndinë e detit është shfaqur mendimi se ilirët kanë pasur një emër të veçantë.²³ Ndërsa emri i Melisës ndoshta jo rastësisht përsërit atë të së shoqes së Periandrit, i cili sundoi në Korint pikërisht në vitet 627-585 p.e.s.²⁴

Le t'u drejtohem tani njoftimeve me karakter të mirëfilltë historik. Tukididi thotë se Epidamnin e kolonizuan korkyrasit dhe të parë bënë Falin, të birin e Eratoklidit nga Korinti, i fisit të Heraklidëve, i cili sipas zakonisht të vjetër u thirr nga qyteti-mëmë. Midis kolonistëve ishin dhe disa korintas, dhe të tjerë nga fisi i dorëve.²⁵

²² Duje Rendić Miočević, *IONIOS TO GENOS IALYPIES*; Adriatica, Zagreb, 1970, 1.350.

²³ H. Ceka. *Bust i mbretit Gent apo figurë e mitologjisë ilire*, Iliria, VI, 1976, f. 142.

²⁴ G. Glotz. *Histoire Grecque*, Tome premier, Paris, 1978, f. 318.

²⁵ Thukididi, në *Ilirët dhe...*, f. 24-29. Kemi pasur në dispozicion veprën e plotë sipas përkthimit frëngjisht nga Ch. Zevor. *Histoire de la Guerre du Peloponnèse*. Paris, Bibliothèque-Charpentier, Eugène Fasquelle éditeur (Më poshtë këtë autor do ta përmendim brenda tekstit).

Shprehja e përdorur këtu Ταύτην ἀπωχισαν μὲν κερχνατοι²⁶ (këtë e kolonizuan korkyrasit) të lë të nënkuptosh se është fjala për një vendbanim të njohur më parë dhe se vetëm e kolonizuan korkyrasit. Ndërsa thënia se u veprua "sipas zakonit të vjetër", na lejon ta shtyjmë dhe më tej arsyetimin: ishte gjithashtu zakon i njohur që kolonive greke u vihej emri i qytetit-mëmë, i një lagjeje të tij, apo i një toponimi tjetër të afërt.²⁷ Por në rastin e Epidamnit nuk kemi një pagëzim të ri; ai përmendet si një toponim që tanimë ekzistonte. Kolonia shihet se nuk merr as emrin e aixidons apo të hyjnisë mbrojtëse.

Një informacion të mirëfilltë historik gjejmë dhe tek Apiani, i cili përveç Tukididit duket se ka pasur në dispozicion dhe ndonjë burim tjetër. Në vazhdim ai thotë: "...pas ca kohe këtë vend dhe qytetin e pushtuan brygët që erdhën nga Frygia, pas këtyre taulantët, fis ilir, dhe pas taulantëve liburnët, tjetër fis ilir, të cilët i grabitnin me anijet e tyre të shpejta... Ata që u dëbuan prej liburnëve, thirrën në ndihmë korkyrasit, të cilët ishin sundues në det dhe i dëbuan liburnët. Pas kësaj korkyrasit përzien me dyrrahasit kolonistët e vet, prandaj limani konsiderohet si helen, kurse emrin e tij korkyrasit e ndryshuan si ugurzi dhe e quajtën Epidamn, sipas emrit të qytetit të sipërm. Edhe Tukididi kështu e quan."²⁸

Për kohën e ngjarjeve të përmendura në këtë dokument janë shfaqur mendime që nuk përputhen. Kështu, Pajakovski i vendos

²⁶ Sipas originalit në Θογκυδιδου Ιστορία; Αθηναίς 1953, I. 21.

²⁷ A. Reinack. në L.Hélenisation du Monde Antiques, Leçons, Paris, 1914. f. 74

²⁸ Ap. vep. e përmend., f. 260-261.

këto ngjarje në fillimin e shek. IV p.e.s.²⁹ Por autorë të tjerë i shtojnë shumë më parë, duke i vendosur pikërisht në kohën e kolonizimit.³⁰ Përpjekjet për marrjen e Epidamnit, siç del nga Apiani, i fillojnë së pari brygët. Prandaj koha e daljes së tyre në bregdetin e Adriatikut do të përbënte dhe kohën e fillimit të këtyre ngjarjeve. Lidhur me këtë kohë janë shfaqur mendime që duhet t'i përkasë fazës së kalimit nga epoka e bronzit në atë të hekurit,³¹ ose shekullit VII p.e.s.³² Kështu, edhe po të marrim për bazë datimin e fundit, ndeshja midis brygëve, taulantëve dhe liburnëve për zotërimin e Epidamnit mund të ketë ndodhur para tri dekadave të fundit të atij shekulli.

Pas përcaktimit të kohës së këtyre ngjarjeve, e thëna e Apianit mund të kuptohet qartë. Taulantët të dëbuar, nga qyteti prej ligurnëve dhe, me sa duket pa forcë detare të mjaftueshme, pranojnë ndihmën që u ofrojnë korkyrasit. të cilët kishin tanimë një shekull që luftonin në Jon e në Adriatik për të thyer të quajturën thalasokraci liburne.³³ Si rezultat i ndihmës, që japin në këtë rast, korkyrasit fitojnë të drejtën për të vendosur në skelën e Dyrrahut kolonistët e tyre, e drejtë kjo që na kujton atë të Herakliut «për t'u bërë pjesëtar në tokë, pasi kish ndihmuar Dyrrahun në luftë kundër vëllezërve të tij.

²⁹ V. Pajakowski. Mbretëria e Bardhyllit, në Kuvendi... f. 335.

³⁰ A Marmora. Istoria di Corfu, Venetia, 1672, f. 33; L. Heuzey, vep. e përmend.. f. 102; N.G.L. Hammond, vep. e përmend. f. 4; V. Toçi. Popullsia ilire.... f. 337.

³¹ N.G.L. Hammond. Varrimet me tuma..., . 160.

³² V. Pajakowski. po aty, f. 334 (që përmend Eugamonin e Kyrenës).

³³ A. Stipčević. Ilirët, Zagreb, 1974, f. 48.

Në këtë mënyrë, po të riprodhojmë skemën e sekuencës së zotëruesve të Epidamnit, do të pranonim në fillim fare një mbret apo dinast vendas, Epidamnin, i cili sipas një njoftimi indirekt duhet të ketë qenë i parthinëve.³⁴ Në shekullin VII p.e.s. për zotërimin e kësaj qendre ndërhyjnë njëri pas tjetrit brygët, taulantët, liburnët dhe përsëri taulantët, këtë herë me ndihmën e korkyrasve. Është ky rasti që u dha mundësi kolonistëve grekë për t'u ngulur në një qendërbanimi të vjetër ilire, pikërisht në një kohë kur në Ilirinë e Jugut ishin pjekur tanimë kushtet ekonomike e shoqërore për marrëdhënie më të gjera me botën greke.

2) Epidamni në pragun e Luftës së Peloponezit

Për periudhën që pasoi ngulimin e kolonistëve grekë në Epidamn të dhënat burimore paraqiten përsëri të kursyera. I vetmi njoftim që kemi është ai i Tukididit; "me kalimin e kohës ky qytet u bë i fuqishëm e me banorë shumë" (po aty). Shumimi i banorëve të Epidamnit nuk mund të jetë arritur veçse mbi bazën e popullsisë së tij fillestare, e përbërë nga vendasit ilirë dhe kolonistët grekë. Nuk dimë të ekzistojë ndonjë e dhënë burimore për valë a grupe të reja kolonistësh.³⁵ Por nuk përjashtohet mundësia e ardhjes së banorëve të rinj nga krahinat e tij të afërta.

Përsa i përket fuqisë ekonomike që arriti Epidamni në dy shekujt e parë pas kolonizimit, kjo kuptohet që pikë së pari i detyrohet tregtisë me krahinat e tjera ilire dhe me metropolet

³⁴ D. Kasi. vep. e përmend., f. 274: Dyrrahu ndodhet në atë tokë e cila u përkiste më përpara ilirëve parthinë.

³⁵ Historia e Shqipërisë... f. 74; Les Illyriens..., f. 46. Shih më poshtë për një përpjekje të pasuksesshme të korintasve.

greke. Këtë e dëshmon fondi pasur i qeramikës korintike e atike në muzeun arkeologjik të Durrësit. Por në Epidamn mori zhvillim edhe zejtaria, si dhe bujqësia në periferinë e tij. Si dëshmi e veprimtarisë në periferi të qytetit, vlen zbulimi i gjurmëve të një tempulli arkaik në këmbët e kodrave të Spitallës³⁶ si dhe i një altari (βωμος) klasik në fushën e kënetës.³⁷

Gjurmët arkeologjike vijnë e shtohen tani, me qeramikë të qytetit e objekte të tjera edhe nga zona fshatare të Durrësit.³⁸ Ndër këto, me rëndësi të veçantë përmendim një relief me mbi-shkrim arkaik kushtuar Herakliut, që është zbuluar në Shijak.³⁹ Ky zbulim flet disi për një nivel të ngritur të zhvillimit kulturor e shoqëror në fshatrat e afërta, për marrëdhënie normale midis tyre dhe qytetit dhe për një aspekt të lidhjeve në fushën e kulteve.

Organizimi shtetëror në Epidamn karakterizohej nga ushtrimi i pushtetit prej kryetarëve të fiseve, fylarhëve, dhe nga ekzistenca e skllavërisë shtetërore: Të gjithë zejtarët ishin skllavër, pronë e përbashkët.⁴⁰

Të dhënat arkeologjike të deritanishme pajtohen në këtë mënyrë me ato burimore se Epidamni në dy shekujt e parë pas kolonizimit ka jetuar një periudhë paqeje dhe qetësie relative, një periudhë mirëkuptimi me botën fshatare përreth, si një qytet i hapët ndaj saj, faktor bazë ky për rritjen dhe begatinë e një

³⁶ M. Zeqo. Dëshmi të artit arkaik në Durrës, kumtesë në Kuvendin II të studimeve lire, Iliria, 1986, 1, (në shtyp).

³⁷ H. Myrto, Germime të vitit 1985 në fushën e kënetës së dikurshme të Durrësit raport në arkivin e Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike Tirane.

³⁸ A. Hoti. Qendra të reja. f. 2-10; H. Myrto, Harte. 111, 1. 24.

³⁹ H. Myrto, po aty, 1, 70,

⁴⁰ Aristoteli. Politika, II, V, në Ilirët dhe..., f. 39.

qyteti. Mirëpo vjen një kohë dhe kjo paqe prishet. Tukididi vijon: "Por thonë se për shkak të grindjeve të brendshme e patën për një kohë të gjatë midis tyre, u shkatërruan në një luftë me barbarët fqinjë dhe e humbën fuqinë e madhe të tyre" (Thuc, po aty).

Prishja e paqes dhe lufta e ilirëve fqinjë kundër Epidamnit, që paraqitet e lidhur edhe me grindjet e brendshme në atë qytet, sigurisht ka pasur motive të forta ekonomike e politike. Duket se në një fazë të caktuar qyteti është veçuar prej krahinave përreth; ai nuk u shërbente atyre si më parë, zhvillimi dhe pozita e tij tani shiheshin me dyshim prej banorëve përreth.

Për të sqaruar këtë situatë, mund të ndihmohemi nga një thënie e Plutarkut: Epidamnasit, fqinjë të ilirëve, meqenëse shikonin që qytetarët e tyre, duke bërë tregti me ta bëheshin më të këqij dhe meqë kishin frikë nga ndonjë lëvizje, zgjidhnin çdo vit një nga qytetarët më të njohur që të shkonte tek barbarët, në emër të gjithë qytetarëve dhe të tregonte me ta. Ky quhej poletes⁴¹. Autori që përmbledh në veprën e tij të dhëna nga jeta shoqërore, politike e kulturore e qyteteve dhe e kolonive greke që nga shek. VIII p.e.s., nuk e përcakton se për ç'kohë është fjala në këtë rast.

Bazuar në këtë njoftim janë shfaqur mendime se poleti ka pasur nën kontroll depozitën e të gjithë trafikut me fiset bregdetare⁴² dhe se si institucion ka ekzistuar gjatë gjithë kohës që Epidamni ishte një koloni greke.⁴³ Por nga e dhëna që

⁴¹ Plutarku. *Questiones Graecae*, 29, në Ilirët dhe..., f. 230.

⁴² V. Toçi. *Popullsia ilire e Dyrahut...* 1. 378.

⁴³ *Historia e Shqipërisë...* 1. 83; *Les Illyriens.....* 45-48.

përmendëm më lart del e qartë se para se të caktohej ky nëpunës në Epidamn ka ekzistuar një tregti e lirë e të gjithë qytetarëve me fqinjët ilirë. Pra, në Epidamn institucioni i poletit me këtë funksion, që është krejt i veçantë me gjithë rastet e njohura, nuk ka qenë vendosur që në fillim dhe nuk mund të ketë qenë i përhershëm për gjithë kohën që ky ishte një polis i pavarur. Një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim me normat e zakonshme të tregtisë në qytetet antike. Disa qytete antike kanë pasur ligje të posaçme që ndalonin çdo tregti ndërmjetëse: fshatari duhet t'ja shiste produktet e tij vetëm konsumatorit direkt.⁴⁴ Në Athinë p. sh. funksioni i poletit, që njihet që nga shek. VI p.e.s., ishte i kufizuar vetëm me shitjen e pasurive të konfiskuara, me vendosjen e taksave dhe me dhënien me qira të tokave publike.⁴⁵

Pa dyshuar për më mbrapa, le të shtrojmë pyetjen: a mund të ketë ekzistuar institucioni i poletit në Epidamn me detyrën e monopolizimit të të gjithë tregtisë me ilirët në gjysmën e dytë të shek. IV p.e.s. ose në gjysmën e parë të shek. III p.e.s.? Një kufizim i tillë i tregtisë direkte midis fshatarëve ilirë, apo qytetarëve të qyteteve dhe qytezave ilire të afërta, me qytetarët e Epidamnit në një periudhë të tillë nuk mund të pranohet, po të kemi parasysh faktin e forcimit. të shtetit ilir, që arrin tani të shtjerë nën kontroll kolonitë e mëdha të bregdetit⁴⁶ si dhe hapjen

⁴⁴ Shih; Historia e Greqisë dhe e Romës, Tiranë, 1962, 58.

⁴⁵ Daramberg e Saglio, Dictionare des antiquités grecques et romains, s.v. Poletai.

⁴⁶ S. Islami. Shteti ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare, në Kuvendi I..., f. 84, 85; H. Ceka, Probleme të numizmatikës ilire, Tiranë, 1965, f. 18: Les Illyriens..., If 65-70.

e portave të këtij qyteti për t'u vendosur aty me banim ilirë të tjerë.⁴⁷

Një provë që tregtia me pakicë midis Dyrrahut dhe zonës ilire përreth nga gjysma e dytë e shek. IV e mbrapa ka qenë e lirë dhe kryhej drejtpërsëdrejti, përbën dhe gjetja e monedhave prej bronzi të Dyrrahut në fshatin Vrrin të Durrësit,⁴⁸ si dhe në qytetet ilire të Zgërdheshit,⁴⁹ të Lisit⁵⁰ e të Dimalit.⁵¹ Së fundi, nuk mund të kuptohet jeta ekonomike e një qyteti si Epidamni, me liri kozmopolite, siç e quan Eliani,⁵² kur tregtia, treguesi kryesor i këtij "kozmpolitizmi", për tregun bazë të tij, të jetë monopolizuar dhe të kryhet vetëm nëpërmjet një dore. Poleti në këtë kohë në Epidamn mund të ekzistonte, por vetëm me funksione të kufizuara, si për shembull me shitjen e produkteve të punish-teve shtetërore, siç është e njohur ajo e tjegullave solene.

Prandaj e dhëna e Plutarkut duket që i referohet gjendjes që ishte krijuar në Epidamn në gjysmën e dytë të shek. V. p.e.s.; ajo i përgjigjet më së miri situatës para një kryengritjeje, të cilën edhe e aludon me fjalët "rreziku i ndonjë lëvizjeje". Monopolizimi i tregtisë në duart e oligarkisë skllavopronare dyrrahase

⁴⁷ H. Ceka. vep. e përmend., f. 31; S. Anamali. Të dhëna mbi elementin ilir në qytetet antike Epidamn dhe Apolloni, në Buletin i Shkencave Shoqërore 1, Tiranë, 1956, f. 13.

⁴⁸ H. Myrto. Një varrezë antike në fshatin Vrrin të Durrësit, Iliria, 2. 1984, f. 215-225.

⁴⁹ S. Islami. Qyteti ilir në Zgërdhesh, Iliria II, 1972, f. 207.

⁵⁰ F. Prendi. Aspects de la vie sociale économique et culturelle de Lissus jusqu'au Ier siècle avant notre ère, Posebna Izdanja Knig. XXXIV, Sarajevo, 1957, f. 152.

⁵¹ B. Dautaj. Aspects de la vie économique à Dimal, po aty, f. 194.

⁵² Ch. Aeliani. Varia Historia, XII, 16.

në fuqi, pasi siç e thamë më lart ajo zotëronte dhe monopolin mbi prodhimin kryesor zejtar, ndalimi i një lirie që kish ekzistuar në kontaktet midis qytetarëve të Epidamnit me ilirët fqinjë, nga frika se të parët bëheshin më të këqij», mbyllja eventualisht e portave të Epidamnit, ka prekur sigurisht masën e gjerë të tregtarëve dhe të zejtarëve të këtij qyteti, po ashtu fshatarët, zejtarët dhe tregtarët ilirë, të cilët kishin ecur përpara në rrugën e diferencimit shoqëror, të urbanizimit, të zejtarisë e të tregtisë.⁵³ Kjo gjë ka vështirësuar gjendjen ekonomike të qytetit, i ka nxitur grindjet e brendshme dhe po ashtu presionin e fqinjëve mbi qytetin.

Nga ana tjetër Epidamni përbënte një pikë të shtrirjes së interesave greke në tokën ilire. Prandaj qëndrimi i ilirëve ndaj tij pasqyron tani qëndrimin e tyre ndaj botës greke, për aq sa kishte të bënte me këtë pikë takimi. Le të shohim si paraqiten tani interesat e qytet-shteteve të mëdha greke ndaj Epidamnit.

Eshtë shfaqur mendimi se grindjet e brendshme që plasën në këtë kohë në Epidamn, në të cilat morën pjesë edhe ilirët, përfunduan me shkëputjen e këtij qyteti nga varësia ekonomike e politike e Korkyrës.⁵⁴ Ky përfundim i drejtë mendojmë se ka vend të çohet më tej po të kemi parasysh faktet që vijnë: Korkyra nuk ndërhyr në grindjet e brendshme të epidamnasve dhe as në luftën e tyre me ilirët fqinjë, që zgjatën shumë dhe që e rrënuan qytetin aq tepër. Edhe kur epidamnasi i parashtrojnë

⁵³ F. Prendi. Urbanizimi i Ilirisë së Jugut, Kuvendi I..., f. 112-113; S. Islami. Shteti..., f. 131.

⁵⁴ H. Ceka. Mbi disa çështje të historisë së ilirëve në dritën e të dhënave numizmatike, Studime historike, 1, f. 131.

asaj kërkesë për të ndërhyrë, ajo refuzon (I, 24), qëndrim ky që nuk i përshtatet një metropoli. Ajo ndërhyr aty vetëm më pas, por e shtyrë nga rreziku që i vinte prej rivalit të saj, Korintit, e mbështetur nga Athina dhe pasi gjen përkrahjen e ilirëve. Nga të gjitha këto do të thoshim se Epidamni e kish fituar pavarësinë nga Korkyra që më përpara, që kur ende nuk e kish humbur "fuqinë e madhe të tij", për të cilën flet Tukididi.

Përsa i përket Korintit, vërejmë se lidhjet metropol-koloni me Epidamnin pothuaj nuk njihen fare. Kjo shpjegohet pikë së pari se që në themelimin e kësaj kolonie përfaqësia korintike nuk ishte veçse simbolike.⁵⁵ Varesia e Epidamnit ndaj Korintit do të ishte, pra, vetëm indirekte, nëpërmjet Korkyrës. Mirëpo Korkyra vetë tani gëzonte një pavarësi të plotë nga metropoli i saj, për shkak të gjendjes së saj ekonomike të një radhe me vendet helene më të përparuara të kohës dhe të përgatitjes ushtarake që e kishte më të fortë se ata (I, 25), duke pasur flotën më të madhe në Greqi pas asaj të Athinës (I, 35). Fakti që gjatë luftës civile epidamnasve nuk u shkon në mendje t'i drejtohen për ndihmë Korintit, bile dhe në rastin me kritik e bëjnë një gjë të tillë vetëm kur ua rekomandon orakulli i Delfit (I, 24), flet qartë se lidhjet e Epidamnit me Korintin, qyteti-mëmë i Korkyrës, ishin harruar.

Mendimin e mësipërm na e përforcon edhe përpjekja e pasuksesshme që bëjnë në këtë kohë korintasit për një rikolonizim të Epidamnit (I, 26, 27). Kjo përpjekje, si dhe pastaj ndërhyrja ushtarake e Korkyrës, duhen shikuar si një dukuri e kohës, e

⁵⁵ I paargumentuar na duket mendimi se në Epidamn ishin vendosur paralelisht dy bërthama kotontate, e korkyrasve në Veri dhe e korintasve në Jug të qytetit (V. Toci. *Popullsia ilire...*, f. 378).

njohur edhe në kolonitë greke të Siçilisë e të Italisë së Jugut, për të përforcuar pozita të dobësuar politike.⁵⁶ Kështu, që para Luftës së Peloponezit metropolet greke nuk kishin veçse një pushtet shumë të dobësuar, ose krejtësisht të humbur, mbi Epidamnin. Përpjekja e tyre tani për ta rifituar atë me forcën e armëve, përbënte një rrezik si për vetë qytetin, edhe për krahinat e brendëshme.

Ndërkaq për Epidamnin nuk ishin të interesuara vetëm metropolet e tij. Këtu kish filluar të ndjehej edhe ndeshja e interesave të qytet-shteteve të tjera greke, si Athina, pa përmendur ato më të voglat, Eginën e Megarën. Me fuqinë e saj të rritur në 50 vjetëshin që pasoi Luftën Greke-Persiane (I, 118), Athina pretendonte tani për hegjemoni tregtare në Mesdhe. Nga gërmimet arkeologjike është provuar se që nga Skythia deri në Egjipt dhe që nga Qiprua deri në Ftruri vazot e Jonisë e të Korintit bëhen gjithnjë e më të rralla, ato të Athinës përherë shtohen.⁵⁷

Në fondet e muzeut arkeologjik të Durrësit vërejmë se qeramika korintike, në mënyrë të veçantë vazot me figura dhe enët e tryezës, në shek. V vijnë duke u zëvendësuar nga ato atiket, që janë të një cilësie më të mirë. Interesi i saj për tregun e Epidamnit vërehet edhe nga vetë monedhat që qarkullonin këtu në atë kohë.⁵⁸ Por Athina në drejtim të këtij qyteti të madh të Adriatikut Jugor nuk vepronte tani vetëm me mjetet ekonomike. Dekreti i saj për të nderuar disa persona ilirë, midis të cilëve dhe

⁵⁶ J. Berard. në "La colonisation", f. 276.

⁵⁷ G. Glotz, vep. e përm. f., 461.

⁵⁸ H. Ceka. Probleme të numismatikës..., f. 15.

një Epikad nga Epidamni,⁵⁹ nuk mund të shihet veçse si një përpjekje për të rritur këtu influencën e saj politike, duke kërkuar të krijojë një shtresë simpatizantësh, që ta mbështesnin në momentin e duhur.

Pikërisht në një periudhë të tillë plot kontradikta të brendshme e të jashtme në Epidamn shpërtheu kryengritja popullore. Tukididi thotë: "...kohët e fundit, pak përpara kësaj lufte, të pasurit, të dëbuar nga populli, u strehuan tek barbarët (Ilirët H. M.) dhe u bashkuan me ta për ta plaçkitur qytetin nga toka e nga deti" (1, 24).

Shkaqet e kryengritjes në Epidamn, në radhë të parë, kanë të bëjnë me rritjen e shtresave që kërkonin të drejta politike kundër masave frenuese të oligarkisë për zhvillimin e lirë të ekonomisë skllavopronare. Duke kërkuar shkaqe të një kuadri më të gjerë, do të vërejmë se në botën greke e kolonitë ishte krijuar ajo situatë e përgjithshme që Aristoteli do ta përmbledhte me fjalët: "kudo athinasit shkatërronin oligarkinë dhe lakedemonët partinë popullore"⁶⁰ Dihet gjithashtu se në periudhën e Luftës së Peloponezit, Athina dhe Korinti rastet për ndërhyrje i nxisnin vetë, pastaj ndërhynin dhe deklararin me zë të lartë: "vullneti ynë është të ndihmojmë cilindo që na thërret, grek apo barbar qoftë" (VI, 18.)⁶¹ Prandaj edhe mundësia e një nxitjeje nga jashtë të grindjes së brendshme që patën epidamnasit nuk duhet përjashtuar.

⁵⁹ S. Anamall. Ilirët dhe qytetet e Ilirisë së Jugut në mbishkrimet e Greqisë, Iliria, 1982, 1, f. 6. (de citon IGI 2, 72).

⁶⁰ Arist. vep. e përmend., V 7.

⁶¹ Nga fjala e Alkiviadit në Athinë para fushatës për në Siçili.

Njihet rrjedha e ngjarjeve në Epidamn pas largimit të aristokracisë dhe bashkimit të saj me ilirët fqinjë: demosi i qytetit kërkon ndihmë Korkyrës oligarkike (është interesant fakti që kryengritja popujve në Epidamn ndodhi disa vjet më parë se në Korkyrë), e cila, siç thamë, refuzoi. Korinti, përkundrazi, iu përgjigj thirrjes duke nisur një garnizon dhe bëri thirrjen për të dërguar aty kolonistë cilët do të dëshironin (436-435 p.e.s.). Atëhere flota e Korkyrës hyri në gjirin e Durrësit, duke pasur me vete të dëbuarit dhe një kontigjent trupash ilire (I, 26), në kohë që forca të tjera ilire mbanin qytetin të rrethuar nga toka. Korkyra korr fitore në betejën që zhvillohet në hyrje të gjirit të Ambrakisë (435-434) dhe po atë ditë Epidamni kapitullon (II, 28). Korinti me ndihmën e aleatëve të Lidhjes së Peloponezit kërkon revansh. Korkyra atëhere hyn në aleancën e Athinës. Në betejën që u zhvillua në ishujt Sybote (432 p.e.s.) me flotën e Korkyrës bashkohet për herë të parë dhe një skuadrilje e Athinës. Kjo shënoi dhe prishjen e paqes midis Athinës dhe Spartës.

Ndodhi kështu që Epidamni u mor si shkas për fillim e Luftës së Peloponezit (431-404 p.e.s.), luftë që përfshiu të gjitha qytet-shtetet greke e kolonitë e tyre dhe nuk la pa prekur as popujt fqinjë. Teatri i saj u shtri në det e në tokë, nga kufiri i Trakisë e Azia e Vogël në lindje deri në Sicili në perëndim, nga Adriatiku i Poshtëm në Veri deri në Egjipt në Jug. Po në të vërtetë, çështja e Epidamnit bën pjesë në shkaksinë, apo është thjesht pretekst i rëndomtë për fillimin e kësaj lufte? Vetë Tukididi e ka ndarë motivin e vërtetë të luftës, që sipas tij ishte “zhvillimi i fuqisë së Athinës, për të cilën mbahet heshtje e thellë”; pra politika e saj hegjemoniste, nga arsyet e paraqitura publikisht (I, 23), siç ishte

rasti i Epidamnit. Megjithatë, fakti që historiani i madh i lashtësisë e ka zgjedhur këtë rast, sikurse dhe atë të Potidesë e të Megarës, nga pretekstet e rëndomta që qarkullonin në atë kohë⁶², tregon se ai vetë çeshtjen e Epidamnit nuk e ka konsideruar thjesht pretekst, një çeshtje të parëndësishme e të evidentueshme.

Për të kuptuar pozitën e Epidamnit dhe qëndrimin e ilirëve në pragun e kësaj lufte dhe gjatë zhvillimit të saj, me gjithë largësinë dhe pozicionin gjeografik të mënjanuar nga epiqendra e luftimeve kryesore, mendojmë se duhet mbajtur parasysh situata e përgjithshme politike, e karakterizuar nga përpjekjet për pushtime dhe prirjet e hapta hegjemoniste të Athinës dhe Spartës me Korintin.

Me 431 p.e.s. Perikliu u drejtohej athinjotëve me fjalët: "Unë do t'ju sinjalizoj një pikë tjetër për të cilën ju duket se nuk e keni harruar kurrë... për rritjen e sundimit tuaj" (II, 62, 63). Ndërsa Alkibiad para fushatës për në Siçili thotë: "Nuk është në dorën tonë të vendosim një kufi ku të ndalojë perandoria jonë" (VI, 18). Kjo politikë ekspansioniste mundahej të përligjej dhe me një bazë të sajën ideologjike, se "në përputhje me traditën hyjnore dhe me atë njerëzore, kudo ku ka fuqi, një nevojë fatale kërkon që të ketë sundim" (VII. 105).

Me shpërthimin e kryengritjes popullore në Epidamn dhe me ndezjen e konfliktit midis fuqive koloniste greke për të rimarrë pushtetin mbi këtë qytet, ilirët hedhin disa hapa njëri pas tjetrit, që s'janë veçse një shkallëzim i veprimtarisë së tyre ndaj një synimi të caktuar: së pari, duke e mbajtur të rrethuar qytetin,

⁶² Shih p.sh. Aristofani. Paqja, botim shqip, Tiranë, 1958, f. 60.

marrin në mbrojtje aristokratët e dëbuar; më pas këta ja kalojnë Korkyrës dhe pastaj ngarkojnë forca të tyre në flotën korkyrase që niset për rrethimin e qytetit edhe nga deti. Të gjitha këto tregojnë para së gjithash se ata dinë ta shfrytëzojnë më së miri situatën e krijuar dhe taktikën e luftës. Në fund, qëndrimi i tyre gjen paralelizëm të plotë me atë të Perdikës në Lindje ndaj Potidesë, për ta bashkuar atë koloni korintike me mbretërinë maqedone, përballë synimeve ekspansioniste të Athinës.

Pas rënies së Epidamnit robërit e huaj u vranë të gjithë, ndërsa korintasit do të mbaheshin në pranga deri në një urdhër të dytë (I, 29). Për urdhrin e dytë më nuk bëhet fjalë. Logjikisht, korintasit e riardhur, edhe në se u janë hequr prangat, nuk mund të jenë mbajtur në Epidamn, në përputhje me vetë kërkesën e parashtruar që më parë prej fitimtarëve (I, 26).⁶³ Nga sa më lart, rezulton e pranueshme se garnizoni korintas që u eliminua, më shumë mundësi është vendësuar një garnizon ilir. Oligarkia e Epidamnit, një herë e rrëzuar natyrisht nuk mund të ndjehej e sigurt në atë qytet pa armët e atyre, tek të cilët u strehua në ditët e vështira dhe u ndihmua për të shtypur kryengritjen e për t'u rikthyer në atdhe.

Duke përmbledhur përfundimet për këtë fazë, mund të themi se kryengritja e demosit në Epidamn shtypet, aty rivendoset pushteti oligarkik, i mbështetur nga Korkyra dhe nga ilirët. Nëse në vepër thuhet shprehimisht se “korkyrasit mbetën zotër të detit në gjithë ato anë” (I, 30), po aq del e qartë se ilirët hynë në Epidamn me armë në dorë. Në këtë mënyrë, nuk mund të thuhet

⁶³ Shih dhe Diodori. Bibliotheca Historia, Libri XII, 31, në Ilirët dhe.. f. 137.

se Korkyra rifitoi pushtetin e humbur mbi Epidamnin, por veçse u sigurua nga rreziku i daljes së armikut të saj kryesor në një pikë me rëndësi në prapashpinë.

3. Epidamni gjatë Luftës së Peloponezit

Pas vitit 433 p.e.s., Epidamni nuk zihet më në gojë në veprën e Tukididit. Prandaj situata në këtë qytet mund të ndiqet njëfarësoj në mënyrë të tërthortë. Kështu pas konfliktit fillestar në bregdetin Jugor të Adriatikut krijohet një zonë relativisht e qetë. Kjo u arrit dhe u mbajt si rezultat i fitores së forcave korkyroathiniote mbi ato Korintit, si dhe nga pamundësia e Lidhjes së Peloponezit për t'i dalë përballë këtui, armikut të saj

Faktor tjetër që përcaktoi situatën e qetë në Adriatik ishte forca dhe qëndrimi i ilirëve. Pasi konflikti per Epidamnin u zgjidh në favor të tyre, ilirët e këtyre trevave nuk i shohim më të marrin pjesë në veprime luftarake tej kufijve të tyre, ose të shkojnë si mercenarë në njerin apo tjetrin bllok⁶⁴, siç bëjnë për shembull ilirët e Epirit. Këta nuk përfshihen as në listë me molosët, lynkestët dhe eliotët, që mbreti i ordysëve të Trakës orvatet më 422 p.e.s. për t'i tërhequr në luftë kundër Maqedonisë, aleates së Spartës.

Më 422 p.e.s., flota e Athinës sulmon me shpejtësi brigjet e Maqedonisë dhe rizbarkon në Potide (IV, 129). Pikërisht në këtë kohë zhvillohet aksioni, i njohur në historiografinë tone, i një

⁶⁴ Në vepër (IV, 43) përmendet një ndër dy gjeneralët e Korintit me emrin Bato, emër i njohur tek ilirët, por që nuk mund të thuhet asgjë e sigurt në këtë rast për origjinën e tij.

ushtrie ilire që shkon papritmas në ndihmë të mbretit të Lynkestëve, Arrabeut, në kufirin e Maqedonisë dhe ngjall panik aty në forcat e bllokut spartan, qe tërhiqen. Njëkohëshmëria e këtyre aksioneve, që nuk përmenden si të koordinuara, mendojmë se përbën një tregues që ilirët ishin të ndërgjegjshëm për situatën; ata i ndiqnin me vëmendje veprimet luftarake të blloqeve kundërshtare në Greqi e në Maqedoni.

Përsa i përket Epidamnit, vërehet se ky paraqitet i shpëtuar nga detyrimet e luftës. Po të ishte i varur plotësisht nga Korkyra, ky qytet duhet të mbante një pjesë të barrës së luftës që i ra mbi shpinë kësaj aleateje të Athinës. Por një gjë e tillë në veprën e Tukididit nuk del. Një rast mund të pritej p.sh. në periudhën e dytë të luftës, kur gjenerali Demosten u drejtua për në Korkyrë për të marrë aty aleatët e këtij ishulli e për të vijuar sa më parë për në Siçili (VII, 26). Kjo mund të pritej po ashtu edhe kur Eurymedoni lundroi për në Korkyrë dhe aty dha urdhër të përgatiteshin 15 anije e ngriti hoplitë (VII, 3). E megjithatë në këto raste nuk përmendet asnjë detyrim anijesh apo hoplitësh që Korkyra do të kish pasur të drejtë t'i nxirrte nga Epidamni, ndonëse Tukididi, duke përshkruar këtë fushatë (të Siçilisë), nuk le pa përmendur edhe kontributin e kolonive (VII, 57).

Kështu, i mbetur jashtë luftës direkte që rënoi ekonomikisht gjithë Greqinë e kolonitë e saj, Epidamni nuk mund të kuptohet veçse si i lidhur më ngushtë me zonën ilire, sesa me ish-metropolin e tij, Korkyrën.

Në këto kushte Epidamni ka pasur mundësi t'i shëronte shpejt plagët e luftës civile dhe të ndërhyrjes. Kriza ekonomike që mbërtheu Atikën Korintin, edhe tregun e Italisë së Jugut në

periudhën e dytë të luftës, ka nxitur sigurisht zhvillimin e zejtarisë në këtë qytet dhe të tregtisë me krahinat përreth. Këto vite kërkonin prej tij të plotësonte kërkesat e tregut ilir me ato mallra që më parë vinin nga jashtë, si dhe të shtonte eksportin e drithërave, për të cilat shtetet greke kishin shumë nevojë dhe i importonin nga perëndimi (III, 88).

Një nga pasojat e luftës që ia shtoi më tepër rëndësinë ekonomike në ato vite Epidamnit, mendojmë se ishte dhe prishja e trafikut tregtar ndërballkanik, nga perëndimi në lindje. Përfshirja e zonës së Kalkidikëve që në fillim nga zjarri i luftës, fushatat e njëpasnjëshme si ajo e Perdikës II, i ndihmuar nga forcat spartane të Brasidës kundër lynkestëve (IV, 83, 124-128), apo ajo e Sitalkut në krye të 15.000 thrakëve në Maqedoninë Lindore, nuk garantonin një tregëti normale drejt brigjeve të Egjeut. Kështu, argjendi i minierave të Damstionit⁶⁵ tani mund të transportohej i sigurt vetëm drejt perëndimit, drejt Epidamnit. Është ky një faktor, mendojmë, që e ndihmoi në ato vite Epidamnin për prerjen e statereve të tij prej argjendi.⁶⁶

Kryengritja dhe kthesa demokratike që ndodhën në Korkyrë më 426 p.e.s., dhe që në vepër përshkruhen me ngjyrat më të gjalla (III, 82), mund të ndikonin shpejt edhe në Epidamn. Demosit të këtij qyteti natyrisht nuk do t'i mungonte tani ndihma e Korkyrës dhe e Athinës, po të ishte ngritur edhe një herë për të fituar atë që nuk mundi ta arrinte disa vjet më parë. Por një gjë e tillë në vepër nuk del dhe. mendojmë, jo sepse kjo nuk do t'i interesonte tanimë autorit, si ngjarje anësore, por vetëm sepse në

⁶⁵ Straboni. Geographica, Libri VII, 7, në Ilirët dhe..., f. 150.

⁶⁶ H. Ceka. Probleme..., f. 15; Mbi disa çështje..., f. 131.

Epidamn një ndryshim i tillë si në Korkyre nuk ka ndodhur. Arsyen duhet ta gjejmë përsëri në mbështetjen dhe sigurinë që gëzonte aristokracia e këtij qyteti nga ana e ilirëve.

Ç'solli pastaj përfundimi i asaj lufte të gjatë për këtë ish-koloni të bregdetit tonë, kjo është e kuptueshme. Pas disfatës në Siçili athinasit detyrohen të largojnë flotën nga Joni e aq më tepër nga Adriatiku. Ndërkaq pas vitit 392 edhe Korinti, edhe Sparta, kanë humbur çdo shpresë për të ndikuar më në Epidamn e në Iliri.⁶⁷ Në këtë mënyrë Epidamni është liruar nga çdo lloj varësie prej botës greke, duke ndjekur rrugën e lidhjes gjithnjë e më të ngushtë me pastokën e tij ilire, pa asnjë forcë të jashtme që t'i garantonte një qëndrim të shkëputur prej saj.

* * *

Të dhënat burimore dhe arkeologjike na orientojnë për të kërkuar në Durrës një qendër protourbane të themeluar së paku nga mbarimi i shek. VIII ose fillimi i shek. VII p.e.s., mbi një vendbanim më të hershëm. Si e tillë, kjo qendër ka paraqitur premisa për ne avancim në rrugën e zhvillimit qytetar dhe rëndësi të veçantë tregtare e strategjike, tepër e lakmuar që nga fillimi i shek. VII p.e.s. prej fiseve ilire të brygëve, taulantëve e liburnëve.

Vendosja e kolonistëve grekë në Epidamn më 627-626 p.e.s. arrihet me ndërhyrjen ushtarake të Korkyrës në grindjen që patën midis tyre për zotërimin e qytetit taulantët dhe liburnët dhe me thyerjen e ke tyre të fundit. Rruga e zhvillimit të këtij qyteti në

⁶⁷ Shih dhe V. Pajakowski, vep. e përm., f. 332, 333.

dy shekujt që pasuan karakterizohet nga një përparim i shpejtë, nga ndikimi i fuqishëm i kulturës së përparuar greke, nga marrëdhëniet normale qytet-fshat dhe nga një varësi koloniale që ka ardhur gjithnjë duke u dobësuar.

Në gjysmën e dytë të shek. V p.e.s. qëndrueshmëria paraqitet e prishur, me ngritjen e popullit kundër pushtetit oligarqik të aristokracisë skllavopronare, me një mbyllje dhe veçim të qytetit nga pastoka e tij dhe me ndeshjen e interesave të poliseve të mëdha greke për të përforcuar apo për të shtrirë këtu influencën, bile dhe pushtetin e tyre. Ilirët priren tani për ta vënë këtë qytet nën kontroll jo vetëm për interesin ekonomik, por edhe sepse deri në atë kohë kolonia kish shërbyer si urë me leverdi reciproke për marrëdhënie me botën greke, e tani mund të shfrytëzohej si urë për vendosjen këtu të dominimit të fuqive hegjemoniste të Greqisë.

Ajo që ndodhi në Epidamn në pragun e Luftës së Peloponezit dhe ngjarjet që u pleksën me të përbëjnë një shfaqje të pavitueshme të fillimit të asaj lufte brenda sferës së mbarsur në kontradikta të zhvillimit të polisit, kontradikta të një kolonie me metropolet dhe me pastokën e saj dhe në përgjithësi me kontradikta athino-korintike.

Pavarësia që fitoi ky qytet gjatë viteve të Luftës, mosangazhimi i tij ndaj detyrimeve që sillte ajo dhe një rimëkëmbje e zhvillim i mëtejshëm ekonomik i tij, i kushtohen çlirimit nga varësia koloniale dhe sigurisë që i jepnin këtij qyteti ilirët e pastokës, të cilët u shfaqën që në fillim dhe mbetën si një fuqi e tretë në këtë zonë periferike të teatrit të Luftës së Peloponezit.

Në tërësi pozita e hershme politike e këtij qyteti vërehet e lidhur me historinë e hershme të ilirëve, jo thjesht si ajo e një kolonie të huaj, e ndarë dhe e veçuar nga toka-mëmë, por si një pjesë e saj, promotor në lidhjet me botën e jashtme.

Résumé

PROBLEMES DE L'HISTOIRE ANTIQUE DE DURRES

L'auteur remet en discussion, dans son exposé, des problèmes de l'histoire antique de Durrës, cité identifiée avec Epidamne et Dyrrhachium antique; la fondation de la cité par des colons grecs; la position d'Epidamne à la veille durant la Guerre du Péloponèse (431-404 avant n.è.) Ces dernières années ont augmenté les trouvailles archéologiques tant à Durrës que dans son environnement. Elles remontent au néolithique, à l'énélithique, à l'âge du bronze et à l'antique époque du fer. D'autre part, les trouvailles archéologiques à l'intérieur du pays ont confirmé que le centre pré-urbain, à partir de l'âge moyen du bronze et ensuite depuis ce temps fait état de rapports commerciaux de notre Ektorat avec le monde égéen, et l'on constate aussi un trafic commercial à travers Balkans, qui passait par l'Albanie centrale.

UN LUOGO DI CULTO CON ALTARE A GRADINI A DURAZZO¹

La ricerca archeologica a Durazzo, l'antica Epidamnus-Dyrrhachium sulla costa albanese, ha portato alla luce diversi monumenti e ha fornito indicazioni circa la topografia del sito nelle sue varie fasi di sviluppo, dall'età della colonizzazione greca all'età romana e bizantina (fig. 1)². Dopo una serie di indagini e scavi, soprattutto quelli condotti durante gli ultimi decenni nella parte centrale della città moderna, sono stati messi in risalto notevoli monumenti antichi, quali un mosaico policromo del IV sec. a. C.³, l'anfiteatro romano del II sec. d. C.⁴, le terme pubbliche della stessa epoca⁵ e il piazzale a colonnato

¹ Marrë nga : "Studi di Antichità" dell Università degli Studi di Lecce, nr.8.I.1995, pp.259-274.

² Per gli inizi della ricerca sistematica archeologica a Durazzo, v. L. HEUZEY - H. DAUMET, Mission archéologique de Macédoine, Paris 1876, pp. 349 ss.; C. PRASCHNIKER - A. SCHÖBER, Archäologischen Forschungen in Albanien und Montenegro, Wien 1919, pp. 36-41; A. SCHÖBER, Zur topographie von Dyrrachium, in JÖAI XXIII, Wien 1926, pp. 231-240.

³ C. PRASCHNIKER, Muzakhia und Malakasta, in JÖAI XXI- XXII, Wien 1920, coll. 203 ss.; Toçi 1965, pp. 49-50; M. MÉTAIS, Les problèmes illyriens, in Archeologia Paris 78, 1975, p. 33.

⁴ V. Toçi, Anfiteatri i Durrësit, in Monumentet 2, 1971, pp. 37-41; K. MIHO, Anfiteatri i Durrësit, Tiranë 1984; L. MIRAJ, Anfiteatri i Durrësit, in Iliria XVI, 2, 1986, pp. 151-170. Riass, fr.

⁵ Toçi 1965, pp. 50-51.

del V-VI sec. d. C.⁶. Alla periferia della città, fuori la cinta muraria bizantina, sono state effettuate indagini nell'area della necropoli del VI-I sec. a.C. sulle colline a nord-ovest⁷, e in quella del I-IV sec. d. C. situata nella pianura a nord.⁸

Le indagini alla periferia della città hanno portato all'acquisizione di dati che interessano anche la bassa pianura a nord-est, che fino al 1962 era una palude. All'interno della ex zona paludosa, prospezioni di superficie hanno permesso di rilevare tracce consistenti di costruzioni antiche, concentrate soprattutto nella parte sud-est.⁹ Scavi effettuati negli anni 1981-1984 in questo settore, a circa 700 m a est dello stadio moderno, hanno portato al rinvenimento di un complesso di strutture antiche, tra cui emerge un altare a gradini del IV sec. a. C. (figg. 2, 3).¹⁰ Il complesso occupa una superficie di 900 mq., però la sua estensione originaria doveva essere maggiore, poichè alcune strutture sono state scoperte solo parzialmente. Una tale sup-

⁶ A. HOTI, *Gërmime në shesh-tregun e qytetit*, in *Iliria* XIX, 2, 1989, p. 293.

⁷ V. Toçi, *Inscriptions et reliefs relevés dans la nécropole de Dyrrachium*, in *Studia Albanica* 2, 1965, pp. 49-99; H. H. DRI, *Gërmime në nekropolin e Dyrrahut-Kodra e Dautes* (viti 1977), in *Iliria* XIII, 1, 1983, pp. 136-180.

⁸ F. TARTARI, *Rite e forma varrimesh nga varreza e Dyrrahut e shek. i-IV e. sonë* (Rites d'inhumation et types de tombes de la necropole de Dyrrachium (Ier-IVe s. de n. ère), in *Iliria* XXI, 1-2, 1991, pp. 197-201.

⁹ H. MYRTO, *Te dhëna mbi shtrirjen e Dyrrahut në pjesën jugëperëndimore të kënetës* (Données sur l'étendue de Dyrrachium dans la partie Sud-Occidentale du "Marais"), in *Monumentet* 2, 1984, pp. 141-158, con riass. fr.; F. MIRAJ-H. MYRTO, *Ujësjiellësi i Dyrrahut (L'aqueduc de Dyrrachium)*, in *Iliria* XII, 1, 1982, pp. 135-156, con riass. fr.

¹⁰ H. MYRTO, *Një sanktuar antik në periferi të Durrësit* (Un sanctuaire antique dans les environs de Durrës), in *Iliria* XIX, 1, 1989, pp. 87-108, con riass. fr., v. M. KORKUTI and K. M. PETRUSO, *Archaeological Projects in Albania*, in *AJA* 97/4, 1992, p. 727.

posizione è avvalorata anche dalle misurazioni elettro-metriche: la carta delle linee isoelettriche (fig. 4) dimostra la probabile estensione delle strutture a nord, ovest e sud.¹¹




Fig. 1. Durazzo. Area archeologica.

¹¹ Le misurazioni sono state effettuate da un'équipe della Cattedra di Geografia presso la Facoltà di Geologia dell'Università di Tirana, diretta dall'Ing. B. ÇANGU a guida del Dr. A. Uçi, che qui ringrazio.

Lo scavo nella parte sud-est ha restituito una stratigrafia che testimonia due livelli. Il livello basso, ad una profondità di 1, 10 m, è quello dell'altare; mentre il livello superiore, che si trova a quota di 0, 60-0, 80 m, è occupato da alcune strutture secondarie che fiancheggiano il monumento ed evidentemente appartengono ad una seconda fase di costruzione.



Fig. 2. DURAZZO. Altare gradinato

L'ALTARE

L'altare, una costruzione isodomica a blocchi squadretti di calcare locale, con la base rettangolare di 4,10 x 3,30 m, alta 1,05 m, è composto da due elementi separati verticalmente (figg. 2, 3, 5, 6, 7). Il primo presenta una struttura piramidale con quattro gradini ai lati. Il gradino superiore costituisce una piattaforma

quadrangolare di 1,60 x 1,50 m. I gradini, che dai lati nord, est e ovest servono per salire su questa piattaforma, sono larghi 0,29 m, tranne il secondo dal basso che è di 0,35 m.




Fig. 3. DURAZZO. Planimetria dell'area di scavo.

Il secondo elemento, una struttura più piccola, è situato davanti al lato sud del primo, distante 0,38 m e alcuni centimetri più elevato. Anche questa struttura presenta una gradinata ai lati, con un blocco squadrato (0,85 x 0,85 x 0,46 m) nella parte superiore. Tre altri blocchi simili, ritrovati poco distante al livello superiore, probabilmente appartenevano in origine a questa struttura, che in questo modo doveva formare una specie di banchina elevata di 1,35 m dinanzi alla suddetta piattaforma. Gli altri blocchi di pietra usati nella costruzione sono di dimensioni: 1,10 x 0,53 x 0,35 m e 0,85 x 0,45 x 0,35 m, posti di taglio e di testa. Alcuni blocchi della piattaforma e dei gradini sono stati uniti tra di loro tramite grappe in piombo, del tipo chiamato "a coda di rondine".¹² L'ordine più basso di blocchi è seminterrato.

Ad una distanza di 3 m dalla parte sud di questa costruzione, e quasi sullo stesso asse, è stata rilevata una krepis evidentemente destinata a sorreggere due colonne doriche (figg. 2, 5, 6 b, 7 b). Si tratta, anche in questo caso, di una costruzione isodomica, di 1,67 x 1,10 m, alta 0,85 m, con gradinata ai lati. Lo stilobate è formato da un blocco unico di 1,10 x 0,38 x 0,31 m. Due ordini inferiori sono costituiti rispettivamente da due e tre blocchi, il più basso essendo quasi interrato. Una delle colonne, insieme con il capitello, è stata scoperta ad est della krepis, abbattuta (fig. 6 c, d). L'altra è stata riconosciuta in una colonna trovata nel corso dei lavori agricoli in questo posto alcuni anni fa e conservata nel Museo di Durazzo, mentre il suo

¹² Cfr. R. MARTIN, *Manuel d'architecture grecque*, I, Paris 1965, pp. 46-47; J.J.COULTON, *Greek Architects at work*, London 1972, p. 12.

capitello è stato trovato, abbattuto, accanto alla krepis. Le due colonne e i loro capitelli sono identici. L'altezza di ciascuna è di 1,85 m, insieme con il capitello 2,05 m; il diametro alla base 0,38 m e il diametro superiore 0,28 m. Esse sono decorate con sedici scanalature a spigolo. Il capitello (fig. 8) è costituito dal sommo-scapo con lo stesso numero di scanalature della colonna, dal collarino ad anello profilato a listello, dall'echino leggermente appiattito a listello e rigonfio, che si raccorda all'abaco quadrato (0,52x0,52 m). Questo tipo di capitello dorico, caratterizzato da una tendenza arcaicizzante soprattutto per quanto riguarda l'echino, trova confronti anche all'inizio del IV sec. a. C.¹³

Il monumento è unico finora in Albania. In relazione ai tipi conosciuti in Grecia per il periodo classico e postclassico, in alcuni aspetti potrebbe trovare confronti con gli altari classificati da Yavis come "piramidali a gradini".¹⁴ In questo modo, la piattaforma potrebbe essere identificata come la tavola dei sacrifici, mentre la piccola struttura, dinanzi, con lo stesso tronco dell'altare. Basandosi sull'architettura e sul materiale archeologico, il monumento può essere datato alla prima parte del IV sec. a. C.

L'identificazione del culto diventa difficile, non avendo trovato espliciti indizi. Di conseguenza, l'unico elemento d'identificazione del culto è costituito dalle due colonne. Infatti, il segno culturale dei pilastri gemelli è d'origine remota nell'area

¹³ A. VILLA, *I capitelli di Solunto*, Roma 1988, pp. 24, 94 (Cd 101).

¹⁴ C. G. YAVIS, *Greek Altars*, Saint Louis-Missouri 1949, pp. 115, 167.

mediterranea ed anatolica¹⁵, però difficilmente si trova un parallelo per il monumento.




Fig 4. DURAZZO. Planimetria dell'area di scavo con le linee di resistenza elettrica specifica.

¹⁵ A. B. COOK, *Zeus. A study in ancient religion*, II, New York 1965, pp. 423, 427; cfr. A. J. EVANS, *Mycenaean Tree and Pillar cult and its Mediterranean relations*, in *JHS*, XXI, 1901, pp. 127, 170; W. B. DINSMOOR, *The architecture of ancient Greece*, New York 1975, pp. 41-42.




Fig. 5. DURAZZO. Pianta e prospetto dell'altare.




Fig. 6. DURAZZO. Particolari dell'altare



Fig. 7. DURAZZO. Altare con le colonne ricostruite.

Data la differenza tra i due livelli ed uno strato sottile quasi sterile che li divide, possiamo ipotizzare l'abbandono del monumento per un certo periodo di tempo e la sua riutilizzazione, probabilmente a partire dal secondo gradino, insieme con le altre strutture circostanti costruite più tardi.

LE ALTRE STRUTTURE

Le altre strutture attorno all'altare appartengono al livello superiore e sono caratterizzate da un materiale e da una tecnica di costruzione di qualità inferiore: piccoli blocchi di pietra semisquadrati e irregolari, sovrapposti a secco (figg. 3; 6 a, b; 7

a, c). Il materiale archeologico recuperato in questo stratto appartiene al IV-III sec. a. C.




Fig 8. DURAZZO. Capitello dell'altare

La piccola area intorno all'altare, a est, a una distanza di 3 m, viene delimitata da un muro lungo 8, 30 m e largo 1, 10 m, costruito a secco con piccole pietre irregolari. L'altezza varia da 0, 30 m dalla parte dell'altare a 0, 70 m dalla parte esterna, dove il terreno sabbioso crea una depressione. Si può supporre che questo muro sia stato costruito in un secondo momento, probabilmente per sostenere ed allargare l'area intorno all'altare.

Ai lati nord-ovest, ovest e sud-ovest dell'area dell'altare corrono due muri di terrazzamento (figg. 3; 6 a, b), rispettivamente di 12 e 17 m di lunghezza e alti 1-1,20 m, che formano tra loro un angolo ottuso e, al livello superiore, delimitano i pavimenti A e B. Questi muri sono stati costruiti con piccole pietre semilavorate, con la faccia esterna quasi rettangolare, disposte in file pressoché regolari. Dalla parte inferiore del muro sporge uno zoccolo che copre leggermente l'angolo nord-ovest del gradino più basso dell'altare. I pavimenti A e B, larghi 4-5 m, sono lastricati con pietre e lastre irregolari.

Tra le costruzioni del livello superiore sono caratteristiche due piattaforme rettangolari, rispettivamente di 7 e 7,90 m di lunghezza (fig. 3), e due altre di 4, 30 m di lunghezza (fig. 3: 8, 9), tutte e quattro di larghezza e altezza uguali, rispettivamente di 2,15 e 0,40 m. Le piattaforme sono delimitate ai quattro lati da muretti bassi, di materiale e tecnica analoga ai suddetti muri di terrazzamento, e sono riempite di terra battuta, di ghiaia e di frammenti di tegole. Sui loro piani si vedono qua e là tracce di pavimentazione realizzate con frammenti di tegole di un color violetto oppure rosso-scuro. Un'altra struttura simile si può supporre a nord-est del complesso; di questa è stato riportato alla luce solo un piccolo angolo (fig. 3:15).

Alle estremità delle piattaforme 6 e 7 sono stati rinvenuti tre blocchi ben squadriati, della stessa pietra e delle stesse dimensioni della struttura dinnanzi all'altare, della quale, come abbiamo detto sopra, è probabile che originariamente abbiano fatto parte.

Va notato che le piattaforme menzionate, nonostante un'asimmetria generale che si nota in tutto il complesso, sembrano tendere verso uno schema determinato che assomiglia alla lettera T, con il segmento superiore diviso in due. Gli zoccoli secondari (fig. 3:11, 12, 13, 14), che non confermano questa regolarità, appartengono evidentemente a un intervento posteriore. Lo stesso si può dire anche per alcune strutture secondarie delimitate da tegole piatte messe verticalmente (fig. 3:10), le quali passano sopra il pavimento F a sud del complesso.

Il terreno tra le strutture di questo livello è piano e qua e là lastricato con frammenti di tegole disposte orizzontalmente (fig. 3:D, E), oppure obliquamente (fig. 3:9).

Per quanto riguarda la funzione di queste costruzioni non possiamo dare un'interpretazione definitiva. Comunque possiamo ipotizzare che i pavimenti A e B, che circondano l'altare da tre parti, fossero utilizzati come luoghi di sosta per i fedeli. Si sa che i fedeli, raggruppati intorno all'altare per seguire le diverse cerimonie, non formavano un cerchio pieno, ma prendevano posto ai tre lati dell'altare lasciando libero il lato est.¹⁶ Anche nel nostro caso, la planimetria dell'area dello scavo e le linee isoelettriche dimostrano che il lato est è rimasto libero. Il fatto

¹⁶ B. BERQUIST, *The archaic Greek Temenos*, Lund 1967, p. 133.

che su questi pavimenti sono stati rinvenuti numerosi frammenti di tegole fa pensare che probabilmente essi erano coperti con un tetto per proteggere i presenti dalle piogge invernali e dal sole durante l'estate.

Le piattaforme rettangolari, alte 0,40 m a partire dal terreno, due delle quali sono dotate di blocchi squadrati alle estremità, probabilmente sono state utilizzate anch'esse come altari minori a cielo aperto, in una fase di allargamento del santuario. Ma è altrettanto possibile che siano servite come strutture per i banchetti rituali, attestati non solo vicino ai prytaneioa ma anche presso gli altari.¹⁷

I RITROVAMENTI

Il materiale archeologico, rinvenuto quasi interamente nello strato superiore, è caratterizzato soprattutto da frammenti di tegole concentrati nella parte est. Inoltre, sono stati ritrovati oggetti ceramici, parecchie monete ed alcuni ornamenti di bronzo, chiodi di ferro, conchiglie e ossa, distribuiti su tutta l'ampiezza dello strato, ma con una concentrazione maggiore presso l'altare e la krepis. Tutti i materiali permettono una datazione al IV-III sec. a. C.

Il materiale laterizio è rappresentato da numerosi frammenti di tegole e di coppi. Le tegole sono di tipo piatto con delle bordure convesse oppure oblique all'interno (fig. 9). La

¹⁷ M.P. NILSON, *Geschichte der Griechischen Religion*, München 1955, p. 830.

lunghezza totale della tegola, integralmente conservata in un solo caso, è di 0,86 m; lo spessore di 5-6 cm.




Fig. 9. DURAZZO. Altare: elementi di tegole.




Fig 10. DURAZZO. Altare: frammenti di forme vascolari a figure rosse e vernice nera.

Alcuni frammenti recano dei bolli a forma di monogramma (fig. 9:9, 12), conosciuti già sulle tegole antiche scoperte a Durazzo. Il primo monogramma, abbastanza comune nell'epigrafia greca, è stato interpretato come abbreviazione di *Sauóeios* (pubblico)¹⁸ e nel nostro caso testimonia non solo l'esistenza di un'atelier statale a Durazzo¹⁹, ma anche il fatto che il santuario veniva mantenuto ed eventualmente restaurato a spese pubbliche.²⁰ Probabilmente anche il secondo monogramma indica un prodotto dell'atelier statale di Epidamnus.

In nessun caso è documentato un bollo con il nome del magistrato eponimo, che si trova tanto spesso sulle tegole di Durazzo del III-I sec.a.C. Questo fatto suggerisce per le costruzioni che affiancano l'altare una datazione precedente la seconda metà del III sec. a. C., quando nomi di magistrati eponimi non erano inseriti ancora neanche sulle dracme di Dyrrachium.²¹ Un altro indizio cronologico, per quanto riguarda la vita del santuario, l'assenza di ceramica a rilievo, che qui compare verso la fine del III sec. a. C.²² e a Corcira solo poco prima.²³

¹⁸ GUARDUCCI 1966, p. 489.

¹⁹ Arist. Polit., II, 7. 1267b, pp. 15-19, ed. Laterza 1983 (presenza dei servi pubblici per attività manuali a Epidamnus).

²⁰ Cfr. GUARDUCCI 1966, p. 489.

²¹ H. CEKA, Datimi i drahmeve të Dyrrahut e të Apolonisë, in *Studime Historike* 1, 1966, 1, pp. 38-39.

²² H. HIDRI, Kupa me dekor në reliev të Dyrrahut, *Iliria* XI, 1, 1981, p. 76. Riass. fr.

²³ G. SEIBERT, Recherches sur les ateliers de bols à reliefs du Péloponèse à l'époque hellénistique, Paris 1978, p. 176.

I coppi sono del tipo "Corinzio" con sezione angolare all'interno e all'esterno, ma si trovano anche con sezione semi-circolare dalla parte interna (fig. 9: 13). I mattoni sono quasi assenti. Sono stati rinvenuti solo due frammenti di un impasto granuloso, poco cotto, di spessore di 9 cm.

La ceramica acroma, la ceramica a figure rosse e quella a vernice nera, è costituita principalmente da frammenti. Gli esemplari più significativi della ceramica, insieme con altri vari oggetti, sono inseriti nel catalogo.

I grandi contenitori, come i pithoi, mancano totalmente. Le anfore sono rappresentate da numerosi frammenti. In base alle forme degli orli e delle anse risultano identificabili le produzioni di Corinto (oppure di Corcira) (catt. 1, 2, 3) e in base a un bollo su un'ansa, la produzione di Cnido (cat. 4). Però, dall'esame delle caratteristiche dell'argilla possiamo dire che la maggioranza dei frammenti di anfore appartiene alla produzione locale, come quasi tutta la ceramica.

La ceramica a figure rosse è rappresentata da due piatti incompleti ornati con figure di pesci, una lekythos e alcuni frammenti piccolissimi di altri vasi. I piatti, di un'argilla ocrarosa, appaiono con ogni probabilità attribuibili alla produzione locale. Per quanto riguarda i motivi e i tipi dei pesci, i nostri piatti trovano confronti sia nella produzione attica che in quella dell'Italia del Sud, soprattutto della Puglia. I pesci *sparus auratus* su entrambi i piatti (catt. 12, 13) e anche *lophius piscatorius*, presente su uno solo (cat. 13), sono tipi comuni in entrambe le

produzioni nel IV sec. a. C.²⁴ Infatti, il *lophius piscatorius*, come anche la posizione dei pesci con la spina rivolta all'infuori, sono attestati per lo più sui piatti apuli.²⁵ Però, il fondo depresso circondato da una linea incisa, la parte esterna del piede curva e anche la decorazione delle onde, che si vedono nel nostro primo piatto, sono più vicini alla produzione attica.²⁶ Comunque, in mancanza di altri indizi, essendo questi gli unici piatti con figure rosse di pesce ritrovati finora a Durazzo, è difficile individuare una influenza dominante attica oppure apula: è forse più probabile, in questo caso, riconoscere una tendenza locale al di sotto delle due influenze.

In generale, i piatti, le *oinochoai*, le *olpai*, gli *skyphoi*, le "fruttiere" e gli altri tipi di ceramica recuperati, rappresentano resti di sacrifici o dediche votive. Di interesse particolare al riguardo sono alcuni fondi perforati al centro (catt. 5, 17, 24; figg. 10:5, 6; e 11:11, 12). Al carattere votivo sono collegate evidentemente una terracotta, l'unica recuperata nello scavo (cat. 10; fig. 11:10), due iscrizioni incise sui fondi di un piatto e di una coppa, pochi ornamenti di bronzo, un alabastro, molte conchiglie e soprattutto ottanta monete di bronzo. Le monete, ritrovate disperse su quasi tutto lo strato, spesso anche a una profondità di 20 cm, sono troppo corrose, senza dubbio dall'azione del sale nell'acqua della laguna, e di conseguenza illeggibili, tranne una (cat. 31).

²⁴ MCPHEE-TRENDALL 1987, pp. 38, 57.

²⁵ ID., p. 57.

²⁶ ID., pp. 56-57.




Fig 11. DURAZZO. Altare: frammenti di forme vascolari acromi e a vernice nera.




Fig 12. DURAZZO. Altare: frammenti di forme vascolari acromi e a vernice nera.

CATALOGO

Il catalogo seguente si riferisce a materiali selezionati principalmente per fornire elementi di datazione necessari all'inquadramento cronologico dell'attività umana intorno all'altare e alle altre costruzioni che lo fiancheggiano. Tutti gli oggetti del catalogo sono conservati nel Museo archeologico di Durazzo (S. nr. 2, R. 32 a, b, c).

Ceramica acroma d'uso comune

1. Fr. anfora commerciale corinzia tipo A' (fig. 12:8). Argilla porosa grigiastra con inclusi, ingubbiatura rossa scura. Parte dell'orlo con bordo inclinato obliquamente all'esterno.

Inizio IV sec. a. C.

Cfr. C. G. KOEHLER, *Corinthian developments in the study of trade in fifth century*, in *Hesperia* XIX, 50/4, 1981, pp. 454, 457; N. CEKA, *Amfora antike nga Margëlliçi*, in *Iliria* 2, 1986, p. 77 (gruppo c). Riass. fr.

2. Fr. anfora corinzia tipo A' (fig. 12: 9).

Argilla dura porosa rosata con inclusi bianchi e neri. Il frammento si riferisce a un'ansa di tipo quasi ad anello, pinzato alla spina per creare una sezione triangolare.

Cfr. nr. 1.

3. Fr. anfora commerciale corinzia tipo B (fig. 12:6). Argilla ocrarosata. H. 12, largh. 13 cm.

L'imboccatura presenta la consueta deformazione in corrispondenza delle anse, per creare una sezione simile al numero 8. Una fascia sottile orizzontale concava sulla parte del collegamento del collo con l'orlo.

Fine del IV sec. a. C.

Cfr. C. G. KOEHLER, *Amphoras on amphoras*, in *Hesperia* 51/3, 1982, p. 286; pl. 79, 18.

4. Fr. anfora di Cnido (fig. 12:5).

Argilla giallina rosata, con inclusi silicei biancastri. Lung. 19 cm.

Ansa a nastro con sezione quasi ovoidale. Sulla parte superiore un bollo circolare con la figura di un'ancora in rilievo, fiancheggiata dalle lettere A-M. III sec. a. C.

Cfr. V. GRACE, *Timbres amphoriques trouvés à Delos*, in *BCH CXXXVI*-1, 1952, tav. XIX, 4.

5. Fr. anfora (fig. 11:11). Argilla rosa. Diam. piede 9 cm. Fondo piatto di un'anforetta con piede ad anello, perforato al centro.

6. Fr. anfora. Argilla rossa con inclusi silicei.

Piede conico con il tallone separato, quasi biconico. All'interno della parte rimasta del fondo è stata trovata una sostanza, forse raggia seccata.

7. *Louterion* (fig. 12: 11). Argilla rossa con inclusi sabbiosi. Tre frammenti. Orlo estroflesso, superioramente convesso, delimitato all'interno da una scanalatura orizzontale. Ansa ad "astragalo" attaccata all'orlo.

IV-III sec. a. C.

Questo tipo è stato utilizzato anche per servizi di culto.

Cfr. M. JAZZO, *Luteria fittili in Calabria*, in *Archeologia Classica XXXIII*, 1981, p. 143.

8. Olpe (fig. 12: 3).

Argilla oca. Diam. fondo 5 cm. , h. 6, 3 cm. La parte inferiore troncoconica, fondo piatto. IV-III sec. a. C.

Cfr. MANO 1971, pp. 187-188, tab. XXXVII, 4.

9. Piede di "fruttiera" (?) (fig. 12:7).

Argilla bruna con inclusi sabbiosi. H. 10 cm. Piede a tromba ornata con anello discoidale; base troncoconica (incompleta).

IV sec. a. C.

Cfr. E. SAMMARTI-GRECO, *La ceramica campaniense de emporion y Rhode*, Barcelona 1978, p. 593, nr. 171.

10. Terracotta (fig. 11: 10).

Argilla oca-rosata. H. 6, 5 cm. Rappresenta una figura femminile stante, lavorata a mano. Il corpo quasi cilindrico, probabilmente vestito con chitone lungo, le braccia tronche rudimentali.

La figura assomiglia alle terracotte arcaiche greche di Rodi identificate con Artemide.

Cfr. R. A. HIGGINS, *Terracottas in the British Museum*, Oxford 1954, p. 277.

11. Oggetto fittile non identificato (fig. 12: 4).

Argilla brunastra con inclusi sabbiosi. Lung. 14 cm. Modellazione che assomiglia ad un corno (incompleta).

Ceramica a figure rosse

12. Piatto da pesce (fig. 10: 1).

Argilla fine oca-rosata. H. 3, 1 cm., diam. orlo 21 cm. Ricomposta da alcuni frammenti. Orlo ripiegato all'esterno quasi

verticalmente, centro depresso; piede largo ad anello. Due figure di pesci (*sparus auratus*) intorno al centro depresso, spina di fuori. Come elemento complementare sono stati utilizzati puntini neri. Sull'orlo, all'esterno, onde a sinistra. Sulla faccia inferiore del piede cerchietti neri e rossi con un punto centrale nero. Seconda metà IV sec. a. C.

Cfr. MCPHEE-TRENDALL 1987, pp. 38, 56, 57.

13. Piatto da pesce (fig. 10: 7). Argilla fine ocre-rosata. Diam. max. 13 cm.

Frammento con le figure (incomplete) dei due pesci (*sparus auratus*) ed un altro piccolo tra di loro (*lophius piscatorius*), intorno al centro depresso. Seconda metà IV sec. a. C.

Cfr. nr. prec.

14. Piede di "fruttiera" (?) (fig. 11: 4).

Argilla ocre-rosata, vernice rossa brunastra. H. 9, 5 cm.

Piede alto a tromba con la base discoidale, decorato con tre anelli discoidali e verniciato di fasce rosse e brunastre. Sul fondo rosso della parte rimasta del piattello, al centro, un punto nero ed un cerchio brunastro. IV sec. a. C.

Cfr. nr. prec.

Ceramica a vernice nera

15. Piatto (fig. 12: 10).

Argilla ocre, vernice nerastra opaca corrosa in superficie. H. 2,7 cm, diam. orlo 16 cm.

Orlo arrotondato e leggermente rientrato, distinto con una risega dalla parete a profilo concavo; piede ad anello. All'interno, in centro, il monogramma A cerchiato, impresso. Integro.

Prima metà III sec. a. C.

Per la forma, cfr. MOREL, F 2222, in particolare tipo 2222 f-g.

16. Piatto (fig. 10:8).

Argilla ocre rosata. Vernice nera opaca, corrosa nella maggior parte della superficie. Incompleta. H. 2, 3 cm. , diam. orlo 15 cm., diam. piede 10 cm. All'interno, al centro, una rosetta circoscritta e sei palmette staccate.

III sec. a. C.

Per la forma, v. nr. prec. Per il motivo decorativo, cfr. LAMBOGLIA 1952, p. 165.

17. Fr. di piatto (fig. 10: 2). Argilla ocre rosata, vernice nera lucente.

Per la forma, v. nr. prec. Sul fondo esterno, l'iscrizione incisa in due righe [APIΣ]THNOY/M... Perforato al centro.

18. Fr. di piatto (fig. 10: 6).

Argilla rosata, vernice nera lucente. Dimens. max. 6 cm.

Sul fondo resta parte di un motivo decorativo a intreccio di palmette.

IV-III sec. a. C.

Cfr. LAMBOGLIA 1952, p. 171.

19. Piattello (fig. 11: 7).

Argilla ocrea, vernice nera lucente. H. 2,5 cm., diam. orlo 12 cm.

Orlo semplice leggermente rientrante; piede ad anello. Sul fondo, quattro palmette a disposizione radiale attorno a un cerchio, impresse. Sul fondo esterno del vaso, risparmiato, cerchi concentrici. Fine IV sec. a. C.

Cfr. LAMBOGLIA 1952, pp. 170-171.

20. Parte di un'*oinochoe* (fig. 11: 1).

Argilla ocrea-rosata, vernice nera opaca. H. 9 cm. Lungo collo, orlo trilobato e svasato, ansa a bastoncino leggermente sormontante. Parte rimasta della spalla decorata da baccellature. Prima metà III sec. a. C.

21. *Guttus* (incompleto) (fig. 11: 2).

Argilla ocrea-rosata, vernice nera abrasa. H. 5, 5 cm. , larg. 9 cm.

Corpo discoidale, orlo con filtro, depresso e delimitato da listello. Decorato da baccellature. Seconda metà IV sec. a. C.

Cfr. produzione apula, MOREL, tipo 8141 a.

22. *Lekythos* (fig. 11: 3).

Argilla ocrea rosata, vernice brunastra lucente sottile con macchie nere. H. 7 cm., diam. piede 4,8 cm. Corpo globulare, collo lungo delimitato da tre linee parallele orizzontali incise; piede troncoconico. Orlo mancante.

23. Parte inferiore di uno *skyphos* (fig. 12: 2).

Argilla oca-rosata, vernice nera poco lucente, fondo esterno entro piede risparmiato. Diam. piede 6, 4 cm.

Pareti rastremate verso il basso, piede ad anello. Prima metà IV sec. a. C.

Cfr. BLEGEN-PALMER-YOUNG 1964, p. 126.

24. Parte inferiore di uno *skyphos* (fig. 10: 5).

Argilla oca-rosata, vernice nera poco lucente. Diam. 4, 5 cm.

Appartiene ad uno *skyphos* con profilo ovoidale, piede a disco. Perforato al centro del fondo. Seconda metà IV sec. a. C.

Cfr. *ibid.*, p. 120.

25. Parte inferiore di uno *skyphos* (fig. 12:1). Argilla oca-rosata, vernice nera poco lucente; una fascia risparmiata alla base della parete. La faccia inferiore del piede decorata con bande alternate concentriche. Diam. piede 4,5 cm. Pareti rastremate verso il basso.

Fine IV sec. a. C.

Per Durazzo, cfr. HIDRI 1983, p. 151, tab. XIII, 1.

26. Fondo di coppa (fig. 10:4).

Argilla oca-rosata, vernice nera, risparmiata sul fondo esterno. Diam. piede 4,5 cm.

Piede ad anello. Nella parte centrale del fondo quattro palmette a croce, impresse, disposte simmetricamente. IV sec. a.C.

Cfr. LAMBOGLIA 1952, pp. 166, 202; per Apollonia, MANO 1971, p. 183, tab. XXXI, 7.

27. Coppa incompleta (fig. 10:9)

Argilla ocra-rosata, vernice nera opaca. Diam. orlo 8,5 cm; piede 5,6 cm.

Orlo assottigliato rientrante, piede ad anello. Sul fondo, in centro, tre cerchi concentrici e quattro palmette (una manca) a disposizione radiale, impresse. Sul fondo esterno un cerchio nero. IV sec. a. C. Cfr. nr. prec.

28. Coppetta (fig. 11: 8).

Argilla ocra-rosata, vernice nera opaca. H. 3 cm. , diam. orlo 4, 6 cm. , diam. piede 3 cm.

Orlo rientrante, piede ad anello. Sul fondo esterno, iscrizione incisa sulla vernice: ΔΙΝ.

III sec. a. C.

29. Lucerna (fig. 11: 5).

Argilla ocra-rosata, vernice nera poco lucente. H. 4,5 cm., piede 4,3 cm.

Corpo a echino, foro di alimentazione depresso, beccuccio svasato, fondo esterno leggermente concavo con piede appena accennato. Ansa mancante. Ultimo quarto del IV sec. a.C.

Cfr. M. T. GIANNOTTA, *Vaste-Fondo Melliche*, in *Archeologia dei Messapi*, a cura di F. D'Andria, Bari 1990, p. 77, nr. 62.

Conchiglie

30. Tre vaghi di conchiglie (fig. 10: 3), con delle baccellature. Lung. 2,5 cm.

Monete di bronzo

Dyrrachium

31. Tipo: Testa di Eracle / Arco, clava e faretra. D/ Ritratto di Eracle con pelle di leone, ds.

R/ Arco, clava e faretra. Dentro l'arco Δ]Y; tra la clava e faretra: Δ]AHN.

Prima metà III sec. a. C.

H. CEKA, *Probleme të numismatikës ilire*, Tiranë 1965, p. 151, nr. 36.

CONCLUSIONE

L'altare e altre strutture che lo fiancheggiano testimoniano la presenza di un luogo di culto del IV-III sec.a. C. nella parte nord-est della periferia di Durazzo. La documentazione archeologica finora non ha restituito tracce della presenza di un tempio nelle vicinanze, pertanto possiamo dire che si tratta di un altare isolato, a cielo aperto. L'identificazione del culto diventa difficile in assenza di dati espliciti. Le due colonne dinanzi all'altare costituiscono l'unico segno rappresentativo del culto, ed essendo in coppia ci permettono di desumere un culto di divinità gemelle. Sarà compito delle future ricerche chiarire l'estensione delle strutture antiche in questo settore e l'attribuzione del culto.

Data la posizione relativamente lontana dalla zona ipotizzata come centro della città antica, circondata dalle mura bizantine e dalle necropoli del VI-I sec. a.C e del I-IV sec. d.C., questo luogo di culto appartiene con molta probabilità alla periferia di Dyrrachium, cioè al territorio suburbano della città antica.

Tuttavia, il luogo di culto occupava evidentemente un posto importante, vicino alla città, non lontano dalla costa e probabilmente a fianco della strada principale. Esso doveva avere un certo ruolo nella vita spirituale degli abitanti della città e del suo territorio e fu probabilmente costruito e riparato a spese pubbliche.

Il periodo tra l'inizio del IV e la metà del III sec. a. C., in cui questo luogo di culto è stato costruito, ampliato e regolarmente frequentato si accorda con la datazione di altri notevoli monumenti di Dyrrhachium, comprovando insieme un certo sviluppo economico e culturale della città. L'abbandono del monumento per un certo tempo, tra altri possibili motivi, potrebbe essere imputato a qualche terremoto. Mentre l'ampliamento, con le strutture posteriori, dimostra senza dubbio l'aumento delle attività cultuali e una maggiore frequentazione del luogo del culto.

Infine, questo monumento e le evidenti tracce di costruzioni antiche nella parte sud-ovest della palude di Durazzo testimoniano inequivocamente che almeno il territorio che essi coprono fu libero dalle acque e fu utilizzato dalla polis, smentendo le ipotesi precedenti che la palude si estendesse su tutta la superficie occupata in epoca moderna. D'altronde, l'assenza di dati sulla presenza di un confine naturale, oppure artificiale, tra la periferia della città e retroterra, permette di supporre che il luogo di culto poteva essere frequentato anche dalla gente che abitava i villaggi vicini.

NJË SANKTUAR ANTIK NË PERIFERI TË DURRËSIT¹

Kërkimet arkeologjike në periferi të Durrësit, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, kanë sjellë të dhëna me interes edhe nga fusha në verilindje të qytetit që, siç dihet, deri në vitin 1960 ishte kënetë. Në një sipërfaqe prej rreth 80 ha të anës jugperëndimore të kësaj fushë, jo larg kufijve të qytetit të sotëm, ndeshen shpesh parcela me material ndërtimor të kohës antike si tjegulla dhe blloqe gurësh të nxjerra në sipërfaqe nga punimet bujqësore (fig. 1). Herë pas here këtu janë zbuluar në mënyrë të rastësishme edhe ndonjë trakt muri, themele, detaje arkitektonike, skulptura e mbishkrime, të datuara në periudhën helenistike dhe në shekujt e parë të erës sonë.²

Vitet e fundit, me anë të një gërmimi të kryer në një pikë brenda kësaj zone, 700 m në lindje të stadiumit të qytetit, ku vite më parë është gjetur një kolonë dorike prej guri gëlqeror, u zbulua një kompleks ndërtimesh antike të shtrira në një sipërfaqe prej 900 m² (fig. 2).³

¹ Marrë nga ILIRIA Nr. 1, 1989, f. 87-104.

² H. Myrto, Mbi shtrirjen e Dyrrahut në pjesën jugperëndimore të «Kënetës», Monumentet, 1984, 1, f. 141-155; shih dhe F. Miraj, H. Myrto Ujësja e Dyrrahut, Iliria, 1982, 1, f. 131.

³ Fillimisht kujtuam se kishim të bënim me mbeturina të një banese të shekujve IV-III p.e.s. (H. Myrto, art. cit., f. 145), por me zgjerimin e mëtejshëm të gërmimit u pa se ndërtimet ishin të një karakteri kulti (H. Myrto, Gërmime të vitit 1986 në Durrës-Kënetë, «Iliria», 1986, 2, f. 257.





Fig 2. Planimetria

Por nga disa konstruksione të zbuluara pjesërisht, si dhe nga materiali ndërtimor që shihet në sipërfaqe rreth e qark, duket që ato kanë një shtrirje edhe më të gjerë. Kjo gjë u provua edhe me anë matjesh elektrometrike. Harta e izovijave të rezistencës elektrike specifike e përpiluar mbi bazën e këtyre matjeve (fig. 3) tregon rezistenca të tilla që, të kontrolluara me anë sondazhesh, dëshmojnë për një tejshtirje të ndërtimeve në anën veriore, në anën perëndimore dhe në arën jugore.⁴ Lidhur me stratigrafinë e gërmimit, u dalluan dy shtresa kronologjike-kulturore (fig. 4, a). Shtresa e parë, më e hershmja, që u identifikua në një sektor të kulizuar, i referohet një kohe në mbarimin e periudhës arkaike dhe fillimin e asaj klasike. Shtresa e dytë, më lart, e ndarë prej të parës nga një mbushje dheu pothuaj sterile, i takon periudhës së hershme helenistike.

Arkitektura

Për aq sa është zbuluar deri tani nga ky kompleks ndërtimesh, si për sa i përket formulimit arkitektonik, ashtu edhe për sa u përket materialit dhe teknikës së ndërtimit, shquhet një altar flijimi monumental (fig. me ngjyra dhe fig 4). Ndërtimet e tjera përbri (fig. 2; fig. 5, a, b, c) janë të një faze të dytë, por të projektuara për të bashkëjetuar me të. Altari përbëhet nga një podium kuadratik (1,60 x 1,50 m) me lartësi 0,98 m, që ka një pedestal më të vogël kuadratik (0,85 x 0,85 m) para tij dhe të dy qëndrojnë mbi një bazament të përbashkët drejtkëndësh (3,70 x

⁴ Matjet u kryen nga një ekip i Katedrës së Gjeofizikës pranë Fakultetit Gjeologji-Miniera të Universitetit «Enver Hoxha», i drejtuar nga ing. Burhan Çangu, nën udhëheqjen e Dr. Alfred Frashërit, të cilët i falënderojmë.

3 m) (fig. me ngjyra; fig. 4, b, c; fig. 5 d). Podiumi i ngjan një piramide të cunguar, me tri këmbëshkallë në secilën anë. Në anën jugore, 0,38 m larg tij, qëndron piedestali i vogël kuadratik. Këmbëshkallët që ngjiten në podium kanë gjerësi 0,29-0,35 m dhe lartësi 0,35 m.




Fig 3. Harta e izovijave të rezistencës elektrike specifike




Fig 4. a – stratigrafia e altarit; b – prerje vertikale; c - planimetria



Fig. 5a



Fig. 5b



Fig. 5c




Fig. 5d

Për ndërtim janë përdorur blloqe gurësh kuadratikë të latuara dhe të skuadruara në mënyrë të përsosur, me gjatësi dhe gjerësi që lëvizin përkatësisht nga 0,85 dhe 0,45 m deri në 1,15 dhe 0,535 m. Lartësia e tyre është pothuaj në të gjitha rastet e barabartë, 0,350 m. Blloqet janë puthitur bukur njëri me tjerin, pa përdorim llaçi. Lidhja e tyre është siguruar me anë kllapash hekuri të veshura me plumb, të një tipi që njihet me emrin «bisht pëllumbi» (fig. 4, c)⁵

Blloqet që formojnë këmbëshkallën e parë janë latuar bukur vetëm në faqen e sipërme, ndërsa në faqen anësore të jashtme nuk janë latuar me të njëjtin kujdes. Në këtë mënyrë kuptohet që

⁵ J. J. Coulton, *Greek Architects at Work*, London, 1972, f. 12.

kjo radhë blloqesh është projektuar për të qenë e ngulur në tokë deri në nivelin e faqes së sipërme, pra përbënte themelin dhe njëkohësisht këmbëshkallën e parë. Me anë sondazhesh u vërejt se poshtë saj gjendet një shtresë zhavorri.

Në një distancë 3 m nga ana jugore e konstruksionit në fjalë dhe pothuaj në një aks me të, gjendet një krepis i vogël (1,10 x 0,38 m), me lartësi 0,85 m (fig. 2). Është ndërtuar me tri radhë blloqesh kuadratike të latuara bukur, pa mjet ndërlidhës midis tyre. Radha e sipërme, vetë stilobati, përbëhet nga një bllok monolit (1,10 x 0,38 x 0,31 m). Dy radhët e tjera më poshtë, të përbëra përkatësisht prej dy dhe tri blloqesh janë pak më të gjera, duke krijuar kështu shkallëzime të vogla në secilën anë. Radha e poshtme përmban gunga të vogla në meset e faqeve të jashtme të blloqeve të lëna në reliev gjatë latimit të tyre, në rastin tonë, me sa duket, për qëllim apotropeik.

Krepisi ka shërbyer për të mbajtur dy kolona dorike prej guri gëlqeror (fig. me ngjyra), njëra prej të cilave, së bashku me kapitelin përkatës, u gjet e shtrirë në anën lindore të tij. Kapiteli i kolonës së dytë u gjet i thyer në dy pjesë, të rëna në secilën anë të skajit tjetër të krepisit. Vetë kolona e dytë, që nuk u gjet në vend, rezultoi se ishte ajo që përmendëm në krye, e prurë në muze vite më parë si gjetje rasti nga ky territor.

Të dyja kolonat dhe kapitelet e tyre janë identike. Ato kanë lartësi 1,85 m, diametër të bazës së poshtme 0,38 m dhe të bazës së sipërme 0,28 m. Secila është e zbukuruar me nga 16 kanelyra vertikale me kurrize të tipit majëmprehtë, ndonëse disa nga këto paraqiten të topitura. Raporti 1:4,6 që vihet re në këtë rast

ndërmjet diametrit dhe lartësisë së kolonës është karakteristikë për kolonat e tempujve ndërmjet viteve 550-450 p.e.sonë.⁶



Fig. 6. Pamja e përgjithshme e altarit

Kapitelet përbëhen nga qafa e shkurtër, e zbukuruar me fillimet e kanelyrave, nga ekini konveks i rumbullakuar në pjesën e sipërme dhe nga abaku katror (0,51 x 0,51 m). Lartësia e tyre është 0,21 m. Kjo formë e kapiteleve dorike, veçanërisht

⁶ A. Baçe, Vështrim mbi besimin dhe arkitekturën e kultit tek ilirët, Monumentet, 1984, 2, f. 15.

përsa i përket ekinit, është e njohur në periudhën arkaike, por vazhdon deri në fundin e shek. V p.e.sonë.⁷

Monumenti deri më sot mbetet unikal në vendin tonë.⁸ Si tip, është i njohur në qendrat antike të Greqisë dhe të Magna Grecias në periudhën klasike dhe helenistike.⁹ Në përputhje me shembujt e njohur, mendojmë se sipër kolonave të ngritura mbi krepisin e vogël ka qenë vendosur statuja e hyjnisë së cilës i ishte kushtuar altari, por që nuk u gjet. Në podiumin e shkallëzuar hipte drejtuesi i ceremonisë fetare për të vendosur dhuratat mbi piedestalin para tij, që ishte vetë «tryeza e hyjnisë».

Duke u mbështetur në stilin dhe në teknikën e ndërtimit si dhe në stratigrafinë, mendojmë se altari është ngritur aty nga fillimi i shek. V p.e.sonë. Ai ka qëndruar në qiell të hapët.

Gjetjet në shtresën e parë.

Shtresa e dheut, me trashësi 0,40 m, që mbulonte tërë sheshin deri në nivelin e këmbëshkallës së dytë, dëshmon për braktisjen e monumentit për një kohë. Kjo shtresë ishte pothuaj pa material arkeologjik. Përmendim vetëm disa fragmente tjegullash solene të zbukuruara në faqe me një shirit spiralik me ngjyrë të kuqe në

⁷ E. Homman-Wedking, *Grecia Arcaica*, Baden-Baden, 1966, f. 128, fig. 29; G. Gruben, *Die Temple der Griechen*, München, 1966, f. 83-84.

⁸ Nuk mund të shërbejnë për krahasim mbeturinat e një altari flijimi me përmasa të vogla dhe të një kohe të mëpasme në Orik (Dh. Budina, *Gërmime në teatrin e Orikumit*, «Studime historike», 1964, 1, f. 160).

⁹ *Dictionnaire des Antiquités grecque et romaine*, Paris, 1877, s.v. Ara; shih edhe M.P. Nilsson, *Geschichte der Griechischen Religion*, München, 1955, tab. XXXIV, 2; M. Santangelo, *Selinunte*, Roma, 1961, f. 87; *Istoria tou elenikou ethnou*, vëll. III, Athinë, 1972, f. 372.

kafe. Ky zbukurim në Durrës është parë në tjegulla arkaike që shoqërojnë një grup terrakotash arkitektonike të shek. VII p.e. sonë.¹⁰ Përmendim dhe gjetjen e një kapaku amforete me vernik të zi me shkëlqim blu, prej një balte të kuqe, që mendojmë se i përket prodhimit atik të shek. V p.e.s.

Me këtë shtresë do të lidhnim dhe një terrakotë, e vetmja në materialin arkeologjik të përftuar prej këtij gërmimi, ndonëse u gjet në fillimet e shtresës së dytë. Është një figurinë antropomorfe me trup gati cilindrik dhe me krahë rudimentarë në trajtë cungjesh të vogla (koka mungon) (tab. III, 10). Është punuar me dorë. Forma e trupit lë për të kuptuar se paraqet një femër të veshur me kiton të gjatë deri në fund të këmbëve.

Balta okër-rozë. Lartësia 6,5 cm.

U ngjan terrakotave arkaike greke të zbuluara në Rod, që janë identifikuar me Artemisin.¹¹

Ndërtime të tjera

Ndërtimet e tjera, që shtrihen përreth dhe që i përkasin horizontit të mësipërm, dallohen për një material ndërtimi dhe teknikë shumë më të dobët: gurë të vegjël e mesatarë gjysmë të punuar, të lidhur në të thatë. Ato dallohen, gjithashtu, për aq sa janë zbuluar, edhe për një asimetri në raport me altarin e flijimit, mund të themi edhe midis tyre (fig. 2). Të gjitha këto si dhe materiali arkeologjik relativisht i bollshëm i shek. IV-III p.e. sonë i zbuluar në këtë shtresë tregojnë se ndërtimet e këtij

¹⁰ M. Zeqo, Dëshmi të artit arkaik në Durrës, «Iliria, 1986, 1, f. 172.

¹¹ R. A. Higgins, Terracotas in the British Museum, Oxford, 1954, f. 277.

horizonti i përkasin një kohe të mëpasme, por siç e thamë, ato duken të bëra për të bashkëjetuar me altarin.

Në anën lindore, sheshi i vogël rreth altarit kufizohet nga një mur 8,30 m i gjatë dhe 1,10 m i gjerë, i ndërtuar me gurë të vegjël të çrregullt (fig. me ngjyra; 2, 3). Lartësia e tij ndryshon nga 0,30 në anën e altarit deri në 0,70 m në anën e jashtme, ku duket se terreni ka një ulje. Ky mur shihet se është i ngritur në fazën e dytë të ndërtimeve, ndoshta për të mbështetur dhe zgjeruar pak sheshin e altarit. Ky supozim gjen mbështetje në faktin se syprina e gjerë e këtij muri arrin nivelin e këmbëshkallës së dytë të altarit, që është ai i bashkëekzistencës së altarit me ndërtimet e fazës së dytë. Në këtë anë të altarit, mbi sheshin e horizontit të dytë, duke përfshirë edhe syprinën e këtij muri, u gjetën gjurmë zjarri dhe kocka bagëtish.

Në anët e tjera të altarit konstruksionet e horizontit të dytë janë mure tarracimi, kalldrëme, platforma kuadratike të kufizuara me mure të ulëta dhe xokolatura (fig. 2). Nga ana veriperëndimore, perëndimore dhe jugperëndimore ngrihen dy mure tarracimi (4,5) të lartë 1-1.20 m, që formojnë një kënd të gjerë midis tyre dhe në horizontin e dytë, më lart, kufizojnë kalldrëmet A dhe B. Këto mure janë ndërtuar me gurë të vegjël e mesatarë, në radhën e fundit edhe me ndonjë popël. Gurët janë gjysmë të punuar, me faqen të prirur për kuadratike dhe janë të vendosur në rreshta pak a shumë të rregullt horizontalë, të lidhur në të thatë. Rreshti i fundit formon një xokël pak të profiluar në anën e jashtme, që mbulon paksa këmbëshkallën e poshtme, duke shtuar kështu edhe një të dhënë që këto mure janë ngritur në një fazë të mëpasme.

Karakteristikë për ndërtimet e këtij niveli janë dy platforma drejtkëndëshe me gjatësi 7 dhe 7,90 m (fig. 2-6, 7) dhe dy të tjera me gjatësi të barabartë 4,30 m (fig. 2-8, 9; fig. 5, b, c), që kanë të katra gjerësi dhe lartësi të barabartë, përkatësisht 2,15 dhe 0,4 m. Këto janë kufizuar nga të katër anët me mure të ulëta, si ato që përmendëm më sipër, dhe brenda janë mbushur me baltë të ngjeshur, me zhur, gurë të vegjël e copëra solenesh. Sipërfaqen e kanë pothuaj të rrafshët, herë-herë të mbuluar me fragmente solenesh të ngjyrosura me një bojë vjollcë ose të kuqe në kafe.

Duhet thënë se, me gjithë asimetrinë që vërehet në ndërtimet e këtij niveli, platformat në fjalë duket se priren ndaj një skeme të caktuar që i ngjan formës së shkronjës T me shtagën e sipërme të ndarë. Xokolaturat sekondare (11, 12, 13, 14), që e prishin këtë rregullsi, i përkasin një dore të dytë në këtë nivel. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për konstruksionet e kufizuara me solene të vendosura në këmbë për së gjati (10), që kalojnë sipër kalldrëmit të anës jugore.

Në skajet e platformave 6 dhe 7 u gjetën tri blloqe të mëdha kuadratike, prej të njëjtit gur dhe të latuar e të skuadruar bukur si blloqet e gurëve të altarit. Përmasat e tyre përputhen me ato të bllokut të sipërm të tryezës së hyjnisë para podiumit të altarit.

Hapësirat e mbetura midis gjithë ndërtimeve që përmendëm më sipër paraqiten të sheshta dhe vende-vende të shtruara me fragmente solenesh të vendosura shtrirë (D, E). ose skiç në formë parketi (C).

Për sa i përket funksionit të këtyre ndërtimeve të pazbuluara në tërë shtrirjen e tyre, është vështirë të bëhet një interpretim përfundimtar. Mund të themi se kalldrëmet A dhe B, që e qar-

kojnë altarin e flijimit pothuaj në tri anë, kanë shërbyer si rrugica për qëndrimin e besimtarëve gjatë ceremonive. Dihet që besimtarët e grumbulluar rreth altarit për të ndjekur ceremonitë e ndryshme nuk formonin një rreth të plotë. Ata zinin vend gjithmonë në tri anë të altarit, duke e lënë të lirë anën lindore.¹² Edhe në rastin tonë, planimetria e ndërtimeve të zbuluara (fig. 2) si dhe harta e izovijave të rezistencës elektrike specifike (fig. 3) tregojnë se ana lindore është e lirë. Sasia e tjegullave të zbuluara mbi këto kalldrëme dhe pranë tyre na shtyn të mendojmë se do të kenë qenë të mbuluara me çati për t'i mbrojtur të pranishmit si nga rreshtjet në kohë të keqe, ashtu dhe nga moti i keq.

Platformat kuadratike që përmendëm, të ngritura 0,40 m nga sipërfaqja dhe disa të pajisura me nga një bllok të madh kuadratik në skajet e tyre, ka mundësi të kenë shërbyer po ashtu si altarë në qiell të hapët në një fazë të zgjerimit të sanktuarit. Por ndoshta mund të kenë shërbyer edhe si struktura për banketet rituale, aq të njohura jo vetëm në pritanitë, por edhe në altarët e flijimit.¹³

Gjetjet në shtresën e dytë

Materiali arkeologjik i shtresës së dytë, të sipërme, përbëhet kryesisht nga fragmente tjegullash të shpërndara në tërë sipërfaqen, por me një dendësi më të madhe në anën lindore. Në të bëjnë pjesë edhe qeramikë e përdorimit të përditshëm, një numër monedhash bronz, disa stoli bronz, disa gozhdë hekuri, një

¹² B. Berquist, *The Archaic Greek Temenos*, Lund, 1967, f. 113.

¹³ S.G. Miller, *The Prytaneion, its Function and Architectural Form* University of California Press, London, f. 34; shih edhe M. P. Nilsson, *vep.cit.*, f. 830.

numër guackash deti dhe një sasi e vogël kockash bagëtish, të shpërndara edhe këto në tërë shtresën, por me një përqëndrim më të theksuar rreth altarit monumental dhe krepisit. I gjithë materiali datohet në shekujt IV-III p.e.sonë.

Tjegullat përfaqësohen nga një mori fragmentesh solenesh dhe kalipteresh. Solenet janë të tipave me buzë të mysët dhe të lugët. Gjatësia e plotë e tjegullës, e ruajtur në një rast, është 0,86 m. Trashësia e tyre është 2-3 cm, tek buzët 5-6 cm. Paraqiten variante përsa i përket gjerësisë së buzëve (tab. I).

Në disa fragmente përmbahen vulat monogram  dhe  (tab. I), që njihen në tjegullat solene të zbuluara në Durrës.¹⁴ Monogrami i parë, i zbuluar në bloqe gurësh të ndërtesave të rëndësishme si dhe në tjegulla në Apoloni dhe në qendra të tjera antike, është lexuar dauóola (shtetërore).¹⁵ Kjo vulë në gërmimin tonë u shfaq dhe në një pjatë me vernik të zi (në katalog nr. 14). që përbën rastin e parë deri më sot në enët e baltës në Durrës. Për sa i përket monogramit të dytë, mendojmë se përbëhet nga shkronjat delta dhe jota. Në rastin tonë, të dyja vulat kuptohet se i përkasin punishtës shtetërore të qeramikës në Dyrrah, e cila, me sa shihet, përveç tjegullave, prodhonte edhe enë balte.

Në gjithë masën e fragmenteve të tjegullave nuk u paraqit në asnjë rast vula me emër pritani eponim, aq e njohur në fondet e muzeut arkeologjik të Durrësit në këtë lloj materiali ndërtimor. Ky fakt mendojmë se tregon këtu një cak kohor para mesit të shek. III p.e.s., kur emrat e pritanëve eponimë nuk ishin shfaqur

¹⁴ Material i pabotuar. ruhet në fondet e Muzeut arkeologjik të Durrësit.

¹⁵ N. Ceka, Apolonia e Ilirisë, Tiranë, 1982, f. 81: Vula antike mbi tjegulla në trevën midis Aosit dhe Genosit, «Iliria» 1982, 1. f. 114. 117.

as në drahmet e Dyrrahut.¹⁶ Këtë mendim na e përforcon, nga ana tjetër, mungesa, këtu, e qeramikës me zbukurime në relief, apo e tipit Megarë, që në Dyrrah shfaqet nga fundi i shek. III p. e. sonë.¹⁷

Kalipteret janë të tipit korintik (tab. I). Tek një pjesë e tyre jo vetëm shpina, por edhe ana e brendshme formon një linjë të thyer në trajtë gjysmëgjashtëkëndëshi. Tek një pjesë tjetër edhe ana e brendshme formon një linjë të harkuar.

Tullat pothuaj mungojnë. U gjetën vetëm dy fragmente, që janë prej një balte jo të pastër, të pjekur jo mirë, me trashësi 9 cm.

Qeramika e përdorimit të përditshëm përbëhet kryesisht nga fragmente enësh, më përfaqësueset e të cilave, si dhe të gjetjeve të tjera, janë përfshirë në katalogun më poshtë. Një pjesë u përket enëve me parete të trasha siç janë amforat. Këto përfaqësohen nga disa pjesë grykash dhe një numër fundesh konike ose të sheshta. Pjesa më e madhe e tyre, duke u bazuar në baltën, mendojmë se i përket prodhimit vendës. Por, duke u bazuar përsëri në karakteristikat e baltës, në një rast edhe tek stampa mbi vegjë, kemi identifikuar edhe prodhimin korintik dhe atë të Knidit (në katalog nr. 1, 2, 4).

Ndër enët e përdorimit të përditshëm vendin kryesor e zënë ato të tavolinës, si pjatat, frutoret, skifosat, ojnohetë e olpet. Mbizotërimi i këtyre mendojmë se lidhet me funksionin që kanë kryer këtu si dhurata në altar, ex-voto. Kështu, dihet që mbi

¹⁶ H. Ceka. Datimi i drahmere të Dyrrahut dhe të Apolonisë. «Studime historike», 1966, 1, f. 38, 39.

¹⁷ H. Hidri, Kupa me dekor në relief të Dyrrahut, «Iliria», 1988, 1, f. 76.

«tryezën e hyjnisë» të altarëve antikë vendoseshin ëmbëlsira, fruta, pije etj. dhe për këto, natyrisht, përdoreshin pjatat, frutoret, ojnohetë, skifosat etj. Ndërsa prurja e vajit dhe e verës për t'u blatur në ceremonitë fetare kryhej sigurisht me anë të amforave, që këtu përfaqësohen relativisht mirë.

Një tregues interesant të karakterit kushtues të enëve të blatuara përbëjnë fundet e disa prej tyre, që u gjetën të biruara në qendër (kat., nr. 6, 15, 23, 26; tab. II, 5; tab. III, 11, 12). Enë të biruara në fundet e tyre me anë të një mjeti të fortë shpues, ndoshta gozhdë, që i përkasin periudhës helenistike, në fondet e Muzeut arkeologjik të Durrësit vijnë dhe nga një pikë tjetër në kodrat e qytetit.¹⁸ Kjo dukuri mendojmë se shpjegohet më së miri si një veprim i qëllimshëm në përputhje me normën e njohur në antikitet, që ndalonte ripërdorimin e enëve të blatuara. Me karakterin kushtues të enëve do të lidhnim së fundi edhe dy mbishkrime brenda këmbës së një pjate dhe të një kupe, të realizuara me gërvishtje sipër vernikut të zi (kat. nr. 15, 27). Njëra mban siç duket, emrin e pronarit të saj, që e ka dhuruar: Agiorývos (tab. II, 2).

Me të njëjtin funksion mendojmë se lidhen gjithashtu edhe pak stoli bronzi (kat., nr. 32-34), një alabastër, një numër guackash deti, një sasi e vogël kockash bagëtish, siç duket të flijuara, dhe sidomos tetëdhjetë monedha bronzi. Këto të fundit, që u gjetën të shpërndara në tërë shtresën, shpeshherë që në thellësinë deri 20 cm, janë tepër të brejtura, pa dyshim nga veprimi gërryes i kripës në ujin e lagunës, dhe të palexueshme.

¹⁸ Material i pabotuar.

Vetëm një monedhë është e lexueshme (kat., 37). Kjo i përket tipit Herakli/armë dhe mban emrin e monetarit Λάηv. Ky fakt mund ta datojë këtë monedhë pas mesit të shek. III p.e.sonë. Por, duke marrë parasysh kronologjinë e përgjithshme të materialit të zbuluar, do të thoshim se ky përbën një përjashtim. Si i tillë, do të shpjegohej nëse vendi i shenjtë i sanktuarit është vizituar nga besimtarët edhe pas braktisjes së tij, dhe ata, në vend të dhuratave të mëparshme, janë mjaftuar duke lënë këtu monedha.

KATALOG

Enë balte me parete të trasha: amforat.

1. Pjesë gryke amfore «korintike-A» (tab. IV, 8). Buza e përvjelë nga jashtë dhe e mbivendosur në formë strehe. Baltë e ashpër, me sipërfaqen të kuqe në kafe dhe thelbin gri të errët. Datohet në shek. V-IV p. e. sonë.¹⁹

2. Fragment vegje amfore «korintike-A» (tab. IV, 9).

I takon një vegje në trajtë unazore, që e ka kurrizin të shtypur për të formuar një prerje gati trekëndëshe. Baltë e fortë në ngjyrë të kuqe, që përmban grimca të bardha e të zeza. Datohet si më lart.

3. Grykë amfore «korintike-B» (tab. IV, 6). E shtypur në të dy anët për të marrë një formë të përafërt me numrin 8.

Buzët pak të trashura, të rrafshta lart, të mysëta anash. Qafa e shtypur në të dy anët e buzëve, me një shirit të ngushtë e të lugët

¹⁹ C. G. Koehler, *Corinthian Development in the Study of Trade in Fifth century*, «Hesperia» 50, 1981, 4, f. 454; shih edhe N. Ceka, *Amfora antike nga Margëlliçi, «Iliria»*, 1986, 2, f. 77, grupi c.

midist dy kanelyrash të cekëta horizontale në vendlindjen e saj me anët e buzëve. Baltë okër-rozë. Diam. 13 dhe 9 cm. Lartësia e qafës 12 cm. Datohet në fundin e shek. IV p.e.s.²⁰

4. Vegjë amfore e Knidit (tab. IV, 5).

Vegjë shiritore me prerje gati vezake. Në kurrizin e harkuar të pjesës së sipërme ka një stampë rrethore që përmban figurën e një amfore dhe në dy anët shkronjat: A-M.

Balta okër-rozë me grimca të bardha. Gjatësia 19 cm. Datohet në shek. III p.e.s.²¹

5. Fund amfore.

Fund konik, me thundër të ndarë gati dykonike. Baltë e kuqe me grimca të bardha. Në pjesën e mbetur të fundit, nga brenda, u gjet një lëndë si rrëshirë.

6. Fund amfore (tab. III, 11).

I sheshtë, me këmbë të ulët unazore. Baltë rozë. Diam. i këmbës 9 cm. Është biruar në qendër.

Enë të tjera me ngjyrë natyrore të baltës.

Vorbë.

7. Pjesë gryke vorbe.

Ka buzë të dyzuara prej një hullize për vendosjen e kapakut dhe vegjë të tipit «kordele». Baltë e kuqe me përbërje ranore.

Olpe.

8. Olpe jo e plotë (tab. IV, 3).

²⁰ C. G. Koehler, Amphorae on amphorae. «Hesperia» 51, 1983, 3, f. 286; Krs. N. Ceka, art. cit., f. 83, grupi C-4.

²¹ V. Grace, Timbres amphoriques trouvés à Delos, «Bulletin de Correspondance Hellénique» SXXVI-1, 1952, tab. XIX, 4.

Ruhet pjesa e poshtme: parete të drejta, fund i sheshtë. Baltë okër. Diam. i bazës 5 cm. Lartësia (e mbetur) 6,3 cm.

Frutore.

9. Këmbë frutoreje (tab. IV, 7).

Këmbë kërcellore jo e plotë. Lart vjen duke u ngushtuar, poshtë mbështetet në një bazë trunگونike. Në pjesën e poshtme kërcelli zbukurohet me një unazë diskoidale. Baltë kafe me përzierje ranore. Lartësia (e mbetur) 10 cm.

10. Fragment luteri (tab. IV, 11).

Buzë të kthjera nga jashtë, pak të mysëta, që në anën e brendshme kufizohen nga një kanelyrë horizontale. Është i pajisur me një vegjë «astragal» të ngjitur tek buzët. Baltë e kuqe me përbërje ranore.

Ky tip dihet që ka pasur përdorim edhe për qëllime fetare.²²

Qeramikë me figura të kuqe.

Pjata.

11. Pjatë peshku (tab. II, 1).

E shtrirë dhe e cekët, me pjesën qendrore pak të thelluar dhe me buzë të përkulura nga jashtë pothuaj vertikalisht. Këmbë e gjerë unazore. Nga brenda është zbuluar me tri figura peshqish, që ruhen jo të plota, të pikturuara me vernik të kuq në rozë mbi sfond të zi. Si zbukurim mbushës janë përdorur pika të zeza. Anët e buzëve, nga jashtë, janë zbukuruar me motivin e valëve

²² Krs. M. Jazzo, Luteria fittili in Calabria, «Archeologia Classica» XXXIII, 1981, f. 143.

të detit. Pjesa brenda këmbës është ngjyrosur me të kuq, me përjashtim të një rrethi dhe të një pike të zezë në qendër.

Baltë e pastër okër-rozë. Diam. (i përlllogaritur) 21 cm. L. 3 cm.

Në Apulje, në Kampanjë dhe në Pestum pjatat me këto motive kanë qenë të rëndomta ndërmjet viteve 350-325 p. e. sonë.²³

Pjata jonë, nga karakteristikat e baltës, mendojmë se i takon prodhimit vendës.

12. Pjesë pjate peshku (tab. II, 7).

Nga forma dhe balta duket se i përket një pjate si e mësipërmja. Paraqet dy peshq dhe një sepje midis tyre, të pikturuar me vernik të kuq mbi sfond të zi.

Lekit.

13. Është gati i plotë, me trup të vogël cilindrik. Si motiv zbukurues ka një palmetë të kuqe mbi sfondin prej verniku të zi.

Baltë okër-rozë. L. 6 cm.

Në disa fragmente të vogla me figura të kuqe vihen re motive të ndryshme: një dorë femre, gjethe kulpri, loze, motivi i valëve etj.

Qeramikë me vernik të zi.

Pjata.

14. Pjatë me stampë (tab. IV, 10).

E cekët, me buzë të vogla e të rrumbullakuara, këmbë unazore. Në qendër, brenda një rrethi, ka stampën: 

²³ A. Trendall, Southitalian vase painting The British Museum, London. 1966, f. 14.

Baltë okër. Diam. tek buzët 16 cm; i këmbës 10 cm, L. 2,7 cm.

15. Pjesë pjate me mbishkrim të incizuar (tab. II, 2).

E cekët, me buzë të trashura e të rrumbullakuara; këmbë e gjerë unazore. Në anën e poshtme, brenda këmbës, shihet një mbishkrim jo i plotë në dy rreshta, i realizuar me gërvishtje sipër vernikut të zi: [API]THNOY/M - - -

Baltë okër-rozë. Diam. (i përllogaritur) 13 cm. L. 2,9 cm. Edhe kjo ka qenë e biruar në qendër.

16. Pjatë me stampë (tab. II, 8).

E cekët, me buzë të kthyera nga brenda; këmbë unazore. Në qendër një stampë e përbërë prej gjashtë palmetash, që rrezatojnë nga një rreth qendror me një rozetë të brendashkruar. Verniku në pjesën më të madhe është rrjepur.

Baltë okër-rozë. Diam. tek buzët 15 cm, i këmbës 10 cm.

17. Pjatëz me stampë (tab. III, 7).

Buzë të rrumbullakuara e të kthyera nga brenda; këmbë unazore. Në qendër një stampë prej katër palmetash në formë kryqi, që dalin nga anët e një rrethi të incizuar. Në anën e poshtme, brenda këmbës, qendra e kuqe qarkohet nga katër breza rrethorë bashkëqendrorë, të alternuar kuq e zi.

Baltë okër. Diam. tek buzët 12 cm. L. 2,5 cm.

13. Pjesë pjate me zbukurim të incizuar (tab. II, 6).

Pjesa qendrore e zbukuruar në qendër me një rozetë të brendashkruar në një rreth, i cili qarkohet nga harqe të kthyera nga jashtë, që ndërpresin njëri-tjetrin. Figurat janë realizuar me

incizim para pjekjes, teknikë e rrallë kjo për enët e kësaj kategorie në fondet e muzeut arkeologjik të Durrësit.

Frutore.

19. Këmbë frutoreje (tab. III, 4).

Këmbë e lartë kërcellore me një bazë të gjerë rrethore. Kërcelli është zbukuruar me tri unaza diskoidale, që zvogëlohen nga lart poshtë, dhe me breza verniku të kuq në kafe. Në qendrën e pjesës së mbetur të pjatës, një pikë verniku të zi, që qarkohet nga një rreth me ngjyrë kafe.

Baltë okër-rozë. L. 9,5 cm. Diam. i buzës 7,4 cm.

Ojnohe.

20. Grykë ojnoheje (tab. III, 1).

Buzë të gjera në trajtë tërfili: qafë e gjerë. Vegja harkohet mbi supet duke u kthyer gati horizontalisht sipër buzëve. Pjesa e mbetur e supeve e zbukuruar me kanelyra vertikale.

Baltë okër-rozë.

Skifosa.

21. Fund skifosi (tab. IV, 2).

I përket një skifosi me pjesën e sipërme të trupit të fryrë, të poshtmen të ngushtuar gati cilindrike me këmbë unazore. me këmbë unazore. Ana e poshtme, brenda këmbës, me vernik të kuq.

Baltë okër-rozë. Diam. i këmbës 6,4 cm. Tipologjikisht datohet në shek. V-VI p. e. sonë.²⁴

²⁴ C.W. Blegen, H. Palmer, R.S. Jung, Corinth, The Fourth Cemetery, XIII, Princeton, 1964, f. 126.

22. Skifos jo i plotë (tab. IV, 1).

Ruhet pjesa e poshtme e trupit, që vjen duke u ngushtuar, për të marrë një formë trungkonike; këmba unazore pak e profiluar. Një brez i kuq në pjesën e poshtme, sipër këmbës. Në anën e poshtme, brenda këmbës, vernik i kuq me një pikë dhe një rreth të zi në qendër.

Baltë okër-rozë. Diam. i këmbës 4.5 cm. Datohet si më lart.

23. Fund skifosi (tab. II, 5).

I përket një skifosi me trup vezak, të ngushtuar në fund, ku lidhet me këmbën diskoidale. Ka si karakteristikë një brimë të shpuar në qendër.

Baltë okër-rozë. Diam. i këmbës 4,5 cm. Tipologjikisht datohet ndërmjet viteve 350-325 p. e. sonë.²⁵

Kupa.

24. Kupë jo e plotë (tab. II, 9).

Trup diskoidal me buzë të trashura e të kthyer nga brenda. Këmbë unazore. Në qendër një stampë prej katër palmetash (një prej të cilave mungon), që dalin nga anët e një figure të përbërë prej tre rrathësh bashkëqendrorë. Nga poshtë, brenda këmbës, vernik i kuq me një brez rrethor të zi.

Baltë okër-rozë. Diam. tek buzët 8,5 cm, i këmbës 5,6 cm.

25. Fund kupe me stampë (tab. II, 4).

Këmbë unazore. Në qendër një stampë prej katër palmetash në formë kryqi. Pjesa e poshtme brenda këmbës me vernik të kuq.

²⁵ Po aty.

Baltk okër-rozë. Diam. i këmbës 4,5 cm.

26. Kupëz. Trup gjysmësferik me buzë të kthyer nga brenda; fund unazor. Fundi është i biruar. Baltë okër-rozë. Tip i rëndomtë në fondet e Muzeut arkeologjik të Durrësit, i datuar në shek. III p. e. sonë.²⁶

27. Kupëz me mbishkrim. (tab. III, 8).

Pjesa e poshtme e trupit trungkonike, buzë e trashë dhe e harkuar nga brenda; këmbë unazore.

Baltë okër-rozë. Diam. tek buzët 4,6 cm, i këmbës 3 cm.

Nga poshtë, brenda këmbës, një mbishkrim i realizuar me gërvishtje sipër vernikut:  IN.

Gutusa

28. Gutus me grykë në trajtë kullese (tab. III, 2).

Trup i fryrë i zbukuruar me kanelyra vertikale, grykë e rrumbullakët, pak e thelluar, e pajisur me brima në trajtë kullese. Vegjë e vogël unazore mbi supe pranë grykës; lëfyti dhe pjesë të tjera të trupit mungojnë.

Baltë okër-rozë, L. 5,5 cm.

29. Gutus (tab. III, 3).

Trup i fryrë diskoidal; qafa lart vjen duke u holluar; poshtë kufizohet nga tri kanelyra horizontale; vegjë unazore mbi supet; këmbë pseudounazore. Gryka mungon.

²⁶ H. Hidri, Gërmime në nekropolin e Dyrrahut (viti 1977), «Iliria, 1983, 7, f. 152.

Baltë okër-rozë. Lyer në tërë sipërfaqen me një lustër kafe me shkëlqim vende-vende me ndonjë njollë të zezë. Diam. i këmbës 4,8 cm. L. (e mbetur) 7 cm.

Kandil.

30. Kandil i plotë (tab. III, 5).

Trup ekinoform, me diskun të rumbullakët, të thjeshtë; pipthi nga poshtë në trajtë karene, me brimën në anën e sipërme; këmbë pseudounazore. Baltë okër-rozë. Diam. i këmbës 5 cm. L. 4,5 cm.

Gjetje të tjera prej balte të pjekur.

31. Modelim në trajtë briri (tab. IV, 4).

Eshtë një modelim që i ngjan një briri demi pak të harkuar, të thyer në majë dhe në bazën e tij. Në anën e brendshme të harkut përshkohet nga një hullizë e thellë.

Baltë e kuqërremtë në kafe, që përmban grimca ranore. Gjatësia e ruajtur 14 cm.




Tabela I




Tabela II




Tabela III




Tabela IV

Gjetje të tjera.

Objekte metalike

32. Gjilpërë bronzi.

Gjilpërë jo e plotë, me kokë në trajtë omegi. Është një tip i njohur në Durrës dhe në qendra të tjera antike të vendit tonë, i datuar në shek. IV-III p. e. sonë.²⁷

33. Vath bronzi.

Përfaqësohet vetëm nga varësja që ka një trajtë shigjetëze me tri fletë. Gjatësia 3 cm.

34. Paftë bronzi.

Përbëhet prej një petëze në trajtë rrethi, të pajisur me dy grremça të vegjël të kthyer nga faqja e brendshme. Në faqen e jashtme ruan gjurmë të një larjeje me ar. Diam. 3,2 cm.

Stoli prej guacke.

35. Rruaza (tab. II, 4).

Tri rruaza të punuara prej guackash deti, me trajtë pothuaj cilindrike, të tejshpuara për së gjati dhe të zbukuruara me kanelyra në sipërfaqe. Gjatësia 2,5 cm.

Alabastër.

36. Fund i një vazoje të vogël me trajtë vezake. L. (e mbetur) 4 cm.

Monedha bronzi.

Monedhë e Dyrrahut.

Tipi Herakli/armë.

AE.

²⁷ S. Anamali, Nekropoli helenistik i Epidamnit, «Buletin për Shkencat Shqërore», 1957, 1, f. 5, fig. 35.

F. Koka e Herakliut me lëkurë luani, dj.

Shp. Hark; mëzdrag. mill. Mëzdragu maj.; milli me grykën dj.

Brenda harkut: ΔY. Midis mëzdragut dhe millit: ΔAHN

Monedha u gjet pranë krepisit, në një thellësi të vogël. Si variant është i njohur.²⁸

PËRFUNDIME

Altari i flijimit monumental, së bashku me ndërtimet e tjera të fazës së dytë pranë tij, që kanë funksionuar për një kohë së bashku, dëshmojnë për praninë e një sanktuari, në këtë pjesë të fushës së Durrësit në shekujt V-III p. e. sonë.

Të dhënat e deritanishme tregojnë se altari i flijimit nuk ka qenë në funksion të një tempulli. Një veçori të qëndrimit të tij më vete përbën dhe orientimi i tij V-J, ndryshe nga ai kanunor L-P për altarët pranë tempujve.²⁹

Identifikimi i hyjnisë, së cilës i ishte kushtuar altari, bëhet një detyrë e vështirë në kushtet e mosgjetyes së statujës që ka qenë vendosur mbi kolonat, të ndonjë simboli të saj, apo të ndonjë mbishkrimi. Megjithatë, ndonjë e dhënë e tërthortë, siç janë pozicioni në fushë i këtij monumenti, prania e frutoreve, madje dhe e gutusave ndërmjet objekteve të kushtuara, po ashtu dhe mungesa e armëve si blatime, na shtyjnë të supozojmë se kemi të bëjmë me kultin e Demetrës. Një supozim i tillë nxitet dhe nga

²⁸ H. Ceka, Probleme të numismatikës ilire, Tiranë, 1965, f. 151.

²⁹ Vitruvi, IV, 8; shih B. Berquist, vep. cit., f. 111.

një reliev i Demetrës me Koren, që vjen si gjetje rasti nga një pikë rreth 500 m më në veri.³⁰

Për sa i përket topografisë, qenia e këtij sanktuari në këtë territor provon së pari që kënetat në atë kohë nuk ekzistonte, madje as në afërsi, pasi nuk do të mund të ndërmerreshin ndërtime të tilla nën kërcënimin e saj. Duke u bazuar në të dhëna të tilla të njohura siç janë nekropolet e Dyrrahut (fig. 1), ndonjë trakt i murit rrethues në themelet e kalasë mesjetare, si dhe mjaft gjurmë të tjera ndërtimesh, që dëshmojnë për shtrirjen e qytetit edhe në atë kohë brenda kufijve të njohur të periudhave pas-ardhëse,³¹ jemi të prirur ta konsiderojmë këtë si një sanktuar suburban.

I ngritur në një territor fushor, në periferi të qytetit, sanktuari u drejtohet më tepër njerëzve që merreshin aty me bujqësi e blegtori, por, me shumë mundësi, ai tërhoqte edhe banorët e zonës së afërt fshatare, fillimi i së cilës është dokumentuar arkeologjikisht vetëm 3 km më tej, në fshatin Vrrin (fig. 1).³² Në këtë mënyrë sanktuari përbën një dëshmi për rëndësinë që kishte marrë territori i afërt bujqësor e blegtoral për qytetin. Zgjerimi i tij në shek. IV-III p.e.s. flet për një pjesëmarrje më të gjerë në aktivitetet kultike, gjë që para së gjithash do të lidhej me ndryshime shoqërore e demografike në qytet dhe në territorin e afërt.

³⁰ H. Myrto, art. cit., f. 149.

³¹ Këtë argumentim e kemi paraqitur edhe në një rast tjetër (shih po aty), f. 151.

³² H. Myrto, Një varrezë antike në fshatin Vrrin të Durrësit, «Iliria», 1984, 1, f. 216.

RESUME

UN SANCTUAIRE ANTIQUE DANS LES ENVIRONS DE
DURRËS

Dans le présent article on analyse un complexe de constructions antiques découvertes environ 700 m au sud-ouest de la ville actuelle de Durrës.

Le principal édifice est un autel monumental de sacrifice (Fig. 1, 2; pl. IV, b, c; V, d) construit vers le début du Ve s. av. n. ère.

L'autel se compose d'un podium tronconique (1,60 x 1,50 m) haut de 0,98, pourvu de trois marches de chaque côté, devant lequel se trouve un socle carré plus petit (0,85 x 0,85 m), tous les deux reposant sur une base commune (3,70 x 3 m).

Du côté sud, à trois mètres de distance, s'élève une petite krépis (1,10 x 0,38 m) haute de 0,85 m, qui a servi comme support de deux colonnes doriques de pierre calcaire. Les colonnes, hautes de 1,80 m et dont le diamètre de la base mesure 0,38 m, sont décorées par 16 cannelures. Les chapiteaux se caractérisent par l'équin convexe, bombé dans sa partie supérieure.

L'autel est construit avec des blocs de pierre bien appareillés liés au moyen de goujons de plomb.

Les autres constructions autour de l'autel sont faites suivant une technique et avec des matériaux de plus mauvaise qualité: pierres de petite et moyenne taille à moitié façonnées, sèches ou liées avec de la boue. Par rapport à l'autel, le plan de ces constructions est asymétrique. Du côté est la petite place de l'autel se limite par un mur mesurant 8,30 m de longueur sur 1,10 m de largeur; construit avec des pierres irrégulières de petite taille et qui atteint le niveau de la deuxième marche de l'autel.

Les constructions du deuxième niveau qui entourent l'autel des autres côtés sont des murs de terrassement (Pl. II, 4, 5), des pavés, plateformes carrées limitées par des murs bas. Certaines plateformes rectangulaires (pl. II, 6, 7, 8, 9; V, a, b, c), larges de 0,40 m, constituent un élément caractéristique de ces constructions. Elles se limitent de tous les côtés par des murettes et sont remplies de terre battue, de gravier, de pierres de petite taille et de fragments de tuiles. Leur surface est plane et parfois recouverte de fragments de tuiles peintes en couleur violette ou rouge tirant sur le brun.

La fonction de ces constructions secondaires, partiellement découvertes, est difficile à déterminer d'une façon claire. L'auteur leur suppose la fonction d'autel à ciel ouvert dans une phase où le sanctuaire fut élargi, mais il est possible qu'elles fussent destinées aux banquets qui avaient lieu près des autels de sacrifice. Les pavés A et B, qui entourent l'autel de trois côtés, à part le côté est, étaient probablement le lieu où se tenaient les croyants pendant les cérémonies. Quoi qu'il en soit, il est évident que ces constructions ont fonctionné ensemble avec l'autel monumental, du moins celles qui se situaient à partir du niveau de sa deuxième marche.

Le matériel archéologique livré par la deuxième couche date d'une période qui s'étend du IV^e s. jusqu'au milieu du III^e s. av. n.ère. Il comprend des fragments de tuiles, dont certains portent des timbres de l'atelier de Dyrrachium, débris d'amphores, de plats, d'oinochoes, de skyphoi, de fruitières, d'olpés, de guttus etc. On a trouvé aussi une lampe, un lécythe et un objet en forme de corne de taureau. La céramique est pour l'essentiel de production locale, mais on a constaté aussi des productions de Corinthe et de Chnide.

On a recueilli aussi environ 80 monnaies de bronze concentrées surtout autour de l'autel, quelques objets de parure en bronze et un certain nombre de coquillages. L'auteur estime que toutes ces trouvailles, ainsi qu'un nombre d'os de bétail, constituent des restes de dédicaces, des ex-voto.

Un indice intéressant de la destination des récipients en terre cuite constituent les fonds de certains d'entre eux qui étaient perforés (cf. le catalogue, n. 6, 15, 23, 26; pl. VII, 5; VIII, 11, 12), L'auteur a exprimé l'opinion selon laquelle ce phénomène s'expliquerait comme un acte intentionnel conformément à l'usage dans l'antiquité qui interdisait le emploi des objets dédiés dans le sanctuaire.

L'autel monumental avec les autres constructions de la deuxième phase témoignent de l'existence d'un sanctuaire suburbain dans les environs de Dyrrachium aux Ve-IIIe s. av. n. ère. Les données obtenues jusqu'à présent montrent que l'autel ne faisait pas partie d'un temple. Son fonctionnement à part est attesté aussi par son orientation N-S, l'orientation normative des autels situés près des temples étant E-O.

L'identification de la divinité à laquelle fut consacré le sanctuaire devient une tâche difficile en l'absence de la statue qui probablement reposait sur les deux colonnes, de son symbole ou bien de quelque inscription complète. Toutefois, certains renseignements indirects tels que la position du monument dans la plaine, l'existence des fruitières et des guttus parmi les objets dédiés, ainsi que l'absence des armes, incitent l'auteur à supposer que l'on a affaire au culte de Déméter.

TË DHËNA MBI SHTRIRJEN E DYRRAHUT NË PJESËN JUGPERËNDIMORE TË KËNETËS¹

Këneta apo laguna e Durrësit para se të bonifikohet, më 1962, shtrihej në verilindje të qytetit, duke zënë një sipërfaqe prej 2050 ha, prej së cilës 1600 ha plotësisht mbuluar me ujë, ndërsa 450 ha pjesërisht.² Në kohë rreshesh ujërat mbulonin një sipërfaqe edhe më të madhe. Në anën jugore kënetat komunikonte me detin me anë të një kanali të gjatë rreth 2.5 km, që arrinte deri te Spitallës, tek vendi i quajtur Balta e Madhe. Në anën verilindore lidhjen me detin e bënte një kanal tjetër, i quajtur i Brukëve të imta, që hynte deri rreth 2 km në brendësi të tokës, vend i quajtur Balta e Vogël.

Sot pjesa më e madhe e kësaj fushe është nën nivelin e kuotës absolute «0.00» (Tab. 1)³, duke përfshirë brenda edhe zona të vogla deri -0.70 m. Por sistemi i kanaleve kullues të lidhur me hidrovorin e mban nivelin e ujërave në -1.80 m.

¹ Marrë nga revista “Monumentet”, 1, 1984, f. 141-158.

² Rilevim topografik para bonifikimit (ruhet në Drejtorinë e ujërave e sistemimeve Durrës). Në vitet e para pas Çlirimit para se të hapet kanali i Jubës, kënetat shtrihej edhe më tepër nga VL, duke zënë një sipërfaqe prej 3000 ha (shih. P. Geco, Gjeografia fizike e Shqipërisë, Tiranë, 1973, fq. 394-395).

³ Harta me izoipsin 0.00 është marrë nga Instituti i Tokave, Tiranë.

Një vështrim mbi gjeografinë historike

Burimet antike e mesjetare paraqiten të kursyera për topografinë e Durrësit. Prandaj mbi gjeografinë historike të kënetës, mund të nxirren vetëm të dhëna indirekte. Autorët më të hershëm, si Thukididi në çerekun e tretë të shek. V p.e.s.⁴ dhe Eratosteni në shek. II p.e.s.⁵ pozitën gjeografike të këtij qyteti e cilësojnë «gadishull». Nga ky njoftim nuk mund të nxirret përfundim mbi qenien ose mosqenien e kënetës, sepse lidhja e kepit të Durrësit me pastokën mund të kuptohet, ose e gjerë si sot, pra pa kënetën, ose e ngushtuar nga shtrirja e saj. «Gadishull» përsërit edhe Straboni në shek. I p.e.s.⁶ Por nga mesi i atij shekulli Çezari bën fjalë për «dy gryka të ngushta»⁷ të komunikimit me qytetin, për të cilat është shfaqur mendimi se duhen marrë si istmi verior dhe ai jugor i lagunës⁸ Ky supozim gjen mbështetje edhe nga njoftimi i Lukanit se «qyteti do të ishte ishull, pa kodrën e vogël»⁹, ndonëse kjo «kodër e vogël» për gjeografinë e sotme fizike të Durrësit është vështirë të identifikohet. Një ndarje ujore e qytetit nga pastoka e tij, madje do të shtonim një ndarje «e kontrolluar», del më qartë nëpërmjet njoftimit të Prokopit të Gazës, autor i fundit të shek. V dhe shek. VI e. s. kur dyrrahasit i quan «njëkohësisht banorë të ishullit dhe të kontinentit». ¹⁰

⁴ Thuc., 26

⁵ Eratosteni sipas Steph, byz. s.v. Dyrrachion.

⁶ Strab, VII, 8

⁷ Caes, B.C., III, 58.

⁸ G. Veith, Der Feldzung von Dyrrachium zwischen caesar und Pompejus, wien, 1920, fq. 168.

⁹ Lucanus, Pharsalia, VI

¹⁰ Procop Gaz, 491-492.

Në shek. XI, Ana Komnena, duke përshkruar rrethimin norman të Durrësit, përmend një kanal që hyn nga deti në tokë në anën jugore¹¹ dhe le kështu për të nënkuptuar ekzistencën e një lagune. Sidoqoftë shtrirja e saj ka qenë e kufizuar. Ajo nuk arrinte të mbulonte fushën para mureve të qytetit, ku u ngrit një kamp ushtarak për 30.000 njerëz të pajisur me kavaleri të rëndë e me kulla lëvizëse.¹² Autorja shton, nga ana tjetër, se rrethojnësit e ngritën kampin midis rrënojave të Epidamnit antik¹³. Më pas, tërmeti i madh i vitit 1273 thuhet se e mbylli grykën e kanalit dhe shkaktoi rritjen e kënetës.¹⁴

Në shek. XV jepet për herë të parë një njoftim direkt mbi praninë e kënetës dhe mbi emrin e saj të mirëfilltë: «Balta»¹⁵ Po në këtë shekull dhe pikërisht më 12 prill të vitit 1442, senati Venedikut urdhëroi të merrej në shqyrtim një propozim i durrakëve që, me ndihmesën e tyre, të hapej një kanal përmes kënetës, nga veriu në jug, për ta kthyer qytetin në ishull.¹⁶ Një kanal i tillë duket se është hapur, tejmbanë apo jo këtë nuk e dimë, por gryka e tij u mbath shpejt nga rëra e detit.¹⁷ Më 1501, kur turqit sulmojnë dhe pushtojnë Durrësin, mësojmë se në shumë vende kënetë ishte tharë.¹⁸

¹¹ A. Comena, «Alexias», VI, 1.

¹² Po aty, shih dhe L. Heuzy-H. Daumet, Mission Archéologique de Macedoine, Paris, 1876, fq. 349.

¹³ A. Comnena, po aty.

¹⁴ M. Shuflaj, Serbët dhe shqiptarët, Tiranë, 1926, fq. 13.

¹⁵ K. Jireček, Die lage und vergangenheit der Stadt Durrazo in Albanien, në «Illyrisch-Albanische Forschungen», Leipzig, 1916, V, I, fq. 158.

¹⁶ Acta et Diplomata, II, 481.

¹⁷ M. Shuflaj, vep. cit, fq. 12.

¹⁸ Po aty,.

Me interes është harta e parë e lagunës, që njohim, e përpiluar më 1861 nën drejtimin e L. Hezeit.¹⁹ Aty për pjesën jugore është vënë emri «lagunë», ndërsa për veriore, vetëm «moçal», me fjalë të tjera bëhet e njohur natyra e saj e ndarë në, siç quhen, lagunë e gjallë» dhe «lagunë e vdekur».

Njoftimet e përmbledhura më sipër na lejojnë, së paku, të pohojmë se jo në të gjitha kohët, territori që kemi në studim ka qenë tërësisht i mbuluar me ujë. Për më tepër, nga sa bën fjalë Ana Komnena, lind sugjerimi se përtej mureve të Durrësit mesjetar, me sa kuptohet në pjesën J-P të kënetës, duhen kërkuar rrënoja të Epidamnit antik.

Përshkrimi i gjetjeve

Objekte antike me prejardhje nga vendi kriporeve të fillimit të këtij shekulli, të cilat gjendeshin anës J-P të kënetës, përmendin për herë të parë Prashniker dhe Shober.²⁰ Disa dekada më pas, në kohën e punimeve bonifikuese, më 1961-1962, në kënetë u shpëtuan një numër fragmente kolonash mermeri e guri gëlqeror, si dhe objekte të tjera.²¹ Midis këtyre përmendim një kokë mermeri të datuar në shek. I e. s. (Fig. 1)²².

¹⁹ L. Heuzey-H. Daumet, vep. cit, (Plan H)

²⁰ C. Praschniker-A. Schober, *Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Wien, 1920, f. 43.

²¹ Sipas njoftimeve gojore që kemi nga bashkëpunëtori i vjetër shkencor V. Toçi, që përfitojmë nga rasti për ta falenderuar. Materiali ruhet në muzeun arkeologjik të Durrësit, i pabotuar.

²² Fotografia e saj është dhënë në albumin «Shqipëria arkeologjike» Tiranë, 1971, nr. 110.



Fig. 1 pjesën jugperëndimore të kënetës, në drejtim të Rrashbullit (Tab. 1)²⁴.

Në vitin 1971, u ndërmorën gërmime shpëtimi, që vijuan pastaj në mënyrë të rregullt në pjesën VL të qytetit të sotëm, vend që dikur arrihej nga zgjerimet e kënetës. Aty u evidentua një varrezë e shekujve të parë të erës sonë.²³ Vitet e fundit kemi dhënë një raport të hollësishëm mbi mbetjet e këmbëve të ujësjellësit antik, që e përshkonte tejmbanë

Por me një vështrim në sipërfaqe, sidomos në kohën e lëvrimit të tokës, vërehet se mbetjet e ndërtimeve antike brenda kufijve të kënetës së dikurshme nuk kufizohen vetëm me gjurmët e ujësjellësit. Ata kanë shtrirje më të gjerë, si në hapësirë, edhe në kohë. (Tab. 1)²⁵ Duke filluar 600-700 m tej linjës së rrethojës së tretë të Dyrrahut, (400-500 m në lindje të stadiumit të sotëm, haset një shumicë material ndërtimi antik i nxjerrë në sipërfaqe nga punimet bujqësore. Kjo pamje, që vërehet edhe në faqet e kanaleve kulluese, ndeshet edhe në brendësi të kënetës, deri 2 km nga kufiri i sipërpërmendur e qytetit antik, si dhe në

²³ F. Tartari, Rezultate të gërmimeve të vitit 1971 në skajin VL të qytetit të Durrësit, në «Buletin arkeologjik», Tiranë, 1971.

²⁴ F. Miraj-H. Myrto, Ujësjellësi i Dyrrahut, «Iliria», 1982, fq. 131.

²⁵ Të dhënat që do të përshkruhen më poshtë janë përftuar nga autori me anë gjurmimesh në sipërfaqe, ndërhyrjesh shpëtimi dhe të një gërmimi të papërfunduar. Për njoftime të mëparshme, shih H. Myrto, Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit, almanak 1, Tiranë; 1983, f. 57 dhe Rezultate të kërkimeve arkeologjike në kënetën e Durrësit, në «Materiale të sesionit shkencor arkeologjik», Durrës, nëntor 1983, fq. 39-47.

një pikë pranë Bisht-Kamzës në veri. Sipërfaqia e përgjithshme e pjesës J-P të kënetës që i shfaq më dendur këto gjurmë arrin në 80 ha.

Përveç blloqeve të mëdhenj gurësh shtufi e konglomerat që shihen të shpërndarë në sipërfaqe, aty-këtu vërehen edhe gurë të tillë në një linjë, që të lënë përshtypjen se përfaqsojnë rrënoja muresh. Në përgjithësi blloqet e gurëve kanë madhësi të vogël e mesatare dhe janë pa forma të rregullta e të palatuar. Por janë hasur edhe blloqe gurësh të latuar. Ndërmjet këtij materiali përmendim edhe tamburë të plotë e fragmente kolonash dorike e jonike.

Qeramika masive e përdorur si material ndërtimi përfaqsohet kryesisht nga solene e kalipërë (Tab. II). Ato janë të tipeve tanimë të njohura, si në Durrës, edhe në qendra të tjera antike të vendit tonë, të shekujve IV-I p.e.s.²⁶ Por nuk mungojnë edhe tipe që janë karakteristike për periudhën pasardhëse.

Për të formuar një ide më të kurtë mbi domethënien e kësaj dukurie, po përshkruajmë më poshtë rezultatet e një gërmimi ende të papërfunduar, si dhe disa gjurmë të tjera që paraqesin elemente më treguese. Në përshkrimin tonë, si kriter bazë për renditjen e materialit kemi zgjedhur atë gjeografik me drejtimin nga jugu në veri, duke e ndarë sipërfaqen që shfaq gjurmë antike në katër sektorë. (Tab. 1).

²⁶ Shih: A. Mano, Të dhëna mbi qeramikën masive të Apolonisë përdorur si material ndërtimi, «Studime Historike» 1, 1965, fq. 51-79.

Sektori A




Fig. 2

Rreth 400 m në veri të linjës së ujësjellësit është zbuluar një pjesë e mbeturinave të një banese në një sipërfaqe prej 250 m² (Fig. 2). Thellësia e shtresës kulturore nuk shkon më tepër se 0.40-0.60 m. Në pjesën e gërmuar kanë dalë në dukje mbetje themelesh, apo xokolatura muresh, dhe shtroje dyshemesh me gurë, pllloça e material qeramik.

Muret zgjaten deri 8-10 m (4, 6, 7, 8). Gjerësia e tyre shkon nga 0.80-0.90 m (7, 8, 12). Ka edhe pjesë muresh më të vogla, me trashësi 0.40 m (1, 2, 3). Lartësia arrin 0.40 m. Janë ndërtuar me gurë ranorë e konglomerat, me madhësi të vogël e mesatare, që arrijnë përmasa maksimale: 0,6 x 0,3 x 0.2 m. Midis tyre ka gurë më të vegjël, të thyer. Lidhja është bërë me baltë.

Brenda mureve vërehen shtroja kalldrëmsh me gurë të vegjël të çrregullt dhe ndërfutje copra tjegullash (A, B). Shtroja në ambientin A arrin deri në nivelin e xokolaturës së mbetur të mureve, kurse në «B» në një nivel 0.20 m më të ulët. Një pjesë dysHEMEJE (E) është prej fragmente solenesh dhe fragmente të

rralla amforash, të shtruara mbi baltë të ngjeshur e përzier me zhurishte.

Në pjesën veriore të sipërfaqes së zbuluar ka dalë jo tërësisht një xokolaturë (15), me formë katërkëndëshi (7,80 x 2,80 m). Kufizohet anash prej një bordure gurësh të vegjël të lidhur me baltë dhe të puthitur mirë, që përcaktojnë lartësinë e saj 0.15m. Brenda është mbushur me baltë të ngjeshur dhe copra tjegullash e gurësh të vegjël. Ka një ndarje të brendshme, e përcaktuar nga një linjë e hollë muri.

Në skajin e kësaj xokolature u gjet një bllok i madh kuadratik travertin (0.85 x 0.85m) i latuar nga të gjithë anët. Në faqen e sipërme të tij mund të dallohet shenja e një rrethi me diametër të madh, e mbetur ndoshta nga mbivendosja e një kolone. Një bllok identik u gjet pranë (Fig. 3).

Anash mureve 1, 4, 6, nga jashtë, si dhe në anë të shtrojes «E» u zbuluan mbetje konstruksionesh të lehta prej tjegullash solene, të një forme interesante. Këto janë në trajtë bankinash të vogla²⁷ të kufizuara anash prej solenesh. Në krah të murit C një «bankinë e tillë u gjet e mbuluar edhe nga sipër me solene të fragmentuara të vendosura në këmbë. Mbushja ishte prej dheu me ndonjë fragment të rrallë ene me vernik të zi,

Si për gjithë planimetrinë e pjesës së zbuluar të kësaj ndërtese në raport me të tërën, edhe për funksionin e këtyre konstruksioneve të lehta në të, nuk mund të japim ende një gjykim të sigurt. Këto të fundit kanë përngjasim ndoshta me konstruksione të një

²⁷ Gjerësia e tyre arrin 0.76 m, thellësia 0.44 m.

natyre të afërt që janë vërejtur në shtëpi të shekujve IV-III p.e.s. në Apoloni.²⁸



Fig. 3



Fig. 4

Mbi gjithë sipërfaqen e zbuluar u gjetën një mori fragmente tjegullash solene e kaliptere, si dhe fragmente enësh balte.

²⁸ L. Rey, Fouilles de la mission française à Apollonie et à Durrazzo «Albania» 1923-1924, fq. 14.

Solenet janë të tipeve të përmendura më lart (Tab. II, 8, 9, 12, 14). Një pjesë e tyre kanë qenë të lyera në faqe me një lustër violet ose të kuqe të hapët. Në një fragment përmbahet vula monogram siç duket e përbërë nga gërmat Δ dhe A (Tab. II). Kjo vulë është e njohur dhe në tjegulla të tjera solene nga Durrësi.²⁹ Ky monogram, por me gërmën M poshtë, është gjetur mbi tjegulla solene në Klos³⁰ dhe është lexuar $\Delta\alpha\mu\omicron\delta\iota\alpha$ (shtetërore). Është gjetur edhe në blloqe gurësh të godinave kryesore në Apoloni³¹ dhe po ashtu është lexuar «shtetërore». Kalipteret janë të tipit «korintik» (Tab. II, 1).

Bie në sy mungesa e tullave. Kjo na lejon të bëjmë supozimin se muret përmbi xokolaturën e gurtë kanë qenë prej qerpiçi të dobët ose prej materiali të drunjtë e të lyer me baltë, që nuk ka lënë gjurmë të dukshme. Kjo teknikë ndërtimi është e njohur në vendin tonë në banesat e periudhës qytetare ilire.³²

Enët e baltës përfaqsohen nga fragmente pitosash e amforash, si dhe enësh kuzhine e tavoline³³ (Tab. III, 1, 2, 4, 8, 9).

²⁹ Material i pabotuar në fondet e Muzeumit të Durrësit.

³⁰ L. Papajani, Gërmimet arkeologjike të vitit 1974 në qytetin ilir të Klosit, në << Buletin arkeologjik » Tiranë, 1974, f. 39-40.

³¹ N. Ceka. Apolonia e Ilirisë, Tiranë, 1982, fq. 81.

³² F. Prendi, Urbanizimi i Ilirisë së Jugut në dritën e të dhënave arkeologjike, «Kuvendi i Studimeve Ilire» Tiranë, 1974, fq. 117.

³³ Këto janë fragmente skyfosash me vernik të zi (Tab. III, 1, 2), fragmente ojnoheje në ngjyrën natyrale të baltës okër-rozë, si dhe një kandil balte me vernik të zi (Tab. III, 3).

Ndërmjet këtyre përmendim një pjatë me figura të kuqe, që paraqet dy peshq dhe një sepie (Fig. 4)³⁴

Janë gjetur edhe disa objekte të pakta metalike (Tab. III)³⁵, si dhe 23 monedha bronzi, tepër të brejtura nga oksidimi. Megjithatë tek disa dallohen të dhëna që mund t'i identifikojmë me monedha të Dyrrahut të tipit Herakli /armë, tip që dihet se ka filluar të pritët në këtë qytet që në shek. IV p.e.s.³⁶

Në këtë mënyrë, shtëpia që evidentohet deri tani pjesërisht dhe që në të ardhmen shpresojmë të zbulohet e plotë, mendojmë se i përket fundit të shek. IV dhe fillimit të shek. II p.e.s.

Mbetje banesash antike në këtë sektor shihen edhe pak më në veri, në skarpatën e një kanali.

Më evidente është faqja e një muri guri në skarpatën e po këtij kanali por rreth 400 m më në lindje (Fig. 5). Ky përbën këmishën e jashtme të një xokolature (me gjatësi 6. 30 m, gjerësi 0.70 m dhe lartësi 0.95m), që vazhdon, e pazbuluar, në drejtim të veriut. Muri është ndërtuar me blloqe të punuar gurësh shtufi e konglomerat me përmasa mesatare që arrijnë deri 0.96 x 0,44 x 0.28 m. Blloqet janë lidhur në të thatë dhe formojnë fugatura horizontale jo fort të drejta. Radha e fundit e gurëve del pak jashtë, duke krijuar një shkallëzim me gjerësi 10-20 cm. Thellësia e bazës së këtij muri nga niveli i sipërfaqes është 1.25 m. Ndërtimi, që siç

³⁴ Pjata peshqish me figura të kuqe të stilit Apul kanë qenë në përdorim të rëndomtë në Apolie, Kampanje dhe Pestum ndërmjet viteve 350-235 p.e.s. (A. Trendall, Southitalian vase painting, «The British Museum», 1966, fq. 14).

³⁵ Të tilla si një gjilpërë dyshe në trajtë «omege» (Tab. III), tip i njohur në stolitë ilire, dy gozhdë bronzi, dy gozhdë hekuri (T. ill).

³⁶ H. Ceka, Probleme të numismatikës ilire, Tiranë, 1965, fq. 38.

thamë mbetet ende i pa zbuluar në drejtim të veriut, të jep përshtypjen se ka shërbyer si një bazament për një mbi-konstruksion që është zhdukur.³⁷



Fig. 5

Rreth 180 m në veriperëndim të kësaj pike, midis një sasive fragmentesh qeramike ngjitur pas plisave argjilorë, kemi gjetur një terrakotë jo të plotë, që tipologjikisht datohet në shek. III-II p.e.s.³⁸

³⁷ Duke pastruar faqet e dukshme të murit, kemi mbledhur fragmente solenesh dhe enësh balte, ndër to edhe një fragment vazoje me figura të kuqe.

³⁸ R.A. Higgins, *Greek Terracottas*, London; 1967, fq. 125.




Tabela I




Tabela III

Po në këtë sektor, në jug të linjës së ujësjellësit antik, duke vërejtur faqet e kanaleve kullues, si dhe gjurmë të dukshme në sipërfaqe, kemi mundur të ndjekim mbetje të një muri me gjatësi rreth 500 m (Tab. 1). Materiali i përdorur në këtë mur, gjerësinë e të cilit nuk kemi mundur ta përcaktojmë, përfaqësohet nga

fragmente tullash (me trashësi 5 dhe 6 cm, por edhe 3-4 cm), si dhe llaç gëlqeror përzier me copra tulle, që formon fugatura horizontale 5-6 cm të trasha. Midis këtij materiali ndërtimor përmendim edhe fragmente detajesh arkitektonike dhe skulpturash, disa syresh prej mermeri.

I murosur në të ka qenë edhe një altar varri me mbishkrim latin (Fig. 6, a, b). Ky u gjet i nxjerrë në sipërfaqe mbi një vazhdë prej gurësh të mëdhenj, fragmente tullash dhe llaçi gëlqeror të përzier me copra të trasha tulle, vazhdë kjo që ndiqet në një gjatësi deri 15m.




Fig. 6, a, b.

Altari është prej mermeri të bardhë. Lartësinë e ka 1.10m, gjerësinë e mbetur 0.43 dhe trashësinë 0.35 m. Vende-vende ruan gjurmë llaçi gëlqeror, si provë e një ripërdorimi në murosje. Lart ai kulmohet nga një pjesë në formë cilindrike. Në anën e sipërme të brinjës së mbetur ballore të tij del në reliev një kokë demi. Brirët e tij janë stolisur me kordele, dy bishta të së cilës

zbresin njëri anash faqes ballore dhe tjetri në faqen anësore. Prej brirëve të demit varet në këto dy faqe edhe nga një feston gjethe lulësh e frutash, që harkohen në anën e poshtme.

Ndërsa në pjesën e sipërme të faqes së mbetur anësore është paraqitur një rozetë në relief, në faqen ballore, brenda një *tabulae ansata*, është gdhendur një mbishkrim latin në gjashtë rreshta, që ruhet jo i plotë në anën e majtë:

(.... mforius/ ... menos/ ... s-perp/ ... rhedris/su-is/d.p.

Motivi i bukranos na kujton fragmentin e frizit të gjetur në Durrës, që tani ruhet në Luvër.³⁹ Një fragment altar varri zbukuruar në të njëjtën mënyrë është gjetur në kishën e Petovës të rrethit të Fierit dhe është datuar në shek. II e.s.⁴⁰ Altari ynë mendojmë se i takon shekullit të parë të erës sonë dhe është marrë diku afër për t'u ripërdorur si material ndërtimi në një mur të shek. V-VI e.s, i ndërtuar ndoshta në rrethana që kërkonin ngutje.

Me materialin e mësipërm do të shoqëronim edhe një cippus (gur varri) me prejardhje nga zona verilindore e qytetit, kufi me fushën e kënetës së dikurshme, ku ngrihen banesa të reja. Është një tip i veçantë (Fig. 7, a, b), i panjohur deri më sot në vendin tonë. Trungu i tij paraleliped (0.97 x 0.46 x x 0.39 m) kulmohej nga një pjesë piramidale e zbukuruar me motivin e luspave të peshkut apo të «tjegullave në çati». Në meset e secilës brinjë të bazës ka kllapa me pjesëza plumbi, të cilat kuptohet se kanë shërbyer për ta lidhur me bazamentin, që mungon.

³⁹ L. Heuzey-H. Daumet, Mission..., fq. 382-384, Tab. XXVII, 4.

⁴⁰ C. Praschniker, Muzakhiu und Malakastra, Wien, 1920, fq. 183, fig. 10.



Fig. 7, a,b

gurtë fronti zbuluar në amfiteatër.⁴²

Motivi zbukuronjës gjen paralelizëm tek një shembull i cippusit të rrumbullakët liburn me mbishkrim latin që ruhet në muzeun e Splitit.⁴¹ Në Durrës e kemi vërejtur vetëm në një rast tjetër, në zbukurimin e një krahu të

Karakteristikë të veçantë, përveç formës, ka edhe përsëritjen e të njëjtit mbishkrim në dy faqe të kundërta:

M(arco) Terentio/Syro/Padia Prima/viva fecit)/ h
(oc)m(onumentum) h(eredem) n(on) s(equetur).

Emri Syro i përket një antroponimi të vjetër ilir.⁴³ I përdorur në këtë rast sipas formulës onomastike romake, në funksionin e «cognomen», përfaqson një shembull të ruajtjes së antropomisë ilire në banorët e Dyrrahut edhe mbas fillimit të përdorimit të emrave romakë. Mendojmë se i takon shek. I e.s.. Paraqitja e të njëjtit mbishkrim në dy faqe të kundërta të monumentit tregon se ka qenë vendosur në anë të një rruge kryesore, për t'u shikuar nga të dy drejtimet.

Në skajin perëndimor të këtij sektori është gjetur një bllok paralelopiped me bazë katrore, prej guri travertin, me lartësi 0.37

⁴¹ J.J. Wilkes, Dalmatia, Cambridge, Massachusetts, 1969, Tab. 22.

⁴² Ruhet në fondet e muzeut arkeologjik të Durrësit.

⁴³ H. Krahe, Lexikon Altilyrischen Personennamen, Heidelberg, 1923 fq. 105. Për përdorime të tjera, shih dhe L. Heuzey, Mission.... fq. 152 si dhe C.I.L. III, 611.

m dhe gjerësi 0.16 m (Fig. 8, a, b). Paraqitet i lëmuar vetëm në tri anë, i thyer në pjesën e sipërme dhe i prerë jo rrafsh në anën e poshtme. Në njëërën faqe të tij, brenda një kornize të cekët, është gdhendur mbishkrimi: PRIVAT. Në faqen e përkundërt lexojmë katër gërma, prej të cilave e para nuk është e plotë PVBL.



Fig. 8, a,b.

Guri na duket i ripërdorur dhe gërmat të gdhendura jo nga një dorë mjeshtri. Mendojmë se është dhënë në trajtën e shkurtër dhe duhet transkribuar: Privat(us), Publ(icus). Kështu do ta merrnim këtë gur si një shtyllëz sinori (cippi terminalis)⁴⁴, i vendosur, siç ishte zakon, në një pikë kufiri midis një toke private dhe pronës publike të qytetit, që në periudhën e mëparshme mund të ishte kullotë, pyll, etj.⁴⁵

⁴⁴ I. Calabi, *Epigrafia latina*, Milano, 1968, (shih cippi terminalis).

⁴⁵ E. Lepore, *Per una fenomenologia storica del rapporto città-territorio in Magna Grecia*, «La città ed il suo territorio», *Atti del settimo convegno di studi sulla Magna Grecia* (Taranta 8-12 ottobre), Napoli, 1968, fq. 32.

Në afërsi të pikës së mësipërme, duke ndërmarrë një gjurmim shpëtimi u zbuluan tre varre 0,5-1 m larg njëri-tjetrit. Dy prej tyre, tek të cilët është zbatuar riti me vendosje kufome, ishin mbuluar me tjegulla në formë kulmi çatie. Varri i tretë, tek i cili ishte zbatuar riti me djegie, përbëhej nga një urnë qelqi e futur brenda një amfore të madhe, pasi kjo ishte sharruar për këtë qëllim mespërmeresi. (Fig. 9). Në supe të amforës ruhet një vulë mbishkrimore në dy rreshta: T. Palfuri Surae T. Palfurilar....

Vula me emrin e Surës na kujton një amforë me «prejardhje ilire», e gjetur në Brindisi të Italisë.⁴⁶ Në Durrës ky emër njihet edhe nëpërmjet gurësh mortorë të shek II e.s.⁴⁷

Nga këto të dhëna dhe në mënyrë të veçantë nga inventari i dy varreve të para, një kupë me figura në relief (Tab III)⁴⁸ dhe një kandil i tipit «korintik» (Tab. III)⁴⁹, ky grup varresh datohet në shek. II-III e. s.

⁴⁶ M.H. Callender, *Roman Amphorae*, Oxford University, Taranto-New-Jersey, 1965, nr. T. 682.

⁴⁷ 6) V. Toçi, *Mbishkrime e relieve nga nekropoli i Dyrrahut*, «B.SH.SH.» 2. 1962; f. 105, nr. 50, shih dhe L. Heuzey, vep. cit, fq. 378.

⁴⁸ Kupa ka trup cilindrik, me një këmbë të ulët unazore (L. 4,6 cm. diam. i grykës 6.2 cm). Gjithë faqja e saj është zbukuruar me një sërë figurash në relief dhe e larë nga brenda e jashtë me një lustër të hollë ngjyrë kafe të hapët. Një kupë e ngjashme është zbuluar në Apoloni (shih. A. Mano, *Nekropoli i dystë i Apolonisë*, «*Iliria* >> III, f. 203). Për datimin e këtij tipi nga mesi i shek. II deri në fundin e shek. III e.s., shih H.S. Robinson, *Roman Pottery*, Princeton-New-Jersey, 1959, f. 54).

⁴⁹ Kandili është i tipit «korintik». Në pjesën qendrore të diskut paraqitet Herakliu në këmbë, lakuriq, me mëzdrakun në dorën e djathtë, të mbështetur në tokë dhe me lëkurën e luanit palosur mbi krahun e majtë, që e ka nxjerrë përpara. Në bazën e rrumbullakët të kandilit ka një vulë mbishkrimore tepër të fshirë: [K]αλλο [TOV] Për datimin e këtij tipi kandilash në shek. II-III e.s., shih Ph. Bruneau, *Lamps Corinthiennes*, «B.C.H.» XCV, 1971, fq. 448.



Fig. 9

SEKTORI B

Është sektori me gjurmë ndërtimesh antike më në brendësi të anës jugore të kënetës së dikurshme, që kemi mundur të evidentojmë. Materiali ndërtimor i fragmentuar këtu shfaqet sidomos në një sipërfaqe rreth 2000 m², e shtrirë kjo në dy anët e kanalit të madh kolektor.

Në skarpatën e kanalit si dhe në anët e dy vijave kulluese që derdhen në të, shihet se materiali i nxjerrë në sipërfaqe vjen nga një thellësi 1.5 m. Në këtë thellësi, në faqen e skarpatës lindore kemi mbledhur tulla katrore (44 x 44 x 8 cm). Këtu vërehet dhe një brez prej fragmente solenesh, pitosash dhe amforash. Në sipërfaqe janë gjetur funde, gryka e kapakë amforash, po ashtu dhe fragmente enësh tavoline me vernik të zi e kafe (Tab. III, 13, 14, 15).

Me interes janë edhe disa fragmente solenesh që mbajnë vula të pjesëshme mbishkrimore (Tab. II).

Në këto vula të pjesëshme lexohet i plotë emri i prytanit eponym Kalen dhe nuk vihet në dyshim ai i prytanit eponim Nesyl. Nga të dhënat numismatike njihen prytanë eponymë të Dyrrahut me emrin Kalen dhe Nesyl që i përkasin shek. III p.e.s.⁵⁰ Tjegulla solene me emrin e prytanit eponym Nesyl janë gjetur edhe në një shtëpi të shek. III p.e.s. në Durrës, në kodrën me lartësi 59 m.⁵¹

Por një pjesë e materialit qeramik paraqet karakteristika kronologjike të mëvonshme. Këtu përfshihen fragmente tjegullash të sheshta me buzë të profiluar, tjegulla me kurriz të harkuar që zbukurohen me vija të bëra me gishta para pjekjes, si dhe fragmente terrasigillata e copra flakonesh apo vazosh qelqi. Një fragment tjegulle e sheshtë, me trashësi 1 cm mban një vulë të pjesëshme mbishkrimore: PD (Tab. III). Ndërsa një fragment buze amfore mban vulën e pjesëshme: HER (Tab. III).⁵²

Banasa apo banesat, që evidentohen nëpërmjet këtyre mbeturinave duket se kanë pasur një jetëgjatësi që nga shek. III p.e.s. deri në fillimin e shek. I e. s.

⁵⁰ H. Ceka, vep. cit, f. 45. dhe 141.

⁵¹ F. Tartari, Një ndërtesë e shek. II p.e.s. në Durrës (dorëshkrim) Përfitoj nga rasti për të falenderuar autorin.

⁵² Për amfora të shek. I p.e.s me vula mbishkrimore «HERG» dhe «HER» në buzë të enës, shih. M.H. Cahlander, vep. cit, nr. 627, fq. 139 dhe nr. 693 fq. 138.

SEKTORI C

Shtrihet në veri të sektorit «A» dhe pothuaj i pandarë prej tij. Nga punimet bujqësore për dystimin e një sopi të vogël, në vitin 1974 dolën në dukje tri kthina jo të plota të një shtëpie me mure tullash. Në gjendjen që e gjetëm, muret arrinin lartësinë 0.80 m. Ato qenë ndërtuar me tulla drejtëkëndëshe jo të plota dhe qenë lidhur me baltë të përzier me rërë të hollë. Në to ishin futur edhe fragmente tjegullash e amforash. Vërejtëm fragmente solenesh me buzë të lugët e të mysët, si dhe fragmente të sheshta me buzë pak të profiluar dhe zbukuruar me vija të bëra me gishta. Kalipteret ishin të tipit me kurriz të harkuar.⁵³

Në afërsi kemi gjetur tre tamburë kolonash guri gëlqeror me kanelyra jonike (Fig. 10, a) dhe lisho (Fig. 10, b). Përmasat e tyre janë: a) L. 58, ø 0,24 m, b) L. 0,44 m, ø 24 m; c) L. 0,41 m, ø, 21 m. Në qendrën e secilës bazë të tamburëve ka gropëza

katrore me tendencë për rrumbullakosje.



Fig. 10, a,b

Gjetje me interes në afërsi të mbeturinave të kësaj banese, të nxjerra në sipërfaqe nga punimet bujqësore, janë një pllakë me dy figura në relief dhe një pllakë me mbishkrim latin. Dorën e djathtë e ka kaluar pas belit të së parës,

⁵³ Këtu janë gjetur edhe fragmente pitosash e amforash, vegje dysh amforash me prerje në trajtë 00, fragmente terrasigillata si dhe monedha bronxi mjaft të dëmtuara.

ndërsa në dorën e majtë mban një degëzë gruri me gjethe, paksa të ravijëzuara.

Në tërësi relievi është tepër i dëmtuar, sidomos në fytyrat e grave. Pllaka është e thyer në anën e majtë, por që nuk të lë përshtypjen se ka pasur edhe një figurë të tretë. Një reliev i ngjashëm është zbuluar në Ballsh, që paraqet po ashtu dy gra në këmbë, prej të cilave ajo e anës së djathtë mban në dorë një kokërr shegë.⁵⁴

Çifti në relievin tonë mendojmë se përfaqson Demetrën dhe Korën. Relievi ka karakter votiv dhe siç duket është mbajtur në një shtëpi të lidhur me ekonominë bujqësore.⁵⁵

Pllaka me mbishkrim latin është një pllakë përkujtimore prej mermeri të bardhë, e thyer në të djathtë (Fig. 12). Ka përmasat: L. 0,26m, gjatësi e mbetur 0,36m. Në anën e majtë një brimëz e rrumbullakët e tejshpuar le për të nënkuptuar se ka shërbyer për montim në vendin e destinuar. Brenda është gdhendur mbi-shkrimi që vijon:

Hono [re usus]/p(rincipi)o(ptimo) aed(ili), v(iro)
b(ono)Marco/cliens.

Kjo pllakë kuptohet se i kushtohet qytetarit të shquar Marko, që në qytet ka pasur edhe postin e edilit, nga ana e një klienti të tij. Nga karakteri i shkrimit mendojmë se datohet në shek. I e.s.

Në një pikë tjetër rreth 300 m në perëndim të së parës është gjetur një fragment frize prej guri gëlqeror që paraqet një triglif

⁵⁴ C. Praschniker, *Muzaknia und...*, f. 162, fig. 78, që e ka cilesuar reliev funerar.

⁵⁵ Për Demetrën *ἐπουκιδίη*, mbrojtëse shtëpisë, shih. D. Callipolitis-Flytmans, *Deméter et les Moires*, «B.C.H» XCIV-1970, fq. 46.

dhe një pjesë metopi. Përbëhet nga një bllok me trashësi 15 cm, gjatësi e mbetur 32 cm dhe lartësi 30 cm. Gjatësia e kanelyrës së triglifit është 17 cm. Në afërsi është gjetur një fragment i vogël kolone guri gëlqeror, lisho me mbishkrim rreth gropës qendrore të bazës: Οεω ...



Fig. 11 dhe Fig. 12.

Në këtë sektor, gjurmë ndërtesash antike shihen edhe më nga veriu, deri përtej rrugës Spitallë-Vrrin. (Shënavlash). Një pikë me interes gjendet pranë Spitallës. Në sipërfaqe mund të mbli-dhen fragmente lastrash mermeri, si dhe tulla katrore me kanale diagonalë në faqe, që kanë përmasat 29 x 29 x 2,5cm. Aty kemi gjetur dhe një fragment të vogël kolone me kanelyra dorike.

Por objekti më i rëndësishëm i dalë në sipërfaqe në këtë pikë nga punimet bujqësore i përket skulpturës. Është një kokë vajze prej mermeri të bardhë (Fig. 13), me madhësi në natyralen.⁵⁶ Ka vrasje të vjetra në hundë e mjekër dhe gërvishje të lehta në ballë

⁵⁶ Shpëtuar gjatë punimeve bujqësore.

e faqe. Ka pësuar gërvishje të reja nga plugu, sidomos në anë të djathtë: faqe, vesh, ballë e qafë. Lartësia e përgjithshme, me gjithë qafën, është 0,33 m, vetëm e fytyrës 0,19 cm.



Fig. 13

Paraqet fytyrën e një vajze me ballë të madh, vetulla të holla, sy në trajtë bajameje me bebëza të theksuara në formë rrethi e me brimëza në qendër, buzë pak të shtrënguara dhe mjekër të rumbullakët. Në tërësi fytyra duket realiste, me subjekt nga jeta, që shpreh një qëndrim serioz dhe deri diku krenar.

Flokët i ka të mbuluara me një kësulë gati nemisferike, me një palë dyshe, si shall, që e qarkon në anën e poshtme. Kjo i lë zbuluar mbi ballë një pjesë flokësh të ndara me vijë në mes e të shtrira

anash; mbrapa flokët i ka të ngritura lart për t'i mbështjellë me kapelen. Poshtë tëmthave i varet nga një tufë flokësh, a stoli, në trajtë veshi rrushi.

Kunji që vijon poshtë qafës tregon se ka qenë vendosur mbi një shtatore, e cila do të ketë shërbyer për zbukurimin e një vile rustica të shek. II e.s.

SEKTORI D

Një pikë tjetër me gjurmë ndërtimesh antike gjendet në pjesën veriore të kënetës, pranë Bisht-Kamzës, rreth 600 m nga bregu i

detit. Shtresa kulturore këtu dallohet në faqen e një kanali, në thellësinë 1.5 m. Materiali paraqet ngjashmëri me atë që kemi parë në banesën e zbuluar pjesërisht në sektorin «A» dhe datohet në shek. III p.e.s.⁵⁷

PËRFUNDIME

Në përfundim të këtij vështrimi mbi të dhënat burimore dhe arkeologjike që përmbledhëm më lart, mund të themi se për periudhën e hershme të Dyrrahut si qytet, ekzistenca e kënetës vihet në dyshim ose, së paku, nuk mund të bëhet fjalë për përmasa të tilla të saj sa për ta kthyer atë në “ishull”. Ndërtimet e shekujve IV p.e.s. deri përafërsisht shek. II-III e.s. që kanë qenë më të evidentueshme deri tani, sidomos në pjesën J-P të saj, këmbët e ujës-jellësit të shek. II e.s. dhe grupe varresh të shekujve II-III e.s. nuk do të pajtoheshin as edhe me praninë e një lagune të vërtetë më në veri, pra në shpinë.

Ajo çka rezulton e pakundërshtueshme është që trualli i kënetës gjatë këtyre dy mijë vjetëve të fundit ka pësuar një ulje, ose të ngadaltë, epirogjenetike, ose të menjëhershme, tektonike, dukuri kjo e pranuar gjeologjikisht⁵⁸ dhe arkeologjikisht edhe në

⁵⁷ Kalipteret janë të tipit me kurriz me kënde si edhe nga to me kurriz të harkuar. Ndër enët e baltës, përmendim një pjatë me vernik të zi që ka në qendër një stampë me pesë gjethe palmetash (Tab. III, 10). si dhe një fund kupe që ka gjithashtu në qendër një stampë, por prej katër palmetash dhe brenda shkruar një rrethi kymatesn dorike.

⁵⁸ N. Luli, S. Boçi, Studim i lëvizjes bregdetare nga pikpamja topografike, «B.SH.N» 2, 1966, fq. 123.

pika të tjera të Ultësirës Bregdetare.⁵⁹ Për rastin tonë, si dëshmi shërbejnë mbetjet e ndërtimeve antike brenda lagunës, në një thellësi 1-1,5 m nën nivelin e detit. Këtë e përforcon edhe njoftimi për mure me blloqe të mëdhenj kuadratikë dhe mori solenesh e kalipteresh që janë vërejtur brenda në det në gjirin e vogël të «Porto Romanos»⁶⁰

Proçesi i kënetëzimit mund të ketë nisur në fund të epokës së kaluar ose në fillimin e epokës sonë dhe ka vijuar gradualisht me formimin e një moçali në pjesën qendrore-jugore, vend që para se të bonifikohej njihej me emrin «Balta e Madhe». Por mund të shpjegohej mirë edhe si pasojë e një tërmeti të shoqëruar me vithisjen e tokës, që është mbuluar pastaj nga uji. Sidoqoftë, duke filluar nga shek. I e.s. ekzistenca e një kënete të parëndësishme mund të pranohej, por që mbahej e ekuilibruar nëpërmjet një kanali të lidhur me detin.

Gjurmët e ndërtimeve antike që vërehen aty, duket që përfaqsojnë kryesisht shtëpi banimi. Për mendimin tonë duket se kemi të bëjmë me një lagje jashtë mureve të qytetit,⁶¹ në horën e tij të ngushtë. Themi «një lagje e jashtme» duke pasur parasysh jo vetëm linjën e njohur të rrethonjës së qytetit, por edhe shtrirjen e nekropoleve të shekujve VI-I p.e.s. dhe të shekujve I-

⁵⁹ A. Baçe, *Rrugët shqiptare në mesjetë, shek. VII-XV*, Kumtesë në «Konferencën Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, kulturës dhe gjuhës së tij, Tiranë, korrik 1982, «Monumentet» 1, 1984.

⁶⁰ M. Zeqo, *Gjurmë ndërtimesh në gjirin e Porto Romanes, Kumtesë, në «Adriatiku»* - almanak, Tiranë, 1982.

⁶¹ C. Praschniker-A. Schober vep. cit, fq. 39-43 sugjerojnë se tej mureve të rrethonjës bizantine do të duhej kërkuar vendi i ngulimit të kolonistëve të vjetër në Epidamn.

IV e.s. që e qarkojnë atë (Tab. 1)⁶². Shembuj të tillë në periferi të qyteteve antike nuk mungojnë.⁶³

Materiali ndërtimor si guri, tullat e tjegullat, sikurse dhe detaje të tilla arkitektonike siç janë pjesët e kolonave prej guri gëlqeror e mermeri, apo fragmenti i frizit me triglif, dëshmojnë për ndërtime jo të thjeshta, që kryesisht mendojmë se kanë qenë banesa. Mbi përmasat e këtyre ndërtesave dhe pozitën shoqërore të pronarëve të tyre në shekujt e IV-I p.e.s. hedhin dritë madhësia e pjesës së zbuluar të shtëpisë në sektorin «A», sipërfaqia e gjerë që zënë gjurmët e dukshme të ndërtesave në pika të tjera, si dhe qeramika e cilësisë së lartë e monedhat.⁶⁴

Shkaku i ngritjes së banesave në këtë territor mendojmë se nuk shpjegohet vetëm me mungesën e sipërfaqes brenda mureve të qytetit, por në radhë të parë me zhvillimin e bujqësisë në horën e tij të ngushtë. Si prova të lidhjes së këtyre banesave me ekonominë bujqësore, përveç vetë fushës ku janë ngritur, mund të merren edhe fragmentet e shumta të pitosave e të amforave, si enë qilari. Një provë interesante është edhe relievi i Demetrës me Koren, si perëndesha që mbrojnë bujqësinë dhe qetësinë e njerëzve të fushës. Kurse fragmenti i frizit dëshmon ndoshta për

⁶² Shih. S. Anamali, Nekropoli helenistik i Epidamnit, «B.SH.SH.» 1, 1957, V. Toçi, Relieve e mbishkrime..., F. Tartari, Rezultate të gërmimeve; H. Hidri, Gërmime të viteve të fundit në nekropolin e Durrësit, dhe I. Toçi, Të dhëna nga zbulime të rastit dhe sondazhe në nekropolin e Dyrrahut, në «Materiale të sesionit shkencor arkeologjik», Durrës, nëntor 1983.

⁶³ E. Conduracni, Problemi della IIIIOAIE e della XOPA nelle città greche del Ponto Sinistro, në «La città ed il.. » f. 147.

⁶⁴ Për banesa pronarësh të pasur në afërsi të Apolonisë në shek. V p.e.s., shih Herod, IX, 93.

ekzistencën e një sanktuari të vogël tej qytetit, që me shumë mundësi do t'i dedikohej Demetrës dhe Kores.⁶⁵

Ndërtimet më të hershme që njohim deri tani (ato të shekujve IV-III p.e.s.), përkojnë kronologjikisht me kohën që Dyrrahu bie në kontrollin e mbretërve ilirë⁶⁶ dhe përbërësi ilir në qytet shtohet⁶⁷. Për atë periudhë kjo lagje jashtë mureve të qytetit nënkupton, nga ana e vet, kushte normale në marrëdhënie me horën e madhe, që banohej vetëm nga vendasit. Rrethanat e favorshme për ndërtime në këtë territor mund të kenë ndikuar edhe në zhvillimin e fshatrave në harkun kodrinor në lindje të Durrësit, siç është rasti në Vrrin.⁶⁸

Për shekujt I-III e.s. gjurmët e ndërtimeve të dokumentuara sidomos në sektorin «C» mund të merren pa hezitim si mbeturina vilash të pronarëve latifondistë.⁶⁹ Pajisja e tyre me skulptura mermeri dhe veçanërisht pllaka me mbishkrim kush-tuar edilit Marko e mbështesin këtë mendim. Por pllaka në fjalë dëshmon gjithashtu edhe për mundësinë që përreth pronave të qytetarëve të rëndësishëm banonin këtu edhe fshatarë, skllevër të liruar e plebej (cliens), të cilët kishin shumë nevojë për

⁶⁵ G. Vallet, në *La cite et son territoire dans les colonies grecques d'Occident*, fq. 87, përmend se ndër gjashtë sanktuarë «<suburbanë>» të Gelës, katër i janë dedikuar Demetrës dhe Kores.

⁶⁶ Diod, XIX, 78, 1; shih: S. Islami, *Shteti ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare*, në *Kuvendi i Studimeve ilire*, Tiranë, 1974, dhe H. Ceka, *Probleme...* fq. 95-96.

⁶⁷ S. Anamali, *Të dhëna mbi elementin ilir në qytetet antike Epidamn dhe Apoloni që përmend Elianin*, «B.SH.SH» 1, 1956; H. Ceka vep. cit, fq. 31.

⁶⁸ H. Myrto, *Një varrezë antike në fshatin Vrrin të Durrësit, «Iliria»* (në shtyp).

⁶⁹ Këto ndërtime tregojnë se nuk mund të jetë ky vendi i braktisur i Epidamnit antik, për të cilin bën fjalë Pausania në shek. II e.s. (VI, 10, 8) shih; Praschniker-Schober për mendimin e tyre hipotetik në vep. cit, fq. 37, 40.

mbrojtjen e të parëve. Kurse guri i sinorit dëshmon se kufi pronave private, kishte edhe prona publike që i përkisnin bashkësisë së qytetit. Përmes kësaj lagjeje siç duket kalonte edhe rruga kryesore që dilte nga qyteti; për këtë dëshmon në një farë mënyre cippusi me mbishkrim të njëjtë në dy faqe të kundërta.

Për periudhën e vonë antike nuk kemi ndeshur gjurmë bane-sash. Nga kjo mund të nënkuptohet se në shekujt V-VI kënetat kishte arritur përmasa më të mëdha. Por ngritja e mureve të tipit «barrierë» në veri dhe në jug dhe mbajtja në funksionim e kanalit që e lidhte me detin, kanë dhënë mundësi nga njëra anë, që shtrirja e saj tani të jetë shfrytëzuar për qëllimin e mbrojtjes dhe, nga ana tjetër, për të kursyer ende të thatë një pjesë të fushës.

Më pas kuptohet që kënetat i ka shpëtuar këtij kontrolli dhe ka arritur kufijtë veriorë dhe lindorë të qytetit, ashtu sikundër ka pasur periudha që është vënë përsëri deri diku nën kontroll me anën e mirëmbajtjes së kanalit. Një kohë kur fusha në V-L të qytetit ishte e lirë nga ujërat, është edhe ajo kur Robert Guiskardi ngriti aty kampin e tij luftarak. Në atë kohë mbetjet e ndërtimeve antike që përshkruam, sigurisht do të kenë qenë më të dukshme dhe, prandaj, mendojmë se është pikërisht kjo pamja që e ka shtyrë Ana Komnenën të shkruajë se kampi u ngrit midis rrënojave të Epidamnit antik.⁷⁰

Me interes na duken së fundi dhe të dhënat onomastike, siç janë emrat ilirë Nesyl, Syro, Sura, sikurse dhe vetë toponimi i parë që njohim për kënetën, «Balta». Nga studimet gjuhësore

⁷⁰ Shih sh. nr. 10, më lart.

rezulton se kjo fjalë i përket leksikut të ilirishtes me kuptimin «kënetë»⁷¹

RESUME

DONNEES SUR L'ETENDUE DE DURRACHIUM DANS LA PARTIE SUD-OCCIDENTALE DU MARAIS

Avant d'être bonifié en 1962, le Marais de Durrës s'étendait au Nord-Est de la ville occupant une superficie de 2050 ha. Aujourd'hui la plus grande partie de cette étendue est au niveau de la côté 0,00 au-dessus du niveau de la mer (Pl. 1).

Aperçu sur la géographie historique

Des données indirectes dont on suppose l'existence d'un marais qui séparait Dyrrachium des terres et le rendait presque en une île, se mentionnent premièrement sous César au milieu du I^{er} siècle avant notre ère et sous Lucien au I^{er} siècle de notre ère. Mais plus clairement c'est dans la communication de Procope de Gaza, auteur de la fin du V^{ème} siècle et du début du VI^{ème} siècle de notre ère.

Anne Comnène, au XI^{ème} siècle, en décrivant le siège de Durrës par les Normands, laisse sous-entendre l'existence d'une lagune, mais de superficie limitée, en mettant Nord-Est de la ville une Etendue libre pour l'emplacement d'un camp militaire

⁷¹ E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, II, A-B, Tiranë, 1976, shih «Baltë», si dhe literaturën që citon. Shih dhe T. Todorov, On the etymology of Deutum, «Thracia», Sofja, 1980, fq. 204.

de 30.000 hommes. L'auteur ajoute que le camp a été installé, sur les mines de l'Epidamne antique. Au XV^{ème} siècle le Marais est mentionné premièrement de façon directe et par son propre nom "Balta".

Données archéologiques

Des objets archéologiques provenant du Marais sont signalés depuis 1920. Lors des travaux de bonification 1961-1962, on a sauvé quelques fragments de colonnes ainsi que d'autres objets. En 1971 un cimetière des premiers siècles de notre ère a été découvert dans la zone nord-orientale de la ville que l'expansion des eaux atteignait autrefois. On a plus tard un rapport détaillé sur les vestiges de l'aqueduc du II^{ème} siècle de notre ère qui traversait de part et d'autre toute la partie sud-occidentale.

Mais les vestiges de construction antiques sur ce territoire ont une étendue plus large dans l'espace et dans le temps.

Pendant des recherches à la surface, surtout au temps des labourages, au bien en effectuant quelques fouilles, nous sommes convaincus que les vestiges de constructions antiques dans la partie sud-occidentale de l'ancien Marais occupent une superficie de 80 ha que nous avons divisée en trois secteurs exception faite d'un quatrième secteur au Nord.

Le Secteur A

1) Par des fouilles encore inachevées ont été découverts des fragments de murs construits en pierres façonnées et des parties de planchers couverts de pierres et d'éclats de tuiles. On a découvert une foule d'éclats de tuiles et holipterch ainsi que de terrines, d'objets métalliques et de monnaies bronze de

Dyrrachium. Les briques manquent. On pourrait encore porter un jugement de valeur sur la planimétrie totale de cette habitation, mais d'après le matériau archéologique elle peut être très bien datée de la fin du IV^{ème} siècle et du début du III^{ème} siècle avant notre ère.

2) Sur le haut d'un canal d'écoulement des eaux Nord-Est du points sus-mentionné on voit un pan de mur qui a 6,30 m de long, 0,70 m de large et 0,35 m de haut. La technique de construction et le matériau archéologique le datent des IV-III^{ème} siècle avant notre ère.

3) Au Sud de la ligue de l'aqueduc antique on remarque la suite d'un mur de matériau de construction caractéristique à la Citadelle de Durrachium, V-VI^{ème} siècle.

4) Un autel de tombeau en marbre y a été emmuré avec cette inscription latine: Mforius. . . menus. . . s-perp. . . rhedris. . . sviss dp, daté au I^{er} siècle de notre ère

5) Un cippe de provenance similaire avec la même inscription latine aux deux côtés contraires. M(arco) Terentio (Syro) Padia Prima (Viva fecit) h(oc) (onumentum) h(eredem) n(on) s(equetur).

Il garde le nom illyrien «Syro» employé ici selon la formule onomastique. Il appartient au I^{er} siècle de notre ère.

6) Un autre cippe, cippus terminolis avec une inscription dans les deux côtés contraires, Privat(us) (P)ubl(icus), a été trouvé à l'extrême occidentale de ce secteur.

7) Un groupe de trois tombes a été découvert à proximité. Les deux premières tombes présentent la sépulture à dépouille

mortelle dans une construction de tuiles en forme de sommet de toit, l'autre tombe c'est à crémation avec les cendres dans une urne de verre déposée dans une amphore L'Amphore porte un sceau avec une inscription de deux lignes et l'on pense qu'elle serait produite à Dyrrachium.

Le Secteur B. Dans une superficie de presque 2000 m² on a trouvé les restes d'une ou plusieurs habitations extraits du sol lors des travaux agricoles. Le matériau en céramique, surtout les tuiles à sceaux épigraphiques de Dyrrachium prouvent que les constructions ont eu une durée de vie depuis le III^{ème} siècle avant notre ère jusqu'au I^{er} siècle de notre ère.

Le Secteur C s'étend au Nord du secteur A dont il est à peine séparé.

1) On y a remarqué les restes d'une habitation construite en briques qui semble appartenir au I-II^{ème} siècle de notre ère. Tout autour on a trouvé des fûts de colonnes en pierres calcaires à cannelures ioniques.

2) A proximité on a trouvé un bas-relief représentant deux figures féminines. Nous pensons que c'est un bas-relief votif dédié à Déméter et à Korê.

3) Une plaque fragmentaire porte une inscription dédiée à l'un des notables de la ville, un magistrat au rang de l'édile, par un de ses clients.

Hono[re usus] / p(rincipi) o(ptimo) aed(ili) v(irc) b(ano)
Marco/clients.

4) 400 m au Nord de ce point parmi le matériau de construction antique on a trouvé un fragment de la triglyphe d'une frise en pierre calcaire et une partie de la métope.

5) Au Nord de ce secteur une tête de jeune fille en marbre blanc a été trouvé dans les restes visibles d'une habitation des premiers siècles de notre ère. Nous pensons que la sculpture appartenait à une statue entière du II^{ème} siècle de notre ère qui ornait à ce qu'il paraît une villa rustique.

Conclusions

A la conclusion de cet aperçu sur les données historiques et archéologiques on peut avancer que pendant l'ancienne période de Dyrrachium en tant que cité, l'existence d'un marais est mise en doute ou au moins on ne peut parler de telles dimensions du marais qui pourraient rendre la ville en une île. Les constructions depuis le IV^{ème} siècle avant notre ère jusqu'aux II-III^{ème} siècles de notre ère, surtout dans la partie sud-occidentale, les piliers de l'aqueduc du II^{ème} siècle de notre ère et les groupes de tombes des II-III^{ème} siècles de notre ère ne sauraient être conciliés pas même avec la présence d'une véritable lagune plus au Nord, sur le dos. Ce qui est incontestable c'est que le terrain du marais pendant les deux derniers millénaires a subi une dépression, ou bien lente, épeirogénique, ou bien brusque, tectonique. C'est un phénomène prouvé géologiquement et archéologiquement dans d'autres points du littoral de notre pays. Dans notre cas, les restes de constructions antiques dans une profondeur de 1 à 15 m au-dessus du niveau de mer viennent aussi à l'appui. Ce qui est affirmé encore par la présence de

murs en grands blocs carrés et d'une foule de tuiles et de calyptères remarquables dans la mer même au baie de Porto Romane.

Le procès de marécage a pu avoir commencé à la fin de l'ère ancienne ou au début de notre ère et s'est poursuivi graduellement jusqu'à la formation d'un marais dans la partie méridionale qu'on appelait «La Grande Boue» avant la bonification. Mais il pourrait très bien être le résultat d'un tremblement de terre accompagné d'écroulements du terrain envahis après par les eaux. Toutefois en commençant par le I^{er} siècle de notre ère on peut accepter l'existence d'un marais peu important équilibré au moyen d'un canal lié à la mer.

Les vestiges de constructions antiques remarquables doivent représenter avant tout des maisons d'habitation. Nous pensons qu'il s'agit d'un quartier externe hors des murs de la ville. Et nous prenons en considération non seulement la ligne connue de murs de clôture de la ville, mais aussi l'étendue des nécropoles des VI-I^{ère} siècles avant notre ère et des I-IV^{ème} siècles de notre ère qui l'entourent. Des exemples pareils ne manquent pas à la périphérie des villes antiques. Le matériau de construction, les pierres, les briques, les tuiles ainsi que de tels détails architecturaux comme les fragments de colonnes en pierre calcaire ou en marbre ou bien le fragment de la triglyphe d'une frise témoignent de constructions qui ne seraient pas assez simples. La grandeur de la partie découverte de l'habitation au Secteur A, la grande surface occupée par les vestiges évidents d'autres constructions, ainsi que la céramique de haute qualité et les monnaies témoignent des proportions de ces constructions et de

la position sociale de leurs propriétaires dans les IV-I^{ère} siècles avant notre ère.

Nous pensons que la raison de la construction des habitations sur ce territoire ne doit pas être trouvée seulement dans l'absence de surface à l'intérieur des murs de la ville mais en premier lieu dans le développement de l'agriculture. Les nombreux fragments de céramique qui accusent la présence d'ustensiles de cave pourraient aussi servir de preuves à l'appui de la liaison de ces habitations à l'économie agricole à part le champ même sur lequel elles sont construites. Une autre preuve assez intéressante c'est aussi le bas-relief dédié à Déméter et Koré, ces deux divinités qui protègent l'agriculture et les gens de la campagne. Quant au fragment de la frise, il témoigne peut-être de l'existence d'un petit sanctuaire dédié plus probablement à Déméter et Koré.

Les constructions plus anciennes connues jusqu'à présent (celles de IV-III^{ème} siècle avant notre ère) coïncident du point de vue chronologique à l'époque de la domination de Dyrrachium par les rois illyriens. C'est pourquoi la composante illyrienne s'accroît dans la ville. A cette époque, le quartier hors des murs de la ville fait penser pour sa part de conditions normales dans les relations de la ville avec la région habitée seulement d'autochtones. Des circonstances favorables à la construction sur ce territoire ont pu influencer sur le développement des villages à la chaîne de collines à l'Est de Durrës comme c'est le cas de Vrrin.

Quant à la période des I-III^{ème} siècles les vestiges de constructions, surtout au Secteur C peuvent être considérés sans

hésitation comme les restes de villas de propriétaires fonciers. Leur ornement de sculptures en marbre et surtout la plaque à inscription dédiée à l'édile Marco viennent à l'appui. Mais la plaque témoigne aussi de la possibilité qu'auprès des propriétés des citoyens importants il y avait des campagnards, des esclaves affranchis et des plébéiens qui auraient très besoin de leur protection. Quant à la borne en pierre, elle témoigne qu'auprès des propriétés privées il y avait aussi des propriétés publiques appartenant à la communauté de la ville. La route principale sortant de la ville semble avoir traversé le quartier; dans une certaine mesure c'est la cippe à la même inscription aux deux côtés contraires qui vient à l'appui.

Quant à la période de l'antiquité tardive il n'y a pas de vestiges d'habitations. Cela fait penser que dans les V-VI^{ème} siècles le Marais avait atteint de grandes dimensions.

Mais la construction des murs en barrière au Nord et Sud et le fonctionnement régulier du canal qui le liait à la mer ont donné la possibilité que, d'une part, son étendue ait été exploitée dans des intentions de défense et de l'autre part, pour garder encore sèche une partie des champs.

Il est évident que plus tard le Marais a échappé à ce contrôle et a atteint les limites nord-orientales de la ville bien qu'il y ait eu aussi des périodes dans lesquelles il soit mis de nouveau en contrôle au moyen de l'entretien du canal. C'est dans une telle période, quand le terrain au Nord-Est de la ville était libre des eaux, que Robert Guiscard a choisi là l'emplacement de son camp militaire. A ce temps-là les restes de constructions anti-ques devaient être plus évidentes et c'est poussée par une telle

vue générale qu'Anne Comnène a pu écrire que le camp a été installé sur les mines de l'Epidamne antique.

Enfin il est intéressant de mettre en vue les données onomastiques comme les noms illyriens Nesyl, Syro, Sura ainsi que le premier toponyme connu concernant le Marais «Balta». Des études linguistiques il résulte que ce mot appartient au lexique de l'illyrien avec le sens de «marais».

MONEDHA PERANDORAKE BIZANTINE

NGA DURRESI (491-1025)¹

Në muzeun arkeologjik të Durrësit ruhet një koleksion me monedha bronzi perandorake bizantine, nga i cili deri më sot është bërë i njohur vetëm një numër i kufizuar². Katalogu që po paraqesim përbëhet nga monedha të pabotuara, prerje që i përkasin harkut kohor nga fillimi i sundimit të Anastasit I (491) deri në fundin e mbretërimit të Vasilit II (1025)³.

Në fondin e monedhave të përfshira në katalogun tonë bëjnë pjesë 126 copë bronzi dhe 1 ari. Ato vijnë nga gjurmimet në termat e shekujve të parë të erës sonë dhe në amfiteatër⁴, në kala dhe në sheshin e tregut të antikitetit të vonë⁵, si dhe nga gjetje rasti në qytet dhe në rrethinat⁶. Kjo sasi, që përbëhet nga prerje

¹ Marrë nga artikulli me bashkautorësi Afrim HOTI, Halil MYRTO - ILIRIA Nr. 1 dhe 2, 1991, f. 91-122.

² H. Spahiu, Monedha bizantine të shek. V-XIII të zbuluara në territorin e Shqipërisë, «Iliria» IX-X, f. 353-394; A. Hoti, Ndihmesë për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit, «Iliria», 1987, 1, f. 249, fig. 1.

³ Pjesa tjetër e monedhave bizantine të perandorëve në vijim, që numerikisht është shumë më e madhe, mbetet për një punim të ardhshëm.

⁴ V. Toçi, Të dhëna mbi topografinë dhe elementin ilir të Durrhut në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike, Konferenca e Parë e Studimeve albanologjike, Tiranë, 1965, f. 461 dhe Amfiteatri i Durrhut, «Monumentet», 1970, 2, f. 39.

⁵ A. Hoti, Gjurmime arkeologjike të vitit 1984, «Iliria», 1984, 2, f. 275; të vitit 1986, Iliria, 1986, 2, f. 269; të vitit 1987, Iliria», 1987, 2, f. 261; të vitit 1988, «Iliria, 1988, 2, f. 272.

⁶ Pjesa më e madhe është mbledhur në pika të ndryshme të qytetit, si gjetje rasti, nga një grup pionierësh të drejtuar nga H. Myrto.

të 18 perandorëve, me përjashtim të një boshllëku prej 150 vjetësh (683-830), mbulon tërë periudhën kohore që përmendëm.

Duke marrë si pikënisje kohën e Anastasit I, u jemi përmbajtur kritereve të reja për katalogimin e monedhave perandorake bizantine, sikundër i kemi ndjekur ato edhe për sa i përket renditjes sipas secilit perandor, punishtes monetare, llojit të metalit, vlerës së monedhës dhe, pastaj, vitit të prerjes⁷.

Monedhat që kemi në dispozicion ndahen në dy faza, që në fakt përputhen me periodizimin e përgjithshëm që u është bërë monedhave bizantine⁸.

Në fazën e parë përfshihen monedhat e prera nga Anastasi I deri tek Konstandini IV Pogonati (491-683), ku numrin më të madh e përbëjnë ato të Anastasit I, të Justinianit I dhe të Justin II. Bronzet e Anastasit I përbëhen nga ato me vlera të mëdha (follis) deri nga ato më të voglat (pentanumia dhe 2 1/2 numia), por, nga gjithsej 13 copë të tij, 12 rezultojnë të prera pas vitit 507.

Justini I përfaqësohet vetëm me dy monedha. Numri i monedhave të Justinianit I tregon një rritje (19 copë). Pastaj vijojnë monedhat e perandorëve të tjerë të kësaj faze: Justini II (9 copë), Tiber Kostandini dhe Maurik Tiberi (nga një copë), Foka (6 copë), Herakliu I dhe Konstandini IV Pogonati (nga një copë) ndërsa Konstanci II në kohën midis tyre përfaqësohet me 6 copë.

⁷ Shih W. Wroth, *Imperial Byzantine Coins in the British Museum*, Chicago, 1956, f. XII dhe W. Hahn, *Monete Imperii Byzantini*, Band I, Wien, 1973. Në katalog janë vënë datat për secilën monedhë, duke filluar nga viti XII u Justinianit I (533/39) e deri në gjysmën e dytë të shek. VII, d.m.th. për tërë kohën që ato e përmbajnë atë. Është bërë gjithashtu një klasifikim i bazuar mbi kritere më të sakta për sa u përket monedhave të Janit I Zimiskit dhe Vasilit II (shih W. Wroth, *vep. cit.*, 480-483) në krahasim me literaturën e përdorur më parë në vendin tonë (J. Sabatier, *Description générale des monnaies byzantines*, Leipzig, 1930).

⁸ Shih W. Wroth, *vep. cit.*, f. LXXXVI.

Natyrisht shifrat tona janë të vogla për të bërë krahasime, megjithatë bie në sy se gjatë kësaj faze numri i monedhave të prera nga perandori Justinian I është më i madh dhe kjo gjë na kujton faktin e njohur se gjatë kohës së sundimit të tij, Durrësi shikohej si një vend i sigurt për ruajtjen e vlerave monetare⁹.

Rënia numerike që vihet re me Justinin II, dhe sidomos pas tij, është një dukuri e konstatuar edhe në qendra të tjera mesjetare të vendit tonë¹⁰. Kjo rënie është karakteristike edhe për viset fqinje. Kështu, është thënë se sasia e monedhave bizantine pas vitit 522 në Korint e Athinë tregon një rënie «dramatike»¹¹.

Mungesa e plotë e monedhave për kohën nga 683 deri më 830 është gjithashtu një dukuri e vërejtur në tërë vendin tonë¹². Kjo, përveç shkaqeve më të ngushta, që ende nuk i njohim, gjen një shpjegim edhe me krizën e përgjithshme të sistemit financiar që preku tërë perandorinë, duke filluar nga koha e Konstancit II (mesi i shek. VII) e deri në fundin e shek. VIII¹³.

Faza e dytë, që nis me monedha të prera nga perandori Theofil, përkon, do të thonim, jo rastësisht me kohën e krijimit të Temës¹⁴. Në katalogun tonë ky perandor në fakt përfaqësohet vetëm me një monedhë. Pastaj vijnë monedha të Vasilit I (5

⁹ Mbretëresha e gotëve, Arnalasuntha, në atë situatë turbullirash, vendosi ta transferonte arkën e shtetit të saj nga Ravena në Durrës (E. Chrysos, Simiroliti Istoriat Iperioi kata tin proto vizantini epohi (4-7), «Ipeiritika», tomos 23. Ioanina, 1981, f. 98.

¹⁰ H. Spahiu, art. cit. (pasqyra statistikore).

¹¹ D. Metcalf, The mint of Thessalonica in the Early Byzantine Period, *Revue Numismatique*, XXI, 1979, f. 117.

¹² H. Spahiu, art. cit. (pasqyra statistikore).

¹³ J. Ferluga, Sur la date de la création du Theme de Durrachium, *Actes du Congrès Intern. d'Etudes Byzantines II*, Belgrade, 1964, f. 84; H. Ahrwiler, *Byzance et la Mer*, Paris, 1966, f. 59, 71.

¹⁴ J. Ferluga, art. cit., f. 85.

copë), të Leonit VI (30 copë). perandor ky që deri më sot përfaqësohet këtu me më shumë monedha. Viojnë pastaj monedha të Romanit I (3 copë), të Konstandinit VII dhe të Nikiforit II Foka (nga 3 copë secili), me një rritje për kohën e Janit I Zimiskit (11 copë) dhe të Vasilit II (12 copë).

Duhet thënë se në sasinë e përgjithshme të monedhave të katalogut tonë, ndonëse jo e konsiderueshme, bëjnë pjesë dhe tipa e variante të panjohura më parë nga botimet në vendin tonë, siç janë (në katalog): nr. 5, 6, 8, 11, 13 (të Anastasit I), nr. 14, 15 (të Justinit I). nr. 16, 18, 19, 21-23, 27-29, 32, 33 (të Justinianit I). nr. 35, 36. 38-40 të Justinit II), nr. 45 (e Maurik Tiberit), nr. 46, 47-51 (të Fokës), nr. 52 (e Herakliut I), nr. 54-57 (të Konstancit II), nr. 59 (e Konstandinit IV Pogonatit), nr. 99-101 (të Konstandinit VII Porfyrogjenetit), pa mundur të bëjmë krahasim për monedhat e Janit I Zimiskit dhe të Vasilit II që janë botuar më parë, mbasi janë kataloguar mbi kritere të vjetruara. Për sa i takon qarkullimit të monedhave me prejardhje nga punishte të ndryshme perandorake, për kohën që ato kanë funksionuar krahas atyre të kryeqytetit, vihet re se nga Konstandinopoja vijjnë 22 copë, nga Selaniku 14 copë, nga Nikomedia një copë. nga Kyzyku 5 copë, nga Antiokia 3 copë, nga Kartagjena 8 copë, nga Sicilia 2 copë dhe nga një punishte e papërcaktuar 3 copë. Në këtë mënyrë listës së punishteve monetare perandorake bizantine, të njohur më parë në vendin tonë, i shtohen dhe dy të reja (Kartagjena, Sicilia).

Koleksioni që trajtuam, ndonëse ende i vogël, përbën një tregues të zhvillimit ekonomik e kulturor, me luhatjet e veta, të diktuar nga rrethanat e ndryshme politike që përjetoi qyteti gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme.

KATALOG

ANASTASI I - (11.4.491 - 1.7.518)

Bronze

Konstandinopol

Follis (1.9.507 - 1.9.512)

F. DNANASTASIVSPPAVIG. Busti i Anastasit I, pa mjekër, në profil dj., me diademë, pancir dhe paludamentum (mantel ushtarak). Shp. Shenja M; lart kryq; në të dj., yll; në të m. yll; poshtë: A; në segment: CON.

1. AE ↓ 16.50 gr. 3 mm (tab. I, 1). Gjetje rasti në qytet, nr. 207¹⁵.

2. Krs. W. Hahn, vep. cit. V. I, tab. 2 dhe pragtab. II, nr. 23. AE 18.40 gr, 34 mm (tab. I, 2).

F. ↓ Si nr. 1

Shp.Si nr. 1; poshtë B.

Gjetje rasti në qytet, nr. 98.

W. Hahn, po aty., nr. 23.

3. AE ↓ 18 gr, 34 mm.

F. Si nr. 1.

Shp.Si nr. 2.

Gjetur në monumentin me kolonadë rrethore (shesh-tregu i qytetit në kohën e vonë antike - më poshtë M.K.), 1987, nr. 922.

¹⁵ Numrat rendorë janë ata të regjistrave provizorë (të gjurmimeve).

4. AE ↓ 18.30 gr, 35 mm.

F. Si nr. 1.

Shp. Si nr. 2.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 922/1.

5. AE ↓ 18,10 gr, 33 mm. (tab. I, 3).

F. Si nr. 1.

Shp. Si nr. 2; në të m. e paqartë.

Gjetur në M.K., 1988, nr. 3543.

Follis (1.9.512 - 1.9.517).

6. AE ↓ 17.90 gr, 36 mm (tab. I, 4).

F. Si nr. 1; legjenda lexohet me vështirësi:

DNANASTASIVSPP...

Shp. Si nr. 1; poshtë: 

Gjetje rasti në qytet. nr. 58.

W. Hahn, vep. cit., po aty. nr. 271.

Për një monedhë të tillë me prejardhje nga Durrësi, shih H. Spahiu, art. cit.. f. 366, nr. 47.

7. AE ↓ 17.80 gr, 35 mm (tab. I, 5).

F. Si nr. 1.

Shp. Si nr. 1; poshtë: 

Gjetur në M.K., 1987, nr. 922/2. W. Hahn, po aty, nr. 272.

8. AE ↓ 9.89 gr., 34 mm (tab. I, 6).

F. Si nr. 1; legjenda: [DNANASTA] SIVSPPAV.

Shp. Si nr. 1; poshtë: 

Gjetur në Fushë-Qerret 1987, nr. 418. W. Hahn, po aty. nr. 28.

9. AE ↓ 14.35 gr, 34 mm.

F. Si nr. 1.

Shp. Si nr. 8.

Gjetje rasti në qytet, nr. 95.

10. AE ↓ 15.40 gr, 34 mm.

F. Si nr. 1; legjenda e fshirë.

Shp. Si nr. 8.

Gjetur në amfiteatër, 1969, nr. 2703.

Pentanumia (1.9.517 - 1.7.518).

F. DNANASTASIVSPPA IVG. Busti i Anastasit I dj., me diademë, pancir dhe paludamentum.

Shp. Shenja  me dy kokrriza lart dhe poshtë shtagës se mesit përpara, A.

11. AE ↑ 2.50 gr, 14 mm (tab. I, 7).

Gjetje rasti në qytet, nr. 921.

W. Hahn, vep. cit. V. I, tab. 3 dhe pragtab. II, 39.

12. AE ↑ 2.19 gr, 13 mm.

F. Si nr. 11; legjenda jo e plotë... SIVSPPAV.

Shp. Si nr. 11.

Gjetje rasti në qytet, nr. 920.

2 1/2, numia (11.4.491- 498).

F. Legjenda rrethore e fshirë. Busti i Anastasit në profil dj.

Shp. Monogrami i Anastasit brenda një kurore: 

13. AE ↓ 0.98 gr, 9 mm (tab. I, 8).

Gjetje rasti në qytet, nr. 922.

Krs. W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 2 dhe Pragtab. II, nr. 40 (ku në monogram mungon kryqi).

JUSTINI I (19.7.518 - 1.8.527)

Bronze

Selanik

Follis (1.9.522 - 4.4.527).

F. DNIVSTI NVSPV AVG. Busti i Justinit I, me kurorë, në profil dj. me diademë, pancir dhe paludamentum.

Shp. Shenja M; lart kryq; në të m. yll; në të dj. yll. Në segment... SO.

14. AE ↓ 13.52 gr, 30 mm (I, 9).

Gjetje rasti në qytet, nr. 21.

W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 11 dhe Pragtab. IV, nr. 70.

Gjysmëfollis

F. DNIVSTINVSPVAVG. Busti i Justinit I, në profil dj., me diademë, pancir dhe paludamentum, duke mbajtur në dorën e dj globin me kryq të mbivendosur; figura në përgjithësi mjaft e fshirë.

Shp. Shenja K; në të m. një kryq i gjatë; në të dj. yll; lart kryq; në segment: **TES**

15. AE ↓ 19 mm, 4.30 gr.

Gjetur në M.K.. 1987, nr. 4229.

W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 10 dhe pragtab. IV, nr. 72.

JUSTINIANI I (1.8.527 - 14.11.565)

Bronze

Konstandinopojë

Follis (1.9.532 - 1.9.537).

F. DNIVSTINIANVISPPAV. Busti i Justinianit I, pa mjekër, në profil dj.. me diademë, pancir dhe paludamentum.

Shp. Shenja M: lart kryq; në të m. yll; në të dj. kryq: poshtë A; në segment: CON,

16. AE ↓ 16.50 gr. 30 mm (tab. I, 10).

Gjetur në M.K., 1987, nr. 702.

W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 19, pragtab. VII, nr. 84

Gjysmëfollis (1.9.537 - 538).

F. Legjenda rrethore e fshirë: [DNIVSTINIANVSPPAVG]. Busti i perandorit në profil dj., me tiparet mjaft të fshira.

Shp. Shenja K; në të m. një kryq i gjatë; në të dj. € lart dhe poshtë yll; në segment: CON.

17. AE ↓ 7.65 gr. 26 mm.

Gjetur në termat. 1960, nr 291.

W. Hahn, rep. cit.. v. I. tab. 20 dhe pragtab. VII, nr. 91.

Selanik

Gjysmëfollis (511 - 512).

F. [DNIVSTINIANVS] PPAVG. Busti i Justinianit I, pa mjekër, përballë, me përkrenare dhe pancir, duke mbajtur globin

me kryq të mbivendosur në dorën e dj. dhe në të m. mburojë; në fushë, djathtas, një kryq.

Shp. Shenja K: lart, kryq: në të dj. (vertikalisht) ANNO; në të m. **X4** në segment: **TES**

18. AE ↓ 11.10 gr, 22 mm.

Gjetur në M.K., 3544.

Gjysmëfollis (548 - 549).

19. AE ↓ 4.90 gr.. 22 m (tab I. 11.)

F. Si nr. 18.

Shp. Si nr. 17; në të m. XXII.

Gjetur në M.K. 1987, nr. 3516.

IS (16 numia) (540 - 542).

F. Legjenda rrethore e lexueshme jo mirë: mirë: DNIVSTINIANVSPPAVG. Busti i Justinianit (deri diku i fshirë) me diademë, parzmorë dhe paludamentum, dj.

Shp. Shenja IS; në të m., A. në të dj. P; në segment **TES**

20. AE ↓ 7.78 gr. 20 mm (fab. I, 12).

Gjetje rasti në qytet, nr. 123.

W. Hahn, vep. cit., v. 1, tab. 29 dhe pragtab. VIII, nr. 169 a2.

Δ (4 numia) (538 - 1.9.542).

F. Si nr. 20; legjenda jo e plotë... PPAVG.

Shp. Shenja Δ lart kryq; në të m. A; në të dj. P.

21. AE ↓ 1.80 gr. 15 mm (tab. II, 1).

Gjetur në M.K., 1986, nr. 3547.

W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 30 dhe pragtab. VIII. 176 a.

Kyzyk

Follis (532/33)

F. [DNIVSTINIAN]VSPPAV Busti i Justinianit I përballë, me përkrenare dhe parzmore, duke mbajtur globin me kryq të mbivendosur me dorën e dj.; në dorën e m. mburojë; në fushë, djathtas, kryq. Shp. Shenja M; lart, kryq: poshtë, A: në të m. (vertikalisht).

ANNO; në të dj.  në segment: KYZ.

22. AE ↓ 10.35 gr, 28 mm (tab. II, 2).

Gjetje rasti në qytet, nr. 208.

Krs. W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 24 dhe VII, 120.

Follis (542/543).

23. AE ↓ 19.50 gr, 38 mm (tab. II, 3).

F. Si nr. 22; legjenda e plotë.

Shp. Si nr. 22; në të dj. 

Gjetje rasti në qytet, nr. 209.

24. AE ↓ 16,90 gr, 35 mm.

F. Si nr. 22; legjenda e plotë.

Shp. Si nr. 22; në të dj. 

Gjetur në bazilikën e Gjuricajt, 1989, nr. 106.

Antiok (Theopolis)

Follis (para vitit 538)

F. DNIVSTINI]ANVSPPAV. Busti i Justinianit I në profil dj. me diademë, pancir dhe paludamentum (figura e dëmtuar).

Shp. Shenja M; lart, kryq; poshtë A; në të dj. yll; në segment: MAN.

25. AE ↓ 15.68 gr, 30 mm (tab. II, 4).

Gjetur në M.K., 1986, nr. 786.

Gjetur në M.K., 1986, nr. 786.

J. Sabatier, «Description générale des monnaies byzantines», I, Leipzig, 1930, tab. XIII, 9.

Follis (550/51):

F. DNIVSTINIANVSPPAVG. Busti i Justinianit I, pa mjekër, përballë, me helmetë dhe pancir; në dorën e dj. mban globin me kryq të mbivendosur; në të m. mburojë me emblemën e kalorësit; në fushë, djathtas, kryq.

Shp. Shenja M; lart, kryq; poshtë ; në të m. **Є** (vertikalisht)
ANNO, në të dj.;  në segment: **ΘΗΥΙΙΧ**

26. AE ↓ 18,20 gr. (tab. II, 5).


Gjetur në Qerret, nr. 1063.

Krs. W. Wroth, vep. cit., f. 60, nr. 327, tab. IX, 5.

Gjysmëfollis (1.9.532 - 1.9.537)

F. DN IVSTINIANVSPPAV. Perandori ulur në fron, përballë, duke mbajtur skeptrin në dorën e di. dhe globin me kry në dorën e m.; është i veshur me rrobën e gjatë; në kokë mban përkrenare me pendë.

Shp. Shenja K; në të m. një kryq i gjatë ndërmjet shkronjave



27. AE ↓ 9.70 gr., 25 mm (tab. II, 6).

Gjetur në M.K., 1987, nr. 3545.

W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 25 dhe pragtab. VIII, 135.

Kartagjenë

Follis (para vitit 538).

F. DNIVSTINI ANVSPPAV. Busti i Justinianit I në profil dj.

Shp. Shenja M; lart, kryq; poshtë; në të dj., kryq; në të m. kryq; në segment: CAR.

28. AE ↓ 14.57 gr, 30 mm.

Gjetje rasti në qytet, nr. 923.

Krs. W. Wroth, vep. cit., f. 65, nr. 368.

Gjysmëfollis (536/537).

F. DNIVSTINIANVSPPAV Bust perballë i Justinianit I, me helmetë dhe pancir. duke mbajtur globin me kryq ne doren e dj.; në fushë, djathtas, një kryq.

Shp. Shenja K; lart kryq: poshtë SO; në të m. (vertikalisht) ANNO; në të dj. X; në segment: ..R.

29. AE ↓ 18.25 gr, 34 mm (tab.II,7)

Gjetur në nekropol, 1947, nr. 1144. Krs. Hahn, tab. 32 dhe pragtab. IX, nr. 196.

Gjysmëfollis (539/540).

F. DNIVSTINIANVSPPAV. Busti i Justinianit I, me helmetë dhe pancir, duke mbajtur globin me kryq në dorën e dj.; në fushë, djathtas, një kryq.

Shp. Shenja K; lart kryq; poshtë J; në të m. (vertikalisht) ANNO; në të dj. XIII; në segment; CA[R

30. AE 10.95 gr, 30 mm (tab. II, 8).

Gjetur në M.K., 1987, nr. 17. W. Hahn, vep. cit., v. I, tab. 32 dhe pragtab. IX, 197.

31. AE 11.60 gr, 30 mm (tab. II, 9).

F. Si nr. 30; legjenda jo plotësisht e lexueshme: DNIVSTINI.

Shp. Si nr. 30; emri i punishtes; CAR.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 926.

Siçili

Dekaniumia (548/49).

F. DNIVSTINIANVSPPAVG. Busti i Justinianit I përballë, pa mjekër, me helmetë, parzmore, duke mbajtur në dorën e dj. globin me kryq.

Shp. Shenja I lart; kryq; në të mj. (vertialisht) ANNO; në të dj. XII. E gjitha brenda një kurore.

32. AE 1.80 gr, 20 mm.

Gjetur në M.K., 1986, nr. 786/1.

Shih W. Wroth, vep.cit. f.69, shënimi 1; krs. f.70. nr. 404-409.

Dekaniumia (553/54).

33. AE ↓ 4.20 gr; 15 mm (tab. II, 10).

F. Si nr. 32; legjenda jo e plotë [DNI]IVSTI[NIANVS]PPAV;
një cep i saçmes i thyer. XX

Shp. Si nr. 32; në të dj. VII.

Gjetje rasti në qytet, nr. 937.

Punishte e papërcaktuar

Gjysmëfollis (537/538).

34. AE ↓ 6.55 gr. 25 mm.

F. Si nr. 30; legjenda; [DNIVSTINIAN]VSPPAVG.

Shp. Si nr. 30; shenja poshtë mungon; në të dj. XI. Emri i
punishtes mungon (është fshirë).

Gjetje rasti në qytet, nr. 924.

JUSTINI II (15.11.565 - 5.10.578)

Justini II me Sofinë

Konstandinopojë

Follis (569/570).

F. DNIVSTIN VSPPAVG. Dy perandorët (Justini II në të m.
dhe Sofia në të dj.) me brerore dhe veshur me rroba të gjata, ulur
në një fron dysh, përballë. Justini II mban në dorën e dj. globin
me kryq; Sofia një skeptër në formë kryqi..

Shp. Shenja M; lart kryq; lart kryq; në të m. (vertikalisht)
ANNO; në të dj.  poshtë; B; në segment: CON.

35. AE ↑ 11.40 gr, 28 mm (tab. II, 11).

Gjetje rasti në qytet, nr. 59. W. Wroth, vep. cit., f. 79, nr. 41.

Follis (571/572).

36. AE ↓ 14.45 gr, 29 mm (tab. II, 12).

F. Si nr. 35; legjenda e plotë.

Shp. Si nr. 35; por lart yll; në të dj. 

Gjetje rasti në qytet, nr. 210.

Selanik

a) Me bustin e Justinit II.

Gjysmëfollis (566/567).

F. Legjenda rrethore në pjesën më të madhe e fshirë: DNIVSTINVSP[AV. Busti me përkrenare, përballë i Justinit II, duke mbajtur në dorën e dj. globin me kryq; në dorën 2 m. mburojë (?).

Shp. Shenja K; lart, kryq në të m. (vertikalisht) ANNC: në të dj. II: në segment: **TES**

37. AE ↓ 4.82 gr, 20 mm.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 684. W.Wroth, vep.cit., f.84, nr. 101.

b) Me figurat e Justinit II dhe të Sofisë.

Gjysmëfollis (569/570).

F. Si nr. 35; mbishkrimi i fshirë: dhe kryq; në të m. (vertikalisht) ANNO

Shp. Shenja K; lart **ΘΚΤ**, në të dj. **Ε** në segment: **TES**

38. AE ↓ 4.95 gr., 20 mm (tab. III, 1).

Gjetur në M.K., 1987, nr. 5552. Krs. W. Hahn, vep. cit., v. II, tab. 7 dhe pragtab. III, 7, nr. 70 c.

Gjysmëfollis (570/71).

39. AE ↓ 4.93 gr, 20 mm.

F. Si nr. 35; Jegjenda rrethore e fshirë.

Shp. Si nr. 38, por lart kryq dhe në të m. **G**.

Gjetur në M.K., 1986, nr. 785. Krs. W. Wrath, vep. cit. f. 35, nr. 111.

40. AE ↓ 5.65 gr., 22 mm.

F. Si nr. 35; legjenda rrethore e fshirë.

Shp. Si nr. 39.

Gjetur në MK, 1988, nr. 1157.

Gjysmëfollis (574/75).

41. AE ↓ 5.90 gr., 22 mm.

F. Si nr. 38, por tepër e fshirë.

Shp. Si nr. 38, por lart kryq, në të dj. X.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 591.

Dekaniumia (565/66 (?)).

F. Legjenda rrethore tepër e fshirë: DNI]VS[TINVSPPAV. Busti i Justinianit II në profil dj. me diademë, pancir dhe paludamentum, në përgjithësi figura e ruajtur dobët. Shp. Shenja 1; lart kryq; në të m. (vertikalisht) ANNO; shenja në të dj. e fshirë; poshtë: **TES**

42. AE ↓ 2,30 gr., 22 mm (Tab. III, 2).

Gjetur në amfiteatër, 1956, nr. 2781.

Krs., W. Hahn, vep. cit., v. II, tab. 6 dhe pragtab. III, 71.

Punishtet e papërcaktuar

Me figurat e Justinit II dhe Sofisë.

Follis (574/75).

43. AE ↑ 13.50 gr, 29 mm.

F. Si nr. 35.

Shp. Si nr. 35, por poshtë A dhe në të dj. X. Një pjesëz e saçmes mungon. Getje rasti në qytet, nr. 936.

TIBER II KOSTANDIN (26.IX.578 13.VIII.582)

Me figurat e Tiberit II dhe Anastasisë.

Selanik

Gjysmëfollis (580/81).

F. Legjenda rrethore jo e plotë: [DNTI₆CONS]TANTPFAV
Tiberi II në të dj. dhe Anastasia në të m., me brerore dhe kurorë,
të ulur, përballë mbi një fron dysh; perandori mban në dorën e
dj. globin me kryq; midis kokave të tyre, një kryq i vogël.

Shp. Shenja K; lart kryq; në të m. (vertikalisht) ANNO; në të
dj. III; poshtë: **TES**

44. AE ↓ 6.55 gr, 23 mm (tab. III, 3).

Gjetur në kala, 1985, nr. 1484.

W. Hahn, vep. cit. V. II, tab. 15 dhe pragtab. V, nr. 65. Shih
W. Wroth, vep. cit., shënimi në faqet 125-126.

MAURIK TIBERI (13.8.582 - 22.11.602)

Nikomedia

Follis (587/588).

F. Legjenda rrethore jo e plotë: DN[mAVTIJbER. Busti i Maurik Tiberit me diademë dhe parzmore, përballë, duke mbajtur globin me kryq në dorën e dj.

Shp. Shenja M; lart, kryq; poshtë A; në të m. (vertikalisht) ANNO; në të dj.  në segment; NIK[O.

45. AE ↓ 10.50 gr, 29 mm (tab. III, 4).

Gjetur në Termat, 1961, nr. 334.

W. Hahn, vep. cit., v. II, tab. 22 dhe VIII, nr. 75D W.

Wroth, vep. cit., f. 140, nr. 129.

FOKA (22.11.602 - 4.10.610)

Bronze

Konstandinopojë

Follis (602/603).

F. DNFOCASPIRPAVG. Busti i Fokës, përballë me kurorë, duke mbajtur globin me kryq në dorën e dj.; në të m. kryq.

Shp. Shenja XXXX; lart ANNO; në të dj. I; në segment: CONB.

46. AE ↑ 11.32 gr, 29 mm (Tab. III, 5).

Gjetur në M.K., 1987, nr. 671.

Krs. W. Hahn, vep. cit., vëll. II, tab. 32 dhe pragtab. XI, nr. 61, Cd (por aty në të dj. II).

Follis (606/607).

47. AE ↑ 11.20 gr, 30 mm.

F. Si nr. 46; legjenda e plotë; tiparet e figurës deri diku të fshira.

Shp. Si nr. 46, por në të dj.  dhe në segment: CONT.
Gjetur në Kryevidh, 1984, nr. 1321.

Follis (607/608).

48. AE ↑ 11.11 gr, 20 mm.

F. Si nr. 46; legjenda e plotë.

Gjetjerasti në qytet, nr. 64.

Krs. W. Wroth, rep. cit., po aty, nr. 45 dhe J. Sabatier vep. cit.,
v. I,

Shp. Si nr. 46, por në të dj.  dhe në segment: CON.
f. 254, nr. 12, tab. XXVII, 3.

49. AE ↑ 10.72 gr. 30 mm.

F. Si nr. 46; legjenda e fshirë.

Shp. Si nr. 46.

Gjetje rasti në qytet, nr. 504.

Kyzyk

Follis (607/608).

50. AE ↑ 11.58 gr, 30 mm.

F. Si nr. 46; legjenda jo e plotë:... AS...

Shp. Si nr. 46, por në segment: KYZA.

Gjetje rasti në qytet, 925.

W. Wroth, vep. cit., f. 173, nr. 90.

Antiok

Follis (604/605).

F. **DNFOCA]NEREAV** Foka dhe Leontia veshur me rrobe të gjata në këmbë, përballë, midis dy kokave, një kryq i vogël. Të dy mbajnë në kokë kurorë me kryq; perandori mban në dorën e dj. globin me kryq të mbivendosur, perandoresha një kryq të gjatë.

Shp. Shenja **1** | lart, kryq; në të m. (vertikalisht) **ANNO** në të dj. **41** në segment: **ThE4P**

51. AE 9.25 gr, 25 mm (tab. III, 6).

Gjetur në M.K., 1987, nr. 1. W. Wroth, vep. cit., f. 175, nr. 105.

HERAKLIU I (5.10.610 11.2.641)

Bronze

Selanik

Follis (529, 630).

F. Legjenda e fshirë: Tri figura **DNHERACLIPPVC** qëndrojnë në këmbë përballë: Herakliu (në qendër), Herakli-Kostandini (në të dj.) dhe Martina (në të m.). Secili ka kurorë me kryq, është i veshur me rrobe të gjata dhe mban në dorën e dj. globin me kryq të mbivendosur. Figurat disi të fshira.

Shp. Shenja M; lart, kryq; poshtë **Ε** (?); në të m. **ANNO**, në të dj. **XX**; në segment; **ΘΕ**

52. AE 4.35 gr. 20 mm (Tab. III, 7).

Gjetje rasti në qytet, nr. 927. Krs. W. Wroth, vep. cit, f. 212, nr. 213.

KONSTANCI II (SHTATOR 641 - SHTATOR 668)

Bronze

Konstandinopol

Follis (613 44).

F. $\epsilon]NT\delta TO[NIKA]$ Konstanci II me kurorë me kryq, në këmbë përballë, duke mbajtur në dorën e dj. një kryq të gjatë, në të m. globin me kryq të mbivendosur.

Shp. Shenja $\mathfrak{M}$ lart ANNA; në të dj. NEO; në të m. CON(?); në segment; AILI.

53. AE 5.50 gr, 22 mm (tab. III; 8).

Gjetur në M.K., 1982, nr. 1103. W. Wroth, vep. cit., f. 269, nr. 105.

Kartagjenë

Follis (653 668).

F. $\epsilon]NT\delta T]O[NIKA$ Legjenda rrethore në pjesën më të madhe e fshirë: Konstanci II në këmbë, përballë, duke mbajtur një kryq të gjatë në dorën e dj. dhe globin me kryq në dorën tjetër.

Shp. Shenja $\mathfrak{M}$ lart, kryq; në të m. (vertikalisht) ANNO; në të dj. $\eta\epsilon O$ në segment: [CRT]S.:

54. AE $\checkmark$ 5.25 gr, 17 mm

Gjetje rasti në qytet, nr. 926.

Për prerjet e Konstancit II në Kartagjenë, shih W. Wroth, f. 295, nr. 302-309.

55. AE $\checkmark$ 3.18 gr, 26 mm.

F. Si nr. 54; legjenda ruhet pjesërisht: ...TON...

Shp. Si nr. 54; emri i punishtes ruhet pjesërisht: C.T.

Gjetur në MK., 1989, nr. 3569.

56. AE ↓ 3.80 gr, 24 mm:

F. Si nr. 54; legjenda ruhet pjesërisht. NIKA.

Shp. Si nr. 54; lart K; poshtë: CRT. Gjetur në MK, 1989, 141.

57. AE ↓ 2.15 gr, 23 mm.

F. Si nr. 54; legjenda ruhet pjesërisht: ...TO...

Shp. Si nr. 54; shenja lart është fshirë; poshtë: CRT.

Gjetur në MK, 1987, nr. 138.

Follis (660/61) Punishte e papërcaktuar

58. AE 2.65 gr. 26 mm.

F. Si nr. 54. Legjenda e fshirë.

Shp. Si nr. 54; në të dj. XX; emri i punishtes nuk lexohet.

Gjetur në amfiteatër, 1966, nr. 2784.

KOSTANDINI IV POGONATI (SHTATOR 668 - SHTATOR 683)

ME TË BIJTË

Ari

Konstandinopol

F. **ONCONSTANANCCPP** Busti i perandorit, pamje ballë, veshur me parzmore dhe me helmetë me pendë; në të m. heshtë e mbajtur transversalisht në të dj. mban globin me kryq të mbivendosur.

Shp. VICTORIA **AV4 KC** Kryq mbi tri këmbëshkallë; në të m. të kryqit, Herakliu; në të dj. figura e shkurtër e Tiberit, secili pa mjekër, me rrobe të gjata, në këmbë, përballë; mbajnë, në kokë kurora me kryq dhe në dorën e dj. globin me kryq të mbivendosur. Poshtë: CONOB.

59. AR 4.25 gr. 20 mm (Tab. III, 9).

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr. 5294.

W. Wroth, vep. cit., f. 314, nr. 4.

THEOFILI

Bronze Konstandinopol

Follis (rreth 830-842).

F. **ΘΓΟΦΙΛ' ΒΑΣΙΛ'** Figura e Theofililit në gjysmëgjatësinë e trupit, në këmbë, përballë; mban kurorë me një ornament në kulm, në trajtë erashke; në të m. globin me kryq; në të dj. laburum të zbukuruar me kryq dhe me dy shirita.

Shp. **ΘΕΟΣ-ΦΙΛΕΑΥΣ-ΟΥΣΤΕΣΥ-ΗΙΚΑΣ** në katër rreshta.

60. AE 9 gr, 27 mm (tab. III, 10).

Gjetje rasti në qytet, nr. 1159.

W. Wroth, vep. cit., f. 423, nr. 20.

Një monedhë si kjo, me preardhje nga Durrësi, është botuar nga

H. Spahiu, art. cit., f. 385, nr. 247.

VASIL I MAQEDONASI (27.9.867 - 29.8.886)

Bronze

Me të bijtë: Konstandinin dhe Leonin

Konstandinopol (370 - 879)

F. **+ΛΕΟΗΒΑΣΙΛ COH5TA[ΥC** Në qendër figura e Vasilit në gjysmë gjatësinë e trupit, me mjekër, përballë; në të m. figura më e shkurtër në gjysmëgjatësi e Leonit VI, përballë; në të dj.

ajo e Konstandinit, përballë, me të njëjtën lartësi si e Leonit. Vasili është veshur me rrobe me kuadrate, në kokë mban kurorë me kryq dhe në dorën e m, mappa. Leoni dhe Konstandini mbajnë kurorë me kryq dhe mantel të lidhur në supin e m.

Shp. +bASIL-COHSAH-[ZSIEQ]H-ΘOBASILS-ROMEON
në pesë rreshta; poshtë yll.

61. AE ↓ 6.75 gr, 28 mm (tab. III, 11).

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr. 2705.

W. Wroth, vep. cit., f. 440, nr. 23.

62. AE ↓ 5.65 gr, 26 mm.

F. Dy monedha të këtij perandori (një e Vasilit I vetëm dhe një me të bijtë), me prejardhje nga Durrësi, janë botuar nga H. Spahiu, art. cit., f. 386, nr. 251, 253.

Shp. Si nr. 61; legjenda e plotë;

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr. 2424.

63. AE ↓ 8.20 gr, 28 mm.

F. Si nr. 61.

Shp. Si nr. 61; legjenda pothuaj e plotë Gjetur në termat, 1961, nr. 320.

64. AE ↓ 5.80 gr, 26 mm (tab. III, 11).

F. Si nr. 61.

Shp. Si nr. 61; legjenda e plotë.

Gjetur në termat, 1960, nr. 303.

65. AE ↓ 6.85 gr, 27 mm.

F. Si nr. 61; legjenda jo e plotë.

Shp. Si nr. 61; legjenda e plotë.

Gjetje rasti në qytet, nr. 928.

LEONI VI (I DITURI)

(29.8.886 - 11.5.912)

Bronze

Konstandinopojë

F. + LEOH BASILEVSROM Busti i Leonit VI, me mjekër të shkurtër, përballë, me kurorë me kryq, veshur me mantel; në të majtë mban *mappa*.

Sh. + LEOH - EHΘEOBA - SILEVSR - OMEOH

në katër rreshta.

66. AE ↓ 7.10 gr. 27 mm (tab. VI, 1).

Gjetje rasti në qytet, nr. 69.

W. Wroth, vep. cit., f. 447, nr. 8, 9, 10.

Katër monedha bronzi të këtij perandori të gjetura në Durrës, janë botuar nga H. Spahiu, art. cit., f. 387, nr. 257, 258, 259, 262.

67. AE ↓ 5.70 gr, 26 mm (tab. IV, 2).

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr. 623/1.

68. AE ↓ 5.05 gr. 25 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në amfiteatër, 1966, nr. 2931.

69. AE ↓ 6.30 gr, 24 mm (tab. IV, 3).

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr 623/4.

70. AE ↓ 6.80 gr, 26 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në kala, 1984, nr. 431.

71. AE ↓ 6.70 gr, 24 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në kala, 1985, nr. 352.

72. AE ↓ 6.60 gr, 26 mm

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në termat, 1962, nr. 313.

73. AE ↓ 4.68 gr, 24 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në termat, 1691, nr. 322.

74. AE ↓ 9.52 gr, 27 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në termat, 1960, nr. 300.

75. AE ↓ 6.80 gr, 26 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 3550.

76. AE ↓ 6.6 gr, 25 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 621.

77. AE ↓ 4.55 gr, 25 mm.

F. Si nr. 66; legjenda jo e plotë.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 701.

78. AE ↓ 6.15 gr, 26 mm.

F. Si nr. 66; legjenda jo e plotë.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 682.

79. AE ↓ 9.45 gr, 28 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 751.

80. AE ↓ 7.32 gr, 23 mm.

F. Si nr. 66; legjenda jo e plotë.

Shp. Si nr. 66.

81. AE ↓ 5.45 gr, 21 mm.

F. Si nr. 66; legjenda lexohet pjesërisht.

Shp. Si nr. 66; rreshti i parë i fshirë.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 631.

82. AE ↓ 4.15 gr, 24 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në M.K., 1987, 742

83. AE ↓ 8.63 gr, 26 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në M.K., 1989, nr. 3565.

84. AE ↓ 6.72 gr., 27 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66. Gjetur në nekropol, 1957, nr. 30.

85. AE ↓ 6.25 gr, 25 mm

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në nekropol 1947. nr. 1146

86. AE ↓ 5.75 gr, 24 MM.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në nekropol, 1947, 1119.

87. AE ↓ 5.75 gr, 26 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetur në nekropol, 1947, nr. 1151.

88. AE ↓ 7.65 gr, 25 mm.

F. Si nr. 66

Shp. Si nr. 66

Gjetje rasti në qytet, nr. 211.

89. AE ↓ 7.70 gr, 26 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetje rasti në qytet, nr. 212.

90. AE ↓ 5.65 gr, 23 mm (tab. IV, 4).

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetje rasti në qytet, nr. 213.

91. AE ↓ 6 gr, 23 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetje rasti në qytet, nr. 77.

92. AE ↓ 5 gr, 25 mm.

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66.

Gjetje rasti në qytet, nr. 71.

93. AE ↓ 4.70 gr, 26 mm.

F. Si nr. 66

Shp. Si nr. 66.

Gjetje rasti në qytet, nr. 938.

94. AE ↓ 5.45 gr, 24 mm (tab. IV, 5).

F. Si nr. 66.

Shp. Si nr. 66

Gjetje rasti në qytet, nr. 938.

95. AE ↓ 6.25 gr, 25 mm

F. Si nr. 66

Shp. Si nr. 66

Gjetje rasti në qytet, nr. 953.

ROMANI I (919 - 944)

Bronze (919 - 921)

Konstandinopol

F. [+RWMAH'BAΣI]LEVSRWMI Busti, me mjekër, i Romanit I, përballë, me kurorë me kryq, duke mbajtur në dorën e m. globin me kryq dhe në dorën e dj. mbështetur në trup laburum.

Shp. RWMA/HEHΘEOBA/SILEVSRWIMAIW^h në katër rreshta

96. AE ↓ 6.55 gr., 25 mm (Tab. IV, 6).

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr. 2667.

W. Wroth, vep. cit., f. 455, nr. 14.

97. AE ↓ 8.90 gr, 28 mm. (tab. IV, 7);

F. Si nr. 96; legjenda jo e plotë: $\cdot\text{RW}\cdot\text{LEVSRW}\cdot$

Shp. Si nr. 96.

Gjetur në Termat, 1960, nr. 307.

98. AE ↓ 5.58 gr, 23 mm (tab. IV, 8).

F. Si nr. 96; legjenda në pjesën më të madhe e fshirë:

Shp. Si nr. 96.

Gjetje rasti në qytet, nr. 930.

KOSTANDINI VII PORFYROGJENETI

(6.6.913 - 15.11.959)

Vetëm

Bronze

Konstandinopojë (945)

F. $[\cdot\text{COHST}]\text{bASILRWm}$ Busti i Konstandinit VII, me mjekër, përballë mban kurorë me kryq dhe është veshur me rroba me kuadrate. Në dorën e dj. mban mappa, në të m. globin me kryq.

Shp. $\cdot\text{COHST}-\epsilon\eta\theta\epsilon\text{O}\beta\text{A}-\text{SIL}\epsilon\text{VSR}-\text{OM}\epsilon\text{O}\eta$ në katër rreshta.

99. AE ↓ 9.70 gr, 19 mm (tab. IV, 9).

Gjetje rasti në qytet, nr. 935.

W. Wroth. vep. cit.. f. 463. nr. 45

100. AE ↓ 3.65 gr, 24 mm.

F. Si nr. 99; legjenda rrethore në pjesën më të madhe e fshirë:

$\cdot\cdot\cdot\text{TbASIL}\cdot\cdot\cdot$

Shp. Si nr. 99.

Gjetje rasti në qytet, nr. 939.

101. AE ↓ 5.45 gr, 24 mm (tab. IV, 10).

F. Si nr. 99; legjenda rrethore në pjesën më të madhe e fshirë:

...STbAS...RWm

Shp. Si nr. 99; rreshti i parë lexohet me vështirësi.

Gjetje rasti në qytet, nr. 940.

NIKIFOR II FOKA (16.8.963 - 10.12.969)

Bronze

Kostandinopol

F. *hICIFRbASILERW Busti i Nikiforit II, me mjekër, përballë mban kurorë me kryq me rrobë me kuadrate; në dorën e dj. mban labururm në kryqformë; në të m. globin me kryq.

Shp. *hICIF-ETHGOBA-SILEVS-RWMAIWh
në katër rreshta.

102. AE ↓ 6.20 gr, 25 mm (tab. IV, 11).

Gjetje rasti në qytet, nr. 66.

W. Wroth, vep. cit., f. 473, nr. 8.

103. AE ↓ 9.53 gr, 25 mm (tab. IV; 12).

F. Si nr. 102; legjenda jo e plotë: hIC...bASILER...

Shp. Si nr. 102.

Gjetur në MK, 1983, nr. 217.

104. AE ↓ 6.15 gr, 23 mm.

F. Si nr. 102; legjenda jo e plotë: ...!FRBAS...

Shp. Si nr. 102.

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr. 623/11.

JANI I ZIMISKI (11.12.969 - 10.1.976)

Bronze

Konstandinopol (972-976)

F. Legjenda rrethore, pothuaj e fshirë: [†EMMANOVHA]
Busti i Krishtit, përballë, me brerore me kryq, me tunik dhe mantel; dorën e dj. në pozë bekimi; në dorën e m. mban librin e Ungjillit. Në fushë: C - XC. Brerorja me një kokrrizë në secilin krah të kryqit. Libri në qendër ka një kokrrizë apo pikëz.

Shp. +*hS45-XRIS45-BASILE4-BASILE*

në katër rreshta. Lart dhe poshtë pikëz.

105. AE ↓ 15.23 gr, 33 mm (tab. V, 1)

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr. 3322.

W. Wroth, vep. cit., f. 477, nr. 14.

106. AE ↓ 12.20 gr, 31 mm.

F. Si nr. 105; legjenda rrethore pjesërisht e fshirë:

...MAN...IC - XC

Shp. Si nr. 105

Gjetur në termat, 1960, nr. 305.

107. AE ↓ 8.10 gr, 30 mm.

F. Si nr. 105; legjenda në pjesën më të madhe e fshirë:

...+IC - XC

Shp. Si nr. 105.

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr. 2467.

108. AE ↓ 12.50 gr, 30 mm (tab. V, 2).

F. Si nr. 105; legjenda jo e plotë: €M...

Shp. Si nr. 105; lart dhe poshtë:

109. AE ↓ 10 gr. 30 mm.

F. Si nr. 105; legjenda rrethore e fshirë, figura e dobët

Shp. Si nr. 108.

Gjetje rasti, nr. 931.

W. Wroth, vep. cit., f. 478, nr. 26.

110. AE ↓ 30 mm.

F. Si nr. 105; legjenda e fshirë.

Shp. Si nr. 108.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 683.

111. AE ↓ 9.20 gr. 29 mm (Tab. V. 3).

F. Si nr. 105, por me dy kokrriza në secilin krah të kryqit dhe në qendër të librit dy pika: (·)

Shp. Si nr. 105. por lart dhe poshtë: 

Gjetur në amfiteatër. 1966, nr. 2885.

W. Wroth. vep. cit., f. 477, nr. 11.

Një monedhë e tillë e gjetur në Durrës është botuar nga H. Spahiu, art. cit., f. 300, nr. 267, tab. VI, 3) si dhe tri të tjera për të cilat mungojnë ilustrimet dhe hollësitë e nevojshme për klasifikimin (nr. 323. 1, 333, 335).

112. AE ↓ 28 mm.

F. Si nr. 105. legjenda e fshirë.

Shp. Si nr. 111, por lart dhe poshtë: 

Gjetje rasti në qytet, nr. 1190.

113. AE ↓ 11,52 gr. 26 mm (Tab. V, 4).

F. Si nr. 105, por në qendër të librit:

Shp. Si nr. 105, por lart dhe poshtë: —  —

Gjetur në MK., 1987, 598.

Krs. W. Wroth, vep. cit., f. 477, nr. 19.

114. AE ↓ 11.55 gr, 28 mm.

F. Si nr. 113.

Shp. Si nr. 105, por lart dhe poshtë: — —

Gjetur në MK, 1989, nr. 3548.

115. AE ↓ 6.20 gr, 30 mm.

F. Si nr. 105; brerorja me dy kokrriza në secilin krah të kryqit; ornamenti në libër, i paqartë.

Shp. Si nr. 105, por ornamenti lart dhe poshtë i paqartë.

Gjetje rasti në qytet, nr. 142.

VASILII II BULLGARVRASËSI (10.1.976 - 15.9.1025)

së bashku me Konstandinin VIII

Bronze

Konstandinopol

F. Legjenda rrethore e fshirë: [+EMMANOVHA] Busti i Krishtit, me mjekër, përballë; mban brerore me kryq, tunik dhe mantel; dorën e dj. në pozë bekimi, në të majtën mban librin e Ungjillit. Në fushë: ἱϛ - x̄c Brerorja e zbukuruar me  në secilin krah të kryqit; libri i Ungjillit me kryq në qendër: (+)

Shp. +lh545 - XRIST45 - bASILE4 - bASILE +

në katër rreshta

Lart dhe poshtë kryq (+).

116. AE ↓ 10.15 gr, 26 mm (Tab. V, 5).

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr. 612/1.

W. Wroth, vep. cit., f. 488, nr. 22.

117. AE ↓ 8.15 gr, 30 mm (Tab. V, 6).

F. Si nr. 116; legjenda ruhet pjesërisht; libri me (:) në qendër.

Shp. Si nr. 116, lart dhe poshtë dredhëz: Gjetur në amfiteatër, 1966, nr. 2444. W. Wroth, vep. cit., po aty, nr. 26.

118. AE ↓ 12.15 gr, 32 mm.

F. Si nr. 117; legjenda e fshirë.

Shp. Si nr. 117; lart dhe poshtë: — — —

Gjetur në amfiteatër (osteotekë), 1987, nr. 3328.

119. AE ↓ 10.55 gr. 29 mm.

F'. Si nr. 117: legjenda rrethore e fshirë, ornamentit në qendër të librit (:) (?).

Shp. Si nr. 117; lart, dredhëz.

Gjetje rasti në qytet, nr. 71.

120. AE ↓ 8.35 gr, 26 mm.

F. Si nr. 117; ornamentit i librit i paqartë.

Shp. Si nr. 117.

121. AE ↓ 9.00 gr., 25 mm.

F. Si nr. 117; legjenda e fshirë;

Shp. Si nr. 117.

Gjetur në M.K., nr. 556.

122. AE ↓ 11.65 gr, 27 mm. tab. V, 7).

F. Si nr. 117; ornamentit i librit i paqartë, brerorja me 

Shp. Si nr. 117: lart dhe poshtë i paqartë.

Gjetur në M.K., 1997. nr. 575.

123. AE ↓ 11.10 gr. 30 mm.

F. Si nr. 116: figura në përgjithësi e fshirë, brerorja e zbukuruar me ✕ ornament i librit i paqartë.

Gjetur në M.K., 1988, nr. 3549. Krs. W. Wroth, rep. cit., f. 489, nr. 37.

124. AE ↓ 13.90 gr., 30 mm.

F. Si nr. 123.

Shp. Si nr. 123.

Gjetur në M.K., 1987, nr. 520.

125. AE ↓ 11.80 gr., 26 mm (tab. V, 8).

F. Si nr. 116; legjenda e fshirë; brerorja e zbukuruar me ✕ libri me ☉ në qendër.

Shp. Si nr. 116; lart dhe poshtë: —◊—

Gjetur në amfiteatër, 1967, nr. 606.

Krs. W. Wroth, vep. cit., f. 489, nr. 37 (por jo me

126. AE ↓ 29 mm.

F. Si nr. 125.

Shp. Si nr. 125.

Gjetje rasti në qytet, nr. 951.

127. AE ↓ 10 gr., 26 mm (tab. V, 9).

F. Si nr. 125; libri me ✕ në qendër.

Shp. Si nr. 125.

Gjetur në amfiteatër, 1966, nr. 2384, W. Wroth. f. 481, nr. 40.

PASQYRË PËR KRONOLOGJINË E PRERJEVE DHE PUNISHTET MONETARE

Perandori	Gjithsej	Vitet e prerjeve	Kostandinopol	Selanik	Nikomedia	Kyzyk	Antioq	Kartagjenë	Siçili	E papërcaktuar
Anastasi I	13	1.4.491-498 1.9.507-1.9.512 1.9.512-1.9.517 1.9.517-1.7.518	1 5 5 2							
Justini I	2	1.9.522-4.4.527		2						
Justiniani I	19	1.9.532-1.9.537 532/33 1.9.537-530 536/37 para v. 538 538-1.9.542 539/40 540-42 541/42 542/43 548/49 550/51 553/54	1 1	 1 1 1		1 2	1 1 1	 1 1 2	 1 1	1
Justini II	9	565/66 566/67 569/70 570/71 571/72	1 1	1 2 2 1						1
Tiber	1	574/75 580/81		1						
Kostandini										
Maurik Tiber	1	587/88		1						
Foka	6	602-603 604-605 606-607 607-608	1 1 2			1 1				
Herakliu I	1	629/30		1						
Konstanci II	6	643/44 641-668 660/61	1					4		1
Konstandini IV Pogonati	1	668-83	1 Ar							
Theofili	1	rrëth 830-842	1							
Vasili I	5	870-79	5							
Leoni VI	30	886-912	30							
Romani I		919-921	3							
Konstandini VII	3	945	3							
Nikifori II Foka	3	963-969	3							
Jani I Zimiski	11	969-976	11							
Vasili II	12	976-1025	12							

RESUME

**MONNAIES IMPERIALES BYZANTINES PROVENANT
DE DYRRACHIUM (401-1025)**

Au musée archéologique de Durrës est conservée une collection de monnaies byzantines dont la plupart sont inédites. Le catalogue cdessus comprend 126 pièces en bronze et une en or, qui représentent les frappes de 18 empereurs et s'échelonnent depuis le début du règne d'Anastase I.r (491) jusqu'à la fin du règne de Vassii II(1025). mais avec un hiatus de 150 ans (683-830).

Les pièces de cette collection remontent à deux étapes. A la première appartiennent 59 pièces frappées depuis le règne d'Anastase Iel jusqu'à celui de Constantin IV Pogonathe (491-683), à la deuxième se situent 68 pièces émises depuis le règne de Théophile jusqu'à celui de Vassili II (830-1025) (voir le tableau récapitulatif de la chronologie des frappes et des ateliers monétaires.

L'absence totale de monnaies de la période allant de 683 à 830 est un fait constaté même au-paravant en Albanie, Outre les causes profondes, que l'on ignore encore, la crise générale du système financier qui toucha l'empire pendant cette période, explique aussi cette absence.

Cette collection est, pour la plupart, constituée de pièces frappées à Constantinople, mais il n'y manque pas non plus les

monnaies, provenant des ateliers provinciaux (Thessalonique, Carthage, Cysique, Antioche, Sicile, Nicomédie).

Bien qu'elle soit encore petite, la collection de monnaies étudiée ci-dessus témoigne du développement économique et culturel de la ville avec ses fluctuations dues aux changements des circonstances politiques pendant la basse antiquité et le haut moyen âge.




Tabela I
Anastasi I – Konstatinopol
Justini - I Selanik
Justiniani I – Konstantinopol, Selanik



Tabela II

Justiniani I – Selanik, Kyzyk, Antiok, Kartagenë, Siçili
Justini II - Kostantinopol




Tabela III

Justini II – Selanik	Herakliu I – Selanik
Tiber Kostantini – Selanik	Kostanci II – Kostantinopol
Maurik Tiberi – Nikomadia	Theofili - Kostantinopol
Foka – Kostantinopol	
Kostantini IV Pogonati - Kostantinopol	




Tabela IV

Leoni VI – Kostantinopol

Romani I – Kostantinopol

Kostantini VII – Kostantinopol

Nikifor II Foka - Kostantinopol




Tabela V
Jani I Zimiski – Kostantinopol
Vasili II - Kostantinopol

KONSIDERATA MBI OBELISKUN E APOLONISË¹

Fillimisht, prania e obeliskut në Apoloni (fig. 1)² është supozuar mbi bazën e figurës së tij të gjetur në monedha bronxi e argjendi të prera në këtë qytet, që nga fundi i shek. V, ose gjysma e parë e shek. IV p.e.s. deri në shek. III e. s.).³ Në to ai është paraqitur në trajtë të zgjatur boshtore, me majë konike dhe me bazament kuadratik, rrallë herë të rrumbullakët, një, dy ose tri këmbëshkallësh (fig. 2). Në më të shumtën e rasteve, pak poshtë majës konike shihet një unazë e profiluar, prej së cilës varet në të dyja anët një kordele e gjatë. Në disa raste shihet dhe një unazë tjetër e profiluar në pjesën e poshtme të trungut. Më pas, ky monument, u bë i njohur edhe arkeologjikisht. Pranë murit të terracimit të shek. III p.e.s., që rrethon temenosin me

¹ Marrë nga revista "Monumentet" Nr. 1 – 1988, f.81-86.

² . Ceka, Mbi historikun e kërkimeve dhe gërmimeve në Apoloni, në «B.SH.SH», 1958, 4, f. 213. Apolonia, Tiranë, 1958, f. 30, Ch. Picard, Anciennes et nouvelles fouilles archeologique en Albanie, Apollonie d'Illyrie në «Revue Archeologique», 1962 - Tome II, f. 215, M. Korkuti, Shqipëria arkeologjike, Album, Tiranë, 1971, nr. 68, N. Ceka; Apolonia e Ilirisë; Tiranë 1982; f. 45-46, Les Illyriens, Tiranë, 1985, fig. 48, P.R. Franke, Antike Welt, 14 (1983); f. 41, K. Xuvara Suli, Janinë 1984, f. 435-437.

³ P. Gardner, Thessaly to Aetolia (Br.M.Cat. vol. VI) London, 1883, f. 56, Tab. 12, 3, B.V. Head, Historia Numorum, Oxford 1911, f. 314, H. Ceka, Probleme të numismatikës ilire, Tiranë 1965, f. 40, 117, 130, Questions de Numismatique Illyrien, Tiranë, 1972, f. 57 dhe 66, shih dhe Apolonia, f. 30.

tempullin e Artemisit, u zbulua një pjesë kolone cilindrike e vendosur mbi një bazament kuadratik prej blloqesh të vogla.⁴



Fig. 1




Fig. 2: a, b – GARDNER (Tab. XII, 2 dhe XIII, 15);
c, d, e - MONELLA APOLLONIATE

⁴ H. Ceka, Apolonia, Po aty, dhe Mbi historikun e kërkimeve..., f. 213.

Kolona e ka lartësinë 0,80 m dhe diametrin 0,47 m. Në fundin e saj është zbukuruar me skocia e toro, ndërsa në lartësinë 0,52 m nga baza, është e pajisur me një unazë të profiluar diskoidale. Monumenti u identifikua me obeliskun e njohur në monedhat⁵, nga ana e H. Cekës.




Fig. 3




Fig. 4

Një obelisk, pothuaj i plotë, u zbulua më pas në rrënojat e harkut të triumfit, të perandorit Oktavian August, mbi të cilin mendohet se ka qenë ngritur (fig. 4)⁶ Ai përbëhet prej një kolone monolite guri gëlqeror me trajtë cilindrike, që lart vjen duke u ngushtuar për të marrë një formë trung-konike. Lartësia e saj është 1,63 m, diametri i bazës 0,40 m. Baza është pak e profiluar e një unaze, e profiluar diskoidale, e rrethon tringun e kolonës

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

edhe në pjesën e poshtme të saj. Në kulm, paraqitet e prerë rrafsh, me një gropëz në qendër. Kjo kolonë u vendos më pas mbi pjesën e obeliskut të zbuluar më parë, duke krijuar kështu monumentin që shohim sot (fig. 1). Kohët e fundit, profesor Franke ka shfaqur mendimin se obelisk duhet marrë dhe një kolonë me një tambur të thyer sipër saj, që është vendosur mbi një bazament kuadratik prej blloqesh të vogla para kurtinës B të murit rrethues,⁷ e konsideruar më parë si pjesë e një kolonade. Diametri i saj është 0,62 m, lartësia së bashku me pjesën e tamburit të mbivendosur, 1,93 m dhe së bashku me atë të bazamentit 3,15 m. Para kësaj kurtine gjenden dhe dy bazamente të tjera identike, të vendosura në të njëjtin drejtim, 3,90 m larg njëri-tjetrit. Në rast se të dhëna të reja do të vërtetonin plotësisht se dhe këtu kemi të bëjmë me një obelisk, atëherë dy bazamentet e tjera do të na bënin të mendojmë se dikur në këtë vend kanë qenë në këmbë tre obeliskë përkrah njëri-tjetrit. Dhe kjo treshe do të na kujtonte një prerje monetare apoloniote të shekujve III-I p.e.s, që paraqet tre obeliskë në krah të njëri-tjetrit.⁸ Nëpërmjet të dhënave numizmatike të shekujve III-II p.e.s.mund të supozohet se obelisk si i Apolonisë janë ngritur dhe në Amanti, Olympe dhe Orik.⁹ Qytet tjetër, ku është vërtetuar prania e këtij lloj monumenti, para

⁷ P.R. Franke, *Po aty*, f. 54, 112, shih dhe K. Xuvara fig. 9. - Suli; vep. përmend; f. 435.

⁸ H. Ceka, *Probleme...*, f. 121, nr. 100, 105, Tab. VI, 8.

⁹ H. Ceka, *Po aty*, f. 113. 135, Sh. Gjongecaj, *Prerje monetare të Amantisë, «Iliria»* 7-8, 1977-78. *Prerje monetare të Amantisë, Bylysit, Olympes dhe Orikut*, Studim pranë Arkivit të Q.K.A. Tiranë, B. Dautaj, *Kalaja e Mavrovës, «Iliria»* 1, 1981, f. 75.

periudhës perandorake romake, është Ambrakia në Epir.¹⁰ Në kohën e August Oktavianit një obelisk është ngritur dhe në Nikopolis¹¹, si dhe një tjetër në varrezën e Korintit.¹²

Për sa i përket zanafillës së obeliskut në Apoloni, mendojmë se kjo i duhet dedikuar më tepër ndikimit të një kulti të lashtë vendas, ilir, se sa një ndikimi të jashtëm. Mendimi se kulti i Apolon Agieut dhe obelisku, si simbol i tij, janë prurë në Apoloni nga ana e kolonistëve të ardhur nga Korinti¹³, na duket se le vend për diskutim. Së pari, na tërheq vëmendjen fakti se para periudhës perandorake romake Agieu në formën e simbolit të tij, obeliskut, është adhuruar në një zonë të kufizuar vetëm me Apoloninë, me qytetet e tjera ilire që përmendëm dhe me Ambrakinë. Nuk njihet asnjë e dhënë e drejtëpërdrejtë ose e tërthortë për të dëshmuar praninë e një monamenti të tillë në Korint ose në Korkyrë, para kohës së Augustit. Nga ana tjetër, me përmasat që ka dhe me karakterin e tij shoqëror, obelisku i Apolonisë nuk mund të barazohet me betylët e thjeshtë të varreve dhe të paraportave, shtyllëzave të vogla të lidhura me kultin e Agieut, të cilat njihen që nga periudha arkaike në disa qytete të Greqisë Veriperëndimore.¹⁴ Një betyl varri shek. VII-VI p.e.s., që ruhet në muzeun e Korfuzit¹⁵ dhe një tjetër me trajtë piramidale e me mbishkrim arkaik (0,57 m i lartë), që ruhet në

¹⁰ P. Gardner, vep. e përmendur, f. 94. B.V. Head, vep. përmend. f. 329. K. Xuvara, Suli, vep. përmend. f. 429-435.

¹¹ Po aty, f. 438 - 439.

¹² Po aty, f. 434, Tab. 7 B.

¹³ Po aty, f. 428, 441

¹⁴ Po aty, f. 428, 442

¹⁵ Po aty, f. 440.

muzeun e Apolonisë mendojmë se nuk përbëjnë prototipin arkitektonik të obeliskut.

Së dyti, dihet që Apolonia, sikurse Dyrrahu, në prerjet e tyre monetare kanë imituar tipe të metropoleve të tyre, Korintit dhe Korkyrës. Mirëpo tipet karakteristike të monedhës apoloniote me obelisk janë krejtësisht të panjohura si në Korint edhe në Korkyrë.¹⁶ Në formën e simbolit të tij, obeliskut, Apolon Agieu mund të ishte shfaqur dhe në monedha të kolonive të tjera të Korintit, në qoftë se do të ishte një prurje e kolonistëve të nisur prej atij qyteti. Mirëpo atë nuk e gjejmë në koloni të tjera korintike, si në Siçili, apo në Btutium¹⁷ dhe bile as në Dyrrah, si kolonia më e hershme e korintit dhe e Korkyrës në bregdetin e Ilirisë.

Së treti, bie në sy se, në Korint kulti i Apolonit dokumentohet shumë më dobët¹⁸ në krahasim me kultet kryesore të qytetit, si ai i Afërditës, i Athinasë, i Herakliut dhe ai i Pegasit, aq të përhapura dhe në shumicën e kolonive korintike.¹⁹ Por janë edhe disa rrethana të tjera, të cilat duket se nuk e favorizojnë origjinën e këtij monumenti si të prurë prej kolonistëve së bashku me kultin e Apolon Agieut. Kështu, duket se në radhën e hyjnive që adhuroheshin më shumë në Apoloni, Artemisi qëndron para Apolonit.²⁰ Kjo hyjneshë ilire e grigjave në Apoloni ka pasur një pikë kulti para kolonizimit grek dhe pikërisht mbi atë bazë u

¹⁶ Shih. B.V. Head, vep.cit, f. 217 e vazhd. dhe f. 334.

¹⁷ Po aty, f. 86 e vazhd. 150159, 278 - 283.

¹⁸ Shih. K. Xuvara - Suli, vep. cit., f. 433.

¹⁹ Shih. B.V. Head, vep.cit, f. 335 341.

²⁰ N. Ceka, Apolonia..., f. 174 175.

ngrit tempulli i mëvonshëm²¹, pranë të cilit gjejmë dhe obeliskun më të vjetër që njohim. Ky konstatim bie në sy më haptaz në Amantia, ku nuk ka asnjë shenjë të kultit të Apolonit dhe në monedhat e qytetit, ku figura e obeliskut paraqitet e shoqëruar vetëm me Artemisin.²² Ndërsa në Dimal atë e gjejmë të shoqëruar me Athinanë.²³ Edhe në Ambraki figura më e hershme e obeliskut, që njihet mbi monedha të shekujve V-IV p.e.s., nuk është e shoqëruar me portretin e Apolonit, siç ndodh më mbrapa, por me atë të Athinasë.²⁴ Në monedhat e këtij qyteti obeliskun e gjejmë të shoqëruar dhe me Dionen.²⁵ Nga këta shembuj, frymëzimin për ngritjen e këtij monumenti priremi për ta kërkuar tek një bazë kultike vendase, gjasisht me origjinë matriarkale, por të afërt me atë të Apolonit, Agieut dhe që bën përpjekje për t'iu përshtatur pantheonit grek.

Në të vërtetë kulti i gurëve të punuar në formë konike, betylëve, ka një origjinë shumë të lashtë, litholatrike, të lidhur ngushtë me kultin solar të majë-maleve e të shkëmbenjve²⁶ dhe njihet në parahistorinë e të gjithë popujve.²⁷

²¹ Po aty, f. 45.

²² Sh. Gjongecaj, Prerje monetare të Amanties, Bylisit...

²³ B. Dautaj, Të dhëna numismatike nga Dimali, «Iliria» 1984, 1, 147.

²⁴ K. Xuvara, - Suli, Po aty, f. 429, Tab. 1; alfa, beta, gama.

²⁵ B. V. Head, Po aty, f. 270.

²⁶ A. Parrot, «Aventure archeologique, Paris, 1979. f. 212. Përmend një betyl të ngritur në qytetin Mari të Mesopotamisë në mijëvjeçarin e tretë p.e.s. shih dhe Dictionaire des antiquites grecques et romaines, Paris 1877, s.v. Beatylia.

²⁷ L.R. Farnel, The Vults of Greek States, IV, f. 150 v). Farnel bën fjalë për një hyjni parahistorike të shtegtimeve dhe të ngulimeve, e cila ecën në krye të gjinisë, duke përcaktuar në rrugën e saj stacione me anë çukash e gurësh të ngritur në këmbë.

Një njoftim interesant për periudhën historike në lidhje të drejtpërdrejtë me obeliskun, sjell Maksimi i Tyrit (4. 8. 6) duke bërë fjalë për ilirët palonë, që e adhuronin diellin në formën e një disku të vogël të ngritur mbi majën e një kolone të lartë.²⁸

Në Apoloni, vërehet se pas kolonizimit, kultet e lashta të ilirëve pjesërisht kanë vazhduar të ruhen të pandryshuara prej vendasve, pjesërisht janë pranuar dhe nga kolonistët, ose janë adoptuar prej tyre në përshtatje me pantheonin grek. Kështu, një dëshmi mbi ruajtjen e një kulti të lashtë vendas, në formën e tij parahistorike, gjejmë tek dëshmia e Aristotelit (De Mir 8336) për një shkëmb në kufi të tokave apoloniote, mbi të cilin hidhnin vaj dhe ndizej. Ndërsa dëshmi mbi një kult solar, që duket përsëri me origjinë të lashtë vendase, gjejmë tek Herodoti (IX. 93) kur bën fjalë për dele kushtuar Diellit, të cilat mbaheshin në një shpellë larg qytetit. Në Apoloni kolonistët grekë zbatojnë praktikën ilire të varrimit në tuma, që tanimë në atdheun e tyre ishte lënë.²⁹ Ky fakt flet pikërisht për vazhdimësi të kulteve vendase dhe për pranimin pjesërisht të tyre dhe prej kolonistëve. Ndërsa, përsa i përket përshtatjeve të përmendura, kemi shembuj të tillë siç është, në radhë të parë, vetë tempulli i Artemisit, për të cilin, siç e thamë, janë gjetur tregues që provojnë se është ngritur mbi një bazë më të hershme vendase të këtij kulti.³⁰ Një përpjekje për përshtatje të kulteve vendase me pantheonin grek shohim dhe te shoqërimi, në monedha apoloniote, i trekëmbëshit të Apolonit me zjarrin e Nymfeut, si dhe të paraqitjes në to të një shpelle,

²⁸ A. Baçe, Vështrim mbi besimin dhe arkitekturën e kultit tek ilirët, Monumentet 2, 1984, f. 6.

²⁹ A. Mano, Nekropoli i Apolonisë,..., f. 199,

³⁰ Shih. Sh. 21, më lart.

pikë kjo, që kuptohet se i ka takuar një kulti vendas.³¹ Pikërisht në një proces të tillë të ndërlidhjeve dhe adoptimeve ilire, greke në fushën e kulteve, mendojmë se duhet kërkuar dhe zanafilla e monumentit të obeliskut në Apoloni. Ngritja e tij është frymëzuar, gjasisht, nga një kult solar vendës me origjinë parahistorike, siç duket i fiseve shtegtare baritore, që me kolonizimin grek njësohet me kultin e Apolon Agieut, si perëndi udhërrëfyese e barinjve dorë dhe, pastaj, si themelues i qyteteve e kolonive.³² Vetë obelisku, figurë simbolike jo antropomorfe e hyut, qëndron më afër konceptit kultik ilir se sa atij grek, së paku për një kohë të tillë, siç është shek. V. p.e.s.³³

Së fundi, duhet vërejtur se kulti i Apolonit nuk është ekskluzivisht grek. Në origjinë ai paraqitet i lidhur jo me grekë. Në Iliadë p.sh. Apolonin nuk e shohim në anën e grekëve, por në atë të armiqve të tyre trojanëve; ilirët, trakët e maqedonët kanë qenë njohur me kultin e Apolonit, para se ky, sipas mitologjisë, të vendosej përfundimisht në Delf. Duke ardhur nëpërmjet rrugës veriperëndimore së bashku me virgjreshat hyperborane, ata kanë vazhduar dhe më pas t'i çonin dhurata Apolonit deri në Delf.³⁴ Për vetë rajonin e Apolonisë mund të citojmë dhe mendimin e N. Cekës, se në shpinë të tokave të këtij qyteti, sikurse Artemisi dhe Apoloni duket se është në vendin e vet dhe se emri

³¹ H. Ceka, Mbi kultin e feve ilire, në Ark. Inst. His. Tiranë A. 1. 72.

³² Shih. E. Kirsten, Santuari di Magna Grecia, Atti del quarto convegno di studi sulla Magna Grecia, Taranto, 11-16 ottobre 1964; Napoli, 1965, f. 81.

³³ Mbi këtë koncept, shih dhe H. Ceka, Po aty, dhe A. Stipçević. Simbolet e kultit tek ilirët, Prishtinë, 1983.

³⁴ Herod, V. 61, VI. 139. Thue, VII 9, 2, Aur. Vict., De Viaris 351, D. i Hilikarnasit, 1, 18, 4, Apollodori, Bibliotheca, 1, 93, shih dhe The Encyclopedia Britanica, New York, 1911; s.v. Apollo.

grek është shumë i ngjashëm me antroponimin ilir Aplo, që e mbanin shumë ilirë taulantë.³⁵ Përsa i takon problemit se ku mund të jetë shfaqur më parë obelisku, si monument, në Apoloni apo në Ambraki, nuk ka të dhëna të sigurta. Por dihet që në Apoloni ai jetoi më gjatë, u kthye në simbol të qytetit dhe arkeologjikisht është dokumentuar më tepër. Forcën rrezatuese të Apolonisë në këtë drejtim e përforcon dhe mendimi i njohur se ngritja e obeliskut në Nikopolis, fqinj me Ambrakinë, i dedikohet më tepër ndikimit apoloniat se sa ambrakiot.³⁶

Në përfundim, obeliskun apoloniat, në ndryshim me betylët e varreve dhe të paraportave, si për karakterin e tij monumental dhe atë shoqëror, priremi ta shohim si një dukuri me shtrirje të kufizuar në Ilirinë e Jugut dhe në Epir, pa një prototip të njohur në vendet fqinje. Ngritja e tij në Apoloni dhe adhurimi për një kohë mjaft të gjatë, së paku për shtatë shekuj, përbën një origjinalitet të frymëzuar me shumë propabilitet nga kultet dhe monumentet natyrore vendëse dhe të realizuar nën ndikimin e artit të përparuar grek që sollën kolonistët.

³⁵ N. Ceka, *Apolonia ...* f. 177.

³⁶ K. Xuvara - Suli, vep. përmend, f. 438. 442.

RESUME

**CONSIDERATIONS SUR UN OBELISQUE A
APOLLONIE**

L'obélisque à Apollonie, monument caractéristique, symbole d'Apollon Agieus, et de la ville même fut connu tout d'abord par les monnaies frappées dans cette ville depuis la fin du Ve sc. av. n. e. jusqu'au début du III-e sc de n. e. Plus tard, il fut documenté par les trouvailles archéologiques.

Une opinion déjà avancée, selon laquelle le culte d'Agieus fut apporté et présenté ici pour la première fois par les colons corinthiens et le monument fut érigé sous l'influence corinthienne, nous paraît discutable. Une telle hypothèse ne trouve appui tout d'abord du fait que ce type de monument, sans le ranger à côté des simples bétyles sépulcraux, avant la période de l'empire romain, me connut qu'un étendu limité dans la ville d'Apollonie, dans quelques villes voisines illyriennes et dans la ville d'Ambracie. Avant l'époque d'Octavianus Auguste, il n'était connu ni à Corinthe ni à Corcyre, en tant que métropoles des colonies grecques de cette région. L'obélisque n'apparaît ni dans les monnaies de Corinthe et de Corcyre, d'où sont imités les principaux types apolloniates, ni dans celles des autres colonies corinthiennes des autres régions. D'après notre avis, même le fait que l'obélisque des monnaies d'Appollonie et des autres villes déjà mentionnées ne se présente pas toujours accompagné d'Apollon, mais quelques fois par d'autres divinités telle Artémis,

Dioné, Athéna, témoigne d'un écartement dédié plutôt à une origine indigène.

On sait que même le culte des bétyles des pierres sacrées coniques, est d'une origine litholatricque connue à la préhistoire de presque tous les peuples. Quant à Apollonie, on a remarqué que les anciens cultes autochtones se poursuivent même après la colonisation, ou s'adaptent au panthéon grecque. Ainsi, les colonisateurs appliquent l'enterrement en tumulus comme les gens du pays; le temple d'Artémis est élevé sur une plus ancienne base illyrienne; dans les monnaies, le symbole de la religion grecque apparait accompagné de telles figures des cultes autochtones telle le fou de nymphée, la grotte etc. Enfin, il faut dire que d'après quelques indices, même le culte d'Apollon, n'est pas un culte connu pour la première fois à l'époque de l'installation des colonisateurs grecs.

En conclusion, nous pensons qu'il faut chercher l'origine de l'obélisque d'Apollonie, dans le processus des relations et des adaptations illyriennes grecques, dans le domaine des cultes. L'obélisque représente une originalité, sans un prototype connu dans les pays voisins, qui probablement fut élevé s'inspirant premièrement d'un culte autochtone qui va s'adapter au panthéon grec.

II
MATERIALE
(*MATÉRIALES*)

DY VARËSE BRONZI TË KOHËS SË HEKURIT¹

Nga rrethina e Durrësit janë të njohura dy varëse bronzi të periudhës së hershme të hekurit, njëra e tipit «kafaz», e gjetur në Bashtovë, dhe tjetra në trajtë brokëze në miniaturë, e gjetur në Armath.² Të dyja janë gjetje rasti. Vitet e fundit janë gjetur, po rastësisht, edhe dy varëse bronzi «Piksidë», tip i panjohur deri tani në vendin tonë. (Fig. 1).




Fig. 1, a, b.

¹ Marrë nga revista "ILIRIA" Nr. 2 – 1984, f. 59-60.

² H. Myrto, Hartë e monumenteve dhe e gjurmëve antike e mesjetare të rrethit të Durrësit, «Monumentet» 2, 1981, f. 65 dhe nr. 1, 1982, f. 24, Tab. II.

Varësja e parë (Fig. 1, a) vjen përsëri nga Bashtova. Ka trajtë gjysmësferike, me grykë të gjerë vezake dhe dy vegjë hënore, horizontale, të ngritura pak mbi nivelin e grykës. Enëza mbështetet mbi tri këmbë si kunjëza të harkuara nga brenda. Anash grykës ka dy vrimëza të rrumbullakëta, njëra pak më e vogël se tjetra, që kanë shërbyer për mbërthimin e kapakut, i cili mungon, si dhe për lidhjen e varësës. Dy vija pikëzash zbukurojnë përqark grykën, njëra prej tyre vazhdon edhe në pjesën e sipërme të vegjeve. Është e lartë 3 cm, e gjatë 7 cm. Ruhet në gjendje të mirë. Varësja e dytë (Fig. 1, b), vjen nga fshati Gosë e Vogël (rreth 10 km nga Bashtova). Është e po atij tipi, po me përmasa pak më të mëdha: lartësia 3.5 cm dhe gjatësia 9.3 cm. Barku i saj vjen pak me majë në pjesën e poshtme. Paraqitet e veshur me një shtresë jeshile, e trashur dhe e brejtur.

Ky tip varëseje në literaturën arkeologjike është përfshirë në bronzet e quajtura «greko-maqedonase»; njihet kryesisht nga gërmimet në Çauçica dhe datohet në shek. VII p. e. sonë.³ Një ekzemplar i vetëm që përmendet në bronzet e Akropolit të Athinës⁴ ka përmasa shumë të afërta me atë të Bashtovës. Mendohet se këto lloj varësesh përdoreshin nga gratë për të mbajtur parfume e kremra ose si amuleta.

Varëset tona e zgjerojnë konceptin e deritanishëm mbi zonën e përhapjes së këtij tipi.

³ Jan Bouzek, «Greco Macedonian Bronzes», Praha 1974, f. 37.

⁴ Po ky autor që citon dhe Rider, «Bronzes d'Acropolis» f. 141, nr. 426, Fig. 96 (gjatësia 7.5 cm, lartësia 3.6 cm); tek Bouzek, Fig. 9.7.

NJË VARREZË ANTIKE NË FSHATIN VRRIN¹

Fshati Vrrin (Shënavlash) gjendet mbi një nga kodrat e ulëta, 5 km në lindje të Durrësit. Të shtyrë nga gjetje rasti, më 1972 filluam një sondazh në këmbët e kodrinës së Proskës, rreth 400 m në jug-perëndim të kishës së Shën Vlashit. Sondazhin e vijuan dhe në dy vitet pasardhëse, duke arritur kështu masën e një gërmimi të zakonshëm: u hapën gjithsej 15 kuadrate (4 x 4m) në një sipërfaqe prej 250 m². Nga ky gërmim u zbuluan 22 varre (Tab. I), që, me një përjashtim, datohen në periudhën helenistike.

Vendi është pak i pjerrët; toka argjilore me ndërfaqe karbo-natesh. Zakonisht poshtë shtresës bimore, prej 0,20 - 0,30 m, vihen re jo rrallë guacka deti të fosilizuara të pliocen-kuaternarit. Për arsye të pjerrësisë së vendit, të erozionit e të punimeve bujqësore, varret e pjesës së sipërme, nga veriu e perëndimi, dolën në thellësinë 0,50 - 0,60 m, ndërsa ato të anës jugore e lindore në thellësi që arrin deri 1,60 m (në një rast 1,90 m).

Të gjitha varret janë të thjeshta, me gropë, pa asnjë lloj ndërtimi. Në tabanin e tyre shpesh herë paraqitet një shtresë e forcuar argjilo-gëlqerore me një përzierje zhavori të imët, dukuri e vërejtur edhe në nekropolin helenistik të Durrësit, pranë Currilave.² Me përjashtim të varrit 3, që është me djegie, në të

¹ Marrë nga revista "ILIRIA" Nr. 2 – 1984, f. 59-60.

² S. Anamali, Nekropoli helenistik i Epidamnit, B.SH.SH. 1, 1957, f. 32.

gjitha të tjerat është zbatuar mënyra e varrimit me vendosje kufome.

Në gjendje të rregullt u gjendën vetëm 14 skelete. Të tjerat ishin të dëmtuara. Tri prej tyre, nr. 4, 11, 19, me sa duket janë dëmtuar që në antikitet. Katër të tjera, nr. 5, 6, 7, ndoshta edhe nr. 21, janë prekur nga punimet bujqësore në kohën e sotme. Në varrin nr. 1, u gjetën dy skelete përkrah njëri-tjetrit, ndërsa në varrin 22 dy skelete njëri mbi tjetrin.

Për vendosjen e kufomave janë zgjedhur dy qëndrime (Tab. I): në shpinë, me gjymtyrë të shtrira drejt (nr. 1, 2, 6, 7, 8, 10-13, 15, 17-22) dhe brinjazi, në qëndrim fjetjeje, me njërën këmbë të shtrirë pothuaj drejt, kurse tjetrën të nxjerrë pak përpara e të përthyer te gjuri (nr. 1, 5, 9, 14, 16). Drejtimi është veri-jug dhe verilindje-jugperëndim. Në disa varre një pjesë e kockave u paraqitën të nxira në sipërfaqe por pa shenja djegieje.

Varret dhe inventari i tyre

Varri 1. Thellësia 1.60 m. Në këtë varr u gjetën dy skelete 10 cm pranë njëri-tjetrit, njëri brinjazi, tjetri në shpinë. Gjatësia e të parit është 1,65 cm kurse e të dytit 1,55 cm.

Pranë këmbëve të skeletit të parë u gjetën një ojnahe me ngjyrë natyrale të baltës okër në rozë dhe një skifos me vernik të zi tepër i copëtuar. Ojnaheja (Tab. II, 12) ka trup barkosh, këmbë unazore, qafë të holle, vegje shiritore. Gryka në pjesën e pasme paraqitet e prerë në mënyrë oblike. Pranë kokës së skeletit të dytë, mbështetur në një tullë të vogël paralelopiped (17 x 7 x 5,5 cm), u gjetën një ojnohe si e para, por mjaft e copëtuar, dhe

një lekit me vernik të zi e figura të kuqe (Tab. II, 13). Në figurën kryesore të lekitit paraqitet profili djathtas i bustit të një gruaje, që mban përpara një timpan.

Si inventar i këtij varri, përfshihet edhe një fibul e harkuar bronzi. (Tab. II, 2), që u gjet në dheun e varrit, por që nuk mundëm të përcaktonim me saktësi pozicionin natyral të saj. Është 3, 5 cm e gjatë dhe 2 cm e lartë. Koka ka trajtë pothuaj të rrumbullakët dhe është e zbukuruar me vija të incizuara për të krijuar idenë e një koke gjarpëri.

Në dheun që mbushte këtë varr, ashtu sikurse dhe në dheun e varreve të tjera, u gjetën fragmente enësh balte. Midis këtyre është një fragment buze soleneje me trajtë të mysët. Trashësia e vetë tjegullës në këtë fragment është 3 cm, ndërsa lartësia e buzës 5,5 cm.

Varri 2. Thellësia 1,40 m. Trajta e kockave dhe gjatësia e skeletit (gati 1 m) tregojnë se i varrosuri duhet të ketë qenë një fëmijë. Në të djathtë të kafkës u gjet një objekt kocke në formë cilindrike, 4 cm i gjatë, ndërsa përmbi supin e majtë një guackë fosile. Në largësi 0, 50 m nga koka ishte vendosur një objekt prej balte të pjekur, që mund të merrej si modelim briri me një majë pak më të hollë e të rrumbullakët. Ka gjatësi 11,5 cm dhe diametër 2 cm. Përshkohet në mes nga një kanal që nuk ka dalje në majë. Balta është me përbërje ranore, ngjyrë okër, e pjekur jo mirë.

Varri 3. Është varr i veçantë për nga thellësia (1,90 m) dhe nga mënyra e varrimit (me djegie). Pranë mbeturinave të kockave të djegura mbi një shtresë të përzhitur, me sipërfaqe të konsiderueshme (Tab. I), u gjetën dy fragmente pitosi të zuku-

ruara nga jashtë me breza paralele në reliev dhe me një brez tjetër, të valëzuar, më lart. Pitosat me këtë zbukurim datohen në shekujt, VI-V p.e.sonë.³

Varri 4. Thellësia 1,50 m. Eshtrat ishin tepër të shpërbëra. Kafka mungonte. Një rast i tillë, pa pasur shenja djegieje, mund të shpjegohet vetëm me shkaqe të periudhës që i përket, mbasi në këtë thellësi nuk kanë arritur punimet e sotme bujqësore.

Varri 5. U zbulua në thellësinë 0,40-0,50 m. Duket që skeleti i këtij varri është dëmtuar nga plugimi i tokës. Kafka nuk është cënuar, megjithatë u paraqit mjaft e shpërbërë. Gjymtyrët e poshtme janë zhvendosur pjesërisht, por u pa se tibia e peroni i djathtë qenë futur kryq nën femurin e këmbës së majtë (në pozicion natyral), siç ndodh edhe në skeletet e tjera me qëndrim brinjazi. Pa inventar.

Varri 6. Thellësia 0,40-0,50 m. Skeleti është dëmtuar nga plugimi i tokës. Kafka mungonte, por në vendin e saj u gjetën disa dhëmbë. Me sa gjykohet nga gjendja e çrregullt dhe e mangët e kockave, i varrosuri duhet të ketë qenë vendosur në shpinë, me kokën nga VL. Pranë vendit të kokës u gjet një fund kotyleje me njolla verniku të zi.

Varri 7. Thellësia 0,40 m. Skeleti ishte shumë i dëmtuar. U gjetën dy tibiet, femurët me ashtin iliak dhe pjesë të tjera nga skeleti i këmbëve. Kafka mungonte, siç duket është nxjerrë në sipërfaqe kohë më parë nga punimet bujqësore.

Pranë femurit të majtë u gjet in situ një kupë e rrumbullakët balte me fasha verniku të zi (Tab. II, 11). Lartësia e saj është 3

³ A. Mano, Nekropoli i Apolonisë Tuma I, «Iliria» I, 1971, f. 155.

cm, diametri 5,5 cm. Balta është e pastër, okër-rozë, e pjekur jo mirë. Verniku është i rrjepur vende-vende.

Varri 8. Thellësia 1 m. Skeleti është ruajtur në gjendje të mirë. Gjatësia 1,70 m. Pranë klavikulës së djathtë u gjet një karficë e thyer (Tab. II, 7) me gjatësi 0,33 cm e gjerësi 0,5 cm. Përbëhet prej një teli të hollë bronzi, i përdredhur në dy skajet për të formuar dy spira.

Varri 9. Thellësia 0,80 m. Karakteristikë e skeletit, me qëndrim brinjazi, ishte vendosja e këmbës së djathtë në një mënyrë të tillë që bënte një kënd përpara dhe futej nën femurin e së majtës, ndërsa kjo ishte e shtrirë me një përkulje të lehtë përpara.

Varri 10. Thellësia 1,10 m. Skeleti u gjet i shtrirë në shpinë, me drejtim të kundërt me atë të varrit 8, duke i pasur kafkat vetëm 20 cm larg njëri-tjetrit (Tab. I). Pa inventar.

Varri 11. Thellësia 1,10 m. Në largësi 0,50 m nga skeleti i varrit 14 u gjetën dy femurë dhe një tibie në qëndrim natyral të vendosjes së tyre, me drejtim VL-JP. Kjo shtresë nuk duket e prekur nga punimet bujqësore të kohës sonë. Pranë këtyre eshtrave u gjetën 3 fragmente qeramike.

Varri 12. Thellësia 0,70 m. Skeleti ishte ruajtur në gjendje të mirë.

Varri 13. Thellësia 1,20 m. Skeleti u gjet i shtrirë në shpinë me këmbët shumë afër atij nr. 15.

Varri 14. Thellësia 1,30 m. Skeleti u gjet në qëndrim brinjazi, në të majtë. Këmba e djathtë ishte shtrirë drejt, kurse e majta qe përthyer te gjuri. Gjatësia e skeletit 1,75 m.




Fig. 1

Inventari: Para duarve u gjetën një vorbë dhe dy kupa balte njëvegjake, ndërsa poshtë ijes së majtë, një kupë balte pa vegje, e lyer me vërnik të zi. Vorba (Tab. II, 9) ishte e fragmentuar dhe është restauruar jo plotësisht. Përmasat: lartësia 13 cm, diametri i trupit 14 cm, diametri i grykës 10,5 cm. Është punuar prej një balte të ashpër me kokrriza rëre e me ngjyrë të kuqe speci. Ka formë sferike, qafë të shkurtër, grykë të gjerë e buzë të përvjelura nga jashtë. Fundi është i rrumbullakët.

Dy kupat me vegje të këtij varri (Tab. II, 10) janë të njëjlojta, me lartësi 3,8 cm e diametër 8 cm. Ato kanë qenë lyer me vernik të hollë ngjyrë kafe në rozë.

Varri 15. Thellësia 1 m. Kockat e këtij skeleti në përgjithësi paraqiten nxira, por jo nga djegia. Pa inventar.

Varri 16. Thellësia 1,45 m. Skeleti u gjet në qëndrim brinjazi, në të majtë, me këmbën e majtë të shtrirë drejt, kurse të djathtën të thyer te gjuri në një kënd të theksuar përpara dhe me shputën të futur nën kërcirin e së majtës. (Tab. I, 16; Fig. 1). Gjatësia e skeletit 1,60 m.

Si inventar, u gjet një rreth bronzi në trajtë gjarpëri (Tab. II, 3) para gishtave të këmbës së majtë, si dhe një unazë e thjeshtë

bronzi (Tab. II, 5) në gishtin e unazës së dorës së djathtë. Rrethi është prej teli bronzi 0,3 cm i trashë, me prerje në trajtë paralelogrami. Unazës i mungon një pjesë e telit. Pafta e sipërme e saj ka trajtë vezake dhe është pak e gropëzuar.

Varri 17. Thellësia 0,60 m. Skeleti nuk ishte ruajtur në gjendje të mirë. Gjatësia 1,35 m.

Para dorës së majtë u gjet një ojnohe. (Tab. II, 14) me trup pak a shumë cilindrik, fund të sheshtë, qafë të shkurtër e grykë në trajtë gjethe tërfili. Vegja del 2,5 cm mbi grykë.

Varri 18. Skeleti u gjet i shtrirë në shpinë në po atë thellësi dhe paralel me atë të varrit 17, por me drejtim të kundërt (Tab. I, 18).

Varri 19. Skeleti tepër i shpërbërë, vetëm femurët janë ruajtur në gjendje të mirë, u zbulua 0,90 m larg atij nr. 17 dhe 0,30 m më thellë nga ai.




Fig. 2

Varri 20. Thellësia 1 m. Skeleti ishte i shtrirë në shpinë me prirje të lehtë nga krahut i majtë.

Inventari: Një rreth bronzi në gishtin e unazës së dorës së majtë (Tab. II, 4). Në dheun e mbushjes së këtij varri, 0,60 m

mbi skeletin, u gjet një monedhë bronzi e Dyrrahut e tipit Herakli-armë.

Varri 21. Thellësia 0,90 m. Kafka mungonte. Në dheun që i përkiste mbushjes së këtij varri, në thellësinë 0,40 m, u gjet një monedhë bronzi e Dyrrahut e tipit Herakli-armë.

Varri 22. Vetëm 10 cm nën skeletin e varrit 21 u gjetën dy skelete njëri mbi tjetrin (Tab. I, 22; Fig. 2). I sipërmi është i shtrirë në shpinë me kokën në drejtim të veriut, të mbështetur mbi këmbët e skeletit të poshtëm; duar të kryqëzuara para mjekrës. Gjatësia 1,75 m. Skeleti i poshtëm ishte i shtrirë në shpinë, me kafkën e kafazin e kraharorit midis këmbëve të të sipërmit; këmbët e tij zgjateshin nën shpinën e kokën e të sipërmit. Gjatësia 1,65 m. Inventar nuk u gjet.

Tipologjia dhe datimi i objekteve

Tipat e enëve prej balte që u panë në këtë varrezë në përgjithësi janë të njohura në qendrat antike të vendit tonë. Ojnahet që u gjetën në varrin 1 (Tab. II, 12), ndonëse ngjasojnë pak me ato të zbuluara në nekropolin helenistik të Durrësit, prapëseprapë mendojmë se qëndrojnë si një variant më vete. Karakteristikë kanë pjesën e pasme të grykës të prerë në mënyrë oblike. Ojnoheja e një tipi tjetër, që u gjet në varrin 17 (Tab. II, 14), nga balta dhe punimi është njëlloj sikurse dy të parat. Të ngjashme me këtë ka në fondet e muzeut arkeologjik të Durrësit.⁴ Po ashtu të tilla janë gjetur edhe në Apoloni dhe u takojnë shekujve IV-III p. e. sonë.⁵

⁴ S. Anamali, vep.cit., f. 38, Fig. 9.

⁵ A. Mano, vep.cit., f. 188, nr. 150 dhe 167 (Tab. XXXVII, 3,4)

Kupat me një vegjë, të lyera me vernik të hollë kafe në rozë (Tab. II, 10) janë të rëndomta në fondet e muzeut arkeologjik të Durrësit. Edhe në Apoloni janë gjetur një sasi e konsiderueshme dhe datohen në shek. IV p.e.sonë.⁶

E vetmja vazo me figura të kuqe që u zbulua në këtë varrezë, ishte lekiti i varrit 1 (Tab. II, 13). Në fondet e muzeut arkeologjik të Durrësit gjenden një numër lekitësh të ngjashëm, të zbuluara në nekropolin e kodrave të Dautes.⁷ Lekitë të ngjashëm janë gjetur edhe në Apoloni.⁸ Një lekiti i tillë është gjetur gjithashtu në kalanë e Margëlliçit, qendër kjo që ka pasur marrëdhënie tregtare edhe me Dyrrahun.⁹

Duke u bazuar në përbërjen e baltës dhe punimin, si dhe duke bërë krahasime me fondin e pasur qeramik të muzeut arkeologjik të Durrësit, mendojmë se e gjithë qeramika e Vrrinit, përfshirë edhe lekitin me figura të kuqe, është e prodhimit vendas.

Stolitë metalike

Stolitë metalike që u gjetën në varret e Vrrinit duken si një veçori që i dallon ato midis numrit të madh të varreve të kësaj periudhe që janë zbuluar në Durrës.

Fibula prej bronzit e varrit 1 (Tab. II, 2) është e një tipi të njohur në vendbanimet ilire të periudhës helenistike. Ky tip në Glasinac është datuar në fazën V, b, rreth viteve 350-320 p. e.

⁶ A. Mano, vep.cit., f. 183 (Tab. XXXIII, 3-6 dhe 13-17).

⁷ H. Hidri, Gërmime në nekropolin e Durrësit, «Iliria» 1981, 1, f. 150.

⁸ A. Mano, vep.cit., f. 175 (Tab. XXIII, 6).

⁹ L. Dervishi, Gjurmë të reja në kalanë e Margëlliçit, «Monumentet», 2, 1971, F. 148.

sonë.¹⁰ dhe në Trebenisht nga fundi i shek. IV p.e.sonë.¹¹ Në vendin tonë është gjetur në kalanë e Irmajt (periudha e hershme helenistike)¹² dhe në Xibër.¹³

Për karficën prej teli të hollë bronzi me dy spira në skajet (Tab. II, 7) nuk kemi gjetur paralele. Por origjina e saj ndoshta arrin që në periudhën e hershme të hekurit.¹⁴

Ndërsa një unazë bronzi (Tab. II, 5) u gjet në gishtin e unazës së dorës së djathtë në varrin 16 dhe një rreth bronzi në gishtin e dorës së majtë në varrin 20 (Tab. II, 4), një rast interesant paraqet rrethi prej teli bronzi në trajtë gjarpëri (Tab. II, 3), që u gjet pranë gishtërinjve të këmbës së përthyer në varrin 16. Vendosja e këtij objekti në këtë pozicion mund të jetë një rastësi, por mund të lidhet edhe me ndonjë qëllim të caktuar, po të kihet parasysh besimi se brenda formës së kësaj unaze fshihet shpirti i fetishi-zuar i gjarpërit.¹⁵

¹⁰ A. Benac B. Čović, Glasinac II (shih: Osnovi tipovi Mladih Glasinaca), Sarajevo 1957.

¹¹ V. Lahtov, «Problem Trebeniske kulture», Ohrid, 1965, (Tab. III, IV).

¹² Fr. Prendi-Dh. Budina, Kalaja e Irmajt, «Iliria» II, 1972, f. 40. (Tab. XVI, 4); N. Ceka, Tipare të kulturës qytetare në Ilirinë e Jugut, «Studime Historike» 2, 1975.

¹³ Një fibul të tillë nga Xibri e kemi parë në Ekspozitën Kombëtare Arkeologjike në Tiranë më 1972.

¹⁴ Ana Maria Betti Sestieri, Fulvia Le Schiavo, Disa probleme rreth..... marrëdhënieve midis Italisë dhe Gadishullit Ballkanik, «Kuvendi I i Studimeve Ilire», Tiranë 1974, f. 235 (Fig. 10, 1-5). Shih dhe: F. Prendi, Vështrim mbi kulturën e periudhës së parë të epokës së hekurit, «Iliria» III, 1974, f. 144, Tab. V, 9.

¹⁵ Unaza e gjarpërit me efektin e saj magjik ruhet edhe sot në përrallat e krahinës së Matit (Ll. Ligori, Material folklorik në prozë i mbledhur në Mat, Dibër, fl. 6, f. 113, në Arshivin e Institutit të Kulturës Popullore, Tiranë).

Monedhat

Gjatë gërmimit u zbuluan gjithsej 9 copë monedha bronz. Disa u gjetën në dheun që mbushte varret, mbi skeletet. Katër prej tyre u zbuluan në thellësinë 0,30 m, në kuadratin 4 që nuk dha asnjë varr (që këtë thellësi nuk përjashtohet mundësia e zhvendosjes së tyre gjatë punimeve bujqësore). Njëra është mjaft e fshirë dhe nuk i dallohet asnjë tipar. Tetë të tjerat janë të dallueshme shumë mirë. Shtatë janë monedha të Dyrrahut të tipit Harkli-armë, kurse njëra, më e vogël, është e Sikionës e tipit Kimerë-pëllumb.¹⁶

Duke qenë se një nga monedhat e tipit Herakli-armë nuk mban emra nëpunësish, këto i takojnë fazës së parë të bronzëve të Dyrrahut, d.m.th. gjysmës së dytë të shek. IV p.e.sonë.¹⁷ Vendosja në këtë varrezë jo shumë kohë pas daljes së tyre në qarkullim duket nga fakti se shumica e këtyre monedhave janë të pangrëna nga fërkimi.

KATALOGU I MONEDHAVE

1. F. Kryet e Herakliut dj. me lëkurë luani.

Shp. Hark, mëzdrag dhe mill (mëzdragu me kokë dj.; milli me grykë mj.) Brenda harkut: AY dhe P midis mëzdragut e millit. AE: 4, 10 g.

2. F. Si nr. 1.

Shp. Si nr. 1, por mëzdragu me kokë mj. , milli me grykë dj. Brenda harkut: ΔP. AE K.

¹⁶ Head, *Historia Numorum*, London, 1977, f. 409.

¹⁷ H. Ceka, «Probleme të numizmatikës ilire», Tiranë, 1965, f. 38.

3. F. Si nr. 1.

Shp. Si nr. 2. AYP mbi harkun. AE; 4,48 g; gjetur mbi varrin 19.

4. F. Si nr. 1.

Shp. **Si nr. 1.**

5. F. AE; 4, 1 g; gjetur mbi varrin 20.

Si nr. 1. Shp. Si nr. 1. AE; 4 g.

6. F. Si nr. 1. Shp.

7. F. Shp. Si nr. 1. AE, ; 4, 40 g.

Si nr. 1 Si nr. 2 AE, ; 3, 35 g.

8. F. Kokë kimere dj.

Gjetje të tjera jashtë varrezës

Gati një km në lindje të vendgërmimit dhe 250 deri 300 m në jug të kishës gjetëm në sipërfaqe një fragment kolone dorike prej guri gëlqeror (Tab. II, 15). Fragmenti e ka gjatësinë 0,71 m, diametrin 0,18 m dhe është zbukuruar me 16 kanelyra majëmprehta, thellësia e të cilave është 1,4 cm.

Rreth 80 m në perëndim të vendgërmimit tonë, në thellësinë 0,80 metra, ramë në gjurmët e mbeturinave të një ndërtese antike, që nuk e ndoqëm më tej. Zbuluam pjesë xokolature muresh të ndërtuara me gurë të vegjël të lëmuar dhe copëra amforash të lidhura me baltë, që duket se formojnë një kthinë katrore. Lartësia e këtyre xokolaturave është 0,30 m, ndërsa trashësia 0,60 m. Pranë gjetëm një stivë me fragmente tjegullash të harkuara. Këto janë prej një balte të pastër me ngjyrë rozë, të pjekura mirë, dhe

kanë përmasat: gjerësia 34 cm, trashësia 2,5 cm dhe lartësia e harkut 4,8 cm.

Në afërsi të kësaj pike gjetëm një uror hekuri të nxjerrë në sipërfaqe nga punimet bujqësore (Tab. II, 6). Është mjaft i ciflosur. Nga forma të kujton shkronjën «B», me gjatësi 7 dm dhe gjerësi 2 cm.

Urorë me trajtë të përafërt, por jo plotësisht të njëjtë, janë gjetur në Bukël të Mirditës¹⁸ dhe në kalanë e Dalmacës.¹⁹ Ky ka ngashmëri edhe me një uror hekuri të zbuluar në Glasinac, në varrin 5 tuma IX, së bashku me një stoli bronzi në formë gjyslykësh (autorët për këtë janë të mendimit se është më i ri nga stolia shoqëruese, «si duket kohës së mesme»)²⁰ Një ekzemplar tjetër të ngjashëm me këtë të Vrrinit, e kemi gjetur në Rogozhinë së bashku me qeramikë të shekujve të parë të erës sonë.

Së fundi përmendim një fibul bronzi të mesjetës së hershme shqiptare (Tab. II, 1), për të cilën është dhënë njoftim vite më parë.²¹ Është një fibul me këmbë të përthyer e trup të gjerë e të harkuar prej pete katërkëndëshe me një kurriz të ngritur në mes. Anash petës së harkuar dhe në dy anët e kurrizit qendror ka zbukurime me pikëza. Në pjesën e sipërme të kërcyellit, pas pëstjelljes ka të incizuara tri vija paralele dhe më tej një «X»

¹⁸ S. Anamali, Një varrezë e mesjetës së hershme shqiptare në Bukël të Mirditës, Iliria», II, 1972, f. 223, (Tab. XXI, 4).

¹⁹ H. Spahiu, Gërmimet e vitit 1961 në kalanë e Dalmacës, «Studime Historike», 3, 1964, f. 220. (lidhur me literaturën që i referohet).

²⁰ A. Benac-B. Čović, «Glasinac I», Bronzozoit, f. 9.

²¹ S. Anamali--M. Korkuti, Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve në dritën e kërkimeve arkeologjike shqiptare, në «Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve», Tiranë, 1969, f. 35; S. Anamali, Mbi kulturën e hershme shqiptare, po aty, f. 194; «Shqipëria Arkeologjike, album, Tiranë, 1971, (shih hartën).

midis dy vijave paralele nga njëra anë dhe dy të tjerave nga ana tjetër. Në anën e poshtme të dorezës ka mbetur një pjesë e gjilpërës prej hekuri.²²

Fibula është e njëlllojtë me ato të mesjetës së hershme shqiptare të zbuluara në kalanë e Dalmacës,²³ në Krujë²⁴ e në Bukël të Mirditës.²⁵

Përfundime

Të dhënat e përfutuara nga gërmimi ynë në Vrrin, si dhe objektet e mbledhura jashtë vendgërmimit, tregojnë se kemi të bëjmë me një fshat antik. Vetë varreza, me një dendësi varresh, dëshmon për njerëz të ngulur me banim në këtë vend. Si gjurmë ndërtimesh, mund të marrim: mbeturinat e mureve në afërsi të varrezës si dhe fragmentin e kolonës dorike që përmendëm.

Të bazuar në inventarin e varreve, mendojmë se varreza i përket fundit të shek. IV dhe fillimit të shek. III p.e.sonë. Varri nr. 3, që datohet në shekujt VI-V p. e. sonë, dëshmon, nga ana e tij, për një ripërdorim të varrezës.

Në krahasim me nekropolin e kësaj kohe të Dyrrahut²⁶ shihen ndryshime si përsa i përket mungesës së ndërtimeve në varr dhe monumenteve mbishkrimore, ashtu edhe përsa i përket inventa-

²² Fibula është gjetur më 1965 nga traktoristi Bajram Hasa, i cili si vend të gjetjes na tregoi pikërisht ngastrën që zgjodhëm për sondazhin tonë.

²³ L.M. Ugolini, «Albania Antica», V, I, Roma-Milano, 1927, (shih: «Komani» varri A); H. Spahiu, vep. cit., f. 240.

²⁴ S. Anamali-H. Spahiu, Varreza e hershme mesjetare e Krujës, Studime Historike 2, 1963, f. 30.

²⁵ S. Anamali, Një varrezë..., f. 223.

²⁶ H. Hidri, vep. cit., dhe Materiale të Sesionit Shkencor Arkeologjik, Durrës, 1983; shih dhe J. Toçi, po aty.

rit. Një ndryshim tjetër vërehet lidhur me vendvendosjen e monedhave të zbuluara: asnjë monedhë nuk u gjet këtu pranë skeletit, ose në gojë, sic ka mjaft raste në Durrës. Do të thonim se materiali i zbuluar në Vrrin karakterizohet nga një origjinalitet në ruajtjen e zhvillimin e traditave vendase. Tipi i varreve, si varre me gropë, riti i varrimit, si dhe objektet e gjetura, sidomos stolitë, mendojmë se janë dëshmi e etnicitetit ilir të banorëve.

Gjetjet e dy skeleteve në një varr (nr. 1 dhe 22) është një dukuri e njohur në varret e kësaj periudhe të qendrave të tjera antike të vendit tonë.²⁷ Një karakteristikë e veçantë, për të cilën nuk kemi gjetur ngjasime, është vendosja e kufomave me qëndrim brinjazi, me njërën këmbë të shtrirë drejt dhe tjetrën të nxjerrë përpara e të përthyer tek gjuri. Sidoqoftë, ndeshja brenda kësai varreze e dy mënyrave të vendosjes së kufomave, brinjazi dhe në shpinë, dëshmon për një periudhë kalimtare për kalimin në një fazë më të zhvilluar të konceptit të këtyre banorëve lidhur me vdekjen.

Fibula e tipit të Komanit dhe urori, si gjetje rasti, e kanë prejardhjen ndoshta nga një varrezë e mesjetës së hershme shqiptare, që nuk e ndeshëm. Prapëseprapë, ato si dhe fibula me kokë gjarpëri e «unaza e gjarpërit», që u zbuluan në varrezën antike, shënojnë, edhe brenda një trualli të ngushtë, hallka ndër-lidhëse në unitetin dhe vazhdimësinë e kulturës iliro-arbërore.

²⁷ Shih p.sh.: A. Mano, vep. cit., f. 110.



Tabela II

Resume

**UN CIMETIERE ANTIQUE DANS LE VILLAGE DE
VRRIN**

Dans le village de Vrrin (Shënavlash), situé à 5 km de Durrësi, nous avons fouillé une superficie de 250 m² et trouvé 22 tombes à fosse simple et sans aucune construction. Les squelettes trouvés étaient posés sur le dos avec les membres allongés, ou couchés sur le côté avec une jambe presque allongée et l'autre repliés. Dans une tombe il y avait deux squelettes l'un à côté de l'autre, alors que dans une autre nous avons trouvé deux squelettes superposés et un troisième 10 cm au-dessus d'eux.

Parmi le matériel d'accompagnement découvert dans une partie des tombes il y avait des récipients de terre et des parures métalliques connues à Dyrrah et dans d'autres centres antique de notre pays durant les IV^e-III^e s. av. n. c. Dans la terre qui couvrait les tombes nous avons trouvé des monnaies de bronze avec Héraclès-arme de Dyrrah appartenant à la fin du IV^e s. av. n. è.

A proximité du cimetière nous avons découverte des restes d'une habitation antique et un fragment de colonne avec des cannelures doriques. Sur le lieu où nous avons fait les fouilles avait été trouvée une fibule de bronze du type de Koman, caractéristique pour la culture albanaise des VII^e-VII^e s. de n.è.

Nous pensons que le cimetière appartenait à un village antique illyrien des alentours de Dyrrah. Le type des tombes, (à

fosse simple, sans monument mortuaire ni inscriptions dessus), le rite de l'enterrement, les parures, les monnaies jetées sur les tombes et non pas posées à la bouche du mort, comme il arrive des fois dans la nécropole contemporaine de Dyrrah, témoignent à notre avis que les habitants de ce village appartenaient à l'ethnie illyrienne.

MBI DISA QENDRA ARKEOLOGJIKE NDËRMJET KAVAJËS DHE DURRËSIT¹

Historia shumëshekullore e Durrësit, nuk mund të kuptohet e shkëputur nga ajo e hinterlandit të tij, sidomos atij të afërtit. Fondet e pasura arkeologjike të Muzeut të këtij qyteti, që vijnë gjithnjë duke u shtuar edhe me materiale nga rrethi e vërtetojnë këtë më së miri. Durrësi i lashtë apo mesjetar shihet i pasqyruar në hinterlandin e tij dhe anasjelltas.

Muzeu i këtij qyteti vitet e fundit, me anë ekspeditash informative dhe një punë studimore, ka marrë përsipër përpilimin e hartës arkeologjike të rrethit. Në këtë artikull do të paraqesim një pjesë të punës që është bërë deri tani, duke informuar mbi disa qendra arkeologjike, ndërmjet Kavajës dhe Durrësit (tab. I).

1. ZIG-XHAFAJ

Më tepër se 100 vjet më parë L. Hezej njoftonte për një fortesë të vogël në katundin Zig-Xhafaj, të cilën e shënonte në termin «akropol helenistik»², pa dhënë hollësira rreth saj.

Zig-Xhafaj ndodhet 4-5 km në verilindje të Kavajës, mbi masivin e kodrave të Menglës. Këto kodra, pak më në veri të këtij fshati, ndërpriten nga një luginë e vogël, për të vazhduar

¹ Marrë nga revista "Monumentet", Nr. 7/8, 1974, f. 247-258.

² L. Heuzey, Operations militaires de Jules César, Paris, 1866 (shih hartën).

përsëri drejt veriperëndimit, në Golemas, Seferaj, Shkallnur e deri në Shkëmbin e Kavajës,

Shpina e kodrës ku shtrihet lagja e Ballijve (fig. 1), me majën më të lartë 239 m. është e butë, me ndonjë shesh apo tarracë të vogël dhe gjithëkund e mbuluar me ullinj e pemë të tjera frutore. Ajo zbret lehtë në drejtim të juglindjes me rrëpira të buta nga jugu e jugperëndimi, kurse nga ana e lindjes, veriut dhe veriperëndimit zbulon shpate shkëmbore mjaft të pjerrëta prej guri shtuf me ndërfitje konglomeratesh dhe gipsi. Rrëzën e shpatit shkëmbor të anës veriperëndimore e ndjek rruga që vjen nga Kavaja. Këtu kjo kapërcen qafën e Zige dhe pastaj, nëpër Qafë-Shkallë, kalon për në luginën e Erzenit dhe Ndroqit. Përveç këtij kalimi nga kalaja e Zig-Xhafës kontrollohet edhe rruga kryesore që kalon në fushën e Kavajës.



Fig. 1

Nga vëzhgimi i mbetjeve në vend dhe i terrenit duket se pjesa më e lartë e kodrës së Zig-Xhafës, nga ana veriperëndimore, perëndimore dhe jugore, ka qenë e rrethuar me mure mbrojtëse. Forma e këtij muri do t'i ngjante një trapezi të çrregullt, me gjatësi mesatare 400 m. e gjerësi 100 m. (shih rilevimin topografik). (tab. II).

Mbeturinat e këtij muri rrethues sot vihen re në anën perëndimore të kodrës, te vendi që mban emrin Muri i Kalasë ose Rrethi i Kalasë (pika B në rilevimin topografik). Këtu është një trakt muri që ndjek rrëpirën e kodrës në një vijë të harkuar 22 m. të gjatë. Me një pastrim të pjesshëm të tij, u vërejt se s'është veçse radha e fundit e murit, ndonëse aty-këtu kanë mbetur edhe 2-3 blloqe njëri mbi tjetrin, in situ. Në këtë mënyrë lartësia e sotme e këtij muri arrin 0,90 m. deri 1,20 m. Në gjendjen që paraqitet, duke qenë nga njera anë i mbuluar pjesërisht nga dherat e kodrës, është vështirë të përcaktohet gjerësia e tij.

Ky trakt muri është ndërtuar me blloqe gurësh konglomerati e shtufi të mëdhenj (fig. 2, 3), që janë lidhur me njëri-tjetrin pa llaç dhe pa ndonjë mjet tjetër ndërlidhës. Një pjesë e tyre janë latuar nga të gjitha anët dhe kanë formë të rregullta paralelpede, ndërsa të tjerët s'janë latuar me të njëjtin kujdes dhe paraqesin formë të çrregullta. Në përgjithësi faqja e jashtme e tyre duket e sheshtë dhe kuadratike. Përmasat e tyre arrijnë: 1,40 x 0,40 x 0,40 m; 1,30 x 0,80 x 0,50 m; 1,43 x 1,15 x 0,60 m. Vihen re shenja të këmishës së brendshme dhe të mbushjes me gurë të vegjël.

Gjurmë të këtij muri rrethues vihen re edhe 50 m. më tej, në drejtim të veriut (pika A në rilevimin topografik), ku terreni i

avitet më tepër rrëpirës shkëmbore pranë qafës, si dhe 100 m. më tej në drejtimin tjetër, nga ana e jugperëndimit (C), duke plotësuar rrethin e mureve nga kjo anë.



Fig. 2



Fig. 3

Rreth 60-70 hapa poshtë majës, nga ana jugore e saj, prej nga është edhe ngjitja më e lehtë për në territorin që përfshihej brenda fortesës, shihen përsëri mbeturina të një muri, që janë pothuaj në nivelin e sipërfaqes (D). Ky është një trakt muri që ka formën e shkronjës «T», dy vijat përbërëse të së cilës janë nga 3 m. të gjata dhe kanë drejtimin e pikave kardinale të horizontit. Edhe këtu blloqet janë kuadratiqe, të latuar dhe të lidhur me njëri-tjetrin sipas teknikës së thatë, por përmasat e tyre janë pak më të vogla. Muri i këtushëm, pranë të cilit nga punimet bujqësore kanë dalë një sasi e madhe fragmente tjegullash solene e kaliptere, tulla, një terrakote (tab. III, 1), e gozhdë hekuri të tipit këpurdhë, mendojmë se i përket ndonjë godine shoqërore brenda murit rrethues.

Përsa i përket stilit të murit të kalasë së Zig-Xhafës, duke gjykuar nga gjurmët e pakta që shihen, është vështirë të bëhet një përkufizim i plotë. Megjithatë janë të dukshëm elementet që e bashkërendisin me tipe të tilla ndërtimesh të periudhës qytetare ilire, të shek. IV-II p.e.sonë.

Në territorin që përfshihej brenda kalasë dhe sidomos pranë pikave të sipërpërmendura, janë gjetur një sasi e madhe fragmente tullash, tjegullash e enësh qeramike me ngjyrën natyrale të baltës ose të lyera me vernik të zi.

Tjegullat solene janë 2,5-3,5 cm. të trasha. Buzët e tyre, që arrijnë deri 6 cm. trashësi, i kanë të trashuara në mënyrë konkave ose konvekse. Tjegullat kalipteret kanë prerje në formë gjysëm gjashtëkëndëshi. Në disa fragmente solenesh shihen vula në formë drejtkëndëshi (18 x 3 cm) dhe mbishkrime të pjesshme (tab. III, 4-6), ku lexojmë:

ΕΠΙ, ΑΡΙΣΤΟΔΑΜΟΥ dhe ΠΑ. ΙΩ . .

Duke pasur parasysh thënien e Aristotelit se në Dyrrah skllëvërit ishin pronë e qytet-shtetit³ (prej nga del që edhe kumitë ishin shtetërore) dhe faktin se parafjala Ell shoqëron pothuajse gjithë emrat që janë regjistruar në vulat e tjegullave solene të këtij qyteti, emra që përputhen me ata të shpinës së monedhave të emetuara këtu, pra, të prytanëve⁴. Këtej del se pjesa më e madhe e tjegullave të Zig-Xhafes janë prodhuar në Durrës në konën e prytanit Αριστοδαμος. Ky emër lexohet (mendojmë) pjesërisht edhe në vulat e soleneve të zbuluara në nekropolin helenistik të Epidamnit⁵. Monedhat e prera në Dyrrah, që mbajnë emrin e këtij prytani, u takojnë viteve 250-200 p.e. sonë.⁶

Ndër objektet pothuaj të plota prej qeramike është një gutus (i gjetur në pikën B), një lakrimore, dy peshore, konike, dhe terrakota që përmendëm më lart. Gutusi (tab. III, 2) në Muzeun e Durrësit qëndron unikal në mes një shumice enësh të këtij lloji të zbuluara në qytet⁷. Lakrimorja (tab. III, 3), që është e lyer me vernik të zi të dobët, nga forma, i afron tipit VI të balsamareve

³ Aristoteli, Pol. II, 7.

⁴ H. Ceka, Probleme të numismatikës ilire, Tiranë, 1965, 52.

⁵ S. Anamali, Nekropoli helenistik i Epidamnit, B.SH.SH., 1957, I, 57.

⁶ H. Ceka, Datimi i drahmeve të Durrahit e Apollonisë, «Studime Historike», 1966, III, 33; «Thesari i Jubicës, Iliria, I, Tiranë, «Studia Albanica», 1972, 52. 1971, 88; Le trésor numismatique de Bakerr

⁷ Një gutus, pothuaj identik kemi parë në ekspozitën arkeologjike që u hap në Tiranë në vitin 1972 - Vitrina «Lissus».

të Gnathias të shek. III p. e. sonë⁸ dhe ka ngjashmëri me shishe balte të gjetura në varret e shek. III-II p.e.sonë në Apolloni.⁹

Nga të dhënat e më sipërme mund të nxjerrim si përfundim se në Zig-Xhafaj gjatë shek. IV-II p.e.sonë ka ekzistuar një qytezë ilire e tipit castellum, që shërbente si vendbanimi, qendër administrative, religjioze dhe vendstrehim, në raste luftërash, për banorët e zonës përreth.

Në sistemin e qendrave të fortifikuara ilire të vrojtuar në afërsi të rrugës së lashtë, asaj që dilte prej Dyrrahit e vazhdonte nëpër luginën e Shkumbinit, si dhe atyre fortesave që vërehen në degëzimin e rrugës kryesore,¹⁰ kalaja e Zig-Xhafes është e para përsa i përket afërsisë me qytetin e madh bregdetar. Ajo është e vetmja kala ilire që kemi parë deri më sot në rrethin e Durrësit.

Kulmin e lulëzimit ekonomik e kultural, me duket, kjo qendër e vogël e ka pasur në shek. e III p.e.sonë. Te pika D u vunë re gjurmë të theksuara të një zarri shkatërrimtar. Ky fakt dhe fragmentet e soleneve të zbuluara po në atë pikë, që mbajnë emrin Αριστοδαμος, prytan i viteve 250-200 p.e.s. të afrojnë mendimin se edhe kjo qytezë e fortifikuar është përfshirë nga luftërat e mbarimit të shek. III p.e.sonë, ndërmjet ilirëve dhe romakëve e maqedonasve, në truallin ilir. Dihet se gjatë asaj periudhe pati faza që fiset ilire «kufitare të Dyrrahit, duke shpresuar në ndryshimin e gjëndjes, ishin ngritur¹¹». Këto luf-

⁸ L. Forti, La ceramica di Gnatia, Napoli, 1965 (Shih «Cronologia»).

⁹ A. Mano, Nekropoli i Apollonisë - Tuma e 1, «Iliria» I, 1971, 162.

¹⁰ N. Ceka - L. Papajani, Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike». Monumentet», 1/1971, 48-49.

¹¹ Livi, XXIX, 12, 13.

tëra mund t'i kenë dhënë fund edhe jetës së kësaj qyteze. Kjo gjë vërtetohet edhe nga fakti se askund në sipërfaqe dhe as pranë pikave të sipërpërmendura, që u hetuan më me kujdes, nuk u pa qeramikë ose objekte të tjera që të datohen si të periudhës romake.

2. SPANJO.

Në afërsi të katundit Spanjo dhe Aganas (tab. I), te kodra e Qenzë, që është një bregore e butë, jo më e lartë se 40-50 m. mbi nivelin e detit dhe që ndodhet në lindje të rrugës Durrës-Kavajë shumë afër lagjes Sallbag të qytetit të dytë, shihen në sipërfaqe fragmente të shumta tullash dhe tjegullash të periudhës heleenistike. Këto janë nxjerrë në dritë nga punimi i tokës me mekanizma bujqësore. Midis tyre gjetëm fragmente soleneje, ku brenda kornizës së zakonshme të vulave drejtkëndëshe (me dimensionet 18 x 3 cm), lexohet emri i prytanit Γαιος emër i njohur ndër prytanët e Dyrrahit të gjysmës së dytë të shek. I p.e.s.¹²

3. SEFERAJ.

Mbi një nga brigjet e veshura me ullinj të fshatit Seferaj, që i thonë «Bregu i Qishës», nga punimet me karakter bujqësor (siç na informuan vendasit), janë zbuluar varre të vjetra, ku përveç skeleteve janë parë dhe objekte të ndryshme, si enë balte etj. Pranë këtij vendi, ka qenë edhe altari me mbishkrimin që është botuar nga H. Ceka dhe S. Anamali.¹³

¹² H. Ceka, vep. cit., 39, 42, 50 dhe 151. 21 350/a

¹³ H. Ceka S. Anamali, Mbishkrime latine të pabotuara të Shqipërisë, B.SH.SH., 1961,



Fig. 4

Mbasi iu nënshtrua një pastrimi të plotë, u bë e mundur të dallohet në njërën prej faqeve anësore të altarit përfytyrimi me reliev i një objekti që ngjet më tepër të jetë një çantë me bravë (fig. 4).

Në fillim të rreshtit të katërt tani dallohen edhe tri shkronja të tjera: MAF. dhe pesë shkronja të tjera në rrethin e shtatë NEMER. Me këto ndryshime mbishkrimi duhet të jetë si vijon:

D(ii)s Manibus) S(acrum) / M]unatia
[Claudia / mariti / Maf(ilia) [et] Cor/
[n]eliae m/[at]ri dulcissi [mae] /
benemerent) i posuit q(uae) (v(ixit)
a(nnos). . .

Nga ky lexim do të thoshnim se altarin ia ka ngritur s'ëmës shumë të dashur dhe të denjë për mirënjohje, Kornelias, e bija, Munatia Klaudia Maritima. Ky altar mermeri mendojmë se i përkiste një pronareje tokash, nga shtresa e kolonizatorëve romakë, që, siç është provuar dhe nga monumente të tjera sepulkrale, në periudhën perandorake u shtri tej Durrësit, në fushën e Kavajës.¹⁴

Po te «Bregu i Qishës», në fasadën e shtëpisë së Shaban Dokës, është vendosur një pllakë varri jo e plotë, ku lexohet një pjesë mbishkrimi: NICEPH... Shkronjat janë të mëdha, të bukura dhe të pajisura me apices.

¹⁴ L. Heuzey - H. Daumet, vep. cit., 392.

4. QERRET

Përballë Malit të Robit (kuota 62 m.), në fushë, në një distancë prej 100 m. nga rruga automobilistike dhe 6-700 m. nga buza e detit, mbi një sipërfaqe prej 1-2 ha, kanë dalë (nga shpyllëzimi dhe punimet bujqësore) mjaft materiale qeramike dhe objekte të tjera me vlerë arkeologjike. Vendi njihet nga banorët e fshatit më të afërt, Qerretit, me toponimin «Qisha». (tab. 1).

Interesi shtohet për këtë pikë duke pasur parasysh edhe njoftimin e Leon Reit, se më 1901, me rastin e punimeve për ndërtimin e trasesë së rrugës Durrës-Kavajë, ndërmjet Malit të Robit dhe detit, u zbuluan themele muresh, ku u gjet një arkëzë prej mermeri të bardhë.¹⁵ Arka përmbante një unazë prej argjendi të praruar, që nga autori i lartpërmendur është konsideruar unazë episkopi. Në arkë qe vendosur dhe një kuti, brenda së cilës kishte një monedhë argjendi të perandorit Aleks Komneni (sh. XI), si dhe monedha të tjera argjendi të shek. XII, XIII, XIV.¹⁶

Duke marrë në këtë vend si pikë referimi shtyllën e tensionit të lartë, gjurmët që vërejtëm aty po i ndajmë në këtë mënyrë:

Rreth njëqind metra në jug të saj shihen mbeturinat e një themeli 40 m. të gjatë, me drejtimin lindje-perëndim. Afër tij nga ana e jugut, ndiqeshin gjurmët e një themeli që ipte një formë gjashtëkëndëshi, me gjatësinë e brinjëve 5,5 m dhe gjerësinë 0,45-0,50 m. Plani poligonal dhe madhësia e këtij themeli na kujton baptisteret e kishave paleokristiane, ndonëse forma e

¹⁵ L. Rey, Répertoire topo-bibliographique des antiquités de l'Albanie (suit), Albania. 1932, 4.

¹⁶ L. Rey, po aty.

preferuar për to ka qenë tetëkëndëshi dhe, në lindje, është aplikuar vetëm në ndërtesat mëdha.¹⁷

Nga materialet e ndërtimit që vihen re pranë themeleve, del se muri këtu ka qenë ndërtuar me gurë të çrregullt, tulla dhe llaç. Shumica e tullave kanë përmasat: 28 x 25 x 4 cm. Llaçi është gatuar me gëlqere dhe rërë deti që përmban mjaft guacka dhe thërmija qeramike. Ai e ka trashësinë 5 cm.

Pranë këtyre themeleve, në largësi 30 m. nga veriu dhe 40 m. nga lindja, u gjetën dy kolona të cinguar prej mermeri të bardhë. E para (fig. 5) është 1,20 m. e gjatë dhe diametrin e bazës e ka 0,45 m..



Fig. 5

Rreth 100-200 m. në lindje të shtyllës së tensionit të lartë shihen materiale ndërtimi të antikitetit të vonë. (tab. IV, 1-3). Interes paraqesin dy fragmente tullash prej balte violë në rozë.

¹⁷ Ch. Delvoye, *L'art Byzantin*, 1967, 49.

Ato kanë trashësinë 4 cm. dhe faqen jo të lëmuar. Mbi njërën është paraqitur në relief një kryq i vogël bizantin, kurse mbi tjetrën shihet një monogram i pjesshëm në relief (tab. IV, 4).

Këto të dhëna na bëjnë të mendojmë, se muret e këtushme duhet t'i takojnë periudhës së fillimit të mesjetës.

Rreth shtyllës së tensionit të lartë, duke qëmtuar në materialet e nxjerra në sipërfaqe nga punimi i tokës, kemi mbledhur një sasi fragmentesh qeramike të enëve të përdorimit të përditshëm, si buzë, vegje e parete vorbash, tasash e amforash. Këto janë prej balte jo të pastër dhe me ngjyrat okër, kafe, rozë e errët dhe okër në violë.

Ndër to ka vegje të zakonshme me prerje ovale, elipsoidale e vegje shpatuke me kanelyra (tab. IV, 5-6). Mbi një vegje është inçizuar një X. (tab. IV, 7). Paretet në përgjithësi janë zbukuruar me të njejtin motiv: breza paralele dhe ravijëza, diku më të shpeshta e diku më të rralla (tab. IV, 8-13). Këto fragmente kanë ngjashmëri me qeramikën e shek. IV-VI të njohur në qendra të ndryshme të vendit tonë, si në Selcën e Poshtëme¹⁸ e Pogradec.¹⁹

Duke gjykuar nga të gjitha materialet e përshkruara më lart, mund të themi se këtu, brijë Via Egnatias, që në shek. I-II dhe më vonë, gjatë periudhës së vonë antike, ka qenë një stacion i banuar. Pastaj, duke mbajtur parasysh mikrotoponimin «Qisha», themelin në formë gjashtëkëndëshi e fragmentet e përmendura

¹⁸ H. Ceka, La ville illyrienne de Basse-Selce. «Iliria», 1972, II, 174 (Pl. VII).

¹⁹ S. Anamali, Rezultatet e gërmimeve në kalanë e Pogradecit, «Buletin arkeologjik», 1969, 97.

arkitektonike pranë tij, mendojmë se këtu ka qenë ngritur një kishë paleokristiane.

Materialet që disponojmë, ende pa kryer gjurmime sistematike në këtë vend, nuk na lejojnë të përcaktojmë se deri në ç'kohë kjo kishë ka qenë në këmbë. Por, po ta lidhim me thesarin e vogël të zbuluar këtu, të cilin e përmendëm më lart, mund të themi se kjo ka jetuar së paku deri në shek. XIV. Atëhere, duke pranuar se në këtë vend në shek. XI ishte në këmbë një kishë, pikërisht këtu duhet kërkuar Kisha e Shën-Todrit, ku u strehua Guiskardi mbas zbarkimit të tij të befasishëm në prapashpinën e perandorit Aleks Komneni dhe jo në Shtodhër të Kavajës.²⁰ Duke mbajtur parasysh thënien e Ana Komnenës se Guiskardi: "...me gjithë ushtrinë e vet zbriti në det e zuri kishën që ishte ndërtuar që në kohët e vjetra për nder të dëshmorit Teodor.... dhe prej këndej, ai shkoi në ballë të normanëve nga ranishtja e detit"²¹, s'ka përse të shkojmë deri në Shtodhër për të kërkuar këtë vend. Largësia e Shtodhrit nga buza e detit, fusha moçalore e Kavajës dhe po ashtu largësia e konsiderueshme me kampin e kundërshtarit, nuk do ta kishin lejuar Guiskardin të kryente brenda një nate gjithë ato veprime që përshkruan Komnena. Kurse pozicioni i këtu-shëm, me lartësinë e Malit të Robit, që vëzhgon mirë grykën strategjike të Petras, mbi të cilën ishte kampi i perandorit, qenia njëkohësisht pranë detit dhe rrugës kryesore, janë në favor të supozimit tonë.

²⁰ Historia e Shqipërisë, botim i U.SH.T., Tiranë, 1957, në faqen 178 këtë vend e identifikon me Shtodhrin e Kavajës.

²¹ Ana Comnene, Alexia, Lib. IV, 6.

5. GJURMË TË RRUGËS EGNATIA

Nga vendi i quajtur «Qisha» e Qerretit, në drejtim të Kavajës deri tek përroi i Fosës, në një distancë prej 4-5 km., mund të ndiqen gjurmët e një rruge të lashtë të shtruar me kalldrëm (shih hartën). Ajo në fillim ecën në vijë të drejtë, në përfundim të rrugës së sotme automobilistike dhe anash katundit Qerret. Pranë shtëpisë së Zef Bokrit, në thellësinë 0,50 m., janë nxjerrë prej trasesë së saj, që ka gjerësi 4 m, rrasa të mëdha me përmasa: 0,50 x 0,30 x 0,10 m.; 0,70 x 0,40 x 0,15 m. Duke shkuar gjithnjë në drejtim të shkollës së Qerretit, kjo rrugë e nëndheshme mund të konstatohet edhe nga një zhvillim i dobët i kulturave bujqësore në një vijë të drejtë me gjerësi 4-5 m.

Pranë shkollës së Qerretit linja e ndjekur nga ne duket se bën një kthesë nga lindja. Këtu, me sa kuptohet, ajo kapërcen rrugën automobilistike dhe hekurudhën. Gjurmët e saj tani ndiqen duke vërejtur kanalet kulluese, të cilët në thellësinë gati 1 m. presin një kalldrëm me rrasa të mëdha.

Kalldrëmi në fjalë mund të studjohet mirë në lagjen Sallbeg të Kavajës, përballë kodrës Qenze, afër shtëpisë së Mahmut Shijakut, jo më tepër se 150-200 m. nga përroi i Fosës. Këtu, në thellësinë 1 m, në të dy faqet e kanalit, që ka drejtimin lindje-perëndim, vërehet mirë prerja e trasesë. Gjeresia e kalldrëmit është rreth 6,5 m. Ai është shtruar me rrasa të mëdha guri që kanë trashësi 15-25 cm. (fig. 6) ndërsa sipër do të jetë mbuluar me një shtresë zhavorri.

Përsa i përket pjesës së rrugës prej «Qishës» deri pranë shkollës së Qerretit, jemi të mendimit se është mbeturinë e një rruge mesjetare, që lidhte këtë qendër me rrugën kryesore. Pjesa

tjetër e kësaj linje, që mund të ndiqet në lindje të hekurudhës, deri te përroi i Fosës, mendojme se është mbeturinë direkte e via Egnatias. Karakteristikat e saj përputhen me ato të përmendura nga Prashnikeri për rrugën prej Durrësit në luginën e Shkumbinit²² dhe nga N. Ceka e Ll. Papajani në këtë luginë, aty ku ata flasin për një periudhë radikale ndërtimi në shekujt e parë të perandorisë.²³



Fig. 6

Qendrat arkeologjike midis Kavajës dhe Durrësit, që përshkruam me lart²⁴, i takojnë një zone të kufizuar, por ato lidhen

²² C. Prashnikeri, *Muzakhia und Malakastira*, Jahreshefte d. Oest, Wien 1920, f. 113.

²³ N. Ceka - Ll. Papajani, *Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike*, «Monumentet», 1/1971, 48-49.

²⁴ Nga qendrat arkeologjike të kësaj zone në këtë artikull nuk janë përfshirë varreza pranë shkollës bujqësore Golem, e përmendur lidhur me një fibul të shek. III-IV (shih. S. Anamali F. Prendi, *Vazhdimësia e kulturës ilire në kulturën e herëshme mesjetare shqiptare*, *Konf. I e St. Alb.*, Tiranë 1965, 471; S. Anamali H. Spahiu, *Varreza e herëshme mesjetare e Krujës*, «Studime Historike» 1963, 3, 3-67 dh *Shkëmbi i Kavajës*, ku kohët e fundit është bërë një sondazh nga F. Tartari, i cili materialet e përfituara i ka në studim.

ngushtë me Dyrrahin, qytetin e madh të bregdetit dhe me kalimin ketu të rrugës kryesore, që degëzohej pastaj në drejtim të lindjes dhe jugut.

Banorët vendas të Zig-Xhafes, Kanapares, Spanjojt e Qerretit, në periudhën helenistike e romake, sigurisht, kanë qënë ilirët. Por informatat letrare dhe arkeologjike të deritanishme janë të pamjaftueshme për të formuar një ide të plotë mbi jetën e tyre ekonomike, shoqërore e politike. Megjithatë duket qartë shtrirja e kulturës qytetare në këtë zonë në periudhën helenistike. Gjetjet në kalanë e Zig-Xhafajt tregojnë ekzistencën e marrëdhënieve të ngushta ekonomike të banorëve të kësaj zone me Dyrrahin.

Dukja e një pjese të Via Egnatia në këtë zonë është një fill që duhet ndjekur më tej. Me këtë rrugë e me atë që shkonte në Apolloni, lidhen stacione të përmendura në burimet, por ende të paidentifikuara. Pranë saj vazhdojnë edhe qendra mesjetare, siç është rasti i Qerretit. Të gjitha kërkojnë një punë të mëtejshme informuese dhe hetuese në terren për të orientuar kërkimet sistematike në të ardhmen.




Tabela I




Tabela II





Tabela III



Mali Robit : Fragmente qeramike ndërtimi e poçerie

Tabela IV

RESUME
A PROPOS DE CERTAINS CENTRES
ARCHEOLOGIQUES SITUES ENTRE KAVAJA ET
DURRËS

Le présent travail est un exposé partiel des travaux accomplis à ce jour pour dresser la carte archéologique du district de Durrës, et plus particulièrement de la zone s'étendant entre cette ville et la localité de Kavaje.

1. ZIG-XHAFAJ

L. Heuzey mentionne la présence, à proximité de Kavaja, d'une petite forteresse. Le lieu Zig-Xhafaj se trouve à 4-5 km. de Kavaja, dans sa partie S. E., et surmonte le massif mamelonné de Mengle.

Le dos de la colline, dont le sommet le plus élevé a une hauteur de 239 m. est marqué par un relief arrondi comprenant quelque étendue plate ou de petites terrasses.

La partie la plus élevée de la colline de Zig-Xhafa était entourée, en direction N-O., O. et S., par des murs défensifs. La forme de ce mur a du ressembler à un trapèze irrégulier, d'une longueur moyenne de 400 m. et d'une largeur de 100 m. (voir l'élév. topographique). Des travaux partiels de déblayage ont montré que nous ne sommes en présence que de la dernière rangée du mur.

Ce trait de mur est construit de blocs de pierres conglomératiques et calcaires, empilés sans mortier. De leur nombre, quelques-uns sont équarris de tous les côtés et ont la forme de parallélépipèdes réguliers. Son parement est généralement plat et quadratique.

Dans la territoire fortifié ont été découverts une foule de fragments de briques, de tuiles et de récipients en céramique, ayant la couleur naturelle de la glaise ou vernissés en noir. Certains fragments de solènnès sont marqués de sceaux à angle droit (18 x 3 cm.) reproduisant les inscriptions partielles (voir le texte albanais). La plupart des tuiles trouvées à Zig-Xhafa ont été produites à Durrës à l'époque du prytane Apuotodamos.

Les données précitées nous permettent d'aboutir à la conclusion qu'à Zig-Xhafa existait, au IV^e-II^e siècle avant notre ère, une citadelle illyrienne du type castellum, servant en même temps comme centre administratif, religieux et lieu de refuge, en cas de guerre, pour les habitants de la zone avoisinante.

2. SPANJO

A proximité des villages de Spanjo et d'Aganas on a découvert un fragment de solène, dont la face reproduit, à l'intérieur du cadre habituel des sceaux à angle droit, le nom du prytane Γαιος, qui s'est distingué parmi ses collègues de Dyrrachium pendant la deuxième moitié du I^{er} siècle avant notre ère.

3. SEFERAJ

A proximité de ce village, on a trouvé un autel portant une inscription déjà publiée (H. Ceka, S. Anamali, Inscriptions latines inédites d'Albanie, Bul. Sciences Soc., 1961, 1, 117-118). A la suite d'un nettoyage l'inscription en question se présente plus complet.

Cet autel en marbre appartient, à notre avis, à une propriétaire terrienne de la couche des colonisateurs romains, qui pendant la période impériale étendirent leur pouvoir hors des limites de Durres.

4. QERRET

Les matériaux mis à jour montrent qu'ici, à côté de la Via Egnatia, dès le Ier-IIe siècle et plus tard, pendant la basse antiquité, se trouvait une station habitée. Le fait que cette station porte le microtoponyme de «Qisha» (= église), ainsi que la présence de fondaments en forme sexangulaire et de fragments architectoniques (colonnes et autres) dans son voisinage, sont autant de témoignages qui nous induisent à penser qu'une église paléo-cretienne s'élevait ici pendant le haut moyen âge. Si nous admettons qu'une église s'érigait ici au XIe siècle, c'est précisément en cet endroit que nous devons rechercher l'Eglise de St. Théodore, où s'est arrêté Guiscard après son débarquement inattendu à l'arrière des forces de l'empereur Alexis Comnène, et non pas à Shtodher de la localité de Kavaja. La distance séparant Shtodher de la mer, la plaine marécageuse de Kavaja, ainsi que la distance considérable du camp de l'ennemi sont autant de faits qui n'auraient pas permis à Guiscard d'effectuer en une seule nuit toutes les notions décrites par la Comnène. Tandis que la position de Qerret, qui s'avantage de la hauteur de Mali Robit et est en mesure d'observer tranquillement le col stratégique de Patras, qui était surmonté par le camp de l'empereur, ainsi que le fait qu'il se trouvait à proximité de la mer et de la route magistrale, sont autant d'arguments qui s'expriment en faveur de notre hypothèse.

5. - TRACE DE LA VIA EGNATIA

Du lieu nommé «Qisha» e Gerretit, en direction de Kavaja, sur une distance de 4-5 km, on peut suivre les traces d'une ancienne route pavée. Les pierres extraites représentent des dalles ayant les dimensions suivantes: 0,50 x 0,30 x 0,10; 0,70 x 0,40 x 0,15 m.

HARTË E MONUMENTEVE DHE E GJURMËVE ANTIKE E MESJETARE TË RRETHIT TË DURRËSIT¹

Qyteti antik i Durrësit ka tërhequr vëmendjen e studiuesve kryesisht që mbas mesit të shekullit të kaluar, ndonëse ndonjë informatë për të kanë lënë edhe udhëtarë, historianë e gjeografë të mëparshëm. Ndër studiuesit e huaj, të shekullit të kaluar dhe të këtij shekulli, që kanë lënë përshkrime e kanë kryer studime për topografinë dhe monumentet e njohura antike të këtij qyteti dhe rrethinave të tij, shquhen Han, Hezej, Prashniker e Shober, Fajt, Rej, Sestieri.

Deri para çlirimit, megjithatë, harta arkeologjike e këtij rrethi do të paraqitej tepër e varfër. Arkeologët e huaj, që krahas Durrësit u kushtuan vëmendje edhe monumenteve e zbulimeve të rastit të bëra në pastokën e tij, arritën ta njihnin vetëm pak tablonë e vërtetë arkeologjike të kësaj zone. Ata mundën të vrojtonin vetëm atë çka u kishte shpëtuar rrebesheve të shekujve dhe që gjendej në vende të dukshme. Por nëntoka këtu ruante mjaft të panjohura që i shfaqti vetëm pas çlirimit të vendit. Në fillim për këtë kontribuan shpyllëzimet, bonifikimet e punimet e thella me mekanizma bujqësore, që përdorëshin për herë të parë në vendin tonë.

¹ Marrë nga revista "Monumentet", NR. 2, 1981, f. 55-79.

Muzeu Arkeologjik i Durrësit, megjithë angazhimin e tij në zbulimet e mëdha, si amfiteatri, termat, nekropoli antik etj.² mori masa që në fillim dhe për kontrollin e punimeve me karakter joarkeologjik dhe për shpëtimin e objekteve me interes. Ky kujdes nuk u kufizua vetëm brenda qytetit, por u shtri edhe në periferinë e tij dhe në të gjithë rrethin. Në rrethin e Durrësit janë organizuar ekspedita përnjohëse e ndonjë gjermim edhe nga Muzeu Arkeologjik dhe Etnografik Tiranës, me pjesëmarrjen e arkeologëve Hasan Ceka e Skënder Anamali. Po ashtu këtu janë kryer punime restauruese dhe studime, sidomos për monumentet e mesjetës, nga Institutit të Monumenteve të Kulturës, Pirro Thomo e punonjësve të Gjerak Karaiskaj e Aleksandër Meksi.

Që nga viti 1971 ekspeditat përnjohëse që janë organizuar nga Muzeu Arkeologjik i Durrësit, tej qytetit, në rrethin e tij, kanë pasur si qëllim të veçantë përpilimin e një harte të monumenteve dhe gjurmëve të kulturës materiale. Në këtë artikull do të përmbledhim pikërisht rezultatet e gjurmimeve të bëra në këtë rreth (duke përjashtuar qytetin dhe periferinë e tij) gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit. Materiali që do të trajtojmë është përfutur kryesisht nga gjetje rasti, nga operacione shpëtimi dhe nga ndonjë gjermim-provë. Do të përfshijmë këtu shkurt dhe monumentet e njohura më parë.

² V. Toçi, Të dhëna mbi topografinë dhe elementin ilir në Dyrrah nën dritën e zbulimeve të reja arkeologjike, Konferenca Nëntor 1962, Tiranë 1965; Mbishkrime e relievve nga nekropoli i Dyrrahit, B.Sh.Sh. e parë e Studimeve Albanologjike, 1962, 2; Të dhëna mbi elementin ilir në Dyrrah në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike, St. hist. 1972, 2.

Para se të fillojmë përshkrimin e pikave që kemi vizituar dhe të objekteve të njohura apo të zbuluara rishtaz, le t'i hedhim zonës një vështrim të shkurtër gjeografik.


Zona që kemi në studim, bën pjesë në ultësirën Perëndimore të vendit tonë.³ Nga pikëpamja gjenetike, kjo është një ultësirë sedimentare që ka filluar të formohet qysh në miocenin e mesëm, ka marrë pak a shumë trajtë në pliocenin e poshtëm në kurriz të detit dhe është në zhvillim e sipër. Kjo është kryesisht një zonë fushore e përshkruar nga kurrize të ulëta kodrinore. Në të vërehen lëvizje uljeje dhe ngritjeje.

Kodrat janë të përbëra prej ranorësh, konglomeratësh dhe argjilesh neogjenike. Ato paraqiten në formë vargjesh me drejtim veriperëndim-juglindje. Midis tyre zgjaten brazda të gjera në formë luginash. Faqet e kodrave janë të veshura me shkurre dhe dushkaja. Karakteristikë e tyre është dukuria e shpeshtë e rrëshqitjes.

Në këtë rreth dallohen tri zona kodrinore. (HARTA 1). Zona e parë është ajo lindore, që fillon me Kepin e Rodonit edhe që duke vazhduar në drejtim të juglindjes, përfshin malësinë e Krrabës në rrethin e Tiranës.

Kjo zonë kodrinore përçahet tërthor prej katër luginash, që në të njëjtën kohë përbëjnë dhe rrugë kalimi të favorshme për lidhjen e bregdetit me zonat e brendshme. Lugina e parë e tërthortë ndodhet përballë Krujës dhe është një shtrat i vjetër i lumit të Zezës, që dikur derdhej në Erzen.

³ Të dhënat mbi gjeografinë dhe gjeologjinë e zonës i kemi kryesisht simbas. P. Geço, Gjeografia fizike e Shqipërisë, Tiranë 1973 dhe Gjeologjia e Shqipërisë, tekst shoqëruesi hartës gjeologjike të Shqipërisë, Tiranë, 1970.



E dyta gjendet përballë Tiranës. Kjo dikur ka qënë shtrat i lumit të Tiranës, që po ashtu derdhej në Erzen. Luginën e tretë tërthor këtyre kodrave e formon lumi i Erzenit, kurse lugina e katërt është ajo e Shkumbinit të Poshtëm.

Zona e dytë kodrinore ndodhet në perëndim të së parës dhe ka më tepër drejtim veri-jug. Ajo përfshin Bishtin e Pallës (71 m lartësi), malin e Durrësit (188 m) dhe, pas një ndërprerje në gjirin e Durrësit, vazhdon me kodrat e Kryevidhit apo Kepin e Lagjit.

Midis këtyre dy zonave kodrinore ndodhet ajo e kodrave në perëndim të Erzenit të Poshtëm, që arrin lartësinë absolute 450 m. Te kjo përfshihen dhe kodrat e Kavajës.

Gjithë zona fushore e rrethit të Durrësit gjeografikisht ndahet në dy fusha të vogla: ajo e Erzen të Poshtëm dhe ajo e Kavajës. Fusha e Erzenit të Poshtëm ka një pjerrësi të lehtë në drejtim të detit. Është krejtësisht e sheshtë, me vetëm disa kodra të ulëta e të buta, si kodrat e Shijakut (105 m) në lindje të Erzenit dhe një antiklinal kodrinor (35 m i lartë) në perëndim të lumit. Ky përfshin kodrat e Shënavlashit, të Rrashbullit dhe të Arapajt. Tokat janë të hinjta-kafe-livadhore dhe aluviale-livadhore.

Fusha e Kavajës kufizohet nga veriu dhe lindja prej kodrave të Kavajës. Nga perëndimi ajo kufizohet pjesërisht prej detit Adriatik dhe kodrav të Kryevidhit, kurse në jug atë e ndan, si një nënnjësi më vete brenda fushës së Myzeqesë, lumi i Shkumbinit. Në pjesën veriore kjo fushë ndahet prej lumit të Darçit dhe prej përroit të Kavajës (apo Leshniqes).

Bregu i detit në pjesën më të madhe është vazhdim i zonës së ulët dhe si i tillë paraqitet i sheshtë. Ai ndërtohet nga rëra të kohës së sotme të cilat përbëjnë ranishte me gjerësi 100-200 m. Gjatë bregut shtriheshin dikur laguna, si ajo Durrësit dhe si

këneta e Bishtarakës në grykë derdhjen e Erzenit. Në bregdet vërehen dhe rrip rëre e duna. Si rezultat i aktivitetit të madh depozitonjës të detit dhe i prurjeve të shumta të lumenjve, vija bregdetare ndryshon me shpejtësi. Ky fenomen favorizohet dhe nga amplituda e dobët e mareve. Në këtë mënyrë, është llogaritur p.sh se zona e veprimit të grykëderdhjes së Shkumbini gjatë këtyre 70 vjetëve të fundit është zgjeruar në kurriz të detit me një mesatare vjetore prej 5-6 m. ⁴

Me rëndësi për hartën arkeologjike të kësaj zone është diskutimi i rrjedhjes së lumenjve. Të gjithë studiuesit që janë marrë me këtë problem pajtohen me mendimin se vijat e rrjedhjes së lumenjve në Ultësirën Perëndimore dhe grykëderdhjen e tyre, kanë pësuar dhe pësojnë ndryshime vazhdimisht. Kjo është një dukuri e shpjegueshme nga vetë karakteri i ultësirës, i vijës bregdetare dhe veprimit mbushës së lumenjve në grykëderdhjet tyre.

Përsa i përket kahjes së spostimit, nuk duket e pranueshme teza se këta lumenj në drejtimin e derdhjes së tyre për në det kanë pësuar spostim vetëm nga e djathta në të majtë⁵, spostime kanë ndodhur edhe në drejtimin e kundërt. ⁶ Gjurmët dhe radha e këtyre spostimeve gjeologjikisht janë të vërtetuara, herë-herë ato janë edhe të dukshme, por datimi i tyre është ende i diskutueshëm.

⁴ S. Boçi, Studim topografik i dinamikës së vijës bregdetare nga Vjosa në Mat, disertacion në Katedrën e Gjeologjisë të U.S.H.T. 1981.

⁵ G. Veith, Der Feldzug von Dyrrhachium Ze schen Caesar und Pompeius, Wien, 1920, f. 31.

⁶

Rrjedha e Shkumbinit është diskutuar më tepër. Në të kaluarën është shfaqur mendimi se Shkumbini në periudhën antike kalonte nëpër fushën e Kavajës, njësohej me Darçin për t'u derdhur në gjirin e Durrësit dhe se spostimi i tij në shtratin e sotëm ka ndodhur në periudhën e vonë antike.⁷ Ky mendim ka pasur pasonjës⁸, ka edhe në ditët tona.⁹

Me anë të sondimeve, është gjetur me të vërtetë një shtrat i vjetër i Shkumbinit, apo i një dege të tij, deri në afërsi të Luzit.¹⁰ Por më tej kjo nuk provohet. Këtu duhet vënë në dukje edhe fakti se lumi i Darçit ka shtratin e vet dhe nuk rrjedh në shtratin e ndonjë lumi më të vjetër.¹¹

Pa vënë në dyshim rolin e Shkumbinit në formimin e fushës së Kavajës në periudhat prehistorike, kalimi i tij në këtë fushë në periudhën antike nuk na duket i provuar. Jemi më tepër për mendimin se ai edhe në antikitet, deri pranë Bashtovës, ka kaluar në shtratin e tij të sotëm.¹² Këtu, natyrisht nuk mund të kundërshtohet ndonjë bryl i tij në drejtim të fushës së Kavajës, rezultat i të cilit në antikitetin e vonë mund të ketë qenë p.sh. kënetat e Zhabjakut.

Për mbështetjen e mendimit se shtrati i vërtetuar i Shkumbinit deri pranë Luzit i përket periudhave prehistorike, vlejné edhe të

⁷ G. Veith, vep. cit., f. 38.

⁸ C. Praschniker, Musakhia und Malakastira, Wien 1920, f. 125-126.

⁹ N. G. L. Hamnod, A history of Macedonia, vol. I, Oxford 1972, f. 23, 26, po ashtu N. Luli, S. Beçi, vep. cit.

¹⁰ S. Beçi, vep. cit.

¹¹ Për këtë shih dhe G. Veith, vep. cit., f. 36-37.

¹² H. Ceka, Dega, Dega jugore e rrugës Egnatia, «Monumentet» 2, Tiranë 1971, f. 29.

dhënat arkeologjike. Kështu, shtresat kulturore të shekujve të parë të erës sonë në Luzin e Vogël, në Luzin e Madh e në Rrogozhinë arrijnë 1-1.80 m (shih më poshtë), ndërsa ngritja që ka pësuar fusha në vendin e kthesës së rrjedhjes së dikurshme arrin 5 m.¹³

«Shtrati i vdekur» i Shkumbinit që evidentohet në veri-perëndim të kalasë së Bashtovës, jo shumë larg rrzës së kodrave, në drejtim të kënetës së Rreth-Grethit, mendojmë se përfaqëson rrjedhjen e tij në kohën antike.¹⁴ Me këtë përfundim duket se pajtohen edhe të dhënat e gjeografit të lashtë, Ptolemeut, i cili distancën e gjerësisë gjeografike të grykëderdhjes së lumit Panaysos (që duhet të jetë Genusi) e cakton baraz me 15' nga Dyrrahi.¹⁵ Në hartat tona, gjerësia gjeografike e kënetës së Rreth-Grethit është 41° e 5', kurse ajo e Durrësit 41° e 20'. Po ashtu 15' minutat e Ptolemeut, duke qenë afërsisht baraz me 16 milie romake, që bëjnë 24 km, na japin përsëri distancën në vijë të drejtë prej Durrësit deri në afërsi të kënetës së Rreth-Grethit.

Në lindje të kalasë që nga shekulli III e. s. shtrati i Shkumbinit nuk duhet të ketë pësuar ndryshime. Përroi i Leshniqes, që njihet gjithashtu me emrin Përroi i Kavajës, duket se nuk e justifikon veten për t'u identifikuar me lumin Palamnus,¹⁶ që përmend Skylaksi në jug të Durrësit.¹⁷ Megjithatë një përrua i vogël pranë

¹³ N. Luli, S. Beçi, Vep. cit., f. 116.

¹⁴ Për ekzistencën e një shtrati të tillë, shih S. Boçi, vep. cit. (rrjedhja nr. 5 në hartën e tij) si dhe Gj. Karaiskaj Kështjella e Bashtovës, Monumentet», 5-6, 1973, f. 59.

¹⁵ Ptolemeu, Geographia, III, 12, 2.

¹⁶ G. Veith, vep. cit., f. 39.

¹⁷ Skylaksi, Periplus, 26,

fshatit Tilaj, disa kilometra më në veri, që thërritet «Palamà», na duket me interes nga kjo pikëpamje. Ndoshta ky përrua derdhej dikur në Leshniqe, që mund të ketë pasur rrjedhën e vet më nga veriu, dhe atëhere hidronimi Palamà ruan vetë emrin e Leshniqes së lashtë. Relievi i rrethit të Durrësit pas çlirimit ka pësuar mjaft ndryshime, sidomos nga një numër veprash bonifikuese dhe ujitëse. Ndër këto mund të përmendim tharjen e kënetës së Durrësit, kanalin ujitës Peqin-Kavajë, liqenet artificiale dhe rezervuaret, si ai i Okshtunit, i Shkallmurit, i Rubjekës, i Tarinit etj.

Nga pikëpamja e komunikimit tokësor, të gjitha pikat e këtij rrethi janë të arritshme pa vështirësi. Rrugët tradicionalisht ndjekin rrëzën e kodrave, por nuk mungojnë të dhënat edhe për rrugë të vjetra përmes fushave. Vendkalimet më të lehta për të kapërcyer vargjet e kodrave që e mbyllin këtë zonë, janë ato të brazdave luginore që i përmendëm më lart. Por ekzistojnë edhe rrugë të tjera të dorës së dytë që përshkojnë kurrizin e kodrave.

Nga përshkrimi gjeografik që paraqitëm më lart, treva ku kemi kryer gjurmimet tona duket se përbën pikërisht atë çka do të mund të quhej pastoka e mirëfilltë e Dyrrahut antik. Për këtë siç duket ekziston edhe një traditë, që vërtetohet me të dhëna nga topografia antike. Asparagu, qytezë mbi Genus (Shkumbin) quhet *Asparagium Dyrrhachinorum*.¹⁸ Po ashtu edhe Ishmi në antikitet quhet *Isamnus Dyrrhachinorum*.¹⁹

¹⁸ Caes. B. Civ., III, 30, 76.

¹⁹ Vibius Sequester, Cituar nga S. Anamali në kumtesën «Mbi toponominë antike në rrethin e Durrësit» majtur në sesionin shkencor të Muzeut Arkeologjik të Durrësit, 1979.

Me këtë, nuk kemi për qëllim të theksojmë se kufijtë administrativë të rrethit të sotëm të Durrësit përcaktojnë një zonë që ka qenë gjithmonë e lidhur politikisht me qytetin. Në periudha të ndryshme historike kufijtë e pushtetit politik të Durrësit kanë qenë shumë më të ngushta. Po ashtu, ka pasur periudha historike që krahina me qendër administrative Durrësin ka qenë shtrirë shumë më tej këtyre kufijve. Por nga ana ekonomike kjo është zona që vetë të dhënat gjeografike ia kanë kushtëzuar më tepër lidhjen me qytetin dhe anasjelltas.

PËRSHKRIMI I MONUMENTEVE DHE I GJURMËVE ARKEOLOGJIKE ZONA E ISHMIT

Kjo zonë përfshin vargun e kodrave që ngrihen në krahun e majtë të rrjedhjes së poshtme të Ishmit dhe që zgjaten drejt veriperëndimit për të formuar kepin e Rodonit. Toka e butë e këtyre kodrave, lugina e Ishmit bashkë me të mirat e tjera të lumit si dhe bregu i detit kanë përbërë këtu gjithmonë kushte të favorshme për jetën njerëzore. Kepi i Rodonit, nga ana e tij, i futur thellë në det midis gjirit të Drinit dhe atij të Lalzës, merr një pozitë kontrolluese mbi bregdet dhe ia shton rëndësinë gjithë zonës. Përkshimin e vrojtimeve tona do ta fillojmë pikërisht nga pika më ekstreme e kepit.



1. KALAJA E SKËNDERBEUT

Njoftimin e parë mbi ndërtimin e kësaj kalaje e kemi prej Barletit.²⁰ Një skicë e thjeshtë e planimetrisë së saj është dhënë

²⁰ M. Barleti, Historia e Skënderbeut, Tiranë 1964, f. 483.

prej Coronelit, kartograf i Republikës së Venedikut (Tab. 1, 3)²¹ Sipas kësaj skice planimetrike, kalaja ka pasur një formë drejt-këndëshe, me katër kulla katrore në qoshe dhe me nga një në mesin e mureve gjatësorë. Më pas kalanë dhe vendin e ngritjes së saj, «Currila» e përmendin disa autorë.²² Një vëmendje të veçantë gjithë qendrave të banuara mesjetare të kepit të Rodonit u ka kushtuar prof. Alen Dyselje.²³

Sot nga kjo fortesë ka mbetur vetëm një pjesë e vogël e mureve dhe pingu (kryekulla) me lartësi 10 m (Tab. I; 1, 2). Disa vjet më parë mbi këto mbetje ka paraqitur një studim Pirro Thomo.²⁴ Autori i mbështetur në buri-met historike dhe në të dhënat arkitektonike, e daton ndërtimin e kalasë nga Skënderbeu pas rrethimit të parë të Krujës, d.m.th. aty nga viti 1451. Ajo shkatërrohet më 1467 nga sulltan Mehmeti dhe rindërtohet nga venecianët, 33



²¹ M. V. Coronelli, M. Vincenze, Citta, fortezze ed altri luoghi principali dell'Albania, Epiro e Livodia.

²² Relacion anonim mbi Shqipërinë (1570) Dokumenta të shek. XV për historinë e Shqipërisë, vëll. IV, Tiranë 1967, f. 108-140; L. Rey, Albania, 4, f. 94-95; F. Noli, Historia e Skënderbeut, Tiranë 1962, f. 74, 88, 99.

²³ A. Ducullier, La façade maritime de la principauté des Kastriotès de la fin dhe Konf. e dytë e Stud. Alb. I, Tiranë 1969, f. 121-153; Gjendja e kepit të Rodonit në fillim të shek. XV sipas disa dokumentave raguzane, St. Hist», 1977, f. 123-132.

²⁴ P. Thomo, Kalaja e Skënderbeut në kepin e Rodonit, «St. Hist». 1967.

vjet më pas, më 1500. Në atë studim shfaqet mendimi se është vështirë që kalaja të jetë ngritur mbi një bazë të hershme.²⁵

2. MBETJE NDËRTIMESH ANTIKE

Jo më tepër se 300 m në verilindje të kalasë, mbi shpatin e lartë që ngrihet thikë mbi det, kemi konstatuar një pjesë të vogël muri të ndërtuar me tulla katrore (0.44 x 0.44 x 0.085 m) të lidhura me baltë. Aty kemi mbledhur fragmente tullash e tjeçullash solene (Tab. 1, 5), fragmente enësh tryeze me vernik kafe si dhe një lakrimore balte të tipit boshtor (Tab. 1, 4) objekte këto që mendojmë se u përkasin shekujve III-I p.e.s.

Tulla me përmasat që përmendëm dhe prej së njëjtës baltë e pjekje janë dhe disa nga ato që formojnë kornizat e kluasonazhit në muret e kalasë. Mendimi ynë është se këto janë material i ripërdorur prej mbetjeve të një konstruksioni antik.

Ka mundësi, gjithashtu, të ripërdorura të jenë edhe disa blloqe kuadratike, që shihen në radhët e poshtme të mureve të kësaj kalaje, sidomos pranë portave (Tab. 1, 6). Ndër këto blloqe ka me përmasa 0.68 x 0.68 x 0.59 m. Karakteristikë e tyre është se paraqesin një rryp apo kornizë të skalitur anash, ndërsa pjesën qëndrore e kanë gufmuar, teknikë kjo e njohur në kalatë e afërta ilire të Zgërdheshit e të Lezhës.

3. KISHA E SHËN NDOUT

Ndodhet rreth 1 km në juglindje të kalasë, pranë bregut të detit. Ajo qëndron ende në këmbë. Është një kishë njënefshe, me planimetri katërkëndëshe. Nga stili i afrohet ndërtimeve roma-

²⁵ Po aty, f. 147.

nike,²⁶ kurse një sërë elementesh të veçantë arkitektonikë e lidhin atë me ndërtimet bizantine.²⁷

4. GJURMË NDËRTIMESH ANTIKE

Pranë kishës së Shën Ndout dhe rreth 80 m prej bregut të detit, në thellësinë 0.50 m shihet faqja e sipërme e një pjese muri, të ndërtuar me blloqe të mëdhenj e mesatarë, pa llaç. Ky e ka gjerësinë 2 m dhe duket se zgjatet në drejtimin veri-jug paralele me vijën e bregut.²⁸

Si përfundim, themi pa ngurim se zona më ekstreme e kepit, Muzhla, siç quhet nga vendasit, ka qënë e banuar në antikitet. Pa bërë gërmime, natyrisht nuk mund të jepet një gjykim i saktë mbi karakterin e ndërtimeve që përfaqësohen nga gjurmët që përshkruam. Megjithatë, pozicioni strategjik i vendit na lejon të supozojmë se duhet të ketë qenë i fortifikuar edhe në antikitet, sikurse në mesjetë.²⁹

²⁶ K. Jireček. Po. aty.

²⁷ P. Thomo, Art. cit.

²⁸ 27. Në faqet e një kanali me thellësi 1.20 m, që nis jo larg këtij trakti muri dhe që u afrohet deri 7-8 m mureve të kishës, vërehen dy shtresa të qarta kulturore: poshtmja, me trashësi rreth 0.40 m, përmban fragmente tjegullash, amforash enësh të tjera antike. Mbi këtë dallohet një shtresë dheu me mbeturina të theksuara djegje e kocka njerëzish. Shtresa e sipërme që ka një trashësi mesatare prej 0.50 m, përmban fragmente qeramikash mesjetare. (Për objektet arkeologjike të mesjetës së hershme shqiptare, të gjetura në kepin e Rodonit, shih Historia e Shqipërisë, Tiranë 1959, f. 167).

²⁹ 8. Për mendimin se Skënderbeu nuk bëri veçse shtesa mbi një kala më të hershme, shih 1. Zamputi, Kontribut për historinë e Shqipërisë, shek. XVI, «St. Hist». 1964/I

Mendimi i shfaqur nga arkeologu H. Ceka se toponimi i këtu-shëm ruan emrin e një hyu ilir, ndoshta emrin e hyut të detit,³⁰ i përforcuar dhe nga një mbishkrim i zbuluar në Salento të Italisë që përmend paralelisht emrat e dy anijeve ilire «Medaur» dhe «Redon»,³¹ na lejon të bëjmë edhe një supozim tjetër.

Gjurmët e ndërtimeve antike që përmendëm më lart, sidomos ato mbi shpatin e thiktë të bregut prane kalasë, një pozicion ky që sheh një horizont të gjerë mbi det, mund të përfaqësojnë ndoshta mbetje të një tempulli. Kishat e ngritura këtu në mesjetë, veçanërisht ajo e Shën Kollit (mbrojtësi i detarëve dhe i lundrimit), na duket gjithashtu se mëshojnë në një traditë të hershme kulturi.

5. MBETJE NDËRTIMESH ANTIKE

Mbi shpinën e një kodre të butë, që njihet me emrin Kodra e Lulit dhe që ndodhet ndërmjet këtij fshatit e kalasë së Skënderbeut, vihen re disa blloqe të mëdhenj gurësh. Shpina e kodrës është e zhveshur pa ndonjë kreshtë shkëmbore dhe vendosja e tyre nuk duket pa ndonjë kriter. Blloqet janë prej gurë shtufi gjysmë të punuar. Ndonjëri arrin përmasat deri 3.35 x 0.65 x 0.35 m.

Pak më poshtë, në faqen jugperëndimore evidentohet linja e një muri që zgjatet poshtë kodrës deri 5 m. Ky është prej gurësh të vegjël dhe mesatarë. Një bllok kuadratik i latuar, që shihet

³⁰ H. Ceka, Bust i mbretit Gent apo figurë mitologjike ilire, «Iliria» VI, 1976, f. 142

³¹ Pagliara, La grotta Percinara al Capo di S. Maria di Leuca-1: Le iscrizioni estratte da annali dell'Università di Lecce vol. VI, Salentina-Calatina 1973 f. 27-28.

këtu, ka përmasat 1.20 x 0.40 x 0.35 m. Në këtë faqe të kodrës si dhe në faqen verilindore gjenden dhe fragmente të rralla qeramike antike. Në anën veri-lindore kemi gjetur një kionisk prej guri gëlqeror, mbishkrimi i të cilit është fshirë.

6. GJURMË NDËRTIMESH ANTIKE

Një kilometër e gjysmë nga Kodra e Lulit, në bregun e detit formohet një gjë i vogël, që mbrohet nga veriu prej vetë kepit. Këtu, rreth 300 m nga bregu, mbi një faqe kodre që vendaset e thërrasin «Kulmëri», vërehen mjaft fragmente qeramike të shekujve të parë të e. s. Pak më poshtë, por të lëvizur prej asaj pike, shihen dy blloqe të mëdhenj shtufi gjysmë të punuar, njëri prej të cilëve është 2.15 m. i gjatë.

7. KISHA E SHËN KOLLIT DHE AJO E SHËN MËRISË

Mbi një majë të rrumbullakët kodre, jo larg nga Kodra e Lulit, gjenden rrënojat e kishës së Shën Kollit, e njohur në shekujt XIV-XV. Rrënojat e kishës së Shën Mërisë,³² kemi mundur t'i identifikojmë kohët e fundit në përfundim të kodrës së Lulit, te vendi i quajtur Kodra e Keqit.

8. STELA E KRITODAMIT (Fig. 1)³³

Është një stelë varri jo e plotë, e përbërë nga tri pjesë të thyera. Pjesën e tretë (që përmban kokën e gruas) e gjetëm në vitin

³² Shih A. Ducellier, vep. cit. dhe literaturën e cituar prej tij. Mbetet ende për t'u identifikuar vendgjetja e kishës së Shën Anastasisë.

³³ Kjo stele është ekspozuar në njerën nga sallat e Muzeut.

1971,³⁴ ku disa vjet më parë, nga punonjësit e Muzeut Arkeologjik të Durrësit ishin gjetur edhe dy pjesët e tjera.

Është prej mermeri të bardhë me rremba të zi. Lartësinë maksimale (me gjithë frontonin) e ka 0.60 m, gjerësinë 0.45 m dhe trashësinë 0.06 m.




Fig. 1

³⁴ Vendgjetja është një faqe kodre e punueshme. Megjithë kërkimet tona imta rreth e qark, nuk rezultoi asnjë gjurmë tjetër antike. Bashkohemi, prandaj, me inendimin e vendasve se ajo është çuar në atë kodrinë më 1916 nga forcat austro-hungareze, që u dislokuan aty përkohësisht. Ka mundësi që të jetë gjetur në ndonjë nga rrënojat e kishave të lashta të këtij fshati ose gjetiu dhe është mbajtur pranë kampit ushtarak të përkohëshëm austro-hungarez me qëllim për t'u mbartur, gjë që, siç duket në rrethana lufte nuk është realizuar.

Nën fronton, brenda kornizës, është paraqitur në relief një skenë lamtumire. Në të majtë shihet një grua e ulur mbi një katedrë. Ajo është veshur me kiton e himation, një kënd të të cilit e ka të hedhur mbi kokë, duke i lënë zbuluar flokët përpara.

Para gjunjëve të saj qëndron më këmbë një djalë i vogël laku-riq. Djalit i mungon koka, njërën dorë e ka të mbështetur mbi kofshët e gruas. Në të djathtë është paraqitur një burrë në këmbë, veshur me himation që i le zbuluar gjoksin. Duart i ka lidhur përpara. Flokët kaçurrele puqen me mjekrën e tij të shkurtër, po ashtu kaçurrele.

Në fronton, mbi një kornizë pak të ngritur shihet në të djathtë, mbishkrimi: KPITOΔAMOY

Shkronjat janë realizuar me incizim. Ato nuk karakterizohen nga realizimi i lartë artistik i këtij relievi.

Figura e Kritodamit dhe në tërësi steleja ka ngjashmëri me fragmente relievesh nga nekropoli i Durrësit, të datuara në shekujt V-III p.e.s.³⁵

9. TORS E NJË GRUAJE³⁶

Është gjetur para shumë vjetësh në rrënojat e kishës së Shën Kryqit. Tani ruhet në Muzeun Arkeologjik të Tiranës. Është prej mermeri të bardhë. Lartësinë e ka 0.35 m, gjerësinë 0.30 m.

Gruaja është e veshur me kiton dhe me një jelek me mëngë të shkurtra, të shtrënguara një rryp në mes. Ka mundësi që të ketë

³⁵ V. Toçi, Mbishkrime e relieve..., f. 74, 114.

³⁶ P. Nuraj, Një fragment statuje vajze nga kepi i Rodonit, Adriatiku, 14 Maj 1978.

pasur dhe një pelerinë ose labane të hedhur mbi kokë, që i evidentohet në pjesën e pasme. Jeleku karakteristik, e bën të krahasueshme veshjen e saj me veshje grash ilire të zbuluar në Durrës.³⁷

10. DY KIONISKË DHE OBJEKTE TË TJERA SEPULKRALE

Në Muzeun Historik të Ishmit ruhen dy kioniskë të fragmentuar. Para se të vendoseshin në këtë muze i kemi parë në shkollën 8 vjeçare të Draçit³⁸.

Të dy janë prej guri gëlqeror. Njëri, me trup cilindrik e bazament paralelopiped, e ka lartësinë e përgjithshme 0.47 m (lartësinë e bazamentit 0.26 m). Në pjesën cilindrike lexohet mbishkrimi:

ΟΕΟΔΩΡΙΑΔΑ
ΑΡΜΙΩΝΟΥ
ΧΑΙΡΕ

Tjetri nuk është i plotë, i mungon pjesa e sipërme, prandaj dhe mbishkrimi është i mangët:

ΧΑΙΡΕ

Nga karakteri i shkronjave dhe punimi i tyre, këta gurë varresh ngjasojnë me objekte të tilla të zbuluara në Durrës dhe të datuara në shekuj III-I p.e.s.³⁹

Në Muzeun Historik të Ishmit, me prejardhje nga Draçi, ruhen dhe dy fragmente pllakash varr me mbishkrime të pjesëshme:

³⁷ S. Anamali, Të dhëna mbi elementin ilir në qytetet antike Epidamn dhe Apolloni, B.SH.SH. 1956, 1, f. 33-35.

³⁸ Draç (fshat pranë Shetajt)

³⁹ V. Toçi, vep. cit., f. 74-80.

në njerën prej tyre lexohet kurse në *ΔΕΣ* tjetrën *ΕΣΤΟΙC*

Përveç këtyre është dhe një arkëzë hiri (urnë cinerare) me trajtë paralelopiedi, si dhe një putër e gdhendur në mermer.

11. GJURMË RRËNOJASH ANTIKE

Në faqen jugore të kodrave të këtij fshati, jo më larg se 1 km nga rrënojat e kishës së Shër Pjetrit, shihet një trakt themeli apo xokolature ndërtuar me gurë të çrregullt. Gjerësinë e ka 0.60 m. Përreth shihen mori fragmente kalipteresh me kurriz të harkuar dhe tjegullash solene me buzë pak të profiluara të shekujve të parë të e.s.

ISHËM

Vetë fshati që mban këtë emër përbëhet në fakt nga tre fshatra të vegjël (ose lagje): Kapidanaj, Kërtushaj, Likmetaj. Këto shtrihen gjatë faqes veriore dhe shpinës së kodrave që ngrihen menjëherë mbi bregun e lumit, paralel rrjedhjes së tij.

12. KALAJA E ISHMIT⁴⁰ (Fig. 2)

Ndodhet mbi një breg në lindje të qendrës së këtij fshati. Ka një planimetri drejtkëndëshe pak a shumë të çrregullt 100x40 m. me drejtimin e faqeve të ngushta veriperëndim-juglindje. Është një kala mesjetare, e ndërtuar ndërmjet viteve 1572-1574.

Nga vrojtimet tona nuk kemi konstatuar gjurmë më të hershme në të, as dhe në afërsi.

Në anën e majtë të luginës, në fushën e vogël që formohet midis kodrave dhe bregut të lumit, si dhe pranë grykëderdhjes

⁴⁰ Gj. Karaiskaj, Kështjella e Ishmit, «Monumentet, 15-16

nuk kemi hasur gjurmë rrënojash antike dhe mesjetare. Po të kemi parasysh ngritjet e nivelit të kësaj pjese, si rezultat i mbushjeve që bën lumi me vërshimet e tij, kjo gjë duket e shpjgueshme. Një provë për të mbështetur këtë mendim kemi në Likmetaj, jo larg bregut të lumit. Këtu në faqet dhe në tabanin e një kanali me thellësi 1. 80 m kemi vrejtur themele guri dhe tjegulla të vona (Tab. III, 1, 2).



Fig. 2

GJURICAJ

12. MBETJE NDËRTIMESH ANTIKE, DETAJE ARKITEKTONIKE

Rreth 4 km në juglindje të kalasë së Ishmit, rrëzë vargut të kodrave që këtu i afrohen bregut të lumit deri 500 m, është një bregore e ulët që njihet me mikrotoponimin «Pazare». Vendasit e moshuar thonë se në këtë vend janë ndeshur rastësisht me mure të vjetra që 40 vjet më parë. Këtë pikë ne e kemi vizituar për herë të parë në vitin 1971.⁴¹

⁴¹ H. Myrto, Relacion mbi vrojtimet arkeologjike në zonën Tetor 1971 (ruhet në Muzeun Arkeologjik të Durrësit). 1978.

Sot aty në një sipërfaqe prej afërsisht 4 ha shihen kryesisht fragmente të vogla tullash e tjegullash, gurë të përdorur në ndërtime dhe copëra pllakash mermeri. Në anën lindore të kësaj sipërfaqeje shihet dhe një trakt muri i ndërtuar me tulla si dhe një kolonë jo e plotë mermeri (Tab. II, 3). Nga «Pazareja» e kanë prejardhjen edhe dy kapitete mermeri dhe një kapitel impost me kryq, që ruhen në muzeun e fshatit (Tab. II, 1, 2).

Trakti i murit që është zbuluar nga një rrëke uji, ka një gjatësi prej 2.5 m dhe lartësi 0.70 m. Atij i shihet vetëm njëra faqe, që duket e ndërtuar me tulla dhe llaç gëlqereje. Tullat janë me përmasa 37 x 29 x 4 cm, 35 x 29 x 4 cm dhe 34 x 28 x 4 cm. Llaçi është bërë me rërë të trashë e copëra të thërmuara tullash. Ai formon fugatura horizontale me trashësi prej 4-5 cm. Tjegullat e përdorura në këtë qendër, duke gjykuar nga fragmentet që shihen në sipërfaqe, janë të tipit solene, të sheshta, me buzë të kthyera në formë kokë zogu». Shpinën e kanë të zbukuruar me tufa brezash të valëzuara.

Teknika e ndërtimit të këtij muri, përafërsisht edhe tullat, kanë ngjasim me ato të murit jugperëndimor të kalasë së Durrësit, të ndërtuar në fundin e shekullit V dhe fillimin e shekullit të VI të e.s.⁴² Edhe tipet e tjegullave që përmendëm kanë paralelizma në monumente të shekujve V-VI.⁴³ Por një tip tjetër tullash që ndeshen më rrallë, duket më i hershëm. Këto janë tulla katrore, sesquipedales, 0.444 x 0.444. Në ndërtimet romake, në Itali e

⁴² Gj. Karaiskaj, A. Baçe, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë, «Monumentet» 9, 1975, f. 8.

⁴³ N. Ceka, Fortifikime të vona antike panë rrugë Egnatia. «Monumentet» 7-8, 1974, f. 75 dhe 81.

gjetiu, kjo formë tulle është preferuar në përgjithësi në periudhën e Domicit të Adrianit, por është përdorur edhe gjatë shekullit III.⁴⁴ Po ashtu, ndonëse rrallë, vërehen edhe fragmente tullash trekëndëshe.

Kolona është prej mermeri të bardhë me gjatësi 1.5 m dhe diametër 0.30 m. Kapitelet (Tab. II, 1) janë identike. Ato janë punuar prej një mermeri të bardhë dhe zbukuruar me dy radhë gjethesh akanthi që dalin nga një kurorëz e mbështjellë në periferinë e bazës. Përmasat e tyre janë: B. 0.43 x 0.50 m; diametri i b. 0.265 m; lartësia 0.30 m.

Trakti i murit dhe objektet e tjera arkitektonike të gjetura këtu mendojmë se i përkasin një kishe të shekujve V-VI, që ndoshta mund të ketë qënë e rethuar edhe me mure mbrojtëse. Por siç e pamë aty janë gjetur edhe tulla karakteristike për periudhën e mëparshme të shekujve II-IV. Nga ana tjetër, sipërfaqja prej 4 ha, në të cilën shihen të shpërndara materialet që përshkruam, tregon se nuk është fjala për një godinë të vetme, por për një njësi godinash, ose dhe më tepër.

14. MBETURINA TË NJË URE

Pothuaj një kilometër e gjysëm nga kjo pikë, aty ku kapërcet lumi i Ishmit për t'u hedhur në katundin Sukth-Vendas (mbi një kodër të vogël) të Fushë-Krujës, deri në vitin 1971 mund të shiheshin ende mbeturinat e këmbëve të një ure të ndërtuar me gurë të çrregullt e llaç. Kjo urë ka pasur gjithsej tri këmbë, njëren në mesin e lumit dhe nga një në secilin breg. Këto

⁴⁴ G. Lugli, *La tecnica edilizia romana*, Roma 1957, f. 547, shih dhe ndërtimet nga Elagabali deri te Probi.

në një gjendje natyrisht më të plotë, ka parë në fillim të këtij shekulli Ipen dhe i ka vlerësuar si «mbeturina nga kohë më të mira». ⁴⁵ Për mendimin tonë kjo urë nuk ka qenë bashkëkohëse me ndërtimet që vërtetohen në «Pazare»; ajo do t'i ketë përkitur rrugës që lidhte në mesjetë kalanë e Ishmit me Krujën dhe Lezhën.

Përsa i përket «Pazares», me gjurmë ndërtimesh prej shekujve II-IV të e.s., e ndodhur pothuaj në breg të lumit të Ishmit dhe pranë një vend kalimi tradicional të tij, duket se përmban disa kushte për t'u identifikuar me Pistumin antik. ⁴⁶

Në kohën kur arkeologët Prashniker dhe Shober në kërkim të këtij stacioni, vizituan Ishmin, ⁴⁷ këto gjurmë të antikitetit nuk njiheshin. Kurse zbulimi i një ndërtese antike e pajisur siç duket edhe me terme, në fshatin Burizanaj të Fushë-Krujës ⁴⁸ nuk na duket se i plotëson kushtet për t'u identifikuar me këtë stacion. Burizania, së pari, ndodhet larg bregut të lumit, ndërsa në itineraret dhe në Tabula Peutingeriana kuptohet se stacione të tilla si Apsi, Genusi, Pistumi etj. kanë qenë ngritur në brigjet e lumenjve. Së dyti, gjurmët që vërehen sot për sot në atë fshat zenë një sipërfaqe të kufizuar, dhe mund të merren si mbeturina të ndonjë vile.

⁴⁵ Th. Ippen, Scutari und die Nordalbanische Küstenebene Sarajevë 1901.

⁴⁶ T.P. Miller IR Col. 462-471, hartë kjo që mendohet se është përpiluar në gjysmën e parë të shek. III dhe anonimi i Ravenës (Rev) Cosmografisë së të cilit mendohet se i ka shërbyer si model ndonjë hartë e shek. V-VI.

⁴⁷ C. Praschniker-A Shober, Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro, Wien 1919, f. 46 dhe 85.

⁴⁸ L. Papajani-G. Pani, Rrugët dhe banjat pranë tyre në antikitet Tradita në arkitekturë dhe art», Tiranë 1978.

Nëse do të pranohej identifikimi i Pazares së Gjuricajt me Pistumin, megjithëse mungojnë prova bindëse, atëherë rruga që vinte nga Dyrrahi në drejtim të Lisit jemi të mendimit se deri në Vorë do të ketë ndjekur pak a shumë drejtimin e rrugës së sotme. Nga Vora rruga do të ketë kaluar rrëzë kodrave të Ishmit, anës veriore të tyre, deri në «Pazare», ku siç duket e kapërcente lumin afërsisht aty ku shihen mbeturinat e urës mesjetare.

Në mbarim të vështrimit tonë mbi zonën e Ishmit duke e marrë këtë si një nënnyjësi prej Kepit të Rodonit deri në Gjuricaj, do të thoshnim se kjo përbën një trevë, shumë premtuese për gjurmimin e vazhdimësisë së kulturës ilire në atë shqiptare. Përveç të dhënave historike dhe toponomastike, dëshmi për këtë janë edhe gjurmët arkeologjike që evidentohen këtu dhe që përfaqësojnë periudhën e qytetërimit ilir, atë të shekujve të parë të e. s. , periudhën e antikitetit të vonë, atë të mesjetës së hershme shqiptare, si dhe periudhën e mesjetës së mesme.

II. ZONA FUSHORE E ERZENIT TË POSHTËM

HAMALLAJ

15. GJURMË NDËRTIMESH ANTIKE

Kjo pikë arkeologjike gjendet në fushë, në sektorin e Hamallajt të N. B. Sukthit, jo më larg se 500-600 m nga buza e detit dhe dy km nga bregu i Erzenit. Vendasit e njohin me mikro-toponimin Kërpi dhe dëshmojnë se para se të shpyllëzohej, aty ishte një kodërz.

Në një sipërfaqe prej 400 m² vërehen të shpërndara mbeturina materialesh ndërtimi dhe fragmente qeramike antike. Së

pari, të bien në sy gurë lumi me madhësi mesatare që duket sikur formojnë pak a shumë një rreth.

Në sipërfaqe kemi mbledhur fragmente tullash me trashësi 7 cm, fragmente tjegullash solene, fragmente amforash e enësh balte të përdorimit të përditshëm, peshore konike etj.

Solenet janë të tipit me buzë konvekse dhe me kanalin anësor nga brenda tyre. Një fragment soleneje (Tab. II, 4) ruan një vulë epigrafike:

ΕΠΙΚΑΛΛΗ..

Duke u nisur nga kjo vulë, mendojmë se solenet e përdorura në këtë pikë janë prodhuar në punishten shtetërore të Dyrrahut.⁴⁹ Siç duket kjo mban emrin e prytanit eponym Καλληνος. Prytanë eponymë të Dyrrahit me këtë emër njihen në monedhat e këtij qyteti të viteve 250-168 p.e.s.⁵⁰

16. TUMË

SHKAFANE

Në afërsi të Shkafanes, brenda luginës që përshkohet nga përroi i Thelbit, tek vendi që njihet me mikrotoponimin «Rrahi i Ibrës», dy kodërza të vogla na bëjnë të dyshojmë për tuma. Në atë vend lugina ka një gjerësi prej 50-60 m dhe përroi i kalon

⁴⁹ Parafjala ΕΠΙ, që shoqëron pothuaj gjithë emrat që janë regjistruar në vulat e tjegullave të këtij qyteti për kohën që ishte i pavarur, duket se tregon që këto emra janë emra të prytanëve eponymë. Këtë gjë e provon edhe fakti ato përputhen me emrat e shpinës së monedhave (shih H. Ceka, Probleme të numismatikës ilire, Tiranë 1965, f. 52).

⁵⁰ H. Ceka, Datimi i drahmeve të Dyrrahut dhe Apollonisë, St. hist. 1966, 3; Thesari i Jubicës, Iliria 1, f. 86, 94.

anash. Njera prej kodërzave ka formë gjysmësferike, me diametër rreth 7 m e lartësi 3 m. Pranë saj ngrihet një kurriz tjetër gjysmëoval, me lartësi rreth 1.5 m dhe gjatësi 10 m.

17. TUMA⁵¹

Vite më parë në fushën e Sukthit, jo larg brigjeve të Erzenit, si dhe në pyllin e fshatit Hamallaj janë evidentuar tuma ilire.

ARMATH

Në kodrën e Valmit, ku janë konstatuar varre të vjetra, është gjetur një brokëzë e vogël bronxi me lartësi 4 cm. Për analogji datohet në periudhën e hershme të hekurit, në shekujt VII-VI p.e.s.⁵²

19. QERAMIKË ANTIKE E STOLI BRONXI

Me një sondazh që u krye këtu në një kodër jo larg shkollës tetëvjeçare të fshatit, është zbuluar qeramikë e periudhës qytetare ilire: gryka, vegje e funde amforash, buzë pjatash, vegje filxhanësh kupa të lyera me vernik të zi, fragmente enësh me pikturim me figura të kuqe si dhe një gjilpërë dyshe bronxi me kokë në trajtë omegë.⁵³

⁵¹ H. Ceka, Elementi ilir në qytetet Dyrrachium dhe Apolloni, B.SH.SH. nr. 3-4, Tiranë 1951; S. Anamali, Të dhëna mbi elementin ilir të qyteteve Epidamn dhe Apolloni, B.SH.SH. 1, 1956, f. 12.

⁵² F. Prendi, Vështrim mbi kulturën e periudhës së parë të epokës së hekurit, Iliria II, 1974, f. 114, Tab. V, 1.

⁵³ S. Hidri, Gjurmime arkeologjike në zonën e Armathit, Drita, 14.x.1973.

20. NJË FRAGMENT TULLE DHE NJË MONEDHË ROMAKE

Në muzeun e shkollës 8 vjeçare të fshatit ruhet një fragment tulle me trashësi 4.5 cm, që ka një vulë në reliev në trajtën e një ylli pesë cepash, po ashtu dhe një monedhë bronxi e Antonin Piut. Thuhet se këto objekte janë gjetur në vendin e quajtur Palush Fushë.

21. ÇEKAN GURI

MANËZ

Në afërsi të rezervuarit të Manzës është gjetur një çekan guri, i lëmuar dhe me brimë në mes.⁵⁴ Sikurse çekanët-sopata, edhe çekanët e biruar, datohen në periudhën e neolitit të vonë, të eneolitit dhe deri në periudhën e bronzit të mesëm ose të vonë.⁵⁵

22. GJURMË RRËNOJASH ANTIKE

Në qendrën e fshatit të Manzës (i vjetri) ng punimet e cekta bujqësore kanë dalë në sipërfaq materiale që e bëjnë këtë pikë me interes arkeologjik. Këto janë: një pjesë kolone dritareje me seksion eliptik prej guri gëlqeror, një pjesë tjetër kolone po prej guri gëlqeror, por e rrumbullakët (me diametër 0.27 m), tulla, copëra pllakash mermeri, fragmente enësh balte dhe gurë mozaiku.

⁵⁴ Ky është thjeshtë çekan, me të dyja anët për rrahje. Bira është llakët dhe e lëmuar nga brenda, me diametrin 2.3 cm.

⁵⁵

Tullat janë drejtkëndëshe me përmasa 0.27 x 0.23 m, por ka edhe katrore me kanale diagonale në sipërfaqe. Nga qeramika e këtushme përmendim një fragment kupe “pseudoterrasigillate” në ngjyrë të kuqe. Janë gjetur gjithashtu copëza qelqi të hollë, transparent, me një nuancë të lehtë jeshile. Gurët e mozaikut janë deri diku kubik prej brumi qelqi opak në ngjyrat blu dhe jeshile.

Mendojmë se këto materiale dëshmojnë për ekzistencën në këtë vend të rrënojave të një kishe paleokristiane.

BORÇË

23. DY SOPATA BRONXI (Fig. 3)

Fshati Borçë ndodhet mbi një bregore të rrumbullakët nën fushë, jo larg Manzës. Në rrëzën jugore të kësaj kodre, te vendi i quajtur «Radhenjtë» janë gjetur dy sopata bronxi.⁵⁶ Ato kanë dalë nga punimi i tokës, një vit njëra pas tjetrës. I përkasin tipit shqiptaro-dalmat» që datohet në periudhë e vonë të bronxit, siç duket në shekullin e XIII p.e.s.⁵⁷.

⁵⁶ H. Myrto, Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit, kumtesë mbajtur në Sesionin shkencor të Muzeut Arkeologjik të Durrësit, Nëntor 1979, dorëzuar për botim në Iliria.

⁵⁷ F. Prendi, Sopata të pabotuara të epokës së bronxit të zbuluara në Shqipëri, B.SH.SH. 1958/1, f. 207; R. Vulpe, Edhe një herë mbi sopatat e bronxit iliro-shqiptare, B.SH.SH. 1960/2. Të dyja sopatat e Borçës janë identike nga trajta, me tri brinjët e gufmuara karakteristike dhe me zgjatimin në formë mamuzeje. Përmasat kryesore i kanë të barabarta: gjatësinë 25 cm, gjerësinë 10.5 cm. Megjithatë ato paraqesin edhe ndryshime: akset gjatësorë të tyre nuk qëndrojnë në të njëjtin kënd ndaj vijës së presës, tek e dyta zgjatimi në formë mamuzeje është 1 cm më i gjatë se tek sopata e parë, ndërsa te kjo mungon brima e zakonshme transversale e tunit.




Fig. 3

RUBJEKË

25. NJË DETAL ARKITEKTONIK DHE NJË VARREZË ANTIKE

Në një gurore në afërsi të këtij fshati kohët e fundit u zbulua rastësisht një bllok guri paralelopiped, i latuar, me përmasat 3.12 x 1.10 x 0.35 m. Për kohën e punimit të tij dhe destinacionin (që duket se nuk e ka mbrritur) nuk mund të themi asgjë të sigurtë.

Jo shumë larg te kodra e Sallakut, në të majtë të rrugës që vjen nga Maminasi për në Manzë, u kryen punime të thella bujqësore dhe me këtë rast u zbuluan disa varre. Si objekte të ruajtura nga inventari i këtyre varreve, na dorëzuan një majë shtize hekuri dhe një kanë të vogël me vernik të zi (Tab. III, 3,

4). Kana (Tab. III, 3) ka qënë lyer si nga brenda edhe nga jashtë me vernik të zi të trashë pa shkëlqim, që vende-vende është rjepur.

Si tip, me zbulimet e deritanishme në Durrës, me sa jemi në dijeni edhe në qendrat e tjera antike të vendit tonë, qëndron unikal. Mendojmë se i përket shekujve IV-III p.e.s.

Maja e shtizës ka trajtën e një gjetheje të gjatë, me kurriz qendror nga të dyja anët e fletës.

26. GJURMË RRËNOJASH ANTIKE

Një pikë me interes arkeologjik është evidentuar rreth 1.5 km në jugperëndim të qendrës së këtij fshati dhe jo më tepër se 2.5 km nga stacioni hekurudhor i Sukthit. Vendi quhet Kodra e Zhurit. Këtu, mbi faqen e një kodre të ulët rrzë fushës së Sukthit, shihen fragmente të shumta tullash e tjegullash dhe enësh balte tepër të copëtuara nga punimet e përsëritura bujqësore. Vërehen gjithashtu dhe gurë të mëdhenj e mesatarë të përdorur për ndërtim.

Fragmentet e tjegullave tregojnë se këto janë të sheshta dhe me buzë të tipit «kokë-zogu» (Tab. III. 6, 7). Tullat janë prej balte të kuqe-rozë me trashësi 4 dhe 5 cm. Ato kanë qënë të lidhura me llaç gëlqereje të shkërmoqshëm, që përmban thërmija të imta tullash.

Një fragment qafe amfore (Tab. III, 8) është zbukuruar me vija të valëzuara, të bëra me incizim para pjekjes, dhe me një sërë drejtkëndëshash të vegjël të mbushur me pika.

Këto të dhëna, ndonëse të pakta, mendojmë se mund të provojnë që këtu ka ekzistuar një ndërtesë në shekujt IV-VI të e.s.

Mungesa deri tani e ndonjë dëshmie karakteristike për arkitektu-
rën dhe dekoracionin e kishave na bën të mendojmë se këto
gjurmë duhen lidhur më tepër me ndonjë godinë laike, si ndonjë
vilë. Pozicioni i kësaj pike rrëzë fushës së gjerë e pjellore të
Sukthit e favorizon një mendim të tillë.

MAMINAS

27. QERAMIKË E PERIUDHËS QYTETARE ILIRE

Në vitin 1960, me rastin e hapjes së themeleve të dyqaneve të
sotme, në të djathtë të rrugës që shkon për në Tiranë, dolën enë
balte të periudhës qytetare ilire.

QERRET

28. MBETURINA TË NJË NDËRTESE ANTIKE

Brenda këndit që formohet nga rruga Xhafzotaj-Sektori i
Fllakës dhe kthesës që bën kjo në drejtim të fshatit Qerret e
Katundit të Ri, ekziston një qendër me material antik mjaft të
evidentuar. Vendi është fushë. Dikur toka ka qënë pak e ngritur.
Që me fillimin e punimeve, këtu u panë mure të ndërtuara me
tulla, si dhe disa dhoma e një koridor i ngushtë.

Sot këtu shihet një material i dendur qeramik i shpërndarë në
një sipërfaqe prej afërsisht 6000 m².

Ndërmjet këtij materiali bien në sy fragmente tullash e tje-
gullash të shekujve të parë të e.s., po ashtu dhe fragmente enësh

balte. Në sasi të konsiderueshme janë fragmentet e pitosave dhe të amforave.⁵⁸

Ky material mendojmë se dëshmon për ekzistencën këtu të një ndërtese, ose të një njësie ndërtesash, të shekujve I-II e. s.

FLLAKË

29. MBETURINA TË NJË NDËRTESE ANTIKE

Ndonjë kilometër e gjysmë në perëndim të qendrës së sektorit të N. B. të Fllakës, dallohen përsëri mbeturina materiali ndërtimi të ngjashme me ato që përmendëm në qendrën e mësipërme. Vendasit flasin për një kalldrëm të hasur në thellësinë 1 m, që duket se lidhte këto dy qendra.

KOXHAS

30. MBETJE NDËRTIMESH ANTIKE⁵⁹

Në të djathtë të rrugës automobilistike Sukth-Maminas, materialet që përfaqësojnë ekzistencën e një ndërtese ose disa ndërtimeve të shekullit të e.s. janë tulla katrore dhe katërkëndëshe, pllaka mermeri të bardhë, fragmente vazosh qelqi, qyngje plumbi etj.

⁵⁸ 56. Karakteristikë janë vegjet shiritore elipsoidale të lyera me vernik të kuq e të zbukuruara me kanelyra në kurrizë, vegjet dyshe me prerje në trajtë, si dhe vegjet brinake me vernik të kuq në kafe. Një shishe e vogël dhe gati e plotë balte (Tab. III, 5) me fund të sheshtë dhe trup të vogël vezak, është e lyer me vernik të kuq nga brenda; qafa edhe nga jashtë. Po ashtu janë gjetur dhe peshore konike prej balte, fragmente terrasigillata, copëra qelqi transparent bojë qielli në jeshil dhe një instrument hekuri i papërcaktuar.

⁵⁹ F. Tartari, Gjurmë të lashta ndërtimesh, «Bashkimi» 9 gusht 75.

SALLMONAJ

31. GUR MILIAR⁶⁰

Më se një shekull më parë në këtë fshat, në bregun e Erzenit jo larg Shijakut, është gjetur një gur miliar, që duket se përcakton milien e VIII të rrugës prej Dyrrahut në Lis.⁶¹

VRRIN (SHËNEVLASH)

32. VARREZË E SHEKUJVE IV-III P.E.S.⁶²

Me një sondazh që filloi në vitin 1972 dhe që vijoi edhe në vitin pasonjës e mori karakterin e një gërmimi të rregullt, te vendi i quajtur «Djerri Qishës», u zbulua një varrezë antike.

Këtu u gërmua një sipërfaqe prej 150 m² dhe zbuluan 22 varre. Varret ishin pa asnjë lloj konstruksioni dhe mbanin brenda nga një skelet, me përjashtim të varrit Nr. 1, që kishte dy skelete në krah të njëri-tjetrit, po ashtu dhe të varrit nr. 22. Te ky i fundit, skeletet u gjetën njeri mbi tjetrin, me kokat në drejtime të kundërta, veri jug.⁶³

⁶⁰ I.L., I-170; Heuzey-Daumet, Mission archeologique de Macédonie, 1876, f. 389, nr. 174; P.C. Sestieri, Mbishkrime latine të Shqipërisë, Në «Studime e tekste-Dega e dytë arkeologjike» nr. 1, Tiranë 1943.

⁶¹ Përmbajtja e mbishkrimit sipas F.C. Sestierit (art. cit.) është DIIS GENITISSET – DEORVM CREATORIBVS – ISAVGG – Λ VIII – AN VIII.

⁶² H. Myrto, Rezultatet e një gërmimi në nekropolin e fshatit Vrrin (Shënevllash) të Durrësit, dorëzuar për botim në «Iliria».

⁶³ Gërmimi u krye në vendin e gjetjes së rastësishme të një fibule të jetës së hershme shqiptare (S. Anamali - M. Korkuti. Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve në dritën e kërkimeve arkeologjike shqiptare. Në “Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve”, Tiranë 1969, f. 35; S. Anamali, Mbi kulturën e hershme shqiptare, po aty, f. 194; Shqipëria arkeologjike, Album, Tiranë 71.

Një pjesë e skeleteve ishin të vendosura në shpinë, me gjymtyrët të shtrira drejt anash trupit, kurse një pjesë ishin vendosur brinjazi. Te këta të fundit u re një dukuri interesante. Në varret nr. 1 (A), 5, 9, 14 dhe 16, të varrosurit

Si inventar, u gjetën enë balte, vorba e ojneh një lekýt me figurë të kuqe, një fibulë dhe dy unaza bronxi. Mbi varre ishin hedhur monedha bronxi të Dyrrahit, të tipit Herakli/armë dhe copëra enësh balte të thyera.

Duke u mbështetur në inventarin dhe veçanërisht në monedhat, që nuk mbajnë emrin e monetarit apo të prytanit eponym, këtë varrezë e kemi datuar në fundin e shekullit IV dhe fillimin e shekullit III p.e.s.

Nga tipi i varreve, riti i varrimit dhe inventari, duket se të varrosurit i përkisnin shtresës së ulët të një vendbanimi (fshati) të afërt me Dyrrahun, që e njihte kulturën e qytetit të madh-koloni, por që ruante edhe tipare të një kulture origjinale vendase.

33. DY FRAGMENTE KOLONASH

Jo larg vendit të kishës së Shënevlashtit, kemi gjetur një fragment kolone të stilit dorik, me kanelyra që është prej guri gëlqeror si dhe një fragment kolone graniti.

34. NJË MONEDHË VENECIANE

Ndonjë kilometër në lindje të Vrrinit pranë bregut të majtë të kanalit të Jubës, është gjetur një monedhë argjendi veneciane.⁶⁴

kanë qenë shtrirë brinjazi në krahun e djathtë ose të majtë, me njërën këmbë të zgjatur drejt, kurse tjetrën të përthyer thellë te gjuri. Shputa e këmbës së përthyer, që formonte një kënd të theksuar përpara, futej pastaj poshtë kërcirit të këmbës tjetër. Duart në këto raste janë të puqura mbi gjoks, ose njëra e ngritur në drejtim të kokës.

⁶⁴ Ka të dhëna gojore se pranë kësaj pike më 1940, punëtorët e shoqërisë kapitaliste «E.I.A.A.» hasën, në thellësinë e 2-3 m, në disa enë të mëdha balte. Sipas tyre autoritetet italiane i larguan punëtorët shqiptarë nga vendi i gërmimit dhe i nisën me nxitim enët e gjetura për në Durrës. Punëtorët shqiptarë protestuan sepse dyshuan në këtë rast, për grabitjen e një thesari.

ARAPAJ⁶⁵

35. PLLAKË ME MBISHKRIME E UJËSJELLËSIT ANTIK TË DURRËSIT

Një pllakë me mbishkrim, që bën fjalë për riparimet e bëra në ujësjellësin e Dyrrahut, të ndërtuar në kohën e Adrianit, nga ana e nipit të tij, perandorit Aleksandër Severi, përmendet së pari prej Hanit.⁶⁶ Më pas për këtë u interesua Leon Hezei i cili e çoi në Luvër (ku ndodhet) dhe e botoi.⁶⁷

36. PUSSETAT E TUNELIT TË UJËSJELLËSIT ANTIK TË DURRËSIT

Nga Çezma e Arapajt deri në afërsi të daljes së tunelit hekurudhor të Rrashbullit (në anën e Shkozetit) janë evidentuar 14 puseta të ujësjellësit antik të Durrësit.⁶⁸ Këto janë në një linjë dhe paraqesin karakteristika të përbashkëta, si nga materiali i ndërtimit, edhe përsa i përket teknikës (Fig. 4). Distanca e tyre

Ka gjithashtu informata gojore se mbas çlirimit po në këtë pikë, vullnetarët e rinisë që punonin për hapjen e kanalit të Jubës kanë hasur në qeramikë të vjetër. Monedha paraqet në faqe Shën Markun duke i dhënë flamurin dozhëve dhe në të djathtë: S.M. Veneti. Datohet ndërmjet viteve 1275 e 1280; Papadopuli, *Le monete di Venezia, Venezia* 1893, f. 118.

⁶⁵ Nuk kam përfshirë këtu zbulimin e një kishe në afërsi të Plazhit, që mendojmë se i përket më tepër periferisë së qytetit.

⁶⁶ J.G. Hahn, *Studime shqiptare*, (përkthim në Arshivën e Institutit të Historisë të Tiranës) A-III-6), f. 118-119.

⁶⁷ L. Heuzey, H. Daumet, vep. cit.

⁶⁸ F. Miraj- H. Myrto, “Ujësjellësi antik i Durrësit”, Artikulli dorëzuar në “Iliria”; kumtesë në sesionin shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Dhjetor 1976, dhe “Tuneli i ujësjellësit antik të Durrësit”, në «Shkenca dhe jeta» nr. 6, 1979.

nga njëri-tjetri rregullisht është 70 m (që bëjnë 240 këmbë dy aktus).⁶⁹



Fig. 4

III. ZONA KODRINORE E SHIJAKUT

SHIJAK

37. PREFËSE STRALLI

Në faqen juglindore të kodrës së Shijakut, ku është ndërtuar depozita e ujës-jellës, janë gjetur një thikë dhe një kruese stralli me retushim.

Me një gjurmim provë, që u organizua një vit më pas në atë pikë nga ana e Muzeut Arkeologjik të Durrësit, nuk u has ndonjë shtresë apo objekt i kulturave prehistorike.⁷⁰

⁶⁹ Shih Plini, Nat, hist., XXXI., 31 dhe XXXVI, 24.

⁷⁰ Gjurmimi u drejtua nga F. Tartari, asistoi dhe autori i këtij shkrimi. Raporti ruhet në Muzeun Arkeologjik të Durrësit.

Veglat prej stralli të Shijakut kanë ngjashmëri të plotë me objekte të tilla të zbuluara në stacionet neolitike të Maliqit⁷¹ dhe të Cakranit.⁷²

38. RELIEVI HERAKLIUT (Fig. 5)⁷³

Është zbuluar në vitin 1950 rrëzë përroit të Gjyshit, me rastin e rihapjes së një pusi. Monumenti tani ruhet në Muzeun Historik të Shijakut.



Fig. 5

Është një pllakë guri gëlqeror në formë trapezi, e profiluar në bazë për të krijuar një mbështetëse. Gjatësitë e bazave janë respektivisht 20 dhe 16 cm, lartësia 25 cm.

Mbi të është gdhendur në relief të lartë figura lakuriq e një burri. Ai qëndron në këmbë, në profil, me gjoksin përballë dhe me këmbën e majtë të nxjerrë përpara. Krahun e djathtë e ka të ngritur mbi kokë, kurse të majtin të shtrirë përpara. Duket se, si në dorën e djathtë edhe në të majtën, ai mbante nga një objekt, që janë thyer. Është thyer dhe mungon edhe pjesa e

⁷¹ F. Prendi, Art. cit., «Studia Albanica» 1966, 1; Tiparet e neolitit të vonë në Shqipëri në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike, (Kultura e Maliq-Kamnikut), St. hist. 1972/2, f. 83.

⁷² M. Korkuti - Zh. Andrea, Vendbanimi neolitik i Cakranit, «St. hist». 1972/2, f. 147.

⁷³ M. Zeqo H. Myrto, Një monument me figurën e Herakliut dhe me mbishkrim arkaik, «Bashkimi», «Adriatiku», 14 Shkurt 1980.

përparame e fytyrës. Megjithatë duket se ka qënë me mjekër të shkurtër dhe flokët i ka pasur të lidhura ndoshta me një kordele.

Përpara figurës, poshtë dorës së majtë, ka një mbishkrim nga lart poshtë, të realizuar me gërvishje në alfabetin arkaik të Korinthit.

Π Β Δ Υ Κ Α Λ Ο Μ
Τ Θ Σ Η Β Δ Α Κ Λ Ο Μ

Një mbishkrim i realizuar po në këtë mënyrë vërehet edhe në kornizën e profiluar të bazës:

Β Σ Μ Τ Σ Α Σ Ο ..

Korniza ka një thyerje në vendin e një shkronje dhe shkronjat e fundit paraqiten shumë të fshira. Figura mendojmë se duhet identifikuar me Herakliun. Në një pozicion të përafërt e shohim Herakliun të figuruar në luftim me Gerionin në një kupë të Eufronit të fundit të shekullit VI p.e.s. (Mynyh).⁷⁴ Por edhe më tepër ngjashmëri vërehet me një vizatim në një vazo etruske me mbishkrim, ku është paraqitur me mëzdrakun të ngritur mbi kokë dhe me krahun të zgjatur përpara, në një pozicion identik të krahëve me këtë që shihet në figurën tonë.⁷⁵ Pozicioni i Herakliut, me këmbët të hapura dhe me një dorë duke tendosur harkun përpara, ndërsa me tjetrën duke mbajtur mëzdra-

⁷⁴ E. Bucher, *Griesische Vasenmalerei*. Munchen 1925, f. 100 dhe Georges Nicole, *La peinture des vases grecs*, Paris et Bruxelles 1926, f. 23.

⁷⁵ Z. Majani, *Fundi i misterit etrusk*, Tiranë 1973, f. 211.

kun mbi kokë, është i njohur në periudhën arkaike edhe në shek. V p.e.s.⁷⁶

Mbishkrimi para figurës mendojmë se duhet lexuar: περικαλλος τοῦ Ἡρακλέος dhe siç duket duhet marrë si një përshëndetje falenderimi drejtuar gjithëmirësisë së Herakliut. Në mbishkrimin e poshtëm dallojmë vetëm një emër njeriu, që mund të jetë dedikuesi, Ιστατος. . .

Objekti jemi të mendimit se është një ex-voto⁷⁷ dhe duhet datuar në shekujt VI-V p.e.s.

Zbulimi i këtij monumenti në pastokën e afërt të Durrësit, koloni e Korintit dhe e Korkyrës, nga njëra anë është i shpjegueshëm me vetë faktin që në autorët e lashtë themelimin e këtij qyteti e gjejmë të lidhur me emrin dhe bëmat e Herakliut,⁷⁸ si dhe me faktin e njohur në jetën e Herakliut që flet për zbritjen e tij në tokën ilire.⁷⁹ Nga ana tjetër përhapja e kultit të Herakliut qoftë edhe 12 km në brendësi të tokës ilire, ta zemë që në shekullin e VI p.e.s., nuk mund të jetë thjeshtë si pasojë e ndikimit helen; mendojmë se do të ishte më e arsyeshme në këtë rast të kemi të bëjmë me një adoptim të kultit helen të Herakliut ndaj një hyu vendas me attribute të përafërta.

Si mbishkrim arkaik, ky mund të quhet i pari i zbuluar në Durrës me rrethinat e tij. Gjetja e këtij mbishkrimi në brendësi

⁷⁶ Ch. Daremberg et E. Saglio, *Diactionnaire des antiquités et romaines* Paris 1887 (Shih Hercules).

⁷⁷ Njihen mbishkrime e relieve apo statuja antike të gjetura në burime uji e kroje që i shprehin mirënjohje Herakliut, nimfave dhe Eskulapit (shih Daremberg et Saglio, vep. cit., s.v. Aquae).

⁷⁸ Tukididî, 1, 24, 2; Straboni VI, 269; Apiani, *Bel. civ.*, 11, 39.

⁷⁹ Apollodori, *Bibliotheca*, f. 75, II, 114 (5, II, 3).

të vendit flet për një nivel të lartë të zhvillimit kulturor dhe sinjalizon për të dhëna premtuese në sqarimin e jetës së ilirëve që jetonin në afërsi të Dyrrahut, dhe të marrëdhënieve të tyre me qytetin e madh, koloni të bregdetit.

TEREZIE

39. VARREZË ANTIKE

Në fshatin Terezie, pranë Shijakut, mbi kodrën e Tales janë hasur varre antike. Në to janë gjetur një ketyle dhe një kupë me vernik të zi, që ruhen në Muzeun Historik të Shijakut.

KËNETË

40. MBETJE TË NJË NDËRTESE ANTIKE

Mbi një kodrinë të rrumbullakët, në bregun lindor të rezervuarit të fshatit Kënetë (një orë e gjysëm nga Shijaku) nga punimet bujqësore kanë dalë në sipërfaqe mbeturina që dëshmojnë për ekzistencën e një ndërtese antike. Gjurmët e themeleve të japin idenë e një planimetrie drejtkëndëshe 60 x 40 m.

Në majën e kodrinës (siç duket një cep i mbetur i ndërtesës) vërehet një grumbull gurësh shtufi me formë pak a shumë të rregullt dhe pranë tyre fragmente tullash e tjegullash karakteristike për shekujt e parë të erës sonë.

Na u tha se në vend janë nxjerrë 8 pllaka të mëdha drejtkëndëshe pragjesh. Njëren prej tyre e gjetëm në afërsi. Ajo është prej guri gëlqeror e lëmuar dhe ka përmasat 1.60 x 0.33 x 0.10 m. Në qendër është e pajisur me një gropëz të vogël, po ashtu dhe në njëren nga anët e ngushta, ku ruhen gjurmë plumbi.

HARDHISHTË

41. GJURMË RRËNOJASH ANTIKE

Brenda territorit të këtij fshati, që shtrihet në të djathtë të Erzenit, rreth 5 km në lindje të Shijakut, gjurmë ndërtimesh antike ruhen në dy pika. Njëra nga këto ndodhet në fushë, jo më tepër se 200 m në veri të qendrës së sektorit të kooperativës. Këtu para disa vjetësh nga hapja e një kanali doli një trakt muri i ndërtuar me tulla e llaç. Muri ka drejtimin lindje-perëndim dhe një gjerësi prej 0.60 m. Tullat dhe llaçi duken të shekujve të parë të e. s.

Pika tjetër ndodhet në lindje të shkollës tetëvjeçare, në faqen «Lakuqe» të kodrës Breggjeta. Edhe këtu shihen fragmente tullash e tjegullash të shekujve të parë të e.s.

42. VARR I NDËRTUAR ME TULLA

Në oborrin e shkollës 8 vjeçare të fshatit, që ndodhet mbi një bregore jo larg bregut të Erzenit, me kohë mësuesve u kishte tërhequr vëmendjen dukja në sipërfaqe e një konstruksioni me formë katërkëndëshe, ndërtuar me tulla. Me një sondazh që kryem aty në verën e vitit 1980, u sqarua se ai konstruksion ishte një varr i madh, i rrënuar në pjesën e sipërme dhe i grabitur (Tab. IV).

Varri ka këto përmasa të jashtme: gjatësi 3.10 m, gjerësi 2.05 m dhe lartësi (në gjendjen që u gjet) 1.35 m. Muri i tij nga të katër anët është i ndërtuar me tulla të plota katërkëndëshe (29-30 x 23-24 x 3.5-4 cm) dhe gjysmëtullash. Këto janë vendosur në rreshta të rregullta horizontale dhe janë lidhur me llaç të fortë, të gatuar me gëlqere dhe rërë të trashë lumi. Trashësia e mureve

është 0.40 m. Në pjesën e poshtme të faqeve të tyre të jashtme vërehen dhe copëra tjegullash e tullash të ngjitura në mënyrë të rrregullt dhe me shumë llaç.

Arka e varrit është 2.30 m e gjatë, 1.43 m e gjerë dhe (në gjendjen e mbetur) 0.55 m e lartë (Tab. IV, b). Ajo u gjet e mbushur me dhe në ngjyrë të errët, ndryshe nga dheu argjilor jashtë varrit. Brenda në të u gjetën disa kocka njeriu, por në nivele të ndryshme e pa ndonjë sistem, copëra tullash e tjegullash, fragmente enësh balte (Tab. IV, c), një fragment i vogël shisheje qelqi e thëngjij. Një kupë e vogël u gjet pothuaj e plotë. Në një fund amfore u gjet një lëndë e mpiksur si dyll.

Karakteristikë e veçantë e këtij varri është dyshemeja me një konstruksion solid dhe me një trashësi të jashtëzakonshme, prej 0.80 m. Në të është aplikuar një teknikë e rrallë, që alternon disa shtresa (Tab. IV. a). Shtresa e sipërme me trashësi 0.13 m është prej llaçi të fortë gëlqereje të përzier me copëra të vogla tullash e tjegullash të shtypura. Në tërë anën e poshtme ajo ka një shtresë prej copa të vogla tjegullash me pak distancë nga njera-tjetra, që janë të ngjitura pjerrtas pas saj. (Një rast i ngjashëm është parë edhe në dyshemetë e termave të Ad Quintum).⁸⁰ Të vendosura në këtë, ato krijojnë ndaj shtresës tjetër, që vjen poshtë, një shtresëz ndarëse prej xhepush të vegjël. Ngjitur në copat e tjegullave vërehet një lloj gëlqereje e pastër me ngjyrë të bardhë në krem.

Shtresa e dytë që vjen më poshtë, konsiston nga dy shtroje tullash me përmasa si ato të mureve, por me ngjyrë më të kuqe.

⁸⁰ N. Ceka, Ad Quintum, «Iliria» VI. 1976, f. 290.

Këto janë vendosur horizontalisht, puqur njëra me tjetrën, në tërë gjerësinë e varrit. Shtroja e sipërme ndahet prej shtrojës së poshtme të tullave prej një shtrese llaçi me trashësi sa vetë trashësia e tyre. Të dyja këto shtroje tullash vazhdojnë të shtrihen pa ndërprerje edhe brenda mureve anësore të varrit.

Shtresa e tretë, më poshtë, që ka një trashës prej 0.37 m, konsiston nga një mbushje solide pre gurësh të vegjël përzier me llaç të bollshëm, epus caementicium. Nën këtë vjen një shtresë tjetër me trashësi 10 cm, që ka të njëjtin ndërtim si shtresa e parë. Edhe kjo po ashtu, përfundon nga poshtë me copëra të vogla tjegullash të ngjitura pjerrtas, që kanë pak distancë nga njëra tjetra. Shtresa e fundit me trashësi 0.12 m, është e njëllajtë me shtresën e tretë opus caementicium. Në qendër të dyshemesë ishte lënë një gropëz gjysmësferike me diametër 0.40 m dhe thellësi 0.25 m. (Tab. IV).

Jashtë varrit, në anën verilindore (ku kryem sondazhe), u vërejtën të shpërndara deri 2.5 m largësi dhe 0.40 m thellësi, fragmente tullash e tjegullash dhe fragmente enësh balte. Midis tyre u vërejtën fragmente pitosi e amfore, si dhe fragmente terra sigillata, që duket se u përkasin të njëjtave enë si ato që u gjetën brenda varrit. Në këtë anë dolën dhe mjaft blloqe të mëdha guri, që mund t'i kenë përkitur mbulesës së varrit dhe mbistrukturës së tij, në se ka pasur.

Duke u mbështetur në teknikën dhe në materialin e ndërtimit si dhe në qeramikën që u gjet brenda dhe jashtë varrit, mendojmë se ky u përket shekujve II-IV të e.s., së njëjtës kohë me varret e

zbuluara në Durrës, në rrugën e Vilës.⁸¹ Por si formë arkitektonike dhe si përmasa, varre të tillë familjarë në vendin tonë njihen që në periudhën e mëparshme, shekujt IV-I p.e.s.⁸²

Përsa i përket dyshemesë së këtij varri, të ndërtuar me teknikën që përshkruam më lart, mund të themi me rezervë se do të jetë bërë për të izoluar atë prej lagështirës nga ana e poshtme. Kjo ndoshta lidhur me inventarin e veçantë që do të ketë pasur.

MEMJE

43. TRAKTE TË UJËSJELLËSIT ANTIK TË DURRËSIT



Fig. 6

Përkundrejt Hardhishtës, në këmbët e kodrave që zbresin mbi bregun e majtë të Erzenit, në të djathtë të rrugës Romanat-Durrës, ruhen trakte dhe gjurmë të ujësjellësit antik të Durrësit.⁸³

Një trakt i kanalit ujëprurës (Fig. 6) është parë në krahun e djathtë të përroit të Memajt, jo më larg se 15 m nga bregu, i lumit. Ky trakt i zbuluar prej vetë përroit, paraqet paretë të ndërtuara me tulla trekëndëshe 28x14 cm dhe trashësi 3.5 cm. Nga jashtë paretet prej tullash të kanalit janë veshur me një muresë tjetër prej gurësh të

⁸¹ F. Tartari, Arkitektura e disa varreve të shek. II-IV në Dyrrah Monumentet 15-16, 1978, f. 65.

⁸² N. Ceka, Ndërtimet supulkrale të qyteteve ilire, Monumentet 9, 1979, f. 36, 38, 44,

⁸³ F. Miraj

çrregullt të lidhur me llaç. Lartësia e mbetur e kanalit këtu është 0.9 m, gjerësia 0.59m.

Një pjesë e murit të kanalit shihet edhe pranë çezmës së Memajt, në anën e majtë të përroit të Gërrhoit, vetë kjo çezëm duke qënë e adoptuar në një trakt të kanalit të ujësjellësit.⁸⁴

Prerja e plotë e kanalit ujëprurës shihet përballë kësaj çezme, në anën tjetër të përroit. Këtu duket që ky është i mbuluar me një qemer cilindrik. Lartësia e kanalit me gjithë qemerin është 1.35 m.

⁸⁴ Shih dhe Ing. J. Adam, B.SH.SH., 1950, I. 7166




Tabela 1



Tabela 2




Tabela 3




Tabela 4

RESUME

**CARTE DES MONUMENTS DE LA RÉGION DE
DURRËS**

La contrée où nous avons effectué nos recherches constitue justement ce qu'on pourrait appeler l'emplacement authentique de Durrah antique. Il paraît qu'il existe pour cela même une tradition, attestée par des données de la topographie antique: Asparag, petite ville sur Genus (Shkumbin) se nomme "Asparagium Dyrrhachinorum". De même Ishëm dans l'antiquité s'appelle «Isamnus Dyrrhachinorum».

Dans de différentes périodes historiques, les confins du pouvoir politique de Durrës ont été beaucoup plus étroits. De même, il y a eu des périodes historiques, où la région, dont le centre administratif était Durrës, s'étendait loin au delà de ces confins. Mais du point de vue économique c'est la zone dont les liens avec la ville et vice versa ont été conditionnés encore plus par les conditions géographiques.

La zonë d'Ishëm

1. La forteresse de Scanderbeg, construite en 1451, démolie par le Sultan Mehmet II en 1467 et reconstruite en 1500 par les vénétiens.

2. 300 m au Nord-Est de la forteresse, un mur en briques, tuiles et céramique du III^{ème} siècle av. n. è.

3. 1 km au Sud-Est de la forteresse, près du bord de la mer, l'église à nef unique de Saint-Ndue, de planimétrie rectangulaire et aux traits romains et gothiques.

4. Près de l'église, un mur en blocs de pierres sèches.

Shetaj

5. Blocs Shetaj de pierre ponce semi-taillés, fragments de céramique antique.

6. Au bord de la mer, céramique des premiers siècles et blocs de pierre ponce semi-taillés.

7. Ruines de l'église de Sainte-Marie du XIVe-XVe siècles.

8. Stèle de marbre du IIe siècle av. n. è. , scène d'adieu sur le fronton l'inscription:

9. Torse de femme en marbre, vêtue de lithan et d'un gilet.

Draç

10. Deux cionisques-cylindriques du IIe et Ier siècles av.n.è.

11. Fragment de fondation e solens des premiers siècles.

Ishëm

12. Forteresse construite en 1571-1574, 100 x 40 m.

Gjuricaj

13. Sur une superficie de 4 hectares: briques, tuiles, mur briques du IIe IV-e siècles, chapiteau imposte avec croix du V-e VI-e siècles.

Shkafanë

16, 17. Tumulus de 7-10 m de diamètre.

Armath

18. Récipient en bronze du VIIe-VIe siècles av. n. è.

19. Céramique antique, aiguilles en bronze.

20. Monnaie d'Antonin-Piu.

Manëz

21. Marteau en pierre

22. Colonnes de fenêtre, briques, morceaux de marbre, fragments de récipients, mosaïque, église paleocretienne.

Borçë

23. Deux haches en bronze de type albano-dalmate (XII siec. av.n.è).

Rushkull

24. Hache en bronze albano-dalmate.

Rubjek

25. Tombes à inventaire du IVe – IIIe siec. av.n.è

26. Fragments de briques, tuiles, récipients du IVe – Vie siec.

Maminas

27. Fragments de récipients antiques.

Qerret

28. Matériel de céramique, briques, tuiles, récipients amphores, sur une superficie de 6000 m². Traces de constructions du I^{er} et II^e siècles.

Flakë

29. Matériaux de construction du I^{er} et II^e siècles.

Kashar

30. Fragments de briques, de tuiles en plomb, de récipients en verre. Probablement, une construction du I-er siècle.

Sallmonaj

31. Borne kilométrique miliar du milier VIII de la route Dyrrah-Lis.

Shënavlash

32. 22 tombes du V-e – III-e siècles av.n.è. avec inventaire des récipients, monnaies de Dyrrah. Herakli-armes.

33. Fragments de colonne dorique.

34. Monnaie de Venise (1275-1280),

Arapaj

35. Plaque avec l'inscription de la réparation de l'aqueduc de Dyrrah par Alexander Sever.

Arapaj-Rashbull

36. 14 puits de contrôle de l'aqueduc antique placé à 70 m loin l'un de l'autre.

Shijak

37. Outil de silex.

38. Relief d'Héraclès.

Une plaque de pierre calcaire en forme de trapèze profilé à la base afin de créer un appui (20, 16, 25 cm).

Sur elle, en haut relief c'est la figure d'un homme nu debout, vu de profil. Son bras droit est levé au-dessus de sa tête, tandis que le bras gauche de même que dans sa main droite il tenait des objets qui se sont cassés. Bien que le visage de l'homme

manque, on se rend compte qu'il a eu une barbe courte et des cheveux attachés peut-être au moyen d'un ruban. Au-dessous de sa main gauche il y a une inscription allant du haut en bas, gravée en alphabet arcaïque corinthien.

Une inscription réalisée de la même façon s'aperçoit même à la corniche profilée de la base.

La corniche comporte une cassure à l'emplacement d'une lettre et les dernières lettres sont presque effacées. Nous pensons que cette figure doit être identifiée à Héraclès. Il s'agit d'une ex-voto du VI-e - V-e siècle a. n. è.

Terezie

39. Tombes antiques avec inventaire.

Kënetë

40. Fragments de briques et de tuiles du premier siècle de notre ère.

Hardhishte

41. Fragments de mur en briques du premier siècle de notre ère.

42. Tombe en briques du IIe-IVe siècle.

Memije

43. Cannal de l'aqueduc de Dyrrah couvert d'une voûte cylindrique d'une hauteur de 1,35 m.

HARTË E MONUMENTEVE DHE E GJURMËVE ANTIKE E MESJETARE TË RRETHIT TË DURRËSIT¹

Pjesa e dytë

4. ZONA KODRINORE E KAVAJËS

SHKËMBI I KAVAJËS (PETRA)

44. Mbetje ndërtimesh antike e mesjetare

Kjo është pika më veriore e kodrave të Kavajës. Kodra këtu përfundon me një shkëmb të lartë në breg të detit, që ka faqe të thikta në anën perëndimore dhe jugore. Shpina e Shkëmbit të Kavajës, megjithëse e vogël, por deri diku e dystë dhe e butë, do të lejonte në të ndonjë ndërtim.

Ky vend strategjik në burimet antike njihet me emrin Petra². Ky duket se është dhe pozicioni i kishës së Shën Nikollës, që përmendet në mesjetë lidhur me luftërat normano-bizantine në territorin e Shqipërisë³. Edhe më pas, në Atlantin e Kamocios (1571), gjejmë të shënuar në juglindje të gjirit të Durrësit një

¹ Marrë nga revista "Monumentet", NR. 1, 1982, f. 11-40.

² Caes., B. Civ., III, 42, 1; Lucan, Phars, VI, 101-102. Shih për këtë identifikim L. Heuzey-H. Daumet, La mission archéologique de Macédoine, Paris 1876, f. 367.

³ A. Comnene, Alex., V. 390. Shih për këtë dhe A. Ducellier, La façade maritime de l'Albanie au moyen âge, Thessaloniki, 1981, f. 35.

kishë me emrin «S. Nicola», ⁴ që përsëri mund të identifikohet me pozicionin e Shkëmbit të Kavajës. Në Petra e vendos kishën e Shën Nikollës edhe Gulielmi i Pulies⁵. Po ashtu, këtë mendojmë se ka parasysh edhe Barleti kur bën fjalë për kripore të ndodhura «ndërmjet një mali e vendi, i cili nga njera anë e ka emrin Selitë, nga tjetra Shën Nikollë, vend shumë i njohur për shkrepat, por edhe i palavdi për rrethimin e dikurshëm dhe fatin e senatit romak»⁶

Në shpatin jugor të Shkëmbit kemi vërejtur një sasi të madhe fragmentesh qeramike antike, të dala në sipërfaqe nga rrëshqitja e dheut. Ato janë kryesisht fragmente kaliptheresh të harkuara, disa me shpinën të lyer me një bojë të kuqe, si dhe fragmente enësh me vernik të zi e kafe.

Më 1973 në qafën që lidh shpinën e butë të Shkëmbit me kodrën prapa, u krye një sondazh dhe u zbulua qeramikë e periudhës qytetare ilire, e shekujve të parë të e.s. dhe qeramikë mesjetare, por jo mure. ⁷ Materiali që provon për mbetje të një ndërtese gjendet më lart, pikërisht mbi shpinën e Shkëmbit. Këtu në një sipërfaqe prej rreth 700 m² shihen të shpërndara fragmente të shumta tullash e tjegullash. Tullat, që kanë një trashësi prej 4 cm, kanë qënë të lidhura me llaç gëlqereje gatuar me rërë të trashë, që formonte fuga horizontale të barabarta me trashësinë e tullave. Fragmentet e tjegullave përfaqësojnë dy tipe: të

⁴ Atlante del Camozio (1571); Citta, forteze ed altri luogi dell' Albania, Epiro e Livadia, Venezia, 1704, nr. 33

⁵ G. Apulus, IV, 459.

⁶ M. Barleti, Historia e Skënderbeut, Tiranë, 1964, f. 100.

⁷ F. Tartari, Lëndë arkeologjike nga Petra (Shkëmbi i Kavajës) në «Buletin Arkeologjik» nr. 3, Tiranë 1975, f. 39; Petra, «Iliria» VI, 1976, f. 350

harkuara dhe të sheshta, me buzë pak të kthyer dhe që përshkohen në faqe nga brazda të bëra me gishta para pjekjes. Këtu kemi gjetur dhe një fragment kolone mermeri të bardhë me rremba gri, me gjatësi 0.80 m dhe diametër 0.45 m.

Ka të dhëna gojore se kohë më parë këtej është marrë material për ndërtimin e kishës së Shën Nikollës në Kavajë. Vendasit ruajnë për këtë pikë mikro-toponimin «Kisha». Ky është pikërisht vendi, mendojmë, ku duhen kërkuar mbetjet e kishës së Shën Nikollës, e përmendur këtu, siç e thamë, që në shekullin XI.

GOLEM

45. VARREZE E SHEKUJVE TE PARE TE ERES SONE

Para 20 vjetësh në parkun para shkollës së mesme bujqësore të Golemit, në thellësinë rreth 1 m, dolën varre me tjegulla në formë çatie.⁸

SEFERAJ

46. ALTAR VARRI ME MBISHKRIM

Fshati Seferaj ndodhet mbi kodrat e veshura me ullinj e pemë të tjera frutore në lindje të Golemit. Këtu, në «Bregun e Qishës», para shumë vjetësh janë zbuluar varre që përmbanin si inventar enë balte. Në fundin e këtij bregu është gjetur dhe një altar varri me mbishkrim latin.⁹

⁸ Në muzeun e Durrësit ruhet një koleksion veglash bujqësore me prejardhje nga kjo varrezë. Në gjetjet bën pjesë dhe një fibul me këmbë të përthyer, e shekujve IV-VI (S. Anamali-F. Prendi, “Vazhdimësia e kulturës ilire në kulturën e hershme mesjetare shqiptare”, (“Konf. e Parë e Studimeve Albano-logjike (1962)”, Tiranë 1965, f. 471).

⁹ H. Ceka-S. Anamali, Mbishkrime latine të pabotuara të Shqipërisë «B.Sh.Sh.» 1, 1961, f. 117-118; H. Myrto, Mbi disa qendra arkeologjike ndërmjet Kavajës dhe Durrësit, «Monumentet» 7-8, f. 249.

TILAJ

47. VARREZA ANTIKE

Në këtë fshat kodrinor, mbi Golem, është evidentuar një varrezë që ka dhënë materiale të shekujve V-II p.e.s.¹⁰.

48. MBETJE TE NJE NDERTESE ANTIKE

Në vendin e quajtur Vrap është zbuluar një pjesë dyshemeje me mozaik prej copërash tulle të thyera (rreth 3x3x2 cm)¹¹

KANAPARE

49. MBETJE RRËNOJASH TË NJË KISHE DHE NJË VARREZË MESJETARE

Mbi një kodër të rrumbullakët, kurrizi i së cilës zbret butë nga ana e veriut, ndërsa bie thikë nga tri anët e tjera, ruhen në sipërfaqe mbeturina themelesh të ndërtuara me gurë të çrregullt e llaç gëlqereje. Pak më poshtë këtyre rrënojave gjatë ndërtimit të rrugës së re të fshatit u hasën varre. Shumica e tyre duket se ka qënë pa konstruksion. Por ka pasur edhe një pjesë që ishin të mbuluar me tjegulla. (Tab. 1). Për datimin e kësaj varreze dhe si pasojë edhe të mbeturinave të rrënojave të kishës pranë saj, siç njihet nga mikrotoponimi,



Fig. 1

¹⁰ Materiali është kryesisht qeramikë dhe përfaqësohet nga skyfosa me vernik të zi të shkëlqyeshëm, të datuar në shekujt V-IV p.e.s. si dhe pjata me buzë të kthyer nga jashtë, amfora, skyfosa e peshore të shekujve IV-II p.e.s (A. Hoti, Rezultatet e kërkimeve arkeologjike në zonën e Kryemëdhenjve të rrethit të Durrësit, kumtesë në sesionin shkencor të muzeut arkeologjik të Durrësit, 1979).

¹¹ A. Hoti, Po aty,

ndihmon gjetja në një varr e një vathi bronxi (Fig. 1) i përafërt me vathë të gjetur në vise të tjera të Ballkanit¹² dhe të Europës Qendrore¹³, që u takojnë shekujve X-XII.

SPANJO

50. GJURME NDERTIMI ANTIK

Tek Kodra e Qenze (ose dhe Kodra e Qytezës) shihen në sipërfaqe fragmente të shumta tullash dhe tegjullash të periudhës helenistike. Midis tyre kemi gjetur një fragment soleni me emrin e prytanit Γαῖος.¹⁴

ZIG-XHAFAJ

51. VENDBANIMI I FORTIFIKUAR ILIR

Njoftimet e para për një fortesë të vogël në katundin Zig-Xhafaj i kemi prej Leon Hezeit; këtë ai e shënon «akropol helenistik» dhe nuk jep hollësira të tjera.¹⁵ Ky fshat ndodhet katër kilometra në verilindje të Kavajës mbi kurrizin e kodrave që vijnë drejt veriperëndimit. Për herë të parë këtë qendër e kemi vizituar në vitin 1972.¹⁶

Nga vëzhgimi i mbetjeve në vend dhe i terrenit duket se pjesa më e lartë e kodrës së Zig-Xhafajt (239 m mbi nivelin e detit) ka qënë rrethuar me mure mbrojtëse në anën veriore, perëndimore dhe jugore. Nga ana e lindjes, e veriut dhe e veriperëndimit ajo

¹² N. Milatic, Elementi della cultura di Koettlach in Bosnia e Erzegovina, «Balcano-slavica», 6, Beograd 1978, f. 98, 99.

¹³ L. Niederle, Rokovset Slavaskych Starzitnest, Pragë, 1953, f. 357-359.

¹⁴ H. Myrto, vep. cit., f. 249.

¹⁵ L. Heuzey-H. Daumet, vep. cit. dhe L. Heuzey, Operations militaires de Jules Cesar, Paris 1866 (shih hartën).

¹⁶ H. Myrto, vep. cit. f. 247-49, fig. 1, 2, 3 dhe tab. II, III.

zbulon shpate shkëmbore mjaft të pjerrëta. Në një trakt muri të mbetur, si dhe në gjurmë të tjera të tij që vërtetohen, vërehet se ka elemente që e bashkërendisin këtë fortifikim me tipe të tilla ndërtimesh të periudhës qytetare ilire, të shekujve IV-II p.e.s. Në disa fragmente solenesh të gjetura këtu kemi lexuar emrin e prytanit eponym dyrrahas, Ἀριστόδαμος.¹⁷⁾

Nga vrojtimet tona dhe materiali arkeologjik i grumbulluar aty, kemi nxjerrë si përfundim se në Zig-Xhafaj gjatë shekujve IV-II p.e.s. ka ekzistuar një qytezë ilire, që siç duket ka shërbyer si vendbanim, qendër administrative dhe vendstrehim, në raste luftërash, për banorët e zonës përreth. Me pozicionin e saj gjeografik, kjo fortesë kontrollonte dhe një nga kalimet e lehta prej fushës së Kavajës për në luginën e Erzenit e Ndroq.

ÇETË

52. KISHA MESJETARE E SHEA PREMTES

Këtë kishë (fig. 2) që është i vetmi monument i ruajtur tërësisht në këmbë i arkitekturës romaniko-gotike në vendin tonë, duke u nisur nga rrethanat historike, A. Meksi e daton në gjysmën e dytë të shekullit XIII, kur pas pushtimit anzhuin, në Durrës u vendosën peshkopë katolikë.¹⁸ Një kohe të mëvonëshme siç duket i përkasin afresket me mbishkrime në gjuhën greke që ruhen në të.

¹⁷ Njihen monedha të Dyrrahut me emrin e këtij prytani eponym, që u takojnë viteve 250-200 p.e.s. (H. Ceka, Datimi i drahmeve të Dyrrahit e Apollonisë, "Studime historike" 1956, III, f. 33; Thesari i Jubicës, "Iliria" 1, 1971, f. 88; Le trésor numismatique de Bakerr, «Studia Albanica» 1972, f. 52.

¹⁸ A. Meksi, "Dy monumente mesjetare të Kavajës", kumtesë dorëzuar në muzeun etnografik të Kavajës, (e pabotuar).

Kisha përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambienti i altarit. Ambienti i altarit ka qënë i pajisur me një ikonostas druri me ikona të piktorit Kostandin Shpataraku.



Fig. 2

53. VARREZA ANTIKE

Rreth 700 m në jug të kishës, te kodra e Varreve, shihet qeramikë e periudhës romake, e dalë në sipërfaqe nga veprimi i përroit dhe nga hapja e rrugës së re. Pak më poshtë kësaj pike buzë rezervuarit, nga hapja e një kanali, kanë dalë dy varre të mbuluar me tjegulla të harkuara, me orientim lindje-perëndim.

Në altarin e kishës është gjetur dhe një stelë varri me tri figura njerëzish në relief dhe me mbishkrim latin, që tani ruhet në muzeun arkeologjik të Durrësit¹⁹.

¹⁹ F. Miraj, Stelë varri e fshatit Çetë, «Adriatiku», 30 Korrik, 1981.

MENGË

54. SHPELLA KARSTIKE

Rreth 12 km në juglindje të Kavajës shtrihet një brez i ulët kodrinor me përbërje shkëmbinjsh gipsorë, ku njihen katër shpella karstike, tri pranë fshatit të Menges dhe një tjetër 2-3 km më tej, në Zikular.²⁰

Këto përbëhen nga galeri horizontale dhe përshkohen në taban nga rrëke uji. Gjerësia maksimale e tyre arrin 4-7 m, ndërsa lartësia 3 deri 4 m. Vende-vende galeria paraqitet mjaft e ulët dhe e ngushtë. Në raste të tjera ajo përmban xhepa me përmasa më të mëdha. Në dy prej tyre kemi mundur të hyjmë 100-150 m.²¹ Brenda jemi ndeshur me pamjen e bukur të stalaktiteve.

Pranë njerës, e quajtur Shpella e Kripës, gjendet një burim nga del ujë i kripur. Aty, në faqen e një sopi jo të lartë, nga rrëshqitja e dheut kanë dalë fragmente të një qeramike të rëndomtë mesjetare. Pranë Shpellës së Gipsave, në vendin e quajtur Merhoraj, shihen në sipërfaqe fragmente tjegullash të shekujve të parë të e.s.

LIS-PATROS

55. MBETJE TË NJË FORTIFIKIMI ILIR

Në krye të së përpjetës që duhet të ngjitet udhëtari për të arritur nga Menga në fshatin kodrinor të Lis-Patrosit, ekziston një vend i quajtur Paraporta e kalasë. Pak më poshtë këtij vendi dhe në

²⁰ H. Myrto, Shpellat karstike të Menges, «Adriatiku», 11 Janar 1979 dhe 31 Janar 1982.

²¹ 20. Në ekspeditë merrnin pjesë F. Tartari, F. Shaka dhe autori.

një drejtim me vijën e kreshtës shkëmbore që i qëndron si parapritë këtu majës së lartë (398 m mbi nivelin e detit), aty ku është hapur rruga e re, kemi vërejtur blloqe gurësh të latuar, kuadratikë (1.30x0.50x0.40 m dhe 0.28x0.38x0.40m). Këto blloqe duket se përfaqësojnë këtu mbeturina të një muri 15 m të gjatë, që mbyllte kalimin, duke lënë të lirë rrëzë shpatit një hapësirë prej 2 m, në të cilën vërehet kalldrëm. Nga pjesët e mbetura, duket se kalldrëmi ka qënë i shtruar me gurë e plloça.²²

Përreth shihen fragmente qeramike antike, si fragmente solenesh të tipit helenistik. (Tab. II), fragmente pitosi e amfore.

Dyqind metra më poshtë, shtegu që i ngjitet kësaj majëkodre duket se është ndërprerë përsëri nga një mur, që linte kalim siç duket vetëm për kalldrëmin e përmendur. Muri ka mbetur në një gjatësi prej 4 m dhe lartësi 0.50 m. Ai është ndërtuar me dy këmishë prej blloqesh gjysmë të punuar dhe me hapësirën midis tyre të mbushur me gurë të vegjël e mesatarë. Gjerësia e tij është 2.20 m. Pranë vërehen përsëri fragmente solenesh dhe fragmente pitosi.

Në fasadën e një shtëpie më lart, në fshat, kemi parë një bllok guri të latuar, kuadratik (0.90 x 0.30 x 0.25 m). Në faqen e dukshme të tij është gdhendur shkronja Θ (Fig. 3). Na thanë se guri është marrë nga muret e sipërpërmendur, që kohë më parë ruheshin në një lartësi të dukshme.

Nga këto të dhëna, jemi të mendimit se këtu kemi të bëjmë me mbeturina muresh fortifikues të tipit "barrierë". Funkcioni i tyre, mendojmë ka qënë për të siguruar mbrojtjen e pjesës së

²² Në Menge një trakti të tillë kalldrëmi i thonë Vrom. Fjala «vrom» në leksikun e zonës do të thotë rrugë fshati, shteg, në një vend të dystë.

sipërme të kodrës, ku është fshati, nga ndonjë rrezik që mund t'i kanosej nga poshtë dhe, po ashtu, për të bllokuar një nga kalimet prej fushës së Kavajës për në zonën e Pezës. Koha që i përkasin mendojmë se është ajo e shekujve IV-II p.e.s.



Fig. 3

56. GJURMË NDËRTIMI

Në njërën nga shtëpitë që ndodhen pikërisht në syprinën e kësaj kodre, ruhet një kapitel (Fig. 4). Vendgjetja e tij i përket një pike pranë, ku vërehen gjurmë ndërtimi: një pjesë e vogël muri (me gjerësi 0.50 m) ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje, si dhe fragmente tjegullash solene me buzë pak të harkuara. Ato përfaqësohen këtu nga fragmente të vogla, megjithatë në të dallohen vija të bëra me gishta para pjekjes.

Kapiteli është prej guri gëlqeror (B. 29 x 29 cm; diam. i b. 21 cm dhe L. 32 cm). Ai është zbukuruar me dy radhë prej tetë gjethesh akanthi secila dhe me voluta në katër cepat. Gjethet duket se janë të tipit me gjëmba të mprehtë. Në punimin e tij është përdorur turjela. Nga këto karakteristika jemi të mendimit se i përket antikitetit të vonë, shekullit V të e.s.



Fig 4

57. MBETURINA TË MANASTIRIT TË PETRAS

Rreth 3 km nga kjo pikë, në një luginë të pyllëzuar me shkurre, pranë një përroi të thellë, vërehen rrënojat e manastirit të Petras. Në gjendjen e tanishme, të mbuluar me ferra, ato duket se shtrihen në një sipërfaqe prej 200-300 m².

Në vend shihet një trakt muri me drejtimin jug-veri, i gjatë 2.40 m, i gjerë 1.10 m, i lartë 1 m. Muri është ndërtuar me gurë shtufi të vegjël dhe me madhësi mesatare, të lidhur me llaç gëlqereje. Gurët janë vendosur në rreshta gati të rregullta, me ndërfitje fragmentesh tulle e tjegulle.

Fragmentet e tullave janë prej një balte rozë, me trashësi 3.5-4.8 cm. Një tullë jo e plotë drejtkëndëshe ka përmasat 13x3.5 cm.

Emri i sotëm i fshatit Lis-Patros duket se vjen nga emrat e fshatrave Ilias dhe manastiri i Petras, të përmendur që në shekullin XV.²³

²³ H. Inalçik, Hiçri 835 Suret-i Defter-i-Sancak-i Arvanid, Ankara, 1954, nahija e Tomonishtës. Shih për manastirin e Petros edhe F. Cordignano, *Geographia Ecclesiastica d'Albania*, Roma, 1934, f. 260 (36).

MLIK

58. GJURMË TË NJË FORTIFIKIMI ILIR

Një vendbanim i vogël antik, që ruan gjurmë fortifikimi është vërejtur edhe në fshatin Mlik, rreth 15 km në juglindje të Kavajës. Kodra e Qishës në afërsi të këtij fshati që kufizohet nga përrenj e gryka të thella, ka formë pak a shumë piramidale dhe arrin lartësinë 447 m mbi nivelin e detit. Maja e saj, me ndonjë shesh apo teracë të vogël, që ka një sipërfaqe prej 0.7 ha mbrohet nga veriperëndimi prej një kreshte të thepisur shkëmbore (Fig. 5). Në anën jugore e juglindore të saj, në një vijë që ndjek konturn e terrenit, vërehen të shpërndara blloqe të mëdha gurësh.



Fig. 5

Në anën veriore që është e pyllëzuar dendur me shkurre, mund të ndiqen me vështirësi mbeturinat e një muri pothuaj të rrafshuar, me gjatësi rreth 100 m dhe gjerësi mbi 2 m, që i afrohet nga perëndimi kreshtës shkëmbore. Tek ky mur janë përdorur gurë të çrregullt me madhësi të vogël e mesatare. Tre grumbuj të mëdhenj gurësh që shtrihen në distanca 30 m njëri nga tjetri, anash linjës së këtij muri, nga jashtë, logjikisht i kemi marrë për mbeturina kullash.

Hyrja më e lehtë brenda këtij territori gjendej nga ana lindore, nga ana e fshatit të sotëm të Mlikut. Një portë natyrale në shkëmb e rregulluar edhe nga dora e njeriut, gjendet në krahun jugor të kreshtës shkëmbore.

Qeramika përfaqësohet kryesisht nga tjegulla dhe tulla të shekujve IV-II p.e.s. (Tab. II). Shihen gjithashtu edhe fragmente pitosash, amforash dhe enësh të vogla balte me vernik të zi, kafe e të kuq.

Në të njëjtën kohë këtu bie në sy dhe material ndërtimi i shekujve të parë të e.s. si dhe i antikitetit të vonë, shekujt V-VI të e.s., siç janë tjegullat e sheshta me buzë të harkuara në formën e quajtur «kokë zogu» e të zbukuruara në sipërfaqe me tufa vijash të valëzuara e zig-zake.

Nga këto të dhëna jemi të prirur që në shekujt IV-II p.e.s. këtë majëkodre ta konsiderojmë të fortifikuar dhe të rifortifikuar përsëri në periudhën e vonë antike. Në pjesën më të sipërme të vendit ruhen mbeturina themelesh të ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje. Këtë pikë vendasit e njohin me emrin «Muret e Qishës».

5. ZONA FUSHORE E KAVAJËS

QERRET

59. MBETJE TË NJË KISHE ANTIKE E VONË DHE MESJETARE

Në të djathtë të rrugës automobilistike Golem-Kavajë, përballë Malit të Robit (kuota 62 m), në fushë, rreth 700 m nga buza e detit, në një sipërfaqe të gjerë (fig. 6) gjenden fragmente materiali ndërtimi dhe enësh balte. Materiali i përket kryesisht antikitetit të vonë dhe mesjetës. Megjithatë vihet re edhe qeramikë e

shekujve të parë të e.s., e përfaqësuar sidomos nga fragmente tullash e tegullash (Tab. II)²⁴



Fig. 6

Duke u nisur nga mbeturinat e themeleve, detajet arkitektonike dhe nga të dhëna të tjera, kemi shfaqur mendimin se këtu ruhen rrënojat e një kishë paleokristiane me vazhdimësi deri në mesjetën e mesme dhe se ky është vendi i kishës së Shën Todrit që përmendet në shekullin XI.²⁵

Pranë kësaj pike, me rastin e ndërtimit të rrugës së re Durrës-Kavajë më 1901, janë zbuluar themele muresh dhe është gjetur një thesar i vogël.²⁶

²⁴ H. Myrto, vep. cit., f. 250-252.

²⁵ H. Myrto, Po aty. Përsa i përket themelit në formë gjashtëkëndëshi, që në rastin e parë e kemi marrë si themel të një baptisteri të veçuar nga kisha, nga një hetim më i imët, kemi ndryshuar mendim: ky themel duhet t'i përkasi vetë absidës së kishës.

²⁶ L. Rey, Répertoire topo-bibliographique des antiquités de l'Albanie «Albania», 1932, 4.

60. GJURMË TË RRUGËS "EGNATIA"

Nga vendi i quajtur Qisha» e Qerretit deri tek përroi i Fosës në drejtim të Kavajës, në një distancë prej 4-5 km, mund të ndiqen gjurmët e një rruge të lashtë të shtruar me kalldrëm. Për këto gjurmë kemi shfaqur mendimin se i përkasin rrugës Egnatia²⁷

RRAKULL

61. TRAKT MURI ANTIK

Në të majtë të rrugës që të çon në Karpën, në thellësinë 1.5 m, është zbuluar një trakt muri i ndërtuar me blloqe të mëdhenj kuadratikë (0.80 x 0.50 x 0.35 m dhe 0.50 x 0.40 x 0.30 m). Disa prej tyre në njerën faqe paraqesin gjurmë llaçi. Lartësia e pjesës së zbuluar të murit është 1 m, kurse gjerësia 0.60 m.

Mbi murin u gjetën fragmente tullash e tjegullash të shekujve të parë të erës sonë, vegjë e funde amforash dhe fragmente enësh të vogla me vernik të kuq e kafe, po ashtu dhe një kosore hekuri.

KRIPORE

62. DEPUA E KRIPËS

Në Atlantini e Kamociës gjejmë të shënuar në të njëjtin drejtim ku ndodhet sot Kriporja e Kavajës, fjalën «Saletta».²⁸ Sot këtu është ende në këmbë Godina e vjetër e depos së kripës (Fig. 7) Mbi portën e saj ruhet një mbishkrim turqisht tepër i dëmtuar. Para portës janë ngulur dy kolona graniti.

²⁷ H. Myrto, vep. cit. f. 252.

²⁸ Shih shënimin 3.

Jo më tepër se 200 m në jug-perëndim të depos së Kripës nga punimet për ndërtimin e rezervuarit të peshkimit, është evidentuar një ujësjellës me qyngja balte, që duket se vjen nga kodra e Karpenit dhe vazhdon në drejtim të bregut të detit. Me ujësjellës prej qyngjash balte të kësaj natyre jemi ndeshur edhe në pika të tjera të rrethit të Durrësit.



Fig. 7

KAVAJË

63. ALTARË VARRESH DHE PLLAKA ME MBISHKRIME LATINE E GREKE

Lajmin e parë mbi një objekt sepulkral antik të zbuluar në afërsi të Kavajës e jep Hani.²⁹ Ai përmend një gur varri të punuar keq, me tri figura në basoreliev dhe me mbishkrim latin. Krahastij, Hezej shton dhe një altar shumë të vogël portativ, një pllakë mermeri me mbishkrim latin si dhe një pllakë tjetër me mbishkrim grek.³⁰ Në mbishkrimin e altarit të vogël Hezei sheh të përmendet fisi AEMILIA. Mbishkrimi i tretë, që është greqisht mban datën 17 Shtator 531.³¹ Interesant është fakti se në të

²⁹ J.G. Hahn, Studime shqiptare (përkthim në Arshivin e Institutit të Historisë në Tiranë, A-III-6), f. 119.

³⁰ L. Heuzey-Daumet, vep. cit., f. 390-392, nr. 175, 176, 177.

³¹ Shih për këto mbishkrime dhe L. Rey, vep. cit., si dhe P.C. Sestieri, Mbishkrime latine të Shqipërisë, në «Studime e tekste», Dega II arkeologjike, nr. 1, Tiranë 1943. Një pllake dhe një altar varri me mbishkrime latine të

njëjtën kohë me këtë mbishkrim greqisht të periudhës së hershme bizantine në Kavajë, në Durrës vazhdojnë të shkruhen lapidarë latinisht.³²

64. GJURMË NDËRTIMESH ANTIKE

Rreth 2 km në jugperëndim të Kavajës, në vendin e quajtur Bullutaj apo Blerime, 1 km nga rruga automobilistike që del prej Kavajës në drejtim të Rrogozhinës në një sipërfaqe prej 5 ha shihet një shumicë fragmentesh qeramike masive ndërtimi, e përfaqësuar nga fragmente solenesh me buzë pak të harkuara ose me buzë të ngritura vertikalisht lart si dhe fragmente tullash. Përveç këtyre vërehen fragmente amforash dhe enësh të vogla me vernik ngjyrë kafe të dobët.

BUKAQ

65. QERAMIKË ANTIKE

Ky fshat gjendet mbi një sop apo kodrinë të ulët 1/2 ore në perëndim të Kavajës. Të dhënat gojore flasin për themele të vjetra, varre dhe për një "kolonë", që nuk kemi mundur t'i vërtetojmë. Në sipërfaqe kemi vërejtur fragmente qeramike të antikitetit të vonë.³³

SHTODHËR

66. VARREZË E SHEKUJVE TË PARË TË ERËS SONË

Në faqen perëndimore të kodrinës së Shtodhërit, fshati i parë në të majtë të rrugës automobilistike që del nga Kavaja në

gjetura vitet e fundit në periferinë e qytetit të Kavajës, janë në studim nga V. Toçi.

³² L. Heuzey-H. Daumet, vep. cit., f. 391.

³³ Midis këtyre përmendim një fragment buze pitosi zbukuruar me vija të valëzuara me incizim.

drejtim të Rogozhinës dhe jo më larg se 2-3 km nga ky qytet, janë zbuluar rastësisht varre të mbuluar me tjegulla.³⁴ Kjo pikë ndodhet pikërisht poshtë vendit që mban emrin e një kishe të Shën Todrit, nga e cila siç duket i ka mbetur emri fshatit.

KRYELUZ

67. GJURMË NDËRTIMESH ANTIKE

Në bregun e majtë të lumit të Darçit, aty ku nga lugina e tij ky del në fushën e Kavajës, në një sipërfaqe të sheshtë prej afërsisht 4 ha, që shtrihet deri rrëzë kodrinës së Kryeluzit, shihet një shumicë fragmentesh qeramike antike (Tab. II). Ky vend ndodhet 200-300 m në anën juglindore të urës hekurudhore dhe të asaj automobilistike (Tab. III). Në dy kanale kullues që kalojnë këtu paralelisht me hekurudhën, kemi vënë re se shtresa që përmban fragmente tullash dhe tjegullash antike, fragmente enësh balte e copëra qelqi arrin deri 1.8 m thellësi.

Në sasi të mëdha vërehen fragmente tullash me trashësi 3.5-5 cm dhe 7.5 cm³⁵ Tjegullat mund të ndahen në tre tipe (Tab. II); solene (60-70 cm x 38-40 x 2-2.5 cm), të zbukuruara në faqe me 2-3 vija të cekta të bëra me gishta para pjekjes; tjegulla të sheshta me buzë të ngritura vertikalisht lart; tjegulla të harkuara që kanë

³⁴ Tjegullat e varrezës së Shtodhërit janë solene pak të harkuara me buzë të kthyer lehtë nga brenda, që e kanë trashësinë sa vetë ajo e tjegullës, 2 cm. Gjerësia e tyre është 40 cm. Në faqe dhe në shpinë janë zbukuruar me breza në trajtë sinusi ose sinusi të dyfishtë (Tab. II). Po ashtu ka dhe tjegulla me kurriz të harkuar që e kanë gjatësinë e harkut 26 cm. Inventar në varret e zbuluar nuk është gjetur.

³⁵ Një tullë e plotë në trajtë katrori, 27 x 27 x 3.5 cm, ka në faqe dy kanale diagonale.

të vizatuar nga brenda një shenjë sinusoidale të bërë me dy gishta para pjekjes.

Llaçi që vërehet ngjitur pas tullave është përgatitur me gëlqere, të përzierë herë me rërë të imët e të pastër dhe herë me rërë të papastër, të trashë e me guralecë.

Tullat dhe tjegullat e Kryeluzit mendojmë se paraqesin karakteristika të njohura në të tilla materiale ndërtimi të përdorura në vendin tonë gjatë shekujve I-III dhe IV të erës sonë.³⁶ Në Durrës tulla dhe tjegulla të ngjashme janë gjetur në nekropolin e shekujve I-III e.s. pranë kënetës së dikurshme.³⁷ Tjegulla si këto dhe kaliptere të vizatuara nga brenda pranë buzës me shenjën që përmendëm, shihen edhe në termat publike të Durrësit që u takojnë shekujve të parë të e.s.³⁸ Material si ky dhe që datohet në fillimin e shekullit IV të e.s. është gjetur dhe pak më tej Kryeluzit, në Harizaj (shih më poshtë).

Edhe qeramika e përdorimit të përditëshëm e Kryeluzit datohet në shekujt e parë të erës sonë.³⁹ Në faqet e kanaleve, në thellësinë 1-1.20 m, duket një brez toke zallishte me mbeturina të theksuara zjarri dhe vende-vende kocka njerëzish.

³⁶ A. Mano, Të dhëna mbi qeramikën masive të Apollonisë përdorur si material ndërtimi, «Studime historike» 1965/1, f. 59, 65-67, dhe Tab. II, XII-XV.

³⁷ F. Tartari, Rezultatet e gërmimeve të vitit 1971 në skajin verilindor të qytetit të Durrësit, «Buletin arkeologjik» 1971, f. 103, 115.

³⁸ V. Toçi, Të dhëna mbi topografinë dhe elementin ilir në Dyrrah nën dritën e zbulimeve të reja arkeologjike, «Konf. e Parë e Stud. Alb. (Nëntor 1962)», Tiranë 1965, f. 462.

³⁹ Nga anët e mëdha vërehen fragmente amforash. Vërehen po ashtu mori fragmente enësh të vogla tavoline, nganjëherë të lyera edhe me një vernik të hollë në ngjyrë të kuqe a kafe të çelët, vegje brinake, fragmente terrasigillata dhe copëra flakonesh qelqi.

Në bregun tjetër të lumit, nga ana e Kavajës, rreth 150 m mbi urën e hekurudhës dhe po kaq larg nga lumi, një kanal kullues në thellësinë 1 m pret një kalldrëm të ndërtuar me gurë të mëdhenj e zhavor. Ky duket se ka një gjerësi më të madhe se 6 m. Ndërtimi dhe drejtimi i tij na bëjnë të mendojmë se i takon «Via Egnatias» që pikërisht këtu siç duket e kapërcente lumin e Darçit mbi një urë.⁴⁰ Më në fund, shtojmë se largësia e këtij vendi nga Durrësi, simbas gurëve të distancave në rrugën hekurudhore, është ekzaktësisht 23 km.

Nga sa thamë më lart, mund të nxjerrim si përfundim se në këtë pikë ka shumë mundësi të ndodhemi para gjurmëve të stacionit të parë të rrugës Egnatia pas Durrësit. Distanca e këtij stacioni nga «Dyrratio» në Tabula Peutingeriana është dhënë baraz me XV m. p⁴¹ (Tab. III) që bëjnë rreth 23 km.

Në Tabula Peutingeriana këtij stacioni nuk i është vënë emri. Aty mungon edhe distanca prej Durrësit apo udhëkryqit pranë tij deri në vendin ku dega e rrugës që shkon për Apoloni pret lumin Genus (Tab. III) dhe ku tek Anonimi i Ravenës gjejmë të shënuar «Genesis fl. »⁴²

Për korigjimin e këtyre boshllëqeve të Tabulas, që mund të jenë shkaktuar gjatë rikopjimeve të saj, janë bërë përpjekje të ndryshme. Kështu është plotësuar distanca prej Durrësit deri në bregun e Genusit, duke zhvendosur shifrën e parë të rrugës «Egnatia», atë prej 15 mijë hapash.⁴³ Tani vonë është shfaqur

⁴⁰ C.Prashniker, Muzakia und Malakstra, Wien 1929, f.119, përmend një urë mbi Darç që e daton si të mbarimit të kohës së lashtë.

⁴¹ Tab. Peut., në: "Ilirët dhe Iliria", Tiranë 1965, fq. 312.

⁴² Ravenatis Anonymi, Cosmographia, V.13.

⁴³ K. Miller, Itineraria Romana, Stutgard 1919, 519.

mendimi se kjo distancë duhet plotësuar me shifrën e dytë të rrugës «Egnatia» me atë prej XXVI m.p., duke zhvendosur gjithashtu edhe të parën.⁴⁴ Një përpjekje tjetër është ajo e disa studiuesve që kanë supozuar se Genusi në antikitet kalonte nëpër fushën e Kavajës dhe derdhej në gjirin e Durrësit. Në këtë mënyrë është shfaqur mendimi se stacioni i Tabulas me shifrën XV ndodhej në breg të Genusit (diku pranë Harizajt) dhe, prandaj, mbante emërin e atij lumi.⁴⁵ Në pajtim me këtë mendim është edhe ai që stacionin «Genesis fl» dhe pikën ku rruga bregdetare ndahej nga «Vija Egnatia» i merr jo larg njera tjetrës.⁴⁶ Duke arsyetuar po në këtë mënyrë për rrjedhjen e Genusit në periudhën antike, kohët e fundit është sugjeruar se stacioni në fjalë, me emrin e Genusit, duhet kërkuar pranë Shtodhërit.⁴⁷

Po të pranohet identifikimi ynë i stacionit me distancë XV m. p. nga Dyrrahi me Kryeluzin, në bregun e majtë të Darçit, atëherë në përgjithësi në llogaritjet dhe supozimet e sipërpërmendura nuk ka veçse një mospërputhje prej dy-tre km. Përsa i përket rrjedhjes së Genusit në periudhën antike, ne jemi të mendimit se është pak a shumë po shtrati i sotëm. Prandaj emri i stacionit në Kryeluz, nuk mund të jetë Genusi».⁴⁸

⁴⁴ H. Ceka, Dega jugore e rrugës Egnatia, Monumentet 2, Tiranë 1971, f. 29.

⁴⁵ G. Veith, Der Feldzug von Dyrrhachium zwischen Caesar und Pompeius, Wien 1920, f. 36, 37 dhe 59.

⁴⁶ C. Praschniker, vep. cit., f. 125-126.

⁴⁷ N.G.L. Hammond, A History of Macedonia, vol. I, Oxford 1972, f. 23 dhe 26.

⁴⁸ 47. Tradita gojore ruan për këtë vend toponimin Margullidë dhe kujtimin e një panairi që zhvillohej aty.

HARIZAJ

68. VARRE TË SHEKUJVE TË PARË TË ERËS SONË

Nga hapje taracash në Kodrën e Vake, 300 m në lindje të hekurudhës, janë zbuluar dy varre.⁴⁹

LUZ I VOGËL

69. SOPI I LUZIT

Rreth 500 m në perëndim të rrugës automobilistike Kavajë - Gosë, në drejtim të lagjes së Ujqëve. është një sop në fushë, me diametër afërsisht 100 m dhe lartësi 5 m. Në sipërfaqen e papunuar të sopit kemi vërejtur fragmente tjegullash të shekujve të parë të e.s., fragmente enësh të holla balte dhe një fragment pitosi.

70. MBETJE TË NJË NDËRTESE TË SHEKUJVE TË PARË TË E.S.

Një kilometër e gjysmë në perëndim të rrugës automobilistike që përmendëm më lart dhe në të majtë të rrugës që të çon për në Luz të Vogël, me rastin e hapjes së një kanali kullues, 1 m i thellë, është parë një themel muri me gurë.⁵⁰

⁴⁹ Si shtroje e varrit të parë shërbente një tjegull solene e tipit të shekujve të parë të e.s. Ajo ka përmasat 0.70 x 0.40 x 0.025 m dhe është e zbukuruar me breza paralele të bëra me gishta para pjekjes. Po në atë varr u gjet një tullë trekëndëshe me përmasat 21 x 21 x 29 x 4 cm. Si inventar i këtij varri na është dorëzuar një monedhë bronxi e Konstantinit të Madh (305-337).

⁵⁰ Përreth kishte fragmente qeramike të ngjashme me ato të Kryeluzit. Ndërmjet tyre ka fragmente të trasha pitosi, fragmente pjatash prej balte të kuqe, vegje me kanelyra dhe të lyera me një bojë kafe, funde me këmbë të lartë si të gotave të pijes etj. Në mes të një fundi tasi me këmbë unazore është incizuar shenja Δ.

LUZ I MADH (SHKOZET)

71. DYSHEME E NJË NDËRTESE ANTIKE

Në vitin 1973, nga dystimi i një sopi të vogël në fushën që zinte dikur kënetë e Zhabjakut, rreth 2.5 km në perëndim të rrugës automobilistike Kavajë-Rrogozhinë, u zbulua një dyshe-me 5x5 m, e shtruar me tulla trungpiramidale. E shtruar në këtë mënyrë (Fig. 8), ajo të kujton formën e hojeve të bletës. Tullat kanë baza në formë gjashtëkëndëshi të rregullt (e poshtmjë me brinjët 3.1 cm, e sipërmjë 3.6 cm, lartësia 4.5 cm). Këto kanë qënë ngjitur mbi një shtresë llaçi gëlqereje të përzier me rërë të trashë e thërmia qeramike. Ky tip tulle është njohur në Durrës, por nuk dimë të jetë njohur në ndonjë qendër tjetër antike të vendit.

Mbi dyshemenë e zbuluar dhe përreth u vërejtën një shumicë fragmentesh qeramike.⁵¹ Një copë tulle me trashësi 4.5 cm mban një kryq në relief. Disa fragmente



Fig. 8

tjegullash janë zbukuruar me tufa vijash paralele që duken të

⁵¹ Fragmentet e enëve të baltës që shihen këtu janë si ato të Kryeluzit. Kemi gjetur vegje brinake në ngjyrën natyrale të baltës dhe fragmente terrasi-gillata me ngjyrë të kuqe e kafe. Një fragment paretit pitosi me trashësi 3.5 cm na njeh me një formë restaurimi antik të këtyre enëve. Ky fragment përbëhet nga dy copë të thyera që janë tejshpuar në dy-tri pika e në të është derdhur plumb. Këto pika janë lidhur pastaj, si nga faqja e jashtme edhe e brendshme, me shirita po prej plumbi.

incizuar me një mjet si pirun. Nga sa shihet, mendojmë se këtu ndodhemi para mbetjeve të një «villa rustica» e shekujve II-V e.s.

GOSË

72. VARREZË E SHEKUJVE TË PARË TË E. S.

Në të majtë të rrugës që shkon për Rogozhinë para disa vjetësh janë hasur varre të shekujve të parë të e.s.⁵²

RROGOZHINË

73. GJURMË RRËNOJASH ANTIKE

Në lugun që formohet me kodrën e Tunelit në veri dhe me kodrën e Sokolit në anën lindore e jugore, nga punimet bujqësore kanë dalë materiale ndërtimi të fragmentuara, një gur mermeri me mbishkrim latin dhe objekte të tjera, që shihen të shpërndara në një sipërfaqe prej 1-2 ha.⁵³

Brenda një përroi të vogël, që i shkon anash kësaj sipërfaqeje, në thellësinë 1.5 m, kemi vërejtur një trakt muri me gjerësi 0.60 m, ndërtuar me gurë shtufi të vegjël e mesatarë të palidhur me llaç.

Guri me mbishkrim (Tab. IV) i gjetur aty pranë, (0.86 x 0.26 x 29 m) ka përafërsisht trajtë paralelopipedi i prerë rrafshët vetëm në anën e majtë (të shikuesit) si dhe në anën e sipërme, ku ka në qendër një gropëz drejtkëndëshe. Në pjesën e poshtme të faqes së parme ruan linja të një kornize, ndërsa pjesa e sipërme ku është dhe mbishkrimi paraqitet e gufmuar. Poshtë mbishkri-

⁵² Inventari i tyre ruhet në muzeun arkeologjik të Tiranës.

⁵³ Kemi mbledhur fragmente kotylesh me vernik të zi, fragmente enësh me vernik të kuq, vegje me kanelyra, vegje me motiv litari, një unazë hekuri etj. (Tab. IV).

mit është paraqitur një figurë në trajtën e një pasqyre. Guri duket se është i ripërdorur.

Mbishkrimi vazhdon edhe në faqen e djathtë anësore. Atë e lexojmë në këtë mënyrë:

D(OMINO) N(OSTER) GAL(ERIO) VAL(ERIO)
M(AXIMIANO) INV(ICTO) AVG(VSTO) ETD(OMI- NO)
N(OSTER) GAL(ERIO) [VALERIOMAXIMIA-
NOJAVG(VSTO) E(IS) I(NDEX) V(ICI) S(ITV)ET MAI
(RVM) [ET SOR] ORORVM

Nga ky lexim del se mbishkrimi ka karakter votiv. Ai u është kushtuar perandorëve me origjinë ilire Galer, i cili sundoi në tetrarki pas abdikimit të Dioklecianit (305-311) dhe nipit të tij, djalit të motrës, që ai e adoptoi dhe i dha emrin e vet, edhe ky Cezar (305-309)⁵⁴ dhe August (309-313), po ashtu nënave dhe motrave të tyre, të cilat në të dy rastet ishin nëna e bija. Koha e mbishkrimit duhet të jetë viti 310 ose 311, kur Galer i jetonte dhe Galer i II e kishte marrë titullin august.

Gropëza që paraqet guri në pjesën e sipërme tregon se mbi të do të ketë qënë vendosur ndonjë skulpturë simbolike. Nuk përjashtohet që në këtë rast të kemi të bëjmë dhe me një gur miliar por nuk shohim tregues të plotë për ta thënë me siguri.

Materiali i ndërtimit që shihet në sipërfaqe, përfaqësohet nga fragmente tullash e tjegullash të shekujve të parë të e.s. Një fragment tjegulle e sheshtë, me trashësi 2 cm, mban një vulë të pjesëshme epigrafiqe: SANO... Shtojmë se këtu janë të dukshme edhe gjurmët e një zjarri shkatërrimtar. Përzier me këto gjurmë

⁵⁴ Orosi, VII, 25.

kemi vërejtur kocka njerëzish dhe një majë heshte hekuri (Tab. III).

Duke gjykuar në tërësi nga karakteri i qeramikës si dhe nga mbishkrimi, jemi të mendimit se ato i përkasin një vendbanimi të vogël përbri rrugës «Egnatia», shekujve II-IV e.s. Ka mundësi që fundi i tij të ketë ardhur me dhunë.

74. NJË TRAKT MURI DHE NJË ALTAR VARI ME MBI-SHKRIM

Kjo pikë ndodhet 2 km në të dalë të Rrogozhinës me drejtim për në Kavajë, tek vendi i quajtur Bishti i Zhurit, 30 m në të majtë të rrugës automobilistike. Këtu, nga hapja e një kanali me drejtim lindje-perëndim, në thellësi 3 m, ka dalë një trakt muri i ndërtuar me tulla, mjaft material i fragmentuar ndërtimi dhe një altar varri me mbishkrim latin.

Trakti i murit u pa në faqen veriore të kanalit për 4 m gjatësi, në thellësinë 1.80 m. Muri ka qënë ndërtuar me tulla të vendosura në radhë të rregullta. Lidhja e tyre është bërë me llaç gëlqereje përzier me pluhur tullash. Llaçi formonte fuga me trashësi sa tullat, 3.5 cm. Sipër këtij trakti u vërejt një shtresë dheu me mbeturina të theksuara zjarri.

Midis materialit të nxjerrë në sipërfaqe u gjetën tulla të mëdha (46 x 46 x 6 cm), të përdorura siç duket për shtroje dysHEMEJE. Tulla të tilla të zbuluara në Apoloni u përkasin shekujve të parë të G. S.⁵⁵

Karakteristike janë një numër tullash të vogla paralelopipedi (11 x 7 x 2.7 cm dhe 9.5 x 6 x 3 cm) (Tab. II). Tulla të ngjashme, por me përmasa 8.7 x 5 x 0.2 cm janë përdorur në shtrimin e një

⁵⁵ A. Mano, Vep. cit., f. 68, 2-80/a

dysHEMEJE me motivin "kurritz peshku» në termat publike të Dyrrahut. Në Romë ato kanë qënë një prodhim i rrallë dhe përdoreshin për shtrim dyshemesh në godinat e rëndësishme, siç është rasti në Vila Adriana.⁵⁶ Në sipërfaqe shihen dhe mjaft fragmente enësh balte.⁵⁷

Rreth 40 m më në lindje, po në atë kanal, u zbulua një altar me mbishkrim, që u gjet in situ (në thellësinë 1.80 m), i vendosur mbi bazamentin e tij. Altari është prej mermeri të bardhë me rremba gri 1.20x0.60x0.80 m) (Fig. 9). Në anën e përparme të tij, brenda një kornize katrore 55 x 55 cm përmbahet një mbishkrim latin në 8 rreshta. Në pjesën e sipërme altari është i rrumbullakuar dhe ka tri gropëza të vogla të vendosura në formë trekëndëshi. Kjo e dhënë na bën të mendojmë se mbi të ka qënë vendosur një tripod.



Fig. 9

Bazamenti mbi të cilin ishte vendosur altari, është prej guri gëlqeror dhe ka formën e paralelopipedit 1.28 x 0.64 x 0.30 m. Në faqen e sipërme të bazamentit, ku ishte mbështetur altari, u gjet një petëz prej plumbi, i përdorur siç duket me qëllim për ta përforcuar lidhjen midis tyre. Këtë qëllim tregojnë siç duket dhe

⁵⁶ G. Lugli, *La tecnica Edilizia Romana*, Roma, 1957, f. 551.

⁵⁷ Nga fragmentet e qeramikës së përdorimit të përditëshëm në këtë pikë përmendim një fragment vegjeje amfore me një vulë të pjesëshme me mbishkrim: L. FOS... Edhe këtu, kemi gjetur vegje brinake, që brithi lart përfundon me majucë.

katër gropëza të vogla me gjurmë plumbi që shihen në mesin e katër anëve të poshtme të altarit si dhe katër të tjera në një drejtim me to tek bazamenti.

Mbishkrimi 8 rreshtësh paraqitet i dëmtuar, tepër i fshirë sidomos në rreshtat e sipërm:

.....ET CAIVS....

...FILIOCAIS...

E(IVS)I(NDEX)N(ATALIBVS)DIVSVITALIS.

Tripodi mbi altar tregon se kushtuesi i ishte drejtuar Mërkurit, në këtë rast ndoshta si mbrojtës i udhëtarëve.

75. MBETJE NDËRTESASH ANTIKE

Kjo pikë ndodhet në juglindje të Rogozhinës, 300 m në të majtë të rrugës që shkon për Peqin, përkundrejt fshatit Thanaj që ndodhet në bregun tjetër të Shkumbinit. Vendasit i thonë Çezma e Thatë. Në këmbët e kodrës vërehen mbeturina muresh të ndër-tuar me gurë të rregullt të vegjël, të lidhur me llaç gëlqereje dhe fragmente tjegullash karakteristike për shekujt e parë të e.s.

Rreth 100 m poshtë kësaj pike, në fushë, në një sipërfaqe afërsisht 0,8 ha, vërehen përsëri fragmente tullash, tjegullash dhe enësh balte të ngjashme me ato që përmendëm në dy pikat e tjera të Rogozhinës. Gjurmë ndërtimesh me tulla janë ngritur dhe në anën e djathtë të rrugës.

Një tubacion prej qyngjesh balte konstatohet në thellësinë 0.8 m, i shtrirë nga këmbët e kodrave në drejtim të rrugës. Qyngjet e baltës së këtij ujësjellësi kanë përmasat: gjatësi 33 cm, diametri i madh 12 cm, diametri i vogël 10 cm.

Ndërtesat që nënkuptohen këtu nga gjurmët që përmendëm më lart duket se ndodheshin përbri rrugës Egnatia,⁵⁸ e cila këtu ka mundësi të ketë pasur po linjën që ka rruga e sotme. Qyngjet e baltës mendojmë se i përkasin një ujësjiellësi mesjetar.

6. ZONA KODRINORE E KRYEVIDHIT

KARPËN

76. VARREZË ANTIKE; NJË KËMBANË KISHE MESJETARE

Ky fshat ndodhet rrëzë kodrave, në skajin më verior të këtij masivi, jo larg bregut të detit. Nga punimet bujqësore këtu është vërtetuar ekzistenca e një varreze antike. Varret kanë qënë mbuluar me tjegulla dhe janë datuar në shekujt I-III e. s.

Në këtë fshat është gjetur dhe një këmbanë bronxi, që mban datën: MCCCCLXV (1465).⁵⁹ Aty gjenden dhe rrënojat e një kishe mesjetare.

KEPI I LAGJIT

77. GJURMË TË NJË NDËRTESE ANTIKE

Në faqen e butë të kodrës që zgjatet në veri të kalasë së Turrës, buzë gjirit të vogël dhe shumë të bukur të Bardhores, gjendet një burim që vendasit e thërrasin «Kroi i Carinës». Burimi është përgjysmë i mbuluar me një kube të vogël prej gurësh të crregullt të lidhur me llaç dhe ka ujë të preferuar.

⁵⁸ Për një kthesë të mundshme të rrugës «Egnatia» në këtë pikë për të kapërcyer lumin në drejtim të fshatit Thanaj, shih N.G.L. Hammond, vep. cit., f. 3.

⁵⁹ F. Tartari, Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit, «Adriatiku» (almanak), Durrës, 1980, f. 75.

Në anën veriore të tij, në një sipërfaqe prej 0.2-0.3 ha vërehen gurë të vegjël e mesatarë dhe fragmente tullash e tjegullash.⁶⁰ Tjegullat duket se në më të shumtën e rasteve janë tipike për shekujt I-IV e.s., por vërehen edhe fragmente tjegullash të zbukuruara me incizim tufa vijash paralele, që mendojmë se u përkasin shekujve V-VI të e.s.

78. KALAJA E TURRËS

Mbeturinat e kësaj kalaje mesjetare në kepin e Lagjit nuk janë studiuar. Vetë emri i këtij kepi për mendet që nga mesi i shekullit XIV, me një skelë sekondare që frekuentohej nga raguzanët.⁶¹ Por toponimi «Carinë» që kemi gjetur në gjirin e vogël, nga ana veriore, dëshmon ndoshta se është përdorur si skelë dhe ka pasur një zyrë doganore kohë më parë, që në periudhën e sundimit serb të Stefan e sundimit Dushanit, apo më parë, në kohën bullgar.

Në burimet historike nuk bëhet fjalë për kështjellë në kepin e Lagjit, por flitet për fillimin e ndërtimit të një kështjelle nga shqiptarët më 1364 në jug të Durrësit, në kepin e Meliarit (caput Meliarum).⁶² Pastaj, në shekullin XV, flitet për ekspedita raguzane ndaj domeneve të Nikita Topisë, në kepin e Melies.⁶³ Në një dokument të shekullit XVI në kepin e Lagjit gjejmë të shënuar «Castel di Raguseo», ndërsa në veri të tij, brenda gjirit

⁶⁰ Qeramika e përdorimit të përditëshëm në këtë pikë përfaqësohet nga fragmente pitosash e amforash, nga fragmente enësh me ngjyrën natyrale të baltës dhe nga fragmente pseudoterrasigillata. Një fragment buzë pitosi është zbukuruar nga sipër me një tufë vijash të valëzuara. Kurse një fragment amfore është zbukuruar me tre breza paralele prej gropëzash të bëra me gishta.

⁶¹ A. Ducellier, *La façade...*, f. 576.

⁶² *Acta et diplomata res Albania mediae aetatis illustration*, Vjenë 1913, II. Shih dhe A. Ducellier, *La façade...*, f. 477.

⁶³ Po aty, f. 576.

të Durrësit, një pikë bregdetare mban emrin «Mulir»,⁶⁴ Emri i fshatit Turnah, i regjistruar këtu nga turqit më 1431-32,⁶⁵ mendojmë se ka në rrënjë «turris» dhe që indirekt dëshmon për ekzistencën e një kulle apo kështjelle.

Emri Melie ose Meliar, me sa kemi mundur të hetojmë, nuk ruhet në toponiminë e zonës. Dhe as gjurmë të ndonjë kështjelle tjetër, përveç asaj të Turrës, nuk kemi hasur. Për mendimin tonë "Meliari" nuk është gjë tjetër veçse «muliri» dhe do ta identifikonim me kepin e vogël të Barbahutës në Karpën. Por ky kep, gjeografikisht është vështirë të ndahet nga njësia më e madhe, e njohur si kepi i Lagjit. Nga kjo do të thoshnim se kështjella për të cilën bëhet fjalë në burimet është vetë kalaja e Turrës.

79. VARREZË E PERIUDHËS QYTETARE ILIRE

Në një rripirë kodre, tek vendi i quajtur Hurat e Bejës, në fshatin Bardhor, kemi vërejtur një grumbull fragmentesh qeramike antike dhe kocka të dala në sipërfaqe nga rrëshqitja e dheut. Mbi një fragment barku pitosi dallohet një mbishkrim i realizuar me gërvishtje:

XAIPEΑΣK

Materiali mendojmë se i përket një varreze dhe datohet në shekujt III-I p.e.s.

HAJDARAJ

80. ÇEKAN GURI

Në këtë fshat që ndodhet rreth 6 km në jugperëndim të Kavajës, rrzës lindore të kodrave të Kryevidhit është gjetur një

⁶⁴ Shih shën. 3 më lart

⁶⁵ H.Inalçik, *Suret-i, defter-i...* Nahija e Izminit.

çekan sopatë prej guri të lëmuar.⁶⁶ Vendi i gjetjes është rreth 1 km në jug-perëndim të shkollës së fshatit. Në anën e përroit nga vendasit është hapur një gurore. Kërkimet tona në atë territor nuk kanë dhënë rezultat për gjurmë prehistorike.

81. VARREZË

Në lagjen e Gjeçe para 15 vjetësh janë gjetur varre që na janë përshkruar të mbuluara me pllaka guri. Nga inventari i tyre është ruajtur vetëm një Takrimore balte me trup gati sferik.⁶⁷ Ky objekt mendojmë se e daton varrezën në shekujt V-IV p.e.s.

RRETH GRETH

82. GJURMË NDËRTIMESH ANTIKE

Ky fshat ndodhet në anën perëndimore të këtyre kodrave, rreth 6 km në verilindje të kalasë së Bashtovës. Këtu, në fundin e kodrës së quajtur “Boka” rrëzë rrypit të fushës që e ndan këtë vend nga buza e detit, vërehen mbetje ndërtimesh antike. Vende vende aty ku gërryerjet e erozionit janë më të theksuara, shihen mbeturina muresh me blloqe gurësh të vegjël kuadratikë të latuar, si dhe me tulla. Këto gjurmë shtrihen në një sipërfaqe prej 2-3 ha. Në sasi të konsiderueshme bien në sy fragmente solenesh. Po ashtu shihen dhe fragmente kalipteresh të tipit "korintik". Nga enët e baltës përmendim fragmente pitosash e amforash si dhe fragmente enësh të vogla me ngjyrën natyrale të baltës ose të lyera me vernik kafe. Këto gjurmë mendojmë se u përkasin shekujve IV-I p.e.s.

⁶⁶ V. Toçi, *Të dhëna mbi elementin ilir...*, f. 103.

⁶⁷ Në pjesën më të gjerë përshkohet nga dy breza verniku kafe të dobët.

83. QERAMIKË MASIVE DHE OBJEKTE TË TJERA

Nga gjetje rasti dhe sondazhe të kryera në këtë fshat është grumbulluar një material me interes arkeologjik. Përveç fragmenteve prej enësh balte të datuara në shekujt III-I p.e.s., si dhe në shekujt e parë të erës sonë, është gjetur dhe një solenë e plotë (0.70 x 0.42 x 0.035 m)⁶⁸

SPANESH KAZIJE

Ndërmjet fshatrave Spanesh dhe Kazije, në veri të rezervuarit, kanë dalë në sipërfaqe tulla të mëdha (44 x 44 x 6 cm), prej një balte të kuqe e pjekur shumë mirë, me disa brimëza të vogla në sipërfaqe. Gjenden gjithashtu fragmente lastrash mermeri dhe fragmente tjegullash të sheshta të zbukuruara në sipërfaqe me vija të valëzuara që kryqëzohen. Ngjitur pas tullave dhe lastrave të mermerit ruhen mbeturina llaçi gëlqereje përzier me pluhur tulle.

Pak më lart, në afërsi të Spaneshit, tek vendi i quajtur Ftohosinë, shihen në sipërfaqe fragmente qeramike të shekujve të parë të e.s. Në afërsi kemi gjetur një vegjë amfore me vulë epigrafike: DORA.

LINËZ

84. OBJEKTE PREHISTORIKE

Në faqen jugore të masivit të kodrave të Kryevidhit, jo shumë larg fshatit Ballaj dhe bregut të djathtë të Shkumbinit, tek vendi quajtur Linëz, është gjetur një sopatë bipene hekuri si dhe një

⁶⁸ S. Hidri, *Zhabjaku në hartën arkeologjike*, «Adriatiku», 12 Maj 1977 dhe kumtesë në sesionin shkencor të muzeut arkeologjik të Durrësit, 1979 (e pabotuar).

varëse bronxi e tipit «kafaz» (Tab. II) që datohen në shekujt VIII-VII p.e.s. Jo larg këtij vendi është gjetur kohët e fundit një çekan-sopatë guri me brimë, si ai i Hajdarajt.

BALLAJ

85. GJURMË NDËRTIMESH ANTIKE

Në kodrinën e ulët pranë urës së Çopanit, që është pika më juglindore e këtij masivi kodrinor, jo më larg se 100 m nga bregu i Shkumbinit, nga punimet bujqësore, kanë dalë në sipërfaqe materiale ndërtimi dhe fragmente enësh balte antike. Ato vazhdojnë poshtë, në këmbët e kodrës duke zënë afërsisht një sipërfaqe prej 2-3 ha. Në një pikë brenda kësaj sipërfaqeje është zbuluar një pjesë dysHEMEJE e shtruar me llaç përzier me pluhur tulle.

Në përgjithësi fragmentet e tullave dhe të tjegullave u përkasin shekujve të parë të e. s. (Tab. II)⁶⁹

Në fundin e kodrinës, jo më larg se 30 m nga shtrati i lumit, në një gropë të thellë 5 m, doli një trakt muri i ndërtuar me tulla e llaç gëlqereje, të cilin mundëm ta ndiqnim në një gjatësi deri 4 m. Trashësia e tullave, që janë prej një balte jo të pastër dhe të pjekura dobët është 8-10 cm, e fugave të llaçit 2 cm.

Fundi i kësaj grope që ka një nivel me shtratin aktual të lumit, është lymor me ngjyrë të verdhë në okër. Ky fakt mund të merret si provë e kalimit të lumit në këtë vend që para ngritjes së qendrës që përfaqësohet nga gjurmët e mësipërme.

⁶⁹ Kemi mbledhur vegje amforash, një kandil balte me trup gati bikonik, lyer me vernik kafë të dobët, fragmente kupash pseudoterrasigillata, fragmente vorbesh dhe copëra flakonesh qelqi ngjyrë vjollcë dhe jeshile të hapët.

Këto gjurmë na shtyjnë të mendojmë se është kjo pikë siç duket që në antikitet mbante emrin «Genus»⁷⁰ Por ka mundësi që emrin e Shkumbinit të Lashtë ta ketë mbajtur gjithë zona breglumore Ballaj-Rreth-Greth (për mendimin tonë Shkumbini në antikitet është derdhur pranë kënetës së Rreth-Grethit). Sidoqoftë gjurmët e ndërtimeve të shekujve të parë të e.s., që vërehen në Luzin e Vogël, në Luzin e Madh dhe Ballaj (shih hartat, Tab. II), mendojmë se tregojnë drejtimin e degës së rrugës Egnatia për Apoloni, pas kthesës që bënte ajo në bregun e Darçit.

VILË BASHTOVË

86. VARREZË ANTIKE

Pranë shkollës 8 vjeçare të fshatit Vilë, me rastin e hapjes së themeleve për ndërtimin e godinave të reja të banimit, u zbuluan disa varre. Nga inventari i tyre ruhen në muzeun historik të fshatit një lekyt dhe një ojnohe me vernik të zi, që datohen në shekujt III-I p.e.s.

Ky vend ndodhet rreth një kilometër e gjysmë nga kalaja e Bashtovës.

87. GJURMË TË NJË NDËRTESE ANTIKE

Në faqen e «shpatit të Vilës», një kodër e butë e me pjerrësi të vogël, rreth 2 km nga bregu i Shkumbinit, vërehen fragmente materiali ndërtimi dhe qeramikë antike shpërndarë në një sipërfaqe prej 0.2 ha. Vendi njihet me emrin «Trojzë»⁷¹

⁷⁰ Shih dhe H. Ceka, *Dega Jugore e rrugës...*

⁷¹ H. Mvrto, *Vila, një toponim 2000 vjeçar*, «Bashkimi», 22 Qershor 75.

Vërehen me shumicë fragmente solenesh dhe kalipteresh të shekujve të parë të e.s. Ndër fragmentet e tullave karakteristike janë ato me formë rrethore (20 x 3.5 cm).⁷² Enët e baltës përfaqësohen nga fragmente amforash si dhe enësh tryeze të lyera me vernik kafe ose të kuq.⁷³

Jemi të mendimit se këtu, në Trojzet e Vilës, ndodhemi para mbeturinave të një villa rustica e shekujve I p.e.s.-I e. s. që mund të ketë mbijetuar edhe më pas.⁷⁴

88. KODRA E GJONE

Kodra që ngrihet në anën veriore të kalasë së Bashtovës, jo më larg se 1 km prej saj, ruan gjurmë ndërtimesh antike. Këto gjurmë vërehen në faqen veriore e perëndimore, si dhe në anën e saj jugore. Në faqen veriore shihen fragmente tullash e tjeগুল্লাsh të periudhës qytetare ilire, të shpërndara në një sipërfaqe prej 2-3 ha. Po ashtu shihen të shpërndarë edhe blloqe të mëdhenj gurësh gjysmë të punuar.

Linja e këtyre gurëve mund të ndiqet mirë në faqen veriperëndimore. Blloqet (100 x 50 x 40 cm) që shihen vende vende në

⁷² Janë të ngjashme me ato që vërehen në termat e Dyrrahut, të datuara në shekujt e parë të e.s. (V. Toçi, *Të dhëna mbi topografinë dhe...*, f. 462).

⁷³ Një pjesë e vogël janë me vernik të zi. Një fragment kupe terrasigillata e kuqe në kafe ka zbukurime një reliev: një sërë rrathësh, një pjesë krahu shpendi dhe pikëza të vogla në trajtë gjysmësferike. Përveç qeramikës kemi parë dhe copra flakonesh qelqi transparent me një nuancë bojëqielli. Midis këtij materiali kemi gjetur dhe një monedhë argjendi romake e periudhës së fundit republikane.

⁷⁴ Për origjinën latino-romane të këtij toponimi, shih E. Çabej, *Studime rreth etnologjisë së gjuhës shqipe XXVII*, «Studime Filologjike», 1968. 1, f. 121 dhe E. Lafe, *Toponimes latino-romains sur le territoire albanais*, «Studia Albanica» 1973, 1, f. 165-166.

sipërfaqe, formojnë një linjë e cila vazhdon afërsisht 200 m. deri në shpatin e kodrës që bie thikë mbi rrugën e Rreth-Grethit.

Në anën jugore të kodrës, me rastin e hapjes së rrugës së re, doli një shtresë e dendur tullash, tjegullash solene dhe kaliptere të tipit «korintik». ⁷⁵

Në se blloqet e gurëve dhe linja që përcaktojnë ato përfaqëson gjurmët e një fortifikimi antik, do të sqarohet nga gërmimet. Qeramika që shihet në sipërfaqe flet për një vendbanim të periudhës qytetare ilire. Në këtë rast, kjo kodër, me lumin Genus (Shkumbinin) që kalonte rrëzës së saj jugore e perëndimore (shih «shënime gjeografike» në numrin e kaluar), na duket se është pika më e përshtatshme për t'u identifikuar me Asparagun e përmendur prej Cezarit. ⁷⁶

89. KALAJA E BASHTOVËS

Kalaja e Bashtovës (60 x 30 m) gjendet në fushë, jo më tepër se 400-500 m nga bregu i djathtë i Shkumbinit dhe 3-4 km nga grykëderdhja e tij. Kohët e fundit një studim të plotë mbi këtë kala ka paraqitur Gj. Karaiskaj. ⁷⁷ I mbështetur në burimet dhe në teknikën e ndërtimit, autori është i mendimit se datën e ndërtimit të saj duhet ta kërkojmë ndërmjet viteve 1467-1478

⁷⁵ Bashkë me këtë material kemi gjetur një fund kotyleje me vernik të zi, vegje skyfosi me vernik të zi në kafe, si dhe një terrakotë. Kjo me sa duket paraqet një dash ose qen.

⁷⁶ 75. Caes. Vep. cit. II, 41. 1; 76, 1 dhe 2. Shih për identifikimin e Bashtovës me Asparagun L. Heuzey, *Les operations...*; «Ilirët dhe Iliria», treguesi i emrave f. 527); H. Ceka, *Dega jugore...*

⁷⁷ Gj. Karaiskaj, *Kështjella e Bashtovës*, Monumentet 5-6, 1979.

dhe se autorët e ndërtimit janë venecianët.⁷⁸ A. Dyselie është i mendimit se përket «epokës së dinastisë justiniane».⁷⁹

Po të marrim parasysh rezultatet e studimeve që provojnë se Shkumbini në zonën e grykëderdhjes shton tokë në kurriz të detit,⁸⁰ në kohën e ndërtimit kështjella nuk duhet të ketë qënë larg bregut. Përsa i përket zhvendosjes së rrjedhjes së Shkumbinit nga shtrati i tij i vdekur» në veriperëndim të kalasë, për në shtratin e sotëm, jemi të mendimit se kjo ka ndodhur në fillimin e erës sonë. Por një degë e tij mund të ketë vazhduar edhe më pas në shtratin e vjetër, ose mund të jetë rikthyer. Prandaj edhe pozicioni fillestar i kalasë ka mundësi të ketë qënë në deltën e formuar midis rrjedhjes kryesore të Shkumbinit dhe një dege të tij të vjetër. Në këtë mënyrë do të justifikohet edhe pozicioni i saj në fushë, që është një dukuri e rrallë për kohën.

Ekzistenca e gjurmëve të një ndërtimi të periudhës bizantine provohet këtu nga detaje arkitektonike të inkastruara në mure me qëllim dekoracioni.⁸¹ Asaj periudhe mendojmë se i takojnë dhe një kapitel e një kollonë mermeri që janë gjetur në territorin e kalasë.⁸² Kapiteli (B. 75 x 75 cm, diam. ø. 45 cm, L. 45 cm) është me pulvino dhe i zbukuruar me gjethe akanthi të stilizuara.

⁷⁸ Po aty, f. 68.

⁷⁹ A. Ducellier, *La façade...*, f. 35-36. Shih po aty dhe sprovën për identifikimin e kësaj kështjelle me qëndrën e rëndësishme të Vregosë, një nga tregjet kryesore të bregdetit shqiptar që nga shekulli XIII.

⁸⁰ Këtë çështje e kemi diskutuar në pjesën e parë të këtij artikulli, botuar në numrin e kaluar (shih "*shënime gjeografike*")

⁸¹ Gj. Karaiskaj, vep. cit., f. 61.

⁸² Kapiteli ruhet në muzeun historik të fshatit, kurse kolona në muzeun arkeologjik të Durrësit.

Kolona rrethore ka sipërfaqe të sheshtë dhe vjen e ngushtuar pak nga kreu (gjatësi 2.40 m, diam. 0.32 m).

Për datimin e kështjellës Gj. Karaiskaj u ka bërë një analizë të hollësishme të dhënave që vijnë nga burimet e shkruara, si dhe të dhënave arkitektonike. Megjithatë jo çdo argument i paraqitur na duket plotësisht i qëndrueshëm. Kështu, mospërmendja e kështjellës së Bashtovës në defterin e regjistrimit të tokave prej turqve më 1431-32, por vetëm e fshatit Bashtovë me 13 shtëpi merret si argument i mosekzistencës së saj në atë kohë. Mirëpo në atë dokument jo rregullisht përmenden edhe emrat e kështjellave, krahas atyre të fshatrave, siç, e pohon dhe vetë autori (po aty).

Edhe mungesa e emrit të kësaj kështjelle në listën e fortesave të bregdetit shqiptar që pretendohen prej venecianëve në fundin e shekullit XIV, kur tregëtimi i drithërave kalon këtu nga dora e raguzanëve në të tyren, nuk na duket një argument plotësisht i qëndrueshëm për mosekzistencën e saj në atë kohë. Në atë listë nuk figuron as kalaja e Turrës e shënuar më pas si «Castel di raguseo» dhe që duket se i përket shekullit XIV.

Së fundi, mendojmë se duhet vërejtur edhe më tepër fakti se rëndësia e skelës në grykëderdhjen e Shkumbinit erdhi duke u rritur në shekullin XIV; nga mesi i atij shekulli ndjehet interesi i të huajve për të dhe në dhjetëvjeçarin e gjashtë të atij shekulli ajo arrin kulmin në eksportin e drithërave.⁸³ Kjo na duket si një kohë që lypte aty ngritjen e një kështjelle. Por në atë kohë

⁸³ Shih shën. 75, më lart. Këtë fakt e përmend dhe Gj. Karaiskaj, po aty, (shih shën. 14, 15).

vendi sundohej nga feudali shqiptar Vlash Mataranga dhe, prandaj, një iniciativë e tillë do t'i takonte vetëm atij.

Duke pasur respekt për kompetencat e autorit të sipërpërmendur në këtë fushë, me vërejtjet që parashtroam kemi qëllim vetëm të shprehim se, për mendimin tonë, lidhur me datën e ngritjes së kalasë së Bashtovës ka ende vend për kërkime.

90. URA E BASHTOVËS

Mbi Shkumbin, në një pikë ndërmjet Ballajt dhe kështjellës ruhen tri bazamente të këmbëve të një ure të vjetër (Fig. 10). Gjerësia e lumit këtu është rreth 50 m dhe bazamentet gjenden nga një në secilin breg e një në mesin e lumit.



Fig. 10

Bazamenti i mesit që ruhet në një lartësi deri në 1 m (Fig. 11). është trajtuar me kënde të mprehta dhe me kthesa për të evituar goditjet e rrjedhjes; si shpori edhe shuarsi paraqesin formë trekëndëshi. Gjatësia nga njeri skaj në tjetrin është 10 m, gjerësia 6 m. Ndërtimi konsiston nga një veshje anësore prej blloqesh kuadratike të latuara (0.50 x 0.38 x 0.20 dhe 0.40 x 0.20 x 0.20 m). Këto janë vendosur në rreshta të rregullta dhe janë lidhur me

llaç gëlqereje të fortë. Në lartësinë e mbetur ruhen katër radhë gurësh. Bërthama e brendshme, me aq sa mundëm të hetojmë, konsiston nga mbushje prej gurësh të vegjël të thyer përzier me llaç gëlqereje të bollshëm.

Bazamentet e këmbëve anësore (Fig. 12) paraqesin të njëjtën teknikë ndërtimi, me përjashtim të formës së tyre që i përngjan më tepër trapezit, me bazën e gjerë nga ana e bregut. Nga ana e lumit linja e tyre paraqitet e lakuar, gjë që na lejon të supozojmë se ura ka qënë ndërtuar mbi harqe.

Prashniker e përmend këtë urë si të ndërtuar me të njëjtën teknikë si ajo e Darçit dhe e daton në mbarimin e periudhës së lashtë». ⁸⁴ Ky datim përputhet me mendimin e tij që vetëm në periudhën e vonë antike Shkumbini e ka lënë fushën e Kavajës dhe është kthyer në shtratin e sotëm. Gj. Karaiskaj është i mendimit se ajo i përket periudhës së vonë romake. ⁸⁵




Fig. 11

⁸⁴ C. Praschniker, *vep. cit.*, f. 126

⁸⁵ Gj. Karaiskaj, *po aty*, f. 59



Fig. 12

Argumentat që kemi paraqitur mbi rrjedhjen e këtij lumi në antikitet, si dhe gjurmët e shekujve të parë të e. s. që evidentohen në Kryeluz, Luz i Vogël, Luz i Madh dhe Ballaj na shtyjnë të mendojmë, siç e kemi thënë më lart, kjo është dhe linja e rrugës bregdetare që ndahej nga «Egnatia» dhe merrte drejtimin e Apollonisë. Ura e Bashtovës kuptohet që ka qënë në funksion të kësaj rruge. Kjo arsye, si dhe vetë teknika e ndërtimit, me elemente që e paralelizojnë me ura të tjera të shekujve I-IV mbi Shkumbinin e Mesëm,⁸⁶ e kundërshtojnë mendimin e shfaqur nga Prashniker.

E krahasuar me urat e sipërpërmendura, kjo paraqet më tepër ngjashmëri në teknikën e ndërtimit me urën e Keçit, e shekullit IV. Por i mungon një element i saj, brezat e tullave që në urën e Keçit përshkojnë muraturën, dy rreshtash në bërthamë dhe pesë në fasadë. Mungesa e këtij elementi në pjesët e mbetura të urës

⁸⁶ A. Baçe në A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo. *Historia e Arkitekturës Shqiptare (maket)* Tiranë 1980, f. 187.

së Bashtovës na shtyn të zgjedhim si datë më të përshtatshme të ndërtimit të saj shekullin e tretë, më me probabilitet periudhën e fundit të tij. Kjo është dhe një kohë që trafiku Dyrrah-Apoloni-Aulonë duhet të ketë pasur një farë rritje.⁸⁷

Përsa i përket një kalldrëmi që është vërtetuar në fushë (në thellësinë 1 m)⁸⁸ dhe drejtimi i të cilit tregon se lidhte kalanë me këtë urë, mendojmë se i përket kohës së kalasë. Kjo tregon se ura do të ketë qënë në përdorim edhe në mesjetë.

PËRFUNDIME

Përmbledhja në këtë shkrim shkurtazi e monumenteve dhe e gjurmëve të lashta e mesjetare të njohura që ndodhen tej qytetit të Durrësit, në rrethin e tij,⁸⁹ përveç vlerësimeve që jemi munduar të bëjmë gjatë paraqitjes së lëndës, na jep mundësi të përpiqemi për të nxjerrë dhe disa përgjithësime përfundimtare, natyrisht me aq sa mund të pretendohet për një hartë të kësaj natyre.

Përsa i përket prehistorisë, megjithëse të dhënat e deritanishme në këtë trevë janë të kufizuara, të bie në sy fakti se ato kanë ardhur duke u shtuar.

Si gjetje rasti, ato përfaqësojnë periudhën e neolitit të mesëm (prefëset e strallit në Shijak), atë të neolitit të vonë (çekanët e gurit të lëmuar në Manës, Hajdaraj, Ballaj), periudhën e bronzit

⁸⁷ Për rëndësinë e portit të Aulonës në vitet 288-333, shih N.G.L. Hammond, *A. History...* vëll. I, pjesa e dytë, f. 1.

⁸⁸ Këtë kalldrëm e përmend dhe Gj. Karaiskaj, po aty,

⁸⁹ Duhet të falenderoj drejtorin e Muzeut Arkeologjik të Durrësit, V.Toçi, për sugjerimet e vlefshme, sh.A.Bojaxhi, punonjës në këtë muze, që më ka shoqëruar në disa ekspedita përnjohëse, si dhe shokët punonjës të bujqësisë e arsimtarë në fshatra që më kanë dhënë njoftime me interes.

të vonë (sopatat e tipit shqiptaro-dalmat) në Borçë e Rrushkull) dhe periudhën e hekurit të hershëm (varësja e bronxit e tipit ojnohe në Armath, sopata bipene prej hekuri dhe varësja e bronzit të tipit «kafaz» në Bashtovë). Gjeografikisht vendgjetjet e këtyre objekteve lokalizohen në dy zona: në kodrinat e zonës fushore të bregut të djathtë të rrjedhjes së poshtme të Erzenit dhe në zonën kodrinore që ngrihet në të djathtë të rrjedhjes së poshtme të Shkumbinit. Të dyja këto zona, me kodrat e buta që ngrihen mbi fushat breglumore, gëzojnë kushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë primitive dhe, si pasojë edhe të jetës sedentare. Një faktor tjetër gjeografik që i karakterizon këto qendra, është edhe afërsia me bregun e detit.

Në tërësi objektet që përmendëm qëndrojnë në unitet me kulturat përkatëse të vërtetuara nga zbulimet e bëra në gjithë vendin tonë. Sopatat e bronzit dhe objektet e periudhës së hershme të hekurit dëshmojnë më tepër për një lidhje me grupin kulturor ilir qendror. Por varësja e bronzit të tipit ojnohe, si në formë edhe në zbulim, paraqet ngjashmëri me një enëz të zbuluar në Gërmenj të Lushnjës.⁹⁰ Në këtë mënyrë, për rastin tonë, kemi së paku një element që dëshmon se në periudhën e hershme të hekurit Shkumbini nuk ka përbërë një kufi të prerë për kulturat e zhvilluara në dy brigjet e tij.

Deri tani dëshmi të kulturës ilire në prag të kolonizimit janë objektet e hekurit të hershëm (shekujt VIII-VII) që përmendëm si dhe tumat e vërtetuara në fushën e Erzenit të Poshtëm.⁹¹ Por

⁹⁰ Zh. Andrea, Një varrezë e dystë në fshatin Gërmenj, «Iliria» 1, 1981, f. 222, Tab. II, 7

⁹¹ Për gjurmë të një kulture dhe të importit helen brenda në Durrës që para vitit 627 p.e.s shih V. Toçi, Popullsia ilire e Dyrrahut në dritën e të dhënave historike-arkeologjike, «Kuvendi il i studimeve ilire», Tiranë 1974, f. 378.

këto nuk mund të jenë të vetmet. Varfëria arkeologjike që paraqitet në këtë drejtim, gjen shpjegim nga që tej Durrësit, në rrethin e tij, nuk janë bërë ende gërmime të rregullta dhe nga që në qendrat e periudhave pasardhëse njohim pothuaj vetëm sipërfaqen.

Dihet se Epidamni u kolonizua nga grekët më 627 p.e.s.⁹² Për periudhën e parë të historisë së tij, shekujt VI-V p.e.s. njoftimi që kemi është shumë konçiz: «me kalimin e kohës Epidamni u bë i fuqishëm e me shumë banorë» thotë Tukididi.⁹³ Edhe arkeologjikisht Durrësi i asaj periudhe njihet pak; mund të themi sapo ka filluar të njihet.⁹⁴

Gjetjet në rrethin e tij që i përkasin asaj periudhe, siç pamë, janë një relief i Herakliut me mbishkrim në alfabetin arkaik të Korintit në Shijak dhe objekte qeramike që vijnë nga varreza, në Tilaj e Hajdaraj. Numri i pakët i qendrave, edhe në këtë rast, mendojmë se shpjegohet me arsyet e sipërpërmendura. Megjithatë ekzistenca e një pike kulti (siç e kemi supozuar), qoftë edhe 12 km tej Durrësit, që (nga mbishkrimi) duket se frekuentohej edhe nga banorët kolonistë të Epidamnit, është një farë dëshmie e marrëdhënieve paqësore, do të thoshnim dhe e një linje uniteti kulturor midis qytetit dhe prapatokës së tij të afërt. Është pikërisht kjo, prapatoka e afërt, që përbën një nga faktorët që e fuqizuan Epidamnin në atë periudhë, natyrisht në sajë të marrëdhënieve të mira të vendosura midis parisë së qytetit dhe aristokracisë fisnore ilire.⁹⁵

⁹² Thuc. 1, 24. Për themelimin e kësaj kolonie në një vendbanim të mëparëshëm ilir, shih Ap., B. Civ., II, 73 si dhe Stef. Byz., s.v. "Dyrrahion".

⁹³ Thuc. Po, aty.

⁹⁴ Në muzeun arkeologjik të Durrësit ruhen një numër vazosh të tipit korintik, të zbuluara në varre, që datohen në shekullin VI p.e.s.

⁹⁵ Shih për këtë mendim, shih S. Anamali, *Të dhëna mbi elementin ilir në qytetet antike Epidamn dhe Apoloni*, në «B.Sh.Sh.» 1 1956, f. 6.

Mirëpo në gjysmën e dytë të shekullit V p.e.s. këto marrëdhënie tronditen rëndë. «Thonë se për shkak të grindjeve të brendshme që patën për një kohë të gjatë midis tyre, epidamnasi u shkatërruan në një luftë me barbarët fqinjë dhe e humbën fuqinë e madhe të tyre», vazhdon Tuhididi (po aty)⁹⁶. Kjo luftë duket se merr fund me fitore për ilirët fqinjë, tek të cilët aristokracia e Epidamnit shtërngohet të kërkojë strehim, pas fitores së kryengritjes së demosit. Ata ndihmojnë për rivendosjen e pushtetit oligarqik në qytet dhe fitojnë disa të drejta, midis të cilave edhe për t'u ngulur aty. Kjo kohë dhe fillimi i shekullit të ri është dhe koha e kalimit të shoqërisë ilire në shoqëri skllavopronare, po ashtu dhe e krijimit të një formacioni shtetëror ilir.⁹⁷ Për prapatakën e afërt të Dyrrahit krijohen kushte të reja shoqërore e politike: nga njera anë, kjo zonë tani e ndien më fuqishëm vetë zhvillimin ekonomik e kulturor të Dyrrahut (që merr ky qytet sidomos që pas Luftës së Peloponezit); nga ana tjetër, mbi të tani ushtrohet gjithnjë e më tepër kontrolli i shtetit ilir, aq sa vetë Epidamni nga fundi i shekullit IV p.e.s. njeh sovranitetin e mbretit të tij.⁹⁸

Gjurmët që u përkasin shekujve IV-II p.e.s. dëshmojnë për një zhvillim relativisht të vrullshëm të jetës fshatare në afërsi të Durrësit, si dhe për një rritje të nivelit ekonomik e kulturor.

Qendrat e banuara të kësaj periudhe përfaqësohen nga mbetje fortifikimesh ilire (Zig-Xhafaj, Mlik, Lis-Patros) ose nga gjurmë

⁹⁶ S. Anamali, vep. cit. (që citon Elianin) dhe H. Ceka, *Probleme të numismatikës*.... f. 31.

⁹⁷ S. Islami, *Shteti ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare*, «Kuvendi i 1 i studimeve ilire», Tiranë 1974, f. 93.

⁹⁸ Po aty, f. 95.

të tyre (Kepi i Rodonit). Ato përfaqësohen dhe nga gjurmë ndërtimesh të zakonshme (Kepi i Rodonit, Hamallaj, Vrrin, Shkëmbi i Kavajës, Spanjo, Rreth-Greth, Bashtovë, Ballaj) si dhe nga varreza (Kepi i Rodonit, Armath, Rubjekë, Terezijë, Vrrin, Tilaj, Bardhore, Zhabjak, Vilë). Ato i gjejmë si në afërsi imediate me Durrësin (Vrrini), edhe më tej, në fushë, rrëzë kodrave apo bregut të detit. Por i gjejmë dhe në majë kodrash deri diku të largëta siç është rasti i vendbanimeve të fortifikuara. Vetë shpërndarja e gjithë këtyre gjurmëve në këtë terren gjeografik dhe prania kudo e një numri fragmentesh enësh balte qilari e transporti dëshmojnë, së pari, për një zhvillim bujqësor.

Furnizimi i këtyre qendrave të vogla fshatare me enë e vazo luksi, me figura të kuqe, ose më pas me zbukurime në reliev të tipit Megarë apo me vernik të zi e kanelyra, sigurisht bëhej nga Dyrrahu. Edhe tjegullat duket se merreshin në Dyrrah. Kjo provohet, së paku, nga fragmentet me vula të gjetura në Zig-Xhafaj e Hamallaj. Por tjegullat e Mlikut, me format e veçanta të buzëve dhe me mungesën e vulave, dëshmojnë ndoshta për një prodhimtari lokale.

Megjithëse monedha të shekujve IV-III p.e.s. deri tani, janë gjetur vetëm në Vrrin, që është dhe i vetmi vend ku është kryer një gjermim i rregullt shkëmbimi tregëtar për të gjithë këtë zonë mendojmë se tanimë kryhej nëpërmjet monedhës.

Ndikimi kulturor i Dyrrahut pasqyrohet dhe në relievet e mbishkrimet e gjetura kryesisht në Kepin e Rodonit, por edhe në Bardhore (kepi i Lagjit). Megjithatë kultura ilire e ruan origjinalitetin e saj edhe në këtë trevë kaq të afërt me koloninë më të madhe greke të Adriatikut. Pa marrë në analizë materialin qeramik, qoftë dhe sipërfaqësor, si elemente origjinale të kulturës

ilire në zhvillim mund të përmendim bustin e gruas së Shetajt në Kepin e Rodonit dhe stoli e armë ilire në Armath, Vrrin, Rubjekë.

Deri ku mund të jetë shtrirë hinterlandi i pushtetit politik të Dyrrahut, kjo është vështirë të përcaktohet, aq më tepër se kufiri i tij në epoka të ndryshme ka ndryshuar. Ai mund të jetë zgjeruar në një periudhë, ndërsa në një tjetër është ngushtuar ose likuiduar fare, siç është rasti kur vetë Dyrrahu njeh sovranitetin e mbretit ilir. Sidoqoftë, pika të tilla strategjike, veçanërisht për sigurimin e lundrimit, si Kepi i Rodonit (ku vërehen gjurmë fortifikimesh) edhe ai i Lagjit, duhet të kenë qenë nën, kontrollin e këtij qyteti për kohën që ai ruante një autonomi. Nën kontrollin e Dyrrahut ka qenë siç duket edhe Asparagu, për të cilin kemi shfaqur mendimin se duhet kërkuar në kodrinën përballë kalasë së Bashtovës.

Tjetër mendim kemi për mbetjet e fortifikimeve në Zig-Xhafaj, Mlik e Lis-Patros (Tab. II), të cilat ndodhen mbi majë-kodrash të vendosura 4-8 km larg rrugës kryesore që kalon në fushën e Kavajës dhe pranë shtigjeve e qafave që të çojnë në brendësi të vendit. Ato në Zig-Xhafaj e në Mlik duket se kanë karakter kështjellash të vogla (περιπόλιε) të destinuara për mbrojtjen e popullatës përreth në raste luftërash, mundet edhe si pika administrative e religjioze.

Mliku paraqet një mbrojtje natyrore dhe gjurmë fortifikimi të drejtuar kundër zonës së ulët, ndërsa zbulon një lidhje të lehtë me kodrat prapa që vijnë në drejtim të Pezës. Edhe kështjella në Zig-Xhafaj, me pozicionin gjeografik dhe me planimetrinë e saj, të le përshtypje se mbrohet nga zona e ulët bregdetare më tepër se sa e mbron atë. Kurse mbeturinat e mureve të tipit «barrierë» në Lis-Patros flasin qartë se kanë pasur si destinacion të

kontrollonin kalimin që vinte nga poshtë, nga lugina që e lidh me fushën e Kavajës.

Kështu, të tria këto pika me gjurmë fortifikimesh të shekujve IV-II p.e.s., duken si avanposte të drejtuara përkundrejt zonës fushore e bregdetare me prapashpinë masivin kodrinor ndërmjet rrjedhjes së mesme të Shkumbinit dhe asaj të Erzenit. Nga ky kënd vështrimi, ato duket se plotësojnë një grupim fortifikimesh ilire me ato që janë të njohura në krahun e djathtë të luginës së mesme të Shkumbinit dhe në luginën e Erzenit.⁹⁹ Në këtë rast, ky rreth i fortifikuar do të qëndronte si bërthamë e një zone më të gjerë ku shtriheshin parthinët.¹⁰⁰ Ngritja e këtij sistemi mund të shpjegohej me shtimin e rrezikut të depërtimit maqedon në brendësi të tokës ilire, veçanërisht kur ky rrezik nga fundi i shekullit IV p.e.s. ndjehet edhe në bregdet.¹⁰¹

Kemi shfaqur mendimin se fundi i fortifikimit ilir në Zig-Xhafaj do të ketë ardhur me luftërat iliro-romake ose maqedono-romake në truallin e Ilirisë. Por mundet që fortifikimet e tjera, ose edhe ai, të kenë marrë përsëri një rëndësi në mesin e shekullit

⁹⁹ N. Ceka, LI. Papajani, *Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike*, Monumentet 1, 1971; N. Ceka, *Vështrim arkeologjik mbi rrethin e Elbasanit*, Monumentet 3, 1972 dhe Gj. Karaiskaj, *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Tiranë 1981, f. 45.

¹⁰⁰ Për shtrirjen e tyre shih, N. Ceka, *Vendi dhe roli i parthinëve në Ilirinë e Jugut në shekujt III-I p.e.s.*, në «Konf. e dytë e Studimeve Albanologjike», Tiranë 1969, f. 347.

¹⁰¹ S. Islami, *Shteti ilir, vendi dhe roli i tij...*, f. 94. Lidhur me fortifikimet në luginën e Shkumbinit është shfaqur mendimi se «duhet që kemi dhe një veprimtari të organizuar nga ana e shtetit ilir kundër invazionit të shtetit maqedon të kohës së diadohëve (N. Ceka, *Vështrim...*, f. 11).

I p.e.s., kur kryengritja e fuqishme e parthinëve mori karakterin e një lufte të vërtetë.¹⁰²

Gjurmët që i përkasin periudhës së pushtimit romak na njohin me një panoramë tjetër. Një pjesë e tyre duket se kanë karakteristika të përbashkëta. Ato ndodhen në fushë ose rrëzë kodrinave a pranë bregut të detit (Rubjekë, Qerret,¹⁰³ Koxhas, Hardhishtë, Tilaj, Spanjo, Luz i Madh, Rogozhinë, Vilë, Bardhore, Spanesh). Materiali i ndërtimit i përdorur në to, tulla dhe tjegulla, veçanërisht tullat dekorative, është material i kushtueshëm për kohën dhe tregon se nuk kemi të bëjmë me rrënoja të thjeshta fshatare. (Këtë e tregon dhe varri monumental i Hardhishtës). Gjetja në to e një numri të madh fragmentesh enësh qilare dhe sidomos fragmente enësh luksi të tipit terrasigillata si dhe prej qelqi, na e përforcon këtë mendim.

Nga ana tjetër, pozicioni i tyre (si në fshatin Vilë), pajisja e tyre me banja, që mund të nënkuptohet nga prania e tullave të rrumbullakta dhe e qyngjeve prej plumbi (Vilë, Koxhas), si dhe afërsia me rrugët kryesore që i lidhnin me qytetin, janë karakteristika të njohura për vilat bujqësore romake.¹⁰⁴ Në këtë mënyrë në mbetjet e rrënojave të qendrave të sipërpërmendura jemi të prirur të shohim mbeturina vilash romake, qendra latifundesh.

Datimi i tyre fillon që mbas mesit të shekullit I p.e.s. (Vilë e Spanjo) dhe vazhdon deri në shekullin, IV (Qerret) dhe shekullin

¹⁰² N. Ceka, *Vendi dhe roli i parthinëve...*, f. 351.

¹⁰³ Këtë qendër (në pjesën e parë të këtij artikulli) e kemi datuar në shekujt I-II e.s. Kohët e fundit aty kemi gjetur një monedhë bronzë të perandorit Dioklecian, si dhe vazo, që e zgjasin kohën e saj deri në fundin e shekullit III, fillimin e shekullit IV. Edhe këtu vihen re mbeturina të theksuara të një zjarri shkatërrimtar.

¹⁰⁴ *Enciclopedia Italiana*, Roma 1937, vëll. XXX, f. 352.

V (Luz i Madh). Ato mendojmë se përbëjnë një dëshmi të grumbullimit të tokave në pak duar, në duart e latifondistëve, dhe, si rrjedhim të prishjes këtu të bashkësive të lira fshatare. Kjo ishte një nga pasojat më të rënda që solli për popullsinë e kësaj zone, ndoshta më shpejt dhe më gjerësisht se në zonat e tjera të vendit, pushtimi romak.

Tjetër karakteristikë paraqesin mbetjet e ndërtimeve të kësaj periudhe në Kryeluz, Ballaj, ndoshta dhe Gjuricaj. Nga pozicioni i tyre, nga shtrirja më e gjerë e gjurmëve, si dhe nga të dhënat burimore, kemi shfaqur mendimin se ato duhet të identifikohen me stacione rrugore.

Prapatoka e afërt e Durrësit njohu në shekullin II edhe ndërtimin e një nga veprave inxhinierike më madhështore të vendit tonë, ndoshta më madhështorja, ujësjellësi i Durrësit, me tunelin e tij të gjatë në kodrat e Arapajt dhe Rrashbullit.

Kjo zonë në këtë kohë përshkohej po ashtu nga rrugë të tilla të rëndësishme, si rruga Egnatia, dega që shkëputej prej saj në Kryeluz për të shkuar në Apoloni, rruga Dyrrah-Lis dhe rruga që ndiqte luginën e Erzenit me drejtim të Krrabës. Gjurmë të rrugës Egnatia njohëm në afërsi të Kavajës, kurse si mbetje nga rruga për Apoloni, kemi urën e Bashtovës.

Duke vështruar hartën të bie në sy shtimi në këtë periudhë i vendbanimeve veçanërisht bri rrugës Egnatia dhe degës që shkonte për Apoloni: Shkëmbi i Kavajës, Golem, Qerret, Rakull, Kavajë, Shtodhër, Kryeluz, Harizaj, Gosë, Rogozhinë dhe Luz i Vogël, Luz i Madh, Ballaj e Vilë. Siç e thamë më lart, një pjesë e tyre mund të identifikohen me stacione rrugore ose me vila latifundistësh. Por një pjesë mund të jenë thjeshtë vendbanime fshatare, të parëndësishme si stacione, ose pika me ndërtesa kulturi.

Objekte sepulkrale me mbishkrime latine (me një përjashtim të vetëm në Kepin e Rodonit) deri tani janë njohur vetëm në zonën e Kavajës, dhe këto në pika bri rrugës Egnatia. Kohë më parë është shfaqur mendimi se objekte të tilla tregojnë që në periudhën perandorake popullsia koloniale e Dyrrahut u përhap edhe në këtë fushë.¹⁰⁵ Ka shumë mundësi që pronarët e latifundëve përreth Durrësit të kenë qenë kryesisht kolonizatorë, por popullsia e stacioneve rrugore që përmendëm, si dhe masa e skllevërve apo e kolonëve që punonin në latifundet ka qënë vendase dhe ajo mbeti e paromanizuar.

Megjithëse kërkimet janë ende në hapat e para për të provuar sa thamë më lart, disa fakte nuk mund të mos vërehen. Pikësëpari të bie në sy se në të gjitha qendrat e shekujve të parë të e.s. si në stacionet rrugore, edhe në ato që i kemi quajtur Vila, qeramika e rëndomtë ruan dhe, siç dihet, ripërtërin elemente vendase, të tilla siç janë p.sh. vegjet brinake. Një vazhdimësi të traditës vërejmë edhe në stolitë ilire, siç është fibula me këmbë të përthyer e shekullit IV në Golem. Po ashtu, veglat e punës trashëgojnë tipare të periudhës paraardhëse dhe paraqesin ngjashmëri me gjetjet në qendrat e tjera të kësaj periudhe në brendësi të vendit (shih Rakull, Golem).

Një karakteristikë tjetër dëshmitare e traditës vendase ilire është dhe riti i varrimit, që në të gjitha rastet, edhe në qendrat bri rrugës Egnatia, është paraqitur vetëm me vendosje kufome, në kohën kur në Durrës ndeshet edhe ai me djegje, si rit në këtë kohë i preferuar më tepër nga romakët. Shekulli i katërt i e.s. e pasqyron në një farë mënyre krizën e përgjithshme të peran-

¹⁰⁵ L. Heuzey-H. Daumet, *Mission...*, f. 351.

dorisë romake edhe në qendrat e njohura përreth Durrësit. Kushtimin që u bëhet në Rrogozhinë dy perandorëve në fillimin e këtij shekulli, e konsiderojmë si një shprehje të shqetësimit të banorëve vendas dhe si një shpresë të tyre për ndryshimin e gjendjes nën perandorët me origjinë ilire. Gjurmët e zjarrit shkatërrimtar që vërehen bri rrugës Egnatia si në Rrogozhinë e Kryeluz, por edhe në Vila të këtij rrethi (Qerret) mund të merren si prova të shkatërrimit të tyre me dhunë ose si rezultat i ndonjë kryengritjeje të skllëvërve e kolonëve, ose si rezultat i dyndjes së parë të barbarëve në këtë trevë në çerekun e fundit të shekullit IV e. s. Saktësi me përse i përket kohës së këtyre shkatërrimeve, edhe shkaku, do të bëhen natyrisht me gërmimet e rregullta në të ardhmen.

Lulëzimi që vërehet në Dyrrah në antikitetin e vonë, shekujt V-VI e.s. pasqyrohet edhe në rrethinat e tij. Mbetje ndërtimesh të kësaj kohe janë ato që shihen në Gjericaj, në Lis-Patros, Qerret e Mlik. Kapitelet e gjetura në dy fshatrat e parë i përkasin një niveli të lartë artistik, që nuk bie aspak më poshtë nga niveli i veprave bashkëkohore të kësaj gjinie të gjetura brenda në Durrës. Fakti i vërtetimit të shkrimit greko-bizantin më parë në Kavajë se në Durrës mendojmë se dëshmon për një mjedis jo aq konservator ndaj latinishtes sa Durrësi.

Përse i përket mesjetës, kemi bashkërenditur këtu monumentet e njohura dhe disa të dhëna të reja. Por kemi lënë pa përfshirë dhe disa rrënoja kishash dhe varreza krishtere e myslimane, që mendojmë t'i paraqesim në një shkrim të veçantë.

Monumentet mesjetare që përmendëm, qofshin kala apo kisha, nga ana arkitektonike dëshmojnë për ndikime me origjinë lindore ose perëndimore, gjë që është e shpjegueshme me vetë

kushtet historike të Durrësit në mesjetë. Megjithatë në ato nuk mungojnë dhe elementet e arkitekturës shqiptare, që i vënë në unitet me veprat bashkëkohore të gjithë vendit. Veç kësaj ato paraqesin një karakteristikë të përbashkët që na duket me interes të veçantë. Në të gjitha rastet, si monumentet që ruhen në këmbë edhe ato që shfaqin vetëm gjurmë (herë-herë dhe detaje arkitektonike siç e pamë) gjenden mbi rrënoja antike ose shumë afër tyre. Këtë dukuri e pamë në Kepin le Rodonit, në Shkëmbin e Kavajës, në Qerret (të Kavajës), në Kanapare, Çetë, Lis-Patros, Mlik, në Kepin Lagjit etj. Ky fakt na duket se nuk mund të mos imerret si ripërtëritje dhe vazhdimësi e një tradite.

Nëse për fortifikimet një përputhje e tillë shpjegohet dhe me kushtet e terrenit e pozicionin gjeoigrafik, nuk ka përse të ishte medoemos kështu dhe me monumentet e kultit. Kishat e Shën Nikollës në Kepin e Rodonit dhe në Shkëmbin e Kavajës, kush-tuar shenjtorit mbrojtës të lundrimit, mendojmë se flasin për një traditë që me krishtërimin pësoi ndryshime, por nuk u mohua plotësisht. Të tilla raste kemi dhe në Kanapare, Qerret të Kavajës, Lis-Patros, Çetë, Karpën e Mlik.

Këmbana e vitit 1465, e gjetur në Karpën, ku ruhen rrënojat e një kishë mesjetare, paraqet një problem të veçantë. Vetëm 33 vjet më parë ky fshat ishte me katër shtëpi.¹⁰⁶ Po të besojmë se këmbana është inaguruar në këtë fshat vitin e prodhimit të saj, si shpjegohet zmadhimi dhe pasurimi i tij në ato vite luftërash aq sa të ndërtonte një kishë e ta pajiste me një këmbanë të madhe? Të dhënat arkeologjike në të ardhmen do të hedhin më tepër dritë


¹⁰⁶ H. Inalçik, Hicri 835 Sureti..., nahija e Izmirit.

siç duhet mbi burimet historike të periudhës së lavdishme të luftërave të popullit tonë nën udhëheqjen e Skënderbeut.


U munduam të hidhnim një vështrim mbi monumentet dhe gjurmët antike e mesjetare në territorin më të afërt me Durrësin, qyteti më i vjetër i vendit tonë, që arriti të quhej një qytet me shumë banorë që nga fundi i shekullit V p.e.s., e që në fundin e shekullit IV e.s. është kryeqendra e Epirit të Ri, metropol i Ilirikut, kryeqendra e temës së Durrësit në shekullin VIII, i vlerësuar më pas dhe si një «Kostandinopol i dytë». Në përfundim të këtij vështrimi që paraqitëm, do të thoshnim se ndërmjet këtij qyteti dhe prapatokës së tij të afërt nuk ka ekzistuar asnjë hendek ndarës. Të dhënat e hedhin poshtë mendimin e shfaqur dikur, se tej Durrësit, në fshatrat, nuk paraqitet asnjë gjurmë e qytetërimit antik.¹⁰⁷ Përkundrazi, ato vazhdojnë natyrshëm, duke filluar nga periferia e këtij qyteti deri në kufijtë e rrethit të tij administrativ që morëm në studim. Vazhdimësia e tyre është e dukshme në hapësirë edhe në kohë.

Jemi të vetëdijshëm se, nëpërmjet zbulimeve të ardhshme këto të dhëna do të vijnë duke u pasuruar e duke u sqaruar më tej.

¹⁰⁷ L.M. Ugolini, *Albania Antica*, Roma 1927, f. 170.




Tab. I



Tab. II

ZONA E KAVAJES



Tab. III

RESUME

LA ZONE DE COLLINE DE KAVAJA

Le rocher de Kavaja (Petra)

44. Céramique de la période hellénistique, des premiers siècles de notre ère et médiévale. Les traces des constructions que l'on voit au plus haut sommet, sur le revers du Rocher de Kavaja, on pense les rattacher aux restes de l'église de Shën-Nikolla, mentionnée dans les sources dès le XI^e siècle. 45. Golem. Cimetière des premiers siècles de notre ère. 46. Seferaj. Des tombes des premiers siècles de notre ère et une pierre tombale avec une souscription latine, publiée. 47. 48. Tilaj. Des tombes des siècles V-II avant notre ère et un plancher couvert de mosaïques faits avec des morceaux de tuiles, dans les premiers siècles de notre ère.

49. Kanapare. Près des ruines d'une église médiévale des tombes sans constructions couvertes de tuiles, qui de par la découverte d'une boucle d'oreille (Fig. 1) sont datées du X au XII^e siècles.

50. Spahjo; Dans la (colline de la cité l'on voit en surface des fragments de tuiles hellénistiques, dont (une porte avec le nom TAIOS, prytam eponym de Dyrrah de la moitié du I^{er} siècle avant notre ère.

51. Zig-Xhafaj. La fortification illyrienne doit être construite vers la fin du IV^e siècle avant notre ère et s'est poursuivie jusqu'au II^e siècle avant notre ère. Parmi les tuiles découvertes il y en a qui portent le nom Αριστοδομδ, prytan de Dyrrah dans les années 250 - 200 avant notre ère.

52, 53. Çetë. Dans ce village près de Kavaja, se trouve une église du XIIIe siècle qui est le seul monument qui tient debout de l'architecture romano-gothique dans notre pays.

Près de l'église ont été découvertes des tombes des premiers siècles de notre ère. Dans la place de l'autel, a été découverte une plaque tombale avec trois figures en relief et avec une souscription latine.

54. Menge. Dans la chaîne des collines en gypse, à 12 km au sud-est de Kavaja ont été découvertes quatre cavernes quart-stiques, à galeries horizontales.

55, 56. Lis-Patros. La seule issue qui monte au sommet d'un flanc (398 mètres au dessus du niveau de la mer) garde des traces de murs du type barrière, construits avec des blocs de pierres rectilignes. L'un d'entre eux porte la lettre 0.

On peut voir aussi de la céramique construite dans les premiers siècles de notre ère; on a trouvé aussi un chapiteau en pierre calcaire orné de feuilles de akanthi du Ve siècle de notre ère.

57. A environ trois kilomètres de là on y conserve un tract mural du monastère de Patros citée dans les sources du XVe siècle.

58. Mlik On y remarque des traces de constructions de la période hellénistique, des premiers siècles de notre ère allant jusqu'aux V-VIes siècles. Les restes des murs prouvent qu'elle a été fortifiée dans les IV-II siècles avant notre ère, ainsi que dans la haute antiquité.

59. Au centre on y conserve les ruines d'une église médiévale.

5. La zone de plaine de Kavaja

60, 61. *Qerret.* Entre la montagne de Robi et la mer ont été découverts les fondements d'une église et du matériel en céramique de la période paléochrétienne. On y a découvert également deux collones en marbre, L. Rey, en 1901 a découvert les fondements et a été trouvé un petit trésor avec anneau épiscopal et des monnaies médiévales. Nous sommes de l'avis que s'est précisément ici que devait se trouver l'église de Shën-Todri, citée au XI^e siècle. A proximité on constate des traces de la voi Egnatia.

62. *Rrakull.* A côté de la rue actuelle Durrës-Kavajë, ont été découvertes des parties de murs, de la céramique des premiers siècles de notre ère ainsi que des faucilles de fer.

63. Le magasin du sel, environ 4 km plus loin, est une construction de la période turque. Il a été découvert également du aqueduc en tyaux de céramique qui va en direction du bord de la mer.

64, 65. *Kavajë.* Ont été découvertes des plaques tombales avec des souscriptions latines, ainsi qu'une pierre tombale avec la souscription grecque du IV^e siècle de notre ère. Ont été découvertes également des restes de constructions des premiers siècles de notre ère.

67. *Shtodhër.* Des tombes des premiers siècles de notre ère couvertes de tuiles.

68. *Kryeluz.* Les traces des constructions antiques que l'on constate sur la rive gauche du fleuve Darç, s'étendent sur une superficie de 4 ha. Il semble qu'elles représentent la station de la rue avec XV m. p. de distance de Durrës, que à Tabula Peutingeriana manque de nom. L'effondrement de cette habitation semble être venu à cause d'une incendie.

69. Harizaj. Des tombes des premiers siècles de notre ère. On y a découverte une pièce de monnaie du grand Constantin.

72. Luz i Madh. Au milieu de la plaine qui s'étend entre les collines de Kavaja, à l'ouest, de celles de Kryevidh à l'est, pas très loin de la rive de Shkumbini fut découvert un plancher avec de petites tuiles en forme de tronc de pyramides. Le matériel de la céramique date dans les II au V^es siècles de notre ère.

74, 75. Rrogozhinë. A deux points proches près de la rue qu'on estime qu'elle suit la voie Egnatias, ont été découvertes des restes de constructions des premiers siècles de notre ère et une pierre dédicale ainsi qu'un autel tombale avec une souscription latine. La pierre semble être dédiée à l'empereur Galerius et à son neveu de même nom, qui régnèrent à la tétrarchie proclamée par Dioclétien, après son abdication.

Sont caractéristiques une typologie de tuiles petites en forme de parallépipède dont on se servait probablement pour couvrir le plancher avec le motif du dos du poisson.

6. La zona de colline de Kryevidh.

77. Karpën. Cimetière des premiers siècles de notre ère. On y a découvert une cloche en bronze qui port l'année MCCCCLXV.

79. Kalaja e Turrës au cap de Lagji nous pensons qu'il faut l'identifier au château dont il est question dans les sources, au cap de Melie.

81, 82. Hajdaraj Marteau en pierre polie, avec un trou au milieu de la période du haute néolithé. A été découverte aussi un cimetière avec une Lakrimore du V^e siècle avant notre ère. 85. Linëz. Marteau-hache en pierre polie, avec un trou, hache en fer bipène en un collier en bronze du type kafaz des VIII-VII^es siècles avant notre ère.

86. Ballaj. Des traces de constructions durant les premiers siècles de notre ère ont été découvertes à l'extrémité du sud-est de ces collines, qu'il faut identifier à la station «Genusus» qui est citée dans les sources antiques.

87, 88. Vilë. Ont été découvertes des tombes de céramiques des III-I siècles avant notre ère. Les restes d'une construction sur le flanc de Vilë des siècles les avant notre ère - au Ier siècle de notre ère nous font penser à une Villa Rustica.

89. Kodra e Gjone. Kodra e Gjone à l'est du chateau de Bashtova, garde des traces de la période hellénistique. Sa position géographique peut être identifiée à l'Asparagu, cité à la moitié du Ier siècle avant n. è.

90. Kalaja e Bashtovës. Elle doit appartenir aux années 1467-1478 par GJ. Karajskaj ne nous parait pas très convaincant. Il y a lieu de croire qu'elle a été construite un siècle avant par le féodal albanais Vlash Matranga.

91. Le pont de Bashtova. Pas très loin du chateau, sur le fleuve Shkumbini, on remarque les trois supports des arches d'un pont de la fin du III e siècle de notre ère.

CONCLUSIONS

Quant à la préhistoire, bien que les données actuelles dans cette contrée soient limitées, il est à souligner le fait qu'elles vont toujours augmentant. En tant que des trouvailles de l'occasion, elles représentent la période du néolithé moyen (prefëset e strallit à Shijak), celle du néolithé récent (les marteaux de pierre polies à Manëz, Hajdaraj), la période du bronze récent (les haches du type «albano-dalmates» à Borçë et Rrushkull) la période du fer antique (Le collier du type ojhone en bronze à

Armath, la hache bipene en fer et le collier en bronze du type «kafaz» à Bashtovë). Géographiquement les lieux de ces objets trouvés se localisent dans deux zones: dans les collines de la zone de plaine de la rive droite du cours inférieur du fleuve Erzen et dans la zone de colline qui s'élève à droite du fleuve Shkumbini sur sa rive gauche. Ces deux zones avec les petites collines jouissent de conditions favorables pour le développement de l'agriculture et de l'élevage primitif, et, en conséquence de la vie sédentaire. Ces zones se trouvent près du bord de la mer.

Les objets que nous avons cité en général forment une unité avec les cultures respectives vérifiées par les fouilles faites dans notre pays entier. Les haches de bronze et les objets de la haute période du fer témoignent davantage pour un rattachement au groupe culturel central illyrien. Mais le collier en bronze du type ojnohe aussi bien en forme que dans ses ornements, a des éléments ressemblants avec un petit récipient découvert à Gërmenj de Lushnja. De la sorte nous avons, dans notre cas concret, nous avons au moins un élément qui témoigne de la période lointaine du fer. Shkumbini n'a pas été une ligne de séparation pour les cultures développées sur ses deux rives.

Jusqu'à ce jour, comme témoignage de la culture illyrienne au seuil de la colonisation sont les objets de la haute période du fer (les VIII-VII siècles) que nous avons cités et les tumulus découverts dans la plaine de Erzeni i Poshtëm. Mais ils ne peuvent être les seuls. La pauvreté archéologique qui se manifeste en ce sens, s'explique par le fait qu'au delà de Durrës, dans ses environnements, n'ont pas encore eu lieu des fouilles régulières et que les centres des périodes qui les ont précédés. on connaît seulement la superficie.

Les trouvailles de la période archaïque dans la région de Durrës se composent par un relief de Heraclite avec un souscription de l'alphabet de Corynthe, trouvé à Shijak et les objets de céramique provenant des cimetières, de Tilaj et de Hajdaraj. Le nombre restreint des centres, nous pensons que même dans ce cas, s'explique par les mêmes arguments cités cicontre. Cependant l'existence d'un objet de culte, ne serait-ce qu'à 12 kilomètres de Durrës, de par l'inscription semble être fréquenté aussi par les habitants colonistes d'Epidam, est un témoignage et un lien d'une unité culturelle entre la ville et de son territoire tout autour de lui. C'est précisément lui, le proche territoire, qui constitue un des facteurs qui reforcèrent Epidamus, dans la période, naturellement grâce aux bonnes relations établies entre les nobles de la ville et de l'aristocratie des tribus illyriennes.

Mais durant la seconde moitié du Ve siècle avant notre ère ces relations furent lourdement secouées. «On dit, à cause des malentendus internes qu'eurent pendant bien longtemps entre eux, les habitants d'Epidamus furent détruits dans une lutte avec les barbares voisins, chez lesquels l'aristocratie d'Epidamus fut obligée de demander refuge, après la victoire de l'insurrection de démos. Ils aident à l'instauration du pouvoir oligarchique dans la ville et obtiennent certains droits, dont celui de s'y établir. Cette époque et le début du nouveau siècle est l'époque du passage de la société illyrienne en société esclavagiste, et de la création d'une formation d'était illyrien. Ainsi des conditions nouvelles sociales et politiques sont créées pour les proches environnements de Dyrrah: d'une part cette zone sent la puissance de son développement économique et culturel, et de l'autre sur lui s'exerce toujours davantage le contrôle de l'Etat illyrien,

au point que Epidam à la fin du IV siècle avant notre ère reconnaît la souveraineté de son propre roi.

Les découvertes qui reviennent aux IV-II siècles avant notre ère témoignent pour un développement relativement impétueux de la vie paysanne à proximité de Durrës, ainsi que pour un accroissement du niveau économique et culturel. Les centres habités de cette période sont représentés par des restes de fortifications (Zig-Xhafaj, Mlik, Lis-Patros) ou de leurs traces (le Cap de Rodone). Ils sont représentés par des traces de constructions normales (Le Cap de Rodone, Hamallaj, Vrrin, Shkëmbi i Kavajës, Spanjo, Rreth-Greth, Bashtovë, Ballaj) ainsi que par des cimetières (Le Cap de Rodone, Armath, Rubjekë, Terezijë, Vrrin; Tilaj, Bardhore, Zhabjak, Vilë). On les trouve aussi bien tout près de Durrës (Vrrini) que loin, dans la plaine aux pieds des collines ou au bord de la mer. Nous les trouvons également aux sommets des collines, voire assez éloignées comme c'est le cas des lieux habités fortifiés. La répartition de toutes ces traces sur ce terrain géographique et la présence un peu partout d'un nombre de fragments de récipients de cuisine et de transports témoignent en premier lieu d'un développement de l'agriculture.

Le ravitaillement de ces petits centres avec des récipients et vases de luxe, avec des images rouges, ou plus tard avec des ornements en relief du type Megarë ou bien avec du verni et des canelures était fait certainement de Dyrrah. Même les tuiles semblent être prises à Dyrrah. Cela est argumenté du moins, par les fragments et les sceaux trouvés à Zig-Xhafaj et Hamallaj. Mais les tuiles de Mlik avec les formes particulières à leurs cotés et l'absence des sceaux, témoignent peut-être d'une production locale. Cependant les montales des IV-III siècles avant notre ère

jusqu'à présent, ont été trouvées uniquement à Vrrin, qui est le seul endroit où des fouilles régulières ont été faites. L'échange commerciale pour toute cette zone nous pensons qu'il devait se faire par la monnaie.

L'influence culturelle de Dyrrah se reflète même dans les reliefs et les souscriptions découvertes surtout au Cap de Rodone, mais aussi à Bardhore (Le cap de Lagji). La culture illyrienne garde son originalité même dans cette contrée si proche de la plus grande colonie grecque de l'Adriatique. Sans prendre en analyse le matériel de la céramique ne serait-ce qu'en surface, en tant qu'éléments originaux de la culture illyrienne en développement, nous pouvons citer le buste de la femme de Shetaj au Cap de Rodone et des ornements et des armes illyriens à Armath, Vrrin et Rubjekë.

Jusqu'ou pouvait s'étendre le Hinterland de Dyrrah, cela est difficile à préciser, d'autant plus que ses frontières, dans les diverses époques ont dû changer. Il a pu s'élargir dans une époque, et dans une autre il a dû se limiter ou disparaître complètement, comme c'est le cas où Dyrrah lui même reconnaît la souveraineté du roi illyrien. Quoi qu'il en soit, de tels points stratégiques, surtout pour protéger la navigation, comme le Cap de Rodone (ou des traces de fortifications ont été découvertes) et celui de Lagji doivent avoir été sous le contrôle de cette ville durant la période qu'elle gardait encore son autonomie. Sous le contrôle de Dyrrah a du être apparamment aussi Asparagu, pour lequel nous pensons qu'il faut le chercher dans la petite colline en face du chateau de Bashtova.

Mais nous sommes de l'avis qu'il en est autrement quant aux restes des fortifications à Zig-Xhafaj, Mlik et Lis-Patros (Tab. III), qui se trouvent aux sommets des collines établies de 4 à 8

km loin de la route principale qui traverse le plaine de Kavaja et près des passages des cols qui mènent à l'intérieur du pays. Celles de Zig-Xhafaj et de Mlik semblent avoir un caractère de petits châteaux destinés à défendre la population tout autour en cas de guerre, et il se peut comme des centres administratifs et religieux.

Mlik présente une défense naturelle et des traces de fortifications dirigées contre la zone de plaine, et offre un léger lien avec les collines derrière en direction de Peza. Même le château à Zig-Xhafaj de par sa position géographique et de sa planimétrie, donne l'impression de se défendre de la basse zone maritime plus que de la défendre. Tandis que les restes des murs du type «Barrière» à Lis-Patros témoignent clairement qu'ils avaient comme destination de contrôler le passage d'en bas, avec la colline qui la relie à la plaine de Kavaja.

Ainsi, ces trois points avec des traces de fortifications des IV-II siècles avant notre ère semblent comme des avant postes dressés contre la basse zone de plaine et maritime ayant derrière le massif des collines entre le cours moyen de Shkumbini et celui d'Erzeni. Dans ce cas ce cercle fortifié résiderait comme un noyau d'une zone plus vaste où se trouvaient les partines.

La mise sur pied de système peut s'expliquer par la menace du danger de la pénétration des macédoniens à l'intérieur des territoires illyriens, surtout quand une telle menace à la fin du IV^e siècle avant notre ère pouvait venir de la mer.

Nous avons exprimé notre point de vue que la fin de la fortification illyrienne à Zig-Xhafaj doit être issue des guerres Illyro-romaines ou macédoino-romaines sur le territoire de l'Illyrie. Mais il se peut que les autres fortifications, même celle-ci aient pris une importance à la moitié du I^{er} siècle avant notre

ère quand la puissante insurrection des parthines prit le caractère d'une véritable guerre.

Les traces qui appartiennent à la période de l'occupation romaine nous présentent un autre panorama. Une partie semble avoir des caractéristiques communes. Elles se trouvent dans les plaines ou aux pieds des collines et près du bord de la mer (Rubjekë, Qerret, Koxhas, Hardhishtë, Tilaj, Spanjo, Luz i Madh, Rrogozhinë, Vilë, Bardhore, Spanesh). Le matériel pour leur construction, les briques et les tuiles, surtout les briques décoratives, est un matériel coûteux pour l'époque et prouve qu'il ne s'agit pas de simples ruines paysannes. En témoigne la tombe monumentale de Hardhishta). La découverte ici d'un grand nombre de récipients de cuisine et surtout des récipients de luxe du type Terrasigillata ainsi que des récipients en verre, vient renforcer cette idée.

D'autre part leur position comme dans la village Vile, leur équipement avec des bains, qui peut être sousentendu de l'existence des briques rondes et des tuyaux de plomb (Vilë, Koxhas), ainsi que leur proximité près des rues principales qui les liaient à la ville, sont des caractéristiques connues pour les villas agricoles romaines. De la sorte des découvertes dans les ruines des centres précités, nous avons tendance à voir des restes de villas romaines, des centres de latitudes.

Leur datation commence après la moitié du I^{er} siècle a. n. ère. (Vilë, Spanjo) et se poursuit jusqu'au IV^e siècle a. n. ère. (Qerret) et au V^e siècle (Luz i Madh). Nous avons lieu de croire qu'ils forment un témoignage de la concentration en peu de mains des terres, dans les mains des latifondistes et, en conséquence de la destruction ici des communautés libres paysannes. Ce fut une des plus lourdes conséquences qui entraînèrent pour la popula-

tion de cette zone plus vite que pour une autre et à plus vaste échelle que dans les autres zones l'occupation romaines.

Une autre caractéristique présentent les restes des constructions de cette période à Kryeluz, Ballaj et il se peut aussi à Gjericaj. De par leur position, de la plus grande répartition des traces, ainsi que des données des informations, nous avons exprimé le point de vue qu'il faut les identifier aux stations des routes.

Les proches environs de Durrës connurent au I^{er} siècle la construction d'une oeuvre ingénieurique grandiose, peut-être la plus grandiose, l'aqueduc de Durrës avec le long tunnel dans les collines d'Arapaj et Rrashbull. Cette zone était parcourue par des voies importantes comme celle Egnatia, sa branche qui se détachait à Kryeluz pour aller en direction de l'Apolonie, la rue Dyrrah-Lis et la voie qui suivait la vallée d'Erzen en direction de Krraba. Des traces de la voie Egnatia furent découvertes aussi à proximité de Kavaja, et comme des restes de la rue d'Apolonie nous avons le pont de Bashtova.

En regardant la carte on est frappé par l'accroissement des habitats surtout tout au long de la voie Egnatia et de la branche qui menait en Apolonie (Shkëmbi i Kavajës, Golem, Qerret, Rrakull, Kavajë, Shtoshër, Kryeluz, Harizaj, Gosë, Luz i vogël, Luz i madh, Ballaj et Vilë). Comme nous l'avons déjà dit une partie peut être identifiée aux stations de la route ou aux villas des latifondistes. Mais une partie peut-être aussi simplement des habitations paysannes ou des centres ou des objets de culte.

Des objets de sépulture avec des souscriptions latines (à une seule exception au Cap de Rodone) jusqu'à présent ont été découverts dans la zone de Kavaja et cela tout au long de la voie

Egnatia. Il y a de cela bien tu temps qu'on avait exprimé le point de vue selon lequel de tels objets prouvent que durant la période de l'empire la population coloniale de Dyrrah s'étendit aussi sur la plaine. Il est foret possible que les latifondistes aux environs de Durrës aient été des colonisateurs, mais la population des stations de route que nous avons mentionnées, ainsi que la masse des esclaves ou des colons qui travaillaient dans le latifundis, a été autochtone et ne fut pas romanisée.

Bien que les recherches soient encore à leurs débuts, pour pouvoir argumenter ce qui a été déjà dit ci-contre, on ne peut pas ne pas remarquer certains faits. D'abord ce qui frappe aux yeux c'est que tous les centres durant les premiers siècles de notre ère ainsi que les stations des routes et ceux que nous avons nommés Vila, la céramique garde et, comme on le sait, rénove des éléments autochtones. Nous constatons une continuité de la tradition même dans les ornements illyriens, comme c'est la fibula avec la jambe courbée du IV^e siècle à Golem. De même les outils de travail gardent des traits de la période qui les précède et présentent des approches avec les découvertes dans les autres centres de cette période à intérieur du pays (voir Rrakull, Golem).

Une autre caractéristique qui témoigne de la tradition autochtone illyrienne est le rite de l'enterrement, qui dans tous les cas, même tout au long de la voie Egnatia, s'est présentée seulement avec le placement du cadavre à une époque ou à Durrës on le faisait aussi bruler, un rite plutôt préféré par les romains.

Le V^e siècle de notre ère reflète en quelque sorte la crise générale de l'empire romain même dans les centres aux environs de Durrës. Les traces du feu dévastateur on les constate longeant

le voie Egnatia comme à Rrogozhine et Kryeluz, mais aussi à Vila de cette région, (Qerret) peuvent être prises comme des preuves de leur destruction par la violence ou par la suite d'une insurrection et des esclaves et des colons, ou comme le résultat des affuts premiers des barbares dans cette contrée au dernier quart du Ve siècle de notre ère. Des précisions quant à l'époque de ces destructions, ou de leurs causes, vont être données par la suite des fouilles régulières dans l'avenir.

Le progrès que l'on voit à Dyrrah dans la haute antiquité les V-VIes siècles de notre ère, se reflète même dans ses alentours. Des restes de constructions de cette époque sont constatés aussi à Gjericaj, Lis-Patros, Qerret et Mlik. Les chapiteaux trouvés dans les deux premiers villages appartiennent à un haut niveau artistique, qui n'est point au-dessous des oeuvres de cette même époque et de ce genre découvertes à Durrës. Le fait de la reconnaissance de l'écriture greco-byzantin d'abord à Kavajë et ensuite à Durrës nous pensons qu'elles témoignent d'un environnement pas aussi conservateur face au latin que celui de Durrës.

En ce qui concerne le moyen-âge, nous avons mis ensemble ici les monuments connus et quelques nouvelles données. Mais n'y sont pas comprises aussi quelques ruines d'églises et des cimetières de chrétiens et musulmans, que nous comptons présenter dans une étude à part.

Les monuments du moyen-âge, ainsi que les monuments qui sont debout et ceux qui ont leur traces (parfois même des détails architectoniques comme nous l'avons vu) se trouvent sur les ruines antiques ou tout près d'elles. Nous avons vu ce phénomène au Cap de Rodone, au Shkëmbi i Kavajës, à Qerret (Kavajë), à Kanapare, Çetë, Lis-Patros, Mlik; au Cap de Lagji etc.

Si pour les fortifications une telle conformité aussi par les conditions du terrain et de la position géographique, il ne pouvait pas ne pas en être ainsi pour les objets du culte. Les églises de Shën-Nikolla au Cap de Rodone et au Shkëmbi i Kavajës, dédiées au saint de la défense de la navigation, nous pensons qu'elles parlent d'une tradition qui avec la christianisations subit des modifications, mais ne fut pas renié complètement. De tels cas nous avons à Kanapare, Qerret de Kavaja, Lis-Patros, Çetë, Karpën et Mlik.

Notre but était de donner un aperçu sur les monuments et les traces antiques et du moyen-âge sur les proches environs de Durrës, sur la ville la plus ancienne de notre pays; qui réussit à devenir une ville de beaucoup d'habitants dès la fin du Ve siècle avant notre ère, et que, à la fin du IVe siècle de notre ère fut le chef-lieu du Nouveau Epire «Metropole de l'Illyrie», le chef-lieu de la contrée de Durrës au Ville siècle, estimé par la suite comme un «second Constantinople». A la fin de cet aperçu que nous avons présenté, nous voudrions dire qu'entre cette ville et ses environs proches il n'y a pas existé d'obstacles qui les séparait. Les données rejettent la thèse exprimée avant comme quoi au delà de Durrës il n'y a pas de traces de la civilisation antique. Tout au contraire cette civilisation se poursuit naturellement, allant de la périphérie de cette ville jusqu'à ses frontières administratives. Leur continuité est manifeste en espace et dans le temps.

III

RAPORTE GËRMIMESH

(RAPPORTES DE FOUILLES)

Gërmimet arkeologjike të vitit 1984

DURRËS KËNETË*

Gërmimi i ndërmarrë në shtatorin e vitit 1984 në Kënetën e Durrësit përbënte një vazhdim të gërmimeve të shpëtimit të bëra më parë nga Muzeu Arkeologjik i Durrësit. Shtresa kulturore që në këtë pikë fillon menjëherë në sipërfaqe dhe që, vende-vende, është prekur rëndë nga punimet bujqësore, arrin thellësinë 0,60-0,75 m. Deri tani është zbuluar një sipërfaqe prej 300 m². Kanë dalë në dukje mbeturina themelesh, xokolatura muresh, platforma e pjesë dyshemesh.

Pjesët e mbetura të themeleve e xokolaturave, që kanë gjerësi deri 0,80 m, janë ndërtuar me gurë mesatarë e të vegjël, të punuar pjesërisht pa lidhje llaçi. Interes paraqet një platformë pothuaj drejtkëndëshe, me gjatësi 7,80 m, gjerësi 2,15 m dhe lartësi 0,35 m. Kjo platformë faqet anësore i ka prej gurësh shtufi e konglomerat të punuar, që kanë forma pak a shumë të rregullta. Sipërfaqja e platformës të lë përshtypjen se është e dystë dhe ka funksionuar me këtë lartësi që ruan.

Të ngjashme me këtë konstruksion janë dhe ato që i kemi emëruar me numrat 8, 11, 13. Në anën jugperëndimore të platformës së parë 9 dhe në anën verilindore të asaj 8 janë gjetur dy

* Marrë nga revista "ILIRIA", Nr.2, 1984, f.267-268.

blloqe gurësh kuadratikë të latuar bukur nga të gjitha anët (0,84 x 0,84 x 0,28), tek njeri prej të cilëve shihen më qartë shenja të mbivendosjes së një kolone.

Si lëndë arkeologjike, në gjithë sipërfaqen e zbuluar, përmendim një shumicë fragmentesh tjegullash solene e kaliptere të tipave të njohur në shekujt IV-II p.e.sonë. Një fragment i vogël soleneje përmban vulën  Janë zbuluar një numër fragmentesh enësh shtëpiake. Janë gjetur dhe 30 monedha bronz, ndër të cilat dallohen disa të Dyrrahut të tipit Herakli-armë.

Duke u bazuar në mbetjet e kësaj ndërtese dhe në materialin arkeologjik që është përfutur deri tani, shprehim mendimin se kemi të bëjmë me një banesë të shek. III p.e.sonë, të ndërtuar ndoshta në fundin e shek. IV p.e.sonë, ku me sa duket, përzihen dy duar ndërtimi.

Gërmimet arkeologjike të vitit 1986

DURRËS-KËNETË*

Gjatë vitit 1986 u zbulua plotësisht monumenti në Kënetën e Durrësit. Konstruksioni i tij përbehet nga një pedestal në trajtë piramidale (me buzën e poshtme 3,70 x 3 m, të sipërmen 1,60 x 1,50 m dhe lartësi 1 m), i pajisur nga tri anë me nga tri këmbëshkallë (Fig. 1). Në anën jugore të tij, pak i shkëputur, por mbi të njëjtën platformë, qëndron një bllok kuadratik (0,84 x 0,84 x 0,53 m). Në një distancë prej 3,50 m po në këtë anë të pedestalit u zbulua një krepidomë e vogël me gjatësi 1,10 m dhe lartësi 0,85 m. Blloku i sipërm i saj ka përbërë stilobatin e një kolone dorike që u gjet e shtrirë në anën lindore të tij së bashku me kapitelin përkatës. Lartësia e kolonës është 3 m, diametri i bazës së poshtme 0,38 m, i të sipërmes 0,28 m. Trungu i saj është i zbukuruar me 16 kanelyra. Kapiteli përbëhet prej një qafe të shkurtër me numër të barabartë kanelyrash me kolonë. Gjetja pranë edhe e një kapiteli tjetër identik na ka nxitur të supozojmë se në gjendjen e rregullt të monumentit numri i kolonave do të ketë qenë dy. Tiparet arkaike i datojnë kapitelet në fundin e shek. VI ose në fillimin e shek. V p.e.sonë.

* Marrë nga revista "ILIRIA", Nr. 2, 1986, f.257.

Si piedestali i shkallëzuar edhe krepidoma janë ndërtuar prej blloqe gurësh travertinë kuadratikë, të latuar dhe të skuadruar bukur (0,63 x 0,48 x 0,35 m; 0,88 x 0,48 x 0,35 m), puthitur njëri me tjetrin sipas teknikës së thatë dhe lidhur me anë kllapash plumbi.



Fig. 1

Mendojmë se kemi të bëjmë me një altar flijimi, të cilin e ndeshim për herë të parë në vendin tonë.

Mjedisi që përmban altarin e flijimit kufizohet nga ana lindore prej një muri të ndërtuar me gurë të vegjël të çrregullt e baltë, i gjatë 8,30 m, i gjerë 1,10 m dhe me lartësi që arrin atë të nivelit të këmbëshkallës së mesit tek piedestali. Ky duket se është një mur tarracimi i ndërtuar në një kohë të mëvonëshme, me qëllim për të mbështetur dhe zgjeruar sheshin e vogël përreth altarit.

Në anën J-P, P dhe V të mjedisit që përmendëm zgjaten dy mure që janë ndërtuar prej gurësh të vegjël e mesatarë gjysmë të punuar, me faqe të prira për kuadratike, të lidhura në të thatë.

Stratigrafia vertikale e përftuar nga kuadratet që u hapën, paraqet dy nivele dhe dy duar kryesore ndërtimi. Niveli më i hershëm është ai i altarit të flijimit, në thellësinë 1,10 m. Materiali arkeologjik që lidhet me këtë nivel, shumë i pakët, përfaqësohet nga fragmente tjegullash të holla të ngjyrosura në faqe, nga një kapak i qeramikës atike me vernik të zi me shkëlqim blu i shek. V p.e. sonë, nga një terrakotë që tipologjikisht datohet në shek. VII-VI p.e.sonë etj.

Niveli më i vonë përfaqësohet nga konstruksionet e tjera që shtrihen në thellësinë 0,60-0,80 m. Materiali arkeologjik i kësaj shtrese ishte shumë i pasur, i përbërë nga fragmente qeramike të shek. IV-III p.e.sonë, nga gozhdë bronzë e hekuri, nga monedha bronzë shumë të dëmtuara, prej të cilave ka edhe dyrrahase të tipit Herakli.

Praktikisht jemi të mendimit se kemi të bëjmë me një sanktuar të ndërtuar në fushë, jo shumë larg portave të qytetit dhe bregut të detit, që, me sa duket, u drejtohet më tepër njerëzve të periferisë së qytetit, të horës së tij të afërt, ndoshta dhe zonës fshatare fqinje.

Gërmimet arkeologjike të vitit 1987

DURRËS – QYTET*

Sondazhi arkeologjik pranë shkollës «16 Shtatori» në qytetin e Durrësit u krye në një shesh të vogël, 6,30 m mbi nivelin e detit, në një distancë prej vetëm 43 m nga linja V-L e rrethojës mesjetare. Këtu u piketuan tri kuadrate, prej të cilëve njëri u thellua deri 5 m, pa mundur të arrihej shtresa sterile, për shkak të ujit që filloi të buronte në sasi të konsiderueshme që në thellësinë 4,60 m.

Me gjithë njëfarë përzierjeje të materialit arkeologjik, të shkaktuar nga një pus i hapur në kohët e vona, në kuadratin 1 u bë i mundur sqarimi i stratigrafisë vertikale në profilin V-L, që është edhe më përfaqësuesi i këtij gërmimi. U dalluan katër shtresa kulturore me gjashtë nivele banimi.

Shtresa më e hershme, që u zbulua në thellësinë 4-5 m, përbëhet nga dhé argjilo-ranor me depozitime të shekujve I-III të e. sonë. Materiali qeramik përbëhet kryesisht nga gryka dhe funde amforash; këtu bëjnë pjesë edhe gryka amforash me buzë të përveshura nga jashtë në trajtë «golfi» e ndonjë fragment terrasigilata, që datohen në shekujt I p.e.sonë - I e. sonë.

* Marrë nga revista "ILIRIA", Nr. 2, 1987, f. 250-251.

Këto depozitime kufizohen lart nga një shtrojë tullash me trashësi 8 cm, të vendosura mbi një shtresë llaçi gëlqeror të bardhë në gri me kokrriza të trasha rëre. Sipër këtij niveli është formuar një shtresë dheu argjilor-humusor me ngjyrë të errët, me trashësi 1,20-1,40 m, që përmban depozitime të shekujve IV-VI-VII të e.sonë dhe varre, me sa duket, të fundit të kësaj periudhe. U zbuluan gjithsej 5 varre, prej të cilëve njëri me muraturë, ndërsa katër të tjerët të mbuluar me tjegulla në trajtë kulmi çatie. Hapësira e varrit të parë (2,50 x 1,70 x x 0,80 m) ishte e ndërtuar me gurë plloçakë të lidhur me llaç gëlqereje dhe lart ishte e mbuluar me qemer tullash (33 x 24 x 3 cm). Ky u gjet i grabitur, me qemerin të prishur, pa skeletin, me përjashtim të pak kockave dhe pa inventar. Orientimi i tij ishte L-P. Edhe varret e mbuluara me tjegulla kishin po këtë orientim dhe qenë pa inventar. Thegullat ishin të sheshta, me buzët pak të harkuara nga brenda dhe të zbukuruara në shpinë me vija paralele e të valëzuara.

Në materialin arkeologjik të kësaj shtrese përmendim një gjysmë kallëpi kandili balte të tipit «naviçelë», me diskun të zbukuruar me një qen apo ujk në relief, një kupë të tipit piksidë, gryka amforash, një pjesë fibule bronzi në trajtë violine, si dhe tri monedha bronzi të Krispit (317-326), Valensit (364-387) dhe Tiber Konstantinit (578-582).

Shtresa e sipërme karakterizohet nga dheu argjilor humusor me pak përmbajtje ranore. Kjo përmban mbeturina të theksuara rrënojash dhe qeramikë të shekujve XI-XV. Karakteristike është një brokë me trup barkosh, fund të sheshtë e qafë trungkonike, e zbukuruar në pjesën e sipërme me breza kanelyrash të drejta e të valëzuara dhe tufa thonjzash që alternohen. Qeramika e gla-

zuruar e kësaj shtrese përfaqësohet nga një gamë e gjerë motivesh zbukurimi të realizuara me pikturim ose me teknikën e sgrafitos me ngjyrat jeshile, bizele, të verdhë, kafe. Ndër motivet e zbukurimit bëjnë pjesë dredhëza spiralike, motivi i grilës, ai i rrjetës, i valëve, si dhe motive të stilizuara nga flora e fauna: lule, gjethe, peshq, shpendë. Në këtë shtresë u gjetën dhe një monedhë bronzi e Aleksit I Komnen (1081-1118) dhe një monedhë anonime e perandorëve latinë (1204-1261).

Shtresa e sipërme e sipërme kulturore që fillon menjëherë nën sipërfaqe dhe vazhdon deri në thellësinë 1,60-1,80 m, përmban dy nivele banimi të përfaqësuara nga themele të rëndomta, si dhe objekte të tjera të datueshme në shekujt XVIII-XIX

Gërmimet arkeologjike të vitit 1988

GJURICAJ, SHKËMBI I KAVAJËS (DURRËS)*

Në fshatin Gjuricaj, mbi faqen e një kodrine të butë që njihet me mikrotoponimin Pazare, rreth katër km në J-L të kalasë së Ishmit dhe jo më tepër se 300 m nga bregu i lumit, vitet e kaluara, nga punimet bujqësore janë zbuluar herë pas here objekte arkeologjike. Ndër këto bëjnë pjesë një bazament i vogël i një monamenti mbivarror me mbishkrim dhe një pjesë stele mermeri e shek. IV-III p.e.s., po ashtu dhe dy kapitete mermeri dhe një impost me kryq të shek. V-VI të e. s.

Me një sondazh që u krye këtë vit, u hasën që në fillim trakte muresh, linjat e të cilave u ndoqën me anë transhesh. Një mur (A), me shtrirje L-P, i ruajtur pjesërisht në lartësinë e dy-tri radhëve tullash dhe pjesërisht vetëm në themelet, u ndoq në një gjatësi deri 30m. Gjerësia e tij është 0,95m. Themeli përbëhet nga gurë të çrregullt me shumë llaç, kurse muratura mbi sipërfaqe nga tulla kuadratike (36 x 29 x 4,5 cm), të vendosura në rreshta të rregullta dhe të lidhura me llaç gëlqeror që përmban copra tullash të thërrmuara. Fugaturat horizontale kanë një trashësi prej 5 cm. Në disa tulla shihen stampa në reliev në formë të kryqit, ndërsa në disa të tjera në formë të një ylli gjashtëcepësh.

* Marrë nga revista "ILIRIA", Nr. 2, 1988, f. 266-267.

Një mur tjetër (B), i ndërtuar me të njëjtin lloj materiali ndër-timor dhe me të njëjtën teknikë, del pothuaj në mesin e të parit dhe ndjek një linjë pak të harkuar V-J, me gjatësi 18 m, duke pasur brenda tij dy porta të baraslarguara. Në skajin jugor ky puqet me një mur (E) paralel me murin e parë (A), që ruhet në lartësinë 1,30m. Tek ky mur u zbulua një portë me gjerësi 1,40m. Me transhetë e hapura për ndjekjen e këtyre mureve, në anën e brendshme, u hasën pjesë dyshemesh të shtruara me tulla.

Si material arkeologjik të përfutur nga sondazhi ynë përmendim një pllakë ikonostasi të fragmentuar (1,80 x 0,87m). Në njërën faqe kjo është zbukuruar me monogramin e Krishtit, ndërsa në faqen tjetër me tri kryqe në reliev. U gjetën dhe një pjesë tjetër pllake ikonostasi, pjesë kolonash mermeri, fragmente kapitelesh e kornizash mermeri, si dhe një kryq hekuri me përmasa të vogla.

Duke u mbështetur në këto të dhëna mund të themi se kemi të bëjmë me një kishë paleokristiane, gjë që do të vërtetohet përfundimisht me gërmimin e plotë në të ardhmen.

Në Shkëmbin e Kavajës u gjurmuar mbetjet e një kishe mesjetare që përmendet në burimet. Si vend më premtues u zgjodh maja e rumbullakët dhe e butë në kurrizin e këtij formacioni (105 m mbi nivelin e detit), që ruan mikrotoponimin Qisha.

Dy transhe të vogla, që u hapën në periferi të sheshit të vogël të krijuar në këtë lartësi, dhanë mori fragmentesh tullash dhe tjegullash mesjetare, copëra llaçi gëlqeror, gurë të përdorur në ndërtim dhe fragmente detajesh arkitektonike. Midis këtyre të fundit bëjnë pjesë një fragment i vogël kapiteli mermeri i zbu-

kuruar me gjethe akanthi dhe një pjesë pllake guri gëlqeror me dekoracion në relief.

Në pjesën qendrore, ku maja e kodrës ruan lartësinë origjinale, në thellësinë 1,10m, u has një trakt muri dhe gjashtë varre. Muri ruhet vetëm në një radhë gurësh. Ai e ka gjatësinë 3m dhe gjerësinë 0,80m.

Varret ishin të gjitha të tipit me gropë. Tek disa paraqitet një konstruksion tepër i pjesshëm si ndonjë tullë a pjesë tjegulle e harkuar që mbulon vetëm kokën. Skeletet u gjetën të shtrira në shpinë, me krahët të kryqëzuar mbi gjoks. Drejtimi i tyre ishte L-P, me kokën nga perëndimi. Si inventar u zbuluan filxhana qelqi të fragmentuar, gozhdë hekuri dhe dy monedha bronzi të prera nga mbreti i Siçilisë, Manfredi, në vitet 1258-1259.

Në përfundim, mund të themi se materiali i zbuluar dëshmon tërthorazi se mbi Shkëmbin e Kavajës, së paku gjatë mesjetës së mesme, ka ekzistuar një ndërtesë, me shumë mundësi kulti, pranë së cilës në çerekun e tretë të shek. XIII janë bërë varrime.

Gërmimet arkeologjike të vitit 1989

GJURICAJ (DURRËS)*

Gërmimi i këtij viti në Gjuricaj, mbi bregun e majtë të Ishmit, ishte vazhdim i sondazhit të vitit të kaluar. Gjatë kësaj fushate gërmimi u zbulua pjesa më e madhe e monumentit. Është një kishë e tipit bazilikal, njëkonke, trinefshe, me absidë në anën lindore, me narteks dhe atrium në anën perëndimore. Ajo ka gjatësi 43,50 m (me gjithë absidën 47 m) dhe është 20 m e gjerë. Nga monumenti ruhen në një gjendje relativisht të mirë një pjesë e mureve, dyshemetë dhe disa detaje arkitektonike prej mermeri.

Kisha është ndërtuar me muraturë guri dhe breza prej pesë radhë tullash të lidhura me llaç gëlqeror. Tullat, me formë katërkëndëshe (34/36 x 27/29 x 4,5 cm), mbajnë në faqe stampa në trajtë kryqi dhe ylli gjashtëcepësh në reliev të cekët. Llaçi, i gatuar me gëlqere, i përzier me rërë të trashë dhe copëra të thërrmuara qeramike, formon fugatura horizontale me trashësi 6-7 cm. Trashësia e mureve është 0,9 - 1 m. Muri absidal, muret anësore si dhe muri perëndimor i narteksit përforcohen në anën e jashtme me kontraforte.

Naosi ndahet nëpërmjet katër pilastrash masivë (2.10 x 1.90m) në tri nefe, qendrori më i gjerë. Dy pilastrat e anës veriore si dhe ata të anës jugore, që ruhen në lartësi 0.60 – 1.40 m, janë lidhur

* Marrë nga revista "ILIRIA", Nr. 2, 1989, f. 298-299.

ndërmjet tyre me anë parapetesh të gjera, që ngrihen deri 0.30 m mbi nivelin e nefit qendror, në dy anët e absidës, duke plotësuar kështu ndarjen e nefeve. Dyshemeja e nefit qendror ruan pjesë të shtruara me pllaka mermeri dhe me tulla. Nefet anësorë janë shtruar me tulla.

Absida gjysmërrethore ka diametër 7 m në anën e brendshme dhe të jashtme. Narteksi, 3.50 m i gjerë, komunikon me sallën e naosit nëpërmjet një porte qendrore (3 m të gjerë) dhe një ose dy portave anësore më të ngushta. Nëpërmjet tri portash të tjera narteksi komunikon me atriumin, i zbuluar pjesërisht. Në anën jugore një portë tjetër të çon nga narteksi në një mjedis tjetër, gjithashtu ende i pazbuluar. Në naos hyhet po ashtu nga një portë në murin verior. Një pjesë e portave ruan pragje prej pllakash të trasha guri gëlqeror.

Mbi dyshemetë u gjetën detaje arkitektonike prej mermeri, si kolona (të fragmentuara), baza, kapitele, imposte, pllaka ikonostasi, e pllaka të tjera me dekoracion e reliev. Kapitelet janë dy tipesh: të tipit të quajtur "teodosian" dhe të tipit me gjethe ankanthi lëkure. Kolonat cilindrike kanë diametër 0.38 m e 0.32 m.

U zbulua gjithashtu një numër gurësh mozaiku shumëngjyrësh prej brumi qelqi, por edhe prej guri të kuq e prej mermeri të bardhë. Po ashtu janë gjetur edhe fragmente të vogla afresku.

Me sa shihet nga trashësia e mureve dhe nga katër pilastrat masivë të vendosur në formë katrori në qendër të naosit, bazilika do të ketë qenë e mbuluar me qemer që përfundonte me kupolë në qendër. Këto të dhëna arkitektonike si dhe teknika e ndërtimit e datojnë atë në çerekun e dytë të shek. VI të e. sonë. Muret e saj janë dëmtuar nga një tërmet i fuqishëm. Materiali arkeologjik i

mblledhur mbi dyshtemenë e bazilikës, i shoqëruar me një mone-dhë të Justinianit I (prerje e vitit 542) dëshmon se ajo nuk ka pasur një jetë të gjatë në gjysmën e dytë të sheku. VI të e.sonë.

Në një kohë më vonë, brenda nefit qendror është adoptuar një kapelë me përmasa moderne (6.10 m x 4.50 m), me një absidë të vogël në skajin J-L të absidës së bazilikës dhe me një portë perëndimore. Muret e saj, të ruajtura në lartësi mbi 1m, janë ndërtuar me gurë të çrregullt, herë-herë me faqe kuadratike të punuar dhe me rreshta jo të plotë tullash të lidhura me baltë, përzier me copëra llaqi gëlqeror nga të monumentit. Në mura-turën e kapelës janë vendosur si material i ripërdorur edhe frag-mente kolonash, kapitele, e baza mermeri.

Në vend u gjetën edhe objekte që datohen në periudhën helenistike, në shekujt e parë të erës sonë si dhe në mesjetën e mesme e të vonë.

Gërmimet arkeologjike të vitit 1990

GJURICAJ-ISHËM (DURRËS)*

Me fushatën e këtij viti u synua zbulimi i plotë i atriumit të kishës, që është një bazilikë trinefshe, me absidën në anën lindore dhe me narteks e atrium në anën perëndimore.

Atriumi ka një plan katror me përmasa 1x17 m dhe kufizohet nga të katër anët me mure guri të lidhura me llaç gëlqeror, që përshkohen nga pesë radhë tullash. Trashësia e mureve është 0,9 m, ndërsa lartësia e mbetur e tyre arrin nga 1,2 deri në 1,9 m. Materiali dhe teknika e ndërtimit në përgjithësi janë të njëjtë me ato të pjesëve të tjera të monumentit, të zbuluara në vitin e kaluar. Tullat kanë formë katërkëndëshe me përmasa 35 x 27 x 4 dhe 38 x 29 x 5 cm. Tjegullat janë të tipit solene me buzën pak të ngritur dhe kaliptere me kurrizin të harkuar e të zbukuruar me tufëza hullish të valëzuara, të bëra me gishta para pjekjes. Llaçi përmban thërrmija qeramike dhe formon fugatura horizontale me trashësi 5-6 cm.

Brenda atriumit, në një distancë 3,20 m prej mureve, u zbuluan pilastrat e një portiku me plan katërkëndësh (12,5 x 11 m). Linjat e tij në anën veriore dhe atë jugore përbëhen nga pesë pilastra, kurse në dy linjat e tjera numri i tyre është katër. Pilas-

* Marrë nga revista "ILIRIA", Nr. 2, 1990, f. 277.

trat kanë prerje katërkëndëshe (1,40 x 0,60 m), me përjashtim të atyre në skajin V-P dhe atë J-P që janë në trajtën e shkronjës L. Këta janë ndërtuar me tulla dhe llaç gëlqeror. Lartësia tyre është 0,85 m.

Pranë njërës pilastër u gjet një pulvino mermeri i zbukuruar në njërën faqe me kryq në relief. Pranë një tjetri u gjet një kapitël mermeri i tipit «theodosian», i ngjashëm me tri kapitelet e tjera të zbuluara vitin e kaluar.

Gjurmë të shtrimit të dyshemesë së portikut nuk janë gjetur, me përjashtim të sipërfaqeve të ngushta midis pilastrave, që janë të shtruara me pllaka guri e tulla.

Në atrium hyhet nëpërmjet një porte në anën veriore dhe një tjetre në anën jugore. Kjo e dyta komunikon me një aneks në këtë anë të atriumit, ende të pazbuluar plotësisht. Brenda këtij mjedisi u zbuluan katër harqe masive të rrëzuar, që ishin ndërtuar me tulla. Me sa duket, kemi të bëjmë me një hajat, që përcakton në këtë anë edhe hyrjen kryesore për në kishë. Në këtë aneks, po ashtu edhe brenda atriumit, u zbuluan varre mesjetare.

Shtresa kulturore në pjesën e poshtme, që fillon menjëherë mbi dyshemenë e monumentit, midis materialit të rrënuar përmban fragmente qeramike të shekujve V-VI të e.s. Në të u gjetën dhe disa kryqe hekuri, një enkolpion bronzi, një numër flakonësh qelqi të fragmentuara, gozhdë hekuri dhe një monedhë bronzi e Anastasit I. Në pjesën e sipërme, që përbëhet nga mbushje të mëvonshme, u gjetën fragmente qeramike mesjetare dhe disa monedha bronzi e argjendi të shek. XII-XV.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Myrto, Halil,

Kërkime arkeologjike dhe historike:
(përmbledhje artikujsh shkencorë) / Halil Myrto;
përzgjedhi e redaktoi Afrim Hoti.

Durrës: Jozef, 2025.

400 f. ; 14,5x 20,5 cm.

ISBN 9789928940568

1.Arkeologjia 2.Historia 3.Studime 4.Shqipëri

902/904(496.5) (081)